




**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË**

**DISERTACION**

**Tema: ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I KOMUNAVE DAJT DHE BËRZHITË**

*(studim krahasues)*

**në kërkim të gradës shkencore “Doktor”**



**DOKTORANTE**

**UDHËHEQËS SHKENCOR**

**MA. Albana KOSOVRASTI**

**Prof.dr. Sabri LAÇI**

**Tiranë 2014**

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	ix
▪ Qëllimi dhe objektivat e studimit	
▪ Metodologjia e studimit	
▪ Hipoteza e punimit	
▪ Studime dhe botime për komunat Dajt dhe Bërzhitë	

## KAPITULLI I

### KONCEPTI DHE PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

I.1 Historia dhe përmbajtja e konceptit “zhvillim i qëndrueshëm”.....	1
I.1.1 Koncepti "zhvillim i qëndrueshëm".....	2
I.1.2 Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.....	4
I.2 Zhvillimi i qëndrueshëm rural në Shqipëri .....	5
I.2.1 Karakteristikat e zhvillimit rural në Shqipëri para vitit 1990 .....	5
I.2.2 Problematika e zhvillimit rural në Shqipëri pas vitit 1990.....	6
I.2.3 Synimet e Strategjisë së Zhvillimit Rural në Shqipëri.....	8
I.2.4 Reformat që janë ndërmarrë për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm rural në Shqipëri.....	11
I.2.5 Zhvillimi rural përtej sektorit bujqësor.....	15
I.2.6 Financimi rural.....	16
I.2.7 Menaxhimi i burimeve natyrore.....	17

## KAPITULLI II

### POZITA GJEOGRAFIKE, KUSHTET DHE PASURITË NATYRORE, SI PREMISA PËR ZHVILLIM

II.1 Pozita gjeografike, kufijtë, përmasat dhe organizimi administrativ.....	20
II.2 Karakteristikat e mjedisit natyror dhe roli i tyre në zhvillim.....	24
II.2.1 Ndërtimi gjeologjik dhe pasuritë nëntokësore në funksion të zhvillimit të sektorit sekondar.....	24
II.2.2 Relievi si përcaktues i profilit ekonomik të zonës.....	26
II.2.3 Klima dhe ndikimi i saj në veprimtaritë jetësore dhe ekonomike.....	29
II.2.4 Pasuri ujore të konsiderueshme.....	34
II.2.5 Tokat dhe përdorimi i tyre .....	37
II.2.6 Veçoritë e florës dhe të faunës.....	43

## KAPITULLI III

### POPULLSIA, VENDBANIMET DHE ZHVILLIMI SOCIAL

III.1 Gjeografia e popullsisë dhe vendbanimeve.....	45
III.1.1 Historiku i popullimit .....	45
III.1.2 Ecuria e numrit të popullsisë sipas komunave (1994 – 2011).....	46
III.1.3 Veçoritë e lëvizjes natyrore .....	54
III.1.3.a Lindjet, vdekjet dhe shtimi natyror.....	54
III.1.3.b Martesat, divorcet dhe abortet.....	54
III.1.3.c Ndikimi i lëvizjes natyrore në numrin e popullsisë.....	55
III.1.4 Struktura moshore dhe gjinore.....	56
III.1.4.a Struktura moshore.....	56
III.1.4.b Struktura gjinore.....	57
III.1.5 Struktura fetare dhe komunitetet kulturore.....	58
III.1.5.a Struktura fetare.....	58
III.1.5.b Komunitetet kulturore.....	59
III.1.6 Lëvizja hapësinore e popullsisë dhe ndikimet në zhvillim.....	59
III.1.6.a Migrimi i brendshëm.....	59
III.1.6.b Emigracioni.....	61
III.1.6.c Ndikimi i lëvizjeve hapësinore në numrin dhe strukturën e popullsisë.....	62
III.1.7. Punësimi dhe papunësia sipas komunave.....	62
III.1.7.a. Punësimi dhe papunësia sipas grupmoshave dhe gjinisë.....	65
III.1.7.b. Të ardhurat dhe niveli i varfërisë.....	67
III.2. Vendbanimet dhe banesat.....	72
III.2.1 Karakteristikat e vendbanimeve.....	72
III.2.2 Banesa rurale, funksionet dhe evolucioni i saj.....	74
III.2.3 Traditat ndërtimore dhe ecuria e numrit të ndërtimeve.....	77
III.3 Veçori të zhvillimit social.....	79
III.3.1 Familja rurale, numri, madhësia dhe evolucioni.....	79
III.3.1.a Marrëdhëniet brenda familjes, roli i kryefamiljarit dhe i anëtarëve të tjerë .....	84
III.3.1.b Mënyra e jetesës: kalim i ngadalshëm nga tradicionalja te modernia.....	85
III.3.2 Arsimi.....	86
III.3.2. a Infrastruktura arsimore.....	86
III.3.2.b Niveli i arsimimit të popullsisë.....	91
III.3.3 Shërbimi shëndetësor.....	93

III.3.4 Objektet dhe veprimtaritë kulturore dhe sportive.....	96
III.4 Infrastruktura fizike.....	98
III.4.1 Komunikacioni .....	98
III.4.1.a Rrjeti i rrugëve.....	98
III.4.1.b Teleferiku.....	100
III.4.1.c Telekomunikacioni.....	101
III.4.2 Furnizimi me ujë të pijshëm dhe sistemi i kanalizimeve.....	102
III.4.3 Furnizimi me energji elektrike.....	103
III.4.4 Grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve.....	103

## KAPITULLI IV

### ZHVILLIMI EKONOMIK I KOMUNËS DAJT DHE BËRZHITË

IV.1 Veçoritë e zhvillimit ekonomik sipas komunave.....	105
IV.2 Ekonomia bujqësore dhe nëndegët e saj.....	105
IV.2.1 Bujqësia.....	105
IV.2.1.a Historia e zhvillimit të bujqësisë para dhe pas v. 1990.....	105
IV.2.1.b Struktura e sipërfaqes së mbjellë.....	107
IV.2.1.c Rrjeti ujitës dhe kullues.....	111
IV.2.1.d Mekanizimi i bujqësisë.....	112
IV.2.1.e Prodhimi bujqësor sipas llojeve.....	114
IV.2.2 Blegtoria .....	116
IV.2.3 Pyjet dhe menaxhimi i tyre.....	120
IV.2.4 Bletaria dhe peshkimi.....	123
IV.3 Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore.....	124
IV.4 Artizanati dhe agroindustria sipas komunave.....	125
IV.4.1 Artizanati.....	126
IV.4.2 Agroindustria.....	126
IV.5 Aktivitete të tjera të sektorit sekondar.....	128
IV.6 Turizmi, degë e rëndësishme e me perspektivë për të ardhmen e të dy komunave.....	130
V.6.1 Potencialet turistike të komunës Dajt.....	130
V.6.1.a Monumentet natyrore e vlerat e tyre turistike në komunën Dajt.....	131
V.6.1.b Monumentet kulturore.....	135
V.6.2 Potencialet turistike të komunës Bërzhitë.....	137
V.6.2.a Monumenetet natyrore në komunën Bërzhitë.....	138
V.6.3 Infrastruktura turistike dhe llojet kryesore të turizmit.....	141
V.6.4 Promovimi i vlerave turistike të komunës Dajt e Bërzhitë, si dhe të zonës përreth.....	145

IV.7 Aktivitete të tjera të sektorit terciar.....	146
IV.7 Burimet financiare sipas komunave dhe investimet.....	147

## KAPITULLI V

### PEIZAZHI, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

V.1 Peizazhi rural.....	151
V.2 Tipare kryesore të peizazhit të komunave.....	152
V.3 Mjedisi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tij.....	155
V.3.1 Ndotja e ajrit.....	156
V.3.2 Ndotja e ujit.....	156
V.3.3 Ndotja e tokës.....	159
V.3.4 Mirëmenaxhimi i florës dhe faunës së pyjeve.....	160
PËRFUNDIME DHE SUGJERIME.....	161
BIBLIOGRAFIA.....	173

## **Lista e tabelave**

- Tabela II.1 Vlerat mesatare mujore të temperaturës së ajrit në komunën Dajt  
Tabela II.2 Rrezatimi diellor sipas muajve të vitit  
Tabela II.3 Ecuria e numrit të orëve me temperaturë  $\geq 10^{\circ}\text{C}$   
Tabela II.4 Vlerat mesatare mujore të reshjeve në komunën Dajt  
Tabela II.5 Vlerat mesatare mujore të temperaturës së ajrit në komunën Bërzhitë  
Tabela II.6 Ecuria e reshjeve mesatare shumëvjeçare në komunën Bërzhitë  
Tabela II.7 Rezervuaret  
Tabela II.8 Ndarja e tokës (ha) sipas mënyrës së përdorimit në komunën Dajt dhe Bërzhitë  
Tabela II.9 Ndarja e tokës (ha) sipas mënyrës së përdorimit në fshatrat e komunës Dajt  
Tabela II.10 Ndarja e tokës (ha) sipas mënyrës së përdorimit në fshatrat e komunës Bërzhitë  
Tabela II.11 Sipërfaqja e tokës së punëshme (dy) për frymë për komunat Dajt dhe Bërzhitë  
Tabela II.12 Përbërja e faunës në PK Dajt  
Tabela II.13 Masat që duhen marrë për mbrojtjen e Parkut Kombëtar të Dajtit  
Tabela III.1 Numri i popullsisë sipas fshatrave në komunën Dajt në vite sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile  
Tabela III.2 Numri i popullsisë në komunën Dajt në vite sipas të dhënave të INSTAT  
Tabela III.3 Numri i popullsisë në komunën e Bërzhitës sipas fshatrave  
Tabela III.4 Numri i popullsisë në komunën Bërzhitë në vite sipas të dhënave të INSTAT  
Tabela III.5 Numri i popullsisë në komunën Dajt e Bërzhitë  
Tabela III.6 Struktura moshore e popullsisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë 2011  
Tabela III.7 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Dajt  
Tabela III.8 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Bërzhitë  
Tabela III.9 Popullsia banuese sipas statusit aktual në lidhje me punësimin në vitin 2001  
Tabela III.10 Popullsia banuese sipas statusit aktual në lidhje me punësimin vitin 2011  
Tabela III.11 Numri i të punësuarve sipas sektorëve  
Tabela III.12 Numri i të punësuarve(%) sipas sektorëve të ekonomisë  
Tabela III.13 Popullsia banuese e punësuar sipas grupmoshave  
Tabela III.14 Popullsia banuese e punësuar sipas gjinisë  
Tabela III.15 Popullsia banuese e papunë sipas grupmoshave  
Tabela III.16 Popullsia banuese e papunë sipas gjinisë  
Tabela III.17 Numri i familjeve me ndihmë ekonomike sipas fshatrave në komunën Dajt  
Tabela III.18 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Bërzhitë  
Tabela III.19 Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Dajt e Bërzhitë  
Tabela III.20 Klasifikimi i fshatrave sipas lartësisë  
Tabela III.21 Ecuria e numrit të ndërtimeve  
Tabela III.22 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Dajt  
Tabela III.23 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Bërzhitë  
Tabela III.24 Numri i familjeve në komunën Dajt dhe Bërzhitë  
Tabela III.25 Numri mesatar i anëtarëve për familje  
Tabela III.26 Shtrirja e shkollave dhe kopshteve në komunën Dajt sipas fshatrave  
Tabela III.27 Shtrirja e shkollave dhe kopshteve në komunën Bërzhitë sipas fshatrave  
Tabela III.28 Niveli i arsimimit të popullsisë në komunën Dajt e Bërzhitë në vitin 2011  
Tabela III.29 Shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe personelit mjekësor sipas fshatrave

- Tabela III.30 Shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe personelit mjekësor sipas fshatrave
- Tabela III.31 Furnizimi me ujë të pijshëm në komunën Bërzhitë
- Tabela IV.1 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (ha) në komunat Dajt e Bërzhitë
- Tabela IV.2 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (%) në komunat Dajt e Bërzhitë
- Tabela IV.3 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (ha) në komunën Dajt
- Tabela IV.4 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (ha) në komunën Bërzhitë
- Tabela IV.5 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme sipas lartësisë në ha dhe % në komunat Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.6 Ecuria në vite e strukturës së mbjelljeve të tokës së punueshme (në ha)
- Tabela IV.7 Mjetet mekanike bujqësore në komunat Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.8 Prodhimet kryesore (t) në komunën Dajt
- Tabela IV.9 Prodhimet kryesore (t) në komunën Bërzhitë
- Tabela IV.10 Prodhimet kryesore (t) në komunën Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.11 Struktura e gjësë së gjallë në vite në komunën Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.12 Struktura e gjësë së gjallë në komunën Dajt
- Tabela IV.13 Struktura e gjësë së gjallë në komunën Bërzhitë
- Tabela IV.14 Prodhimet blegtorale në komunën Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.15 Sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave (ha) në komunën Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.16 Struktura e sipërfaqes pyjore në % në komunën Dajt dhe Bërzhitë
- Tabela IV.17 Shpërndarja e koshereve të bletëve sipas fshatrave në komunat Dajt e Bërzhitë
- Tabela IV.18 Ndërmarrjet agropërpunuese në komunën e Dajtit
- Tabela IV.19 Shpërndarja e ndërmarrjeve të sektorit sekondar
- Tabela IV.20 Shpërndarja e ndërmarrjeve të sektorit sekondar
- Tabela IV.21 Masat që duhen marrë për mbrojtjen e Parkut Kombëtar të Dajtit
- Tabela IV.22 Hotelet dhe resortet
- Tabela IV.23 Biznese të sektorit terciar në komunën Dajt
- Tabela IV.24 Biznese të sektorit terciar në komunën Bërzhitë
- Tabela IV.25 Burimet financiare të komunës Dajt në vitet 2008-2011 ( në lekë)
- Tabela IV.26 Burimet financiare të komunës Bërzhitë në vitet 2008-2011 ( në lekë)
- Tabela IV.27 Investimet publike të kryera në komunën Dajt në vitet 2008-2011
- Tabela IV.28 Investimet publike të kryera në komunën Bërzhitë në vitet 2008-2011

### **Lista e grafikëve**

- Grafiku II.1 Ecuria e temperaturave mesatare shumëvjeçare në komunën Dajt
- Grafiku II.2 Trëndafili i erës, stacioni Tiranë
- Grafiku II.3 Ecuria e reshjeve mesatare shumëvjeçare në komunën Dajt
- Grafiku II.4 Ecuria e temperaturave mesatare shumëvjeçare në komunën Bërzhitë
- Grafiku II.5 Ecuria e reshjeve mesatare shumëvjeçare
- Grafiku III.1 Numri i popullsisë sipas fshatrave në komunën Dajt në vite sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile
- Grafiku III.2 Numri i popullsisë së komunës Dajt në vite
- Grafiku III.3 Numri i popullsisë në komunën e Bërzhitës në vite
- Grafiku III.4 Numri i popullsisë në komunën Bërzhitë në vite sipas të dhënave të INSTAT
- Grafiku III.5 Numri i popullsisë në komunën Dajt e Bërzhitë në vite

- Grafiku III.6 Struktura moshore e popullsisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë 2011  
Grafiku III.8 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Bërzhitë  
Grafiku III.7 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Dajt  
Grafiku III.9 Struktura fetare e popullsisë  
Grafiku III.10 Numri i popullsisë banuese e punësuar në komunat Dajt e Bërzhitë 2001, 2011  
Grafiku III.11 Përqindja e popullsisë banuese e papunësuar në 2001 e 2011  
Grafiku III.12 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Dajt  
Grafiku III.13 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në fshatrat e komunës Dajt  
Grafiku III.14 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Bërzhitë  
Grafiku III.15 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Dajt  
Grafiku III.16 Numri i familjeve në komunën Dajt  
Grafiku III.17 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Bërzhitë  
Grafiku III.18 Numri i familjeve në komunën Bërzhitë  
Grafiku III.19 Numri i familjeve në komunën Dajt dhe Bërzhitë  
Grafiku III.20 Niveli i arsimimit të popullsisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë (2011)  
Grafiku IV.1 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme sipas lartësisë(ha) në komunën Dajt  
Grafiku IV.2 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme sipas lartësisë(ha) në komunën Bërzhitë  
Grafiku IV.4 Burimet financiare të komunës Bërzhitë në vitet 2008-2011 ( në lekë)  
Grafiku IV.3 Burimet financiare të komunës Dajt në vitet 2008-2011 (në lekë)

### **Lista e figurave**

- Fig. II.1 Pamje nga shkëmbinj terrigjenë në komunën e Dajtit  
Fig. II.2 Lumi i Tiranës  
Fig. II.3 Lumi i Erzenit  
Fig. III.1 Emblema e komunës Dajt  
Fig. III.2 Emblema e komunës Bërzhitë  
Fig. III.3 Ndërtesa shumëkatëshe në Qesarakë, në fshatin Linzë, komuna Dajt  
Fig. III.4 Ndërtim i ri në komunën Dajt  
Fig. III.5 Ambient sportiv në fshatin Linxë, komuna Dajt  
Fig. III.6 Grupi artistik i komunës Dajt  
Fig. III.7 Rruga e Arbrit  
Fig. III.8 Punime në Rrugën e Arbrit  
Fig. III.9 Punime në Rrugën e Arbrit  
Fig. III.10 Teleferiku Dajti Express  
Fig. III.11 Autostrada Tiranë-Elbasan  
Fig. III.12 Tuneli i Elbasanit  
Fig. IV.1 Bllok i ri drufrutor në komunë Dajt  
Fig. IV.2 Tokë e mbjellë me jonxhë në komunën Bërzhitë  
Fig. IV.3 Stallë lopësh në komunën Bërzhitë  
Fig. IV.4 Pamje nga pyjet në Parkun Kombëtar të Dajtit  
Fig. IV.5 Dëmtimi i pyjeve në Parkun Kombëtar të Dajtit  
Fig. IV.6 Gurore në malin e Dajtit



- Fig. IV.7 Shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumit të Erzenit
- Fig. IV.8 Punime artizanale në komunën Dajt dhe Bërzhitë
- Fig. IV.9 Agropërpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale
- Fig. IV.10 Punime mermeri në një punishte në Tufinë, konuna Dajt
- Fig. IV.11 Teleferiku Dajti Expres
- Fig. IV.12 Imazhi Satelitor dhe kufijtë e PKD
- Fig. IV.13 Rezervuari i Bovillës
- Fig. IV.14. Pamje nga Shkalla e Tujanit
- Fig. IV.15 Fragmente të murit të Kalasë së Dajtit
- Fig. IV.16 Ura e Brarit
- Fig. IV.17 Pamje nga Shpella e Zezë (Pëllumbasit)
- Fig. IV.18 Pamje nga lumi i Erzenit
- Fig. IV.19 Hotel Belvedere
- Fig. IV.20 Kompleksi Chateau Linza
- Fig. IV.21 Kompleksi King Park
- Fig. IV.22 Restorant Gurra e Perrisë
- Fig. IV.23 Palma Nova Resort
- Fig. IV.24 Resort Teatër Kame
- Fig. IV.25 Pallate shumëkatëshe në fshatin Linxë, komuna Dajt
- Fig. V.1 Pamje piktoreske të malit të Dajtit
- Fig. V.2 Gryka e Skoranës dhe peizazhi përreth saj
- Fig. V.3 Rezervuari i Bovillës
- Fig. V.4 Pamje nga Mali me Gropa
- Fig. V.5 Foto satelitore e luginës së lumit Erzen

### **Lista e hartave**

- Harta II.1 Pozita administrative e komunave Dajt dhe Bërzhitë
- Harta II.2 Pozita gjeografike e komunave Dajt dhe Bërzhitë
- Harta II.3 Përdorimi i tokës në komunën Dajt
- Harta II.4 Përdorimi i tokës në komunën Bërzhitë
- Harta III.1 Ndryshimet e popullsisë (2001-2011)
- Harta III.2 Harta e varfërisë
- Harta III.3 Ecuria e numrit të ndërtesave në periudha të ndryshme
- Harta III.4 Numri i banesave në vitin 2011

### **Lista e skemave dhe skicave**

- Skema I.1 Koncepti i qëndrueshmërisë dhe zhvillimit
- Skema I.2 Ndryshimi i konceptit të zhvillimit
- Skica III.1 Shtrirja e shkollave në komunën Dajt
- Skica III.2 Shtrirja e shkollave në komunën Bërzhitë

### **Lista e shkurtesave**

ASHSH - Akademia e Shkencave e Shqipërisë  
BB- Banka Botërore  
DARQT - Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë  
FSHZH - Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
IDA - International Development Association  
INSTAT - Instituti i Statistikave  
JICA - Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar  
KBMZH - Komisionit Botëror mbi Mjedisin dhe Zhvillimin  
MKZ - Mbrojtja Kundër Zjarrit  
PPB - Produkti i Përgjithshëm Bruto  
PKD - Parku Kombëtar i Dajtit  
QSGJ - Qendra e Studimeve Gjeografike  
RZ - Rekreacion Natyror  
SKZHR - Strategjia Ndërsektorale e Zhvillimit Rural  
ZMMT- Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës  
ZTM - Zona e Tiranës Metropolitane

## **HYRJE**

Disertacioni synon të pasqyrojë dhe analizojë karakteristikat natyrore dhe humane të komunave Dajt dhe Bërzhitë, të rrethit të Tiranës, me specifikat e veçoritë e secilës, si dhe në këndvështrimin krahasues.

Objekt i disertacionit janë: veçoritë e zhvillimit demo-social, ekonomik dhe mjedisor i komunave Dajt dhe Bërzhitë në vite. Do të evidentohen transformimet natyrore, social-kulturore dhe ekonomike që kanë pësuar këto komuna pas vitit 1990, si dhe do të analizohen faktorët që i kanë shkaktuar ato. Nëpërmjet metodave kërkimore (cilësore dhe sasiore) dhe qasjeve shkencore, studimi do të tentojë të evidentojë dinamikën e këtyre transformimeve dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe peizazh, si dhe do të japë sugjerime konkrete mbi rrugët dhe drejtimet që duhen ndjekur për të planifikuar dhe realizuar zhvillim të qëndrueshëm të komunave.

Ndryshimi i sistemit politik dhe ekonomik në Shqipëri u shoqërua me sfida të mëdha e të panjohura për shoqërinë shqiptare, të tilla si braktisje masive të zonave malore, migrime të brendshme dhe emigracion të përmasave të mëdha, konflikte për pronën, informalitet etj. Këto zhvillime kanë ndikuar në përdorimin e hapësirës, rregullimin e territorit, peizazhin dhe mjedisin e komunave Dajt dhe Bërzhitë.

*Rëndësia e këtij studimi konsiston në:*

- evidentimin e njohjen e problemeve social-ekonomike dhe mjedisore të komunave;
- propozimin e rrugëve konkrete që duhet të ndiqen për një menaxhim të suksesshëm të pasurive natyrore dhe humane të tyre;
- nisur nga fakti që këto komuna janë zhvilluar deri më sot në mënyrë kaotike dhe informale, studimi, duke u mbështetur në analiza të hollësishme social-ekonomike dhe mjedisore, synon t'i propozojë pushtetit vendor disa sugjerime mbi zhvillimin e disa sektorëve të ekonomisë që janë më fitimprurës për to, duke ruajtur e shfrytëzuar në mënyrë racionale pasuritë e shumta natyrore dhe humane që ato kanë;
- disertacioni do të ofrojë një model që mund të shërbejë për studime të komunave të tjera në Shqipëri.

Vlerat *teorike* të punimit qëndrojnë në paraqitjen e detajuar dhe të qartë të gjendjes sociale dhe ekonomike të komunave, në këndvështrimin krahasues. Ecuria e numrit të popullsisë, problemet e lëvizjes natyrore dhe migruese të saj, niveli i të ardhurave dhe i mirëqenies, zhvillimi i arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës etj, janë analizuar me synimin për të sjellë në vëmendje të pushtetit vendor dhe atij qendror mundësitë e shumta që kanë këto komuna për zhvillim.

Në kushtet e mungesës së studimeve shkencore dhe të zhvillimit spontan të dukurive e proceseve demografike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, shfrytëzimi i burimeve natyrore është bërë pa kriter, prandaj në disertacion i është kushtuar rëndësi trajtimit të parimeve të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe mundësisë së aplikimit të tyre në terrenin konkret.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar studimit të evolucionit të peizazhit, situatës mjedisore dhe problematikave lidhur me to.

Për realizimin e qëllimeve kryesore të këtij disertacioni, kujdes i veçantë i është kushtuar punës për grumbullimin e informacioneve, kryesisht statistikore, në zyrat e

komunave Dajt dhe Bërzhitë, si dhe në institucione të tilla si INSTAT, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Qarku Tiranë etj.

Gjithashtu librat, monografitë, studimet, projektet dhe informacionet e tjera ndihmëse, të siguruara nga institucionet kryesore qendrore dhe vendore, Biblioteka Kombëtare, ajo e UT-së, e FHF-së etj, janë përzgjedhur dhe sistemuar sipas kapitujve dhe çështjeve të trajtuara në disertacion. Në ndihme të këtij disertacioni kanë qenë dhe informacionet e siguruara nga artikujt, kumtesat dhe referatet e studiuesve vendas e të huaj, që kanë trajtuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale në përgjithësi dhe të komunave Dajt e Bërzhitë në veçanti.

Krahas burimeve zyrtare, për sigurimin e të dhënave janë përdorur edhe intervistat në terren me drejtues të pushtetit vendor, ekspertë të fushave të ndryshme si agronomë, ekonomistë, inxhinierë pyjesh, specialistë të mjedisit etj.

Disertacioni është realizuar duke u bazuar në një sërë metodash kërkimore bashkëkohore. Metoda bazë ka qenë ajo e krahasimit të treguesve demo-socialë, ekonomikë e mjedisorë të komunave, e cila është përdorur në të gjithë kapitujt e këtij studimi. Janë përdorur metodat statistikore për nxjerrjen e korrelacioneve midis treguesve social-ekonomikë e mjedisorë. Metoda e paraqitjes grafike të dukurive dhe treguesve është përdorur kryesisht në kapitullin e tretë dhe të katërt, ku trajtohen zhvillimet demo-sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, janë përdorur metoda e vëzhgimit, anketimit të banorëve, përshkruese, analizuese etj.

*Duke u bazuar në dinamikën e zhvillimeve të sotme, ky studim synon të ndërtojë një platformë të plotë dhe realiste të planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm të komunave Dajt dhe Bërzhitë, e cila paraqet drejtimet kryesore të zhvillimit perspektiv të tyre.*

Disertacioni është konceptuar në pesë kapituj dhe një çështje ku janë përmbledhur përfundimet dhe sugjerimet. Çdo kapitull është fokusuar në një problematikë të veçantë, në funksion të drejtpërdrejtë të objektivave që ai ka synuar të realizojë.

### ***Hipoteza e punimit***

Gjatë fazës fillestare të punës për disertacionin, krahas përcaktimit të zonës së studimit, boshteve kryesore të kërkimit dhe përzgjedhjes së metodës bazë studimore (asaj krahasuese), është përpiluar edhe hipoteza kryesore:

***Komunat Dajt dhe Bërzhitë kanë hedhur hapat e para në rrugën e zhvillimit social-ekonomik të qëndrueshëm, por me ritme të ndryshme.***

Nisur nga synimi për të vërtetuar nëse kjo hipotezë mund të qëndrojë ose jo, janë realizuar një sërë trajtesash analitike mbi tregues dhe komponentë të ndryshëm, të karakterit natyror, demografik, social, ekonomik dhe mjedisor, në përpjekje për t'i sintetizuar ato, duke përcaktuar stadin e zhvillimit të secilës komunë dhe prirjet në të ardhmen, si dhe duke konkluduar në lidhje me integrimin e tyre në dinamikën e zhvillimit të qëndrueshëm.

### **Studime dhe botime për komunat Dajt dhe Bërzhitë**

Komunat Dajt dhe Bërzhitë, për shkak të pozitës së tyre pranë Tiranës, si dhe të potencialeve të shumta natyrore e humane, kanë qenë dhe janë në fokusin e shumë studimeve dhe analizave të ekspertëve të fushave të tilla si: gjeomorfologjia, biologjia, demografia, ekonomia etj.

Një kontribut të rëndësishëm në studimin e tyre ka dhënë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që në bashkëpunim me pushtetin vendor, ka evidentuar gjendjen social-ekonomike dhe ka përcaktuar rrugët dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm.

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces që i jep mundësi qeverisjes vendore dhe komuniteteve të kontrollojnë dhe të hartojnë të ardhmen e tyre.

Si studime të tilla përmendim Planin e Zhvillimit të komunës Bërzhitë, i cili ka synuar të identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat financiare, të masë rezultatet e punës së qeverisë vendore, të planifikojë shërbime dhe projekte për të siguruar një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunës. Një plan i tillë zhvillimi është në proces hartimi edhe për komunën e Dajt.

Studime të tjera të rëndësishme, në nivel shtetëror dhe rajonal, të cilave duhet t'u referohen qeveritë vendore, janë:

- *Strategjia e Zhvillimit Rural të Shqipërisë, mbështetje për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm (nëntor 2002), përgatitur nga Departamenti i Zhvillimeve të Qëndrueshme Sociale dhe Mjedisore për Europën dhe Azinë Qendrore, Banka Botërore dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Shqipërisë.* Ajo përbën një burim të rëndësishëm orientues për evidentimin e potencialeve dhe përcaktimin e rrugëve për zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të rajoneve dhe njësive vendore me profil rural.
- *Strategjia Ndër-Sektoriale Shqiptare e Zhvillimit Rural (SKZHR, 2007-2013), përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUK, Tiranë 2007).* Ajo mundëson zgjerimin e njohurive për bashkëveprimin e domosdoshëm dhe të rëndësishëm ndërmjet degëve kryesore të ekonomisë rurale. Vetëm duke i trajtuar problematikat në një plan gjithëpërfshirës bëhet i mundur suksesi në zhvillimin e qëndrueshëm rural të vendit dhe çdo njësie vendore.
- *Koncepti i Zhvillimit Rajonal për Qarkun e Tiranës. Orientimet Strategjike për Zhvillimin Rajonal 2012- 2017, përgatitur nga N. Mazari, me mbështetjen e Fondacionit Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Vendore.* Në të, komunat Dajt dhe Bërzhitë shihen në një këndvështrim krahasues me njësitë e tjera vendore të qarkut Tiranë, duke evidentuar zhvillimet e transformimet që kanë ndodhur në to, duke nënvizuar problematikat e hasura, si dhe duke përcaktuar e sugjeruar rrugët e mundësitë për zgjidhjen e tyre.

Studime më të specifikuar për komunën Dajt dhe Bërzhitë janë:

- *Identifikimi i burimeve njerëzore, materiale dhe aktiviteti ekonomik, Komuna Dajt, Rrethi Tiranë (H. Sulovari, Z. Gjeta, A. Ibraliu, Tiranë 2005).* Në të jepet një panoramë e detajuar e zhvillimit social-ekonomik të komunës Dajt, i parë në një këndvështrim historik, që përfshin veçoritë e tij para dhe pas vitit 1990. Autorët, nëpërmjet evidentimit të fakteve, dukuri ve dhe proceseve, si dhe analizave të hollësishme të tyre, kanë arritur të japin karakteristikat kryesore të zhvillimit të

degëve kryesore të ekonomisë së komunës. Gjithashtu ato kanë dhënë disa sugjerime të rëndësishme për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm social-ekonomik të saj.

- *Bujqësia e qëndrueshme...në praktikë me autorë Gjoka F., Nasto Th., Koçi M., Tiranë 2005.* Autorët, në kapitullin *Disa aspekte të qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat malore dhe ekosistemeve ujore*, trajtojnë një përvojë nga Pirenejtë (Spanjë) dhe disa mendime për zonën e komunës Dajt. Parë në një këndvështrim krahasues, autorët evidentojnë mundësitë e shumta natyrore që ka kjo komunë e shfrytëzimin e pakët të tyre, shpesh të harruara si potenciale zhvillimi për të.

Ata evidentojnë zhvillimin e turizmit malor në këtë komunë si një prioritet që ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Ata sugjerojnë përmirësimin e infrastrukturës turistike, jo vetëm të sistemit rrugor, të ujit të pijshëm, ta transportit publik, por dhe përdorimit të flet-palosjeve, mikro-guidave, lokaleve “mikse” për shërbime akomodimi e ushqimi, por njëkohësisht dhe si “muze” historik, etnografik etj.

- *Relacioni i studimit të masterplanit të komunës Dajt*, Tiranë 2011, i cili ka si objektiv krijimin e një vizioni të qartë për zhvillimin e qëndrueshëm urban e turistik të komunës Dajt, duke shfrytëzuar resurset, potencialet dhe avantazhet e zonës.
- *Plani i Zhvillimit të Komunës së Bërzhitës*, mbështetur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në këtë plan jepet një informacion i përgjithshëm për këtë komunë, aspekte kryesore të zhvillimit social-kulturor dhe ekonomik të saj. Janë evidentuar potencialet natyrore dhe humane që ka kjo komunë, parë këto si mundësi të mira për zhvillimin e mëtejshëm të saj.
- *Plani i zhvillimit të turizmit për komunat Petrelë, Bërzhitë e Baldushk*, mbështetur nga Fondacioni ALCDF në bashkëpunim me Komitetin e Veprimit për Turizmin në të tre komunat. Ky plan synon të përmbledhë të gjitha prioritetet e këtyre zonave në një “Dokument” të vetëm që do të shërbejë si një guidë në organizimin e turizmit për të ardhmen. Me mbështetjen e pushtetit lokal të të trija zonave është realizuar hartimi i këtij plani, ku si fillim është ngritur Komiteti i Veprimit të Turizmit (KVT) me synimin e hartimit dhe zbatimit të veprimeve të detajuara për të arritur qëllimet dhe objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në këto komuna.
- Në komunën e Dajt del çdo dy javë *Gazeta Dajti*, që pasqyron veprimtaritë kryesore social-ekonomike që zhvillohen në territorin e saj. Në intervale të shkurtra kohore, janë botuar edhe disa revista, kryesisht të karakterit informues për të dy komunat.
- Kontribut për njohjen e vlerave turistike të fshatrave të rrethit të Tiranës ka sjellë botimi i Skënder H. Farka, titulluar “*Shëtitje turistike nëpër fshatrat e rrethit të Tiranës*”. Nëpërmjet evidentimit të vlerave natyrore dhe historike të fshatrave, autori sugjeron vendet që duhet të vizitohen.

Informacioni që sjellin studimet dhe botimet e deritanishme është marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së disertacionit.

Studimi synon të evidentojë të gjitha karakteristikat demografike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, për komunat Dajt dhe Bërzhitë, në një këndvështrim krahasues midis tyre dhe lidhur ngushtë me konceptin e zhvillimit rural të qëndrueshëm. Pikërisht kjo është e reja që ai sjell. Pasi analizon në mënyrë të hollësishme faktet, dukuritë dhe proceset që kanë ndodhur deri në vitin 2012, dhe pasi prezanton gjendjen e sotme të tyre, studimi tenton të sugjerojë zgjidhje për problemet e krijuara dhe të përcaktojë rrugët dhe mjetet për zhvillimin e qëndrueshëm të komunave Dajt dhe Bërzhitë.

### *Mirënjohje dhe falënderime*

I shpreh mirënjohje të thellë udhëheqësit shkencor, Prof. dr. Sabri LAÇI, për konceptimin e temës dhe strukturimin e përmbajtjes, mbështetjen e vazhdueshme, udhëzimet metodike dhe profesionale, si dhe redaktimin shkencor të disertacionit.

Një falënderim i sinqertë u adresohet kolegeve dhe mikeve të çmuara Dr. Sonila XHAFA dhe MSc. Edlira KOLA, për ndihmën e pakursyer që më kanë dhënë.

Falenderoj shumë stafin e Departamentit të Gjeografisë të UT-së për sugjerimet dhe vlerësimet, të cilat më kanë nxitur për përfundimin e këtij studimi.

Falenderoj gjithashtu të gjithë specialistët dhe drejtuesit vendor të komunave Dajt e Bërzhitë, të qarkut dhe prefekturës Tiranë, të DAR të Qarkut Tiranë, për mundësitë që më krijuan për sigurimin e informacionit dhe të dokumenteve të domosdoshme për realizimin e punimit.

*Autorja*

## KAPITULLI I

# KONCEPTI DHE PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

### I.1 Historia dhe përmbajtja e konceptit “zhvillim i qëndrueshëm”

Koncepti “zhvillim i qëndrueshëm” ka ndryshuar gjatë viteve, duke pasqyruar stadin e zhvillimit ekonomik, social e kulturor të shoqërisë njerëzore. Gjatë viteve ky koncept u pasurua në elementë dhe përmbajtje, duke pasqyruar qartë lidhjen dhe bashkëveprimin e ndërsjellët mjedis-shoqëri njerëzore.

Ky bashkëveprim është konstatuar nga shkrimtari i njohur francez Antoine de Saint-Exupery që në vitet 30-të të shekullit të kaluar, kur ai shkruante se "Ne nuk e trashëgojmë tokën nga paraardhësit, por e kemi marrë atë hua nga fëmijët tanë".

Në vitin 1949, presidenti i SHBA-së H. Truman u shpreh se “jemi larg nga të menduarit se njerëzimi do të përballet një ditë me kufizim të burimeve natyrore”, por njerëzimi filloi të bëhej i vetëdijshëm për këtë kufizim që në vitet 1970.

Fillimisht, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm u lidh me problemet e mjedisit dhe krizën ekologjike të burimeve natyrore, me problemet e energjisë etj. Ai u mendua si zgjidhje e krizës së shkaktuar nga shfrytëzimi intensiv i burimeve natyrore, që solli përkeqësimin e mjedisit.

Për herë të parë termi “zhvillim i qëndrueshëm” u paraqit nga Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit (KBMZH), në raportin e Brundtland-it “E ardhmja jonë e përbashkët”, më 1987, ku theksohej se problemet mjedisore nuk mund të izolohehin nga problemet e tjera, të tilla si varfëria dhe shtresëzimi social. Komisioni e pa zhvillimin e qëndrueshëm si një mundësi për minimizimin e rrezikut të krijimit të problemeve të reja apo të përkeqësimit të atyre ekzistuese. Me fjalë të tjera, e pa atë si “një zhvillim që përputhet me nevojat e së tashmes, pa kompromentuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre”.<sup>1</sup>

Sipas përcaktimit të Komisionit Botëror mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Raporti Brundtland), zhvillimi i qëndrueshëm është një model zhvillimi, që përcaktohet nga interesat publike, duke marrë parasysh aspektet e përgjithshme mjedisore të një bote të globalizuar. Ai është një zhvillim që plotëson nevojat e tanishme pa kompromentuar interesat e brezave të ardhshëm.

*“Nëse një aktivitet është i qëndrueshëm, ai mund të ekzistojë përgjithmonë”<sup>2</sup>, shprehet Klara Börjesson në “Sustainable Tourism - Nature for all”.*

Në vitin 1992, në Samitin e Tokës, që u zhvillua në Rio de Zhaneiro të Brazilit, vendet pjesëmarrëse adoptuan Agjendën 21, si një udhërrëfyes për të rishikuar rritjen ekonomike, avancimin e barazisë sociale dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit, në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> World Commission on Environment and Development (1987). Our Common Future.

<sup>2</sup> Börjesson K., Sustainable Tourism - Nature for all, Uetlands and valuable landscapes for rural development, fq. 28.

<sup>3</sup> Khindi N., Drejt zhvillimit të qëndrueshëm Rio+20, Panorama, 20 qershor 2012.



Më 20-22 qershor 2012, Organizata e Kombeve të Bashkuara solli përsëri në Rio+20 (Rio de Janeiro, Brazil) institucionet ndërkombëtare, qeveritë, sektorin privat, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare dhe grupet e mëdha të interesit, për të rënë dakord mbi një gamë më të gjerë, më të menduar, më të avancuar masash që mund të ulnin varfërinë, ndërsa do të promovojë punësimi, energjia e pastër dhe një përdorim më i qëndrueshëm dhe i drejtë i burimeve natyrore.

I quajtur si një “moment historik”, ky samit do të fokusohet në dy drejtime kryesore:

- Ndërtimin e një ekonomie të gjelbër për të ulur varfërinë dhe arritur zhvillimin e qëndrueshëm;
- përcaktimin e kuadrit institucional për zhvillimin e qëndrueshëm në shtatë fusha parësore: punësimi, energjia, qytetet e qëndrueshme, sigurimi i ushqimit dhe bujqësia e qëndrueshme, uji, oqeanet dhe gatishmëria në raste fatkeqësish natyrore.


Zhvillimi i qëndrueshëm përbën një nga objektivat e zhvillimit gjatë mijëvjeçarit të ri, të miratuar nga të gjithë shtetet anëtare të OKB-së .

Zhvillimi i qëndrueshëm ka rëndësi të veçantë për të gjithë, në kushtet e veprimit të faktorëve të tillë si:

- ❖ kriza ekologjike dhe sociale që është shfaqur tashmë si problem global,
- ❖ pakësimi deri në shterim i burimeve natyrore, sidomos i rezervave të naftës,
- ❖ thellimi i dallimeve ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim,
- ❖ humbjet drastike të biodiversitetit,
- ❖ rritja e popullsisë së botës,
- ❖ shtimi i fatkeqësive natyrore etj.

### I.1.1 Koncepti "zhvillim i qëndrueshëm"

Koncepti “zhvillim i qëndrueshëm” shihet nga disa studiues si kombinim i koncepteve “qëndrueshmëri” dhe “zhvillim”. Ndërkohë, një kategori kritikësh thonë: "qëndrueshmëri po – zhvillim të qëndrueshëm jo", pasi, kombinimi i zhvillimit me qëndrueshmërinë është një kundërshti në vetvete: ndërsa qëndrueshmëria i përket botëkuptimit të ri ekologjik, koncepti i zhvillimit rrjedh nga botëkuptimi i vjetruar mekanicist. Me gjithë kritikën, kombinimi "zhvillim i qëndrueshëm" është pranuar nga shumica e studiuesve dhe nuk mund të shmanget. Në pikëpamje skematike, ky koncept paraqitet si vijon.



Skema I.1 Koncepti i qëndrueshmërisë dhe zhvillimit<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Autori Ragnar Müller, marrë nga [http://www.dadalos.org/nachhaltigkeit\\_alb/grundkurs\\_5/entwicklung.htm](http://www.dadalos.org/nachhaltigkeit_alb/grundkurs_5/entwicklung.htm), vizituar më 15.04.2014.

Madje dhe vetë koncepti i zhvillimit në vite ka ndryshuar. Në mënyrë skematike ai paraqitet si më poshtë.

**Ndryshimi i konceptit të zhvillimit**

	<b>Koncepti i vjetër mbi zhvillimin: Zhvillim rekuperues</b>	<b>Koncepti i ri mbi zhvillimin: Zhvillim i qëndrueshëm</b>
<b>Çfarë konsiderohet si problem?</b>	Nëzhvillimi i vendeve në zhvillim	Zhvillim i gabuar veri-jug
<b>Perspektiva</b>	Para së gjithash ekonomik	Ekonomik, social dhe ekologjik
<b>Strategjia</b>	Zhvillim rekuperues i Botës së Tretë	Orientim i ri shoqëror në veri dhe në jug
<b>Mjetet</b>	Rritja ekonomike plus ndihma për zhvillim nga jashtë	Shndërrim ekologjik dhe social në veri dhe në jug, ndihmë teknol. dhe financiare për jugun
<b>Ideali</b>	Shoqëri perëndimore të mirëqënies	Një model i zhvillimit të qëndrueshëm, për t'u shtjelluar

Skema I.2 Ndryshimi i konceptit të zhvillimit<sup>5</sup>

Siç e shohim dhe nga skema e paraqitur koncepti i zhvillimit sot është më i gjerë, më gjithëpërfshirës.

Termet më të përshtatshëm, që përdoren gjerësisht sot nga specialistë të fushave të ndryshme, janë “rritje ekonomike e qëndrueshme” dhe “zhvillim i qëndrueshëm”<sup>6</sup>. Në rastin e rritjes ekonomike të qëndrueshme vlerësohet fakti se ajo ruan një ritëm pozitiv dhe të qëndrueshëm nga njëri vit në tjetrin, pra garanton jo vetëm rritjen, por dhe ritmin e rritjes. Faktorët kryesorë që garantojnë këtë janë të ashtuquajturit “burime të qëndrueshme të rritjes”. Sipas përkufizimit në Raportin e Brundtland-it (KBMZH, 1987), zhvillim i qëndrueshëm, garanton rritjen ekonomike, por jo ritmet e saj. Në fakt, koncepti “zhvillim i qëndrueshëm” është më i gjerë, e përfshin edhe ritmin e rritjes.

<sup>5</sup> Autori Ragnar Müller, marrë nga [http://www.dadalos.org/nachhaltigkeit\\_alb/grundkurs\\_5/entwicklung.htm](http://www.dadalos.org/nachhaltigkeit_alb/grundkurs_5/entwicklung.htm), vizituar më 15.04.2014.

<sup>6</sup> Civici A., *Rritje ekonomike apo zhvillim i qëndrueshëm?* Revista Monitor 14.06.2009.

Përkufizimi i ofruar nga Banka Botërore i eliminon dilemat mbi këtë koncept: Zhvillim i qëndrueshëm do të thotë zhvillim që vazhdon<sup>7</sup>.

### ***1.1.2 Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm***

Sipas studiuesit amerikan Jonathan M. Harris, parimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm fokusohen në tri drejtime kryesore, të cilat janë<sup>8</sup>:

1. *Ekonomik*: një sistem ekonomikisht i qëndrueshëm duhet të jetë i aftë të prodhojë të mira materiale dhe shërbime në baza të qëndrueshme, të mbajë në nivele të menaxhueshme qeverisjen dhe borxhin e jashtëm dhe të shmangë pabarazitë e skajshme sektoriale që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor dhe industrial.
2. *Social*: një sistem i qëndrueshëm nga pikëpamja sociale duhet të garantojë barazi në sigurimin dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale, duke përfshirë ato shëndetësore dhe arsimore, barazi gjinore, si dhe qëndrueshmëri dhe pjesëmarrje politike.
3. *Mjedisore*: një sistem i qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore duhet të garantojë një bazë të qëndrueshme resursesh, duke shmangur mbishfrytëzimin e sistemeve të resurseve të rinovueshme ose të funksioneve mjedisore, si dhe duke përdorur burimet e parinovueshme deri në atë shkallë ku mund të sigurohen investime për resurse zëvendësuese. Kjo përfshin ruajtjen e biodiversitetit, qëndrueshmërisë atmosferike dhe funksioneve të tjera që përgjithësisht nuk cilësohen si resurse ekonomike.

Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm është të krijojë modele të qëndrueshme në tri aspekte të veprimitarisë njerëzore: në aspektin ekonomik, social, ekologjik. Këto njihen ndryshe dhe si tri kolonat në të cilat mbështetet zhvillimi i qëndrueshëm sot. Kohët e fundit, këtyre iu është shtuar dhe një tjetër: trashëgimia kulturore ose mjedisi kulturor.

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është një gjendje statike, por një proces transformimi, në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale duhen bërë në përputhje me të ardhmen dhe kërkesat e saj.

Pra, termi “zhvillim i qëndrueshëm” ka evoluar, pasi sot ai përbën një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar, që merr në konsideratë jo vetëm përfitimet ekonomike, por edhe zhvillimet sociale, të mjedisit, kontrollin e flukseve migruese dhe funksionimin e institucioneve demokratike<sup>9</sup>.

Ardhja e mijëvjeçarit të ri ofron për të gjithë mundësi të reja për reflektim mbi arritjet dhe dështimet e njerëzimit gjatë mijëvjeçarëve të shkuar dhe për mobilizim për sfidat që duhen fituar në epokën e re edhe më të ndërvarur të historisë së njerëzimit. Ndërkohë, shumë nga shqetësimet e sotme mund të duken të parëndësishme në një perspektivë afatgjatë, por synimi për një zhvillim të qëndrueshëm, të barabartë dhe të shëndetshëm nga ana mjedisore, merr rëndësi edhe më të madhe, pasi ka të bëjë pikërisht me mbijetesën e jetës në Tokë.

---

<sup>7</sup> Sachs W., *Pas nesh e ardhmja. Konflikti global mbi drejtësinë dhe ekologjinë*. Frankfurt/Main 2002. fq.65

<sup>8</sup> Harris J. M., *Basic Principles of Sustainable Development*, Global Development and Environmental Institution (working paper 00-04). SHBA qershor 2000.

<sup>9</sup> Annan K., *Fjalimi i përshëndetjes në Konventën e Aarhusit*, Danimarkë 25 qershor 1998.

### ***1.1.3 Zhvillimi i qëndrueshëm rural***

Sipas përkufizimit të Bankës Botërore, zhvillimi rural është një strategji e projektuar për të përmirësuar jetën shoqërore të një grupi specifik njerëzish: fshatarëve të varfër (fermerët e vegjël, qiramarrësit dhe fshatarët pa tokë). Sipas kësaj strategjie u morën masa për rritjen e prodhimit, punësimit dhe qarkullimit bujqësor, qarkullimin e punës dhe të kapitalit. Por, u vu re se varfëria dhe pabarazia mund të reduktoheshin nëse ky zhvillim përfshinte dhe vlerat e cilësinë e jetës dhe fermerët merrnin pjesë drejtpërdrejt në vendimmarrje. Kjo strategji u njoh si “zhvillim me drejtësi”<sup>10</sup>.

Më pas, përdorim të gjërë mori termi “zhvillim i integruar rural” i cili synonte përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë rurale, shfrytëzimin racional të pasurive natyrore në zonat rurale si dhe zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë e sektorëve të tjerë të ekonomisë në këto zona.

Që nga fillimi i mijëvjeçarit të ri, te studiuesit e botës rurale po zë vend gjithnjë e më shumë ideja për një zhvillim që merr në konsideratë përparësitë e zhvillimit rural të integruar (kompleksitetin dhe integrimin e të gjitha çështjeve të botës rurale) dhe atij të qëndrueshëm (përdorimin racional të resurseve natyrore). Kjo është fazë e përparuar e zhvillimit rural, në të cilën deri më sot, janë përfshirë vetëm vendet e zhvilluara<sup>11</sup>.

## **1.2 Zhvillimi i qëndrueshëm rural në Shqipëri**

Zhvillimi i qëndrueshëm rural përbën një komponent të rëndësishëm në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit e rajonit. Zhvillimi rural është i qëndrueshëm, kur ai rrit në vazhdimësi prodhimet dhe të ardhurat që vijnë nga sektori i bujqësisë, plotëson nevojat në rritje të popullsisë për produktet bujqësore duke ruajtur dhe rritur cilësinë e jetës së fermerëve dhe të popullsisë në tërësi, rrit kontributin e saj për plotësimin e nevojave për lëndë të parë për agro-industrinë, industrinë, turizmin e degë të tjera të ekonomisë, duke ruajtur e shfrytëzuar në mënyrë racionale pasuritë natyrore dhe mjedisin në tërësi.

### ***1.2.1 Karakteristikat e zhvillimit rural në Shqipëri para viti 1990***

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, e gjen Shqipërinë një vend të prapambetur agrar, me mbizotërim të theksuar të marrdhënieve feudale, ku popullsia fshatare përbënte rreth 77 % të popullsisë së vendit.

Me miratimin e Ligjit mbi Reformën Agrare, më 29 gusht 1945, u realizua shpronësimi pa pagesë i pronarëve ekzistues dhe u realizua rishpërndarja e tokës së punëshme, ullishteve, gjësë së gjallë etj. bujqëve të varfër me ose pak tokë nën moton “ Toka u përket atyre që e punojnë”. Reforma shpërndau gjithsej 288.000 ha tokë, nga të cilat 90 % iu dhanë 21.544 familjeve fshatare pa tokë dhe 48.667 familjeve me pak tokë.

---

<sup>10</sup> Laçi S., “ *Gjeografia rurale*”, Tekst universitar. Shtëpia botuese “PROGRES”, viti 2005, fq. 58.

<sup>11</sup> Laçi S., në bashkëpunim me Kola E., Xhafa S., Laçi E., “ *Gjeografia rurale*”, Tekst universitar. Shtëpia botuese “Lilo”, viti 2014, fq. 76

Gjithashtu, fshatarëve iu shpërndanë dhe 50 % e ullinjve dhe rreth 6.000 krerë kafshë pune dhe gjithë inventari tjetër bujqësor<sup>12</sup>.

Megjithë mbizotërimin për disa vite i sektorit privat në bujqësi, sektori shtetëror, i kooperativave bujqësore dhe fermave shtetërore (të ngritura sipas modelit të kolkozeve dhe sovkozeve sovjetike), u bë shpejt dominues në ekonominë bujqësore të vendit deri në fillim të viteve '90- të.

Gjatë kësaj periudhe u morën masa për zhvillimin e bujqësisë (megjithëse prioritet iu dha industrisë, e veçanërisht industrisë së rëndë), si tharja e bonifikimi i kënetave, hapja e tokave të reja, futja e mekanikës bujqësore, krijimi i sistemit të ujitjes artificiale, përdorimi i kimikateve dhe farërave të zgjedhura, përmirësimi racor etj., masa të cilat sollën rritjen e prodhimit bujqësor në vend. Kështu, në vitin 1950, bujqësia jepte 60,1% të Produktit të Përgjithshëm Bruto të vendit<sup>13</sup>

Gjithashtu, u morën masa për zhvillimin e infrastrukturës rurale si hapja e rrugëve të reja, elektrifikimi i vendit, furnizimi me ujë të pijshëm, u morën masa për zhdukjen e analfabetizmit e zhvillimin e arsimit e kulturës në të gjithë vendin, u morën masa për rritjen e kujdesit shëndetsor të popullsisë etj.

Megjithë zhvillimin që pati ekonomia bujqësore, pesha e roli i saj në ekonominë e vendit në vite erdhi duke u ulur. Kështu, në vitin 1960, bujqësia jepte 27,5% të PPB, ndërsa në vitin 1990, bujqësia kontribonte me 25,1% në PPB të vendit.<sup>14</sup>

Zbatimi i një sërë politikave jo të drejta, gjatë periudhës së regjimit komunist (1945-1990), si ndalimi me ligj i lëvizjes së popullsisë, politikat pronataliste që stimulonin rritjen e numrit të lindjeve në vend, sollën një mbipopullim të rajoneve malore e kodrinore që karakterizoheshin nga një zhvillim më i ulët social-ekonomik. Kjo popullsi në rritje, në përpjekjet e saj për mbijetesë, rriti presionin ndaj mjedisit duke degraduar vlerat e tij.

Kështu, u zvogëlua sipërfaqja me bimësisë natyrore, si pasojë e zgjerimit të tokave të punëshme në shpatet e kodrave dhe maleve. Nga 1.293.000 ha që zinin pyjet në vitin 1960, në vitin 1990 zinin 1.051.000 ha. Gjithashtu, u përgjysmua sipërfaqja e kullotave dhe sipërfaqja e livadheve u pakësua 10 herë<sup>15</sup>. Ndodhi dëmtimi gradual i strukturës së tokës nga përdorimi i tepërt i plehrave kimike dhe mosqarkullimi i kulturave bujqësore. Kjo, bëri që ekonomia bujqësore të mos arrinte të plotësonte më nevojat e popullsisë së vendit me produkte bujqësore dhe ashtu si gjithë sistemi komunist të hynte në një krizë të thellë, zgjidhja e së cilës do të ishte ndryshimi i regjimit në fuqi.

### ***1.2.2 Problematika e zhvillimit rural në Shqipëri pas vitit 1990***

Shqipëria, pas vitit 1990, bëri hapa të konsiderueshme për të lënë pas trashëgiminë e regjimit të vjetër dhe për të hyrë në rrugën e zhvillimit ekonomik. Ajo e filloi periudhën kalimtare drejt ekonomisë së tregut më 1991, në kushte më të vështira se vendet e tjera të

---

<sup>12</sup> *Historia e Shqipërisë*, vëll. IV, viti 1983, fq. 66-67.

<sup>13</sup> SHEME S. & QALLIAJ A., “*Tipologjia industriale dhe transformimet urbano-territoriale gjatë periudhës së tranzicionit*”, Studime Albanologjike, viti 2008, fq. 8.

<sup>14</sup> Po aty, fq.8

<sup>15</sup> *Vjetari Statistikor i Shqipërisë*, 1991, Tiranë 1992, fq.10

Europës Lindore dhe Qendrore. Faza e parë e kësaj periudhe ishte jashtëzakonisht kaotike dhe rezultoi me një përmbysje të menjëhershme ekonomike, rënie të prodhimit pothuajse sa gjysma e atij të vitit 1989 dhe me nivele të larta të inflacionit. Në tre vitet në vijim (1992-1995), ekonomia u rrit me rreth 9% në vit, por pa arritur asnjëherë prodhimin e viteve të mëparshëm.

Disa nga reformat kryesore që u morën pas vitit 1990-të ishin:

- privatizimi dhe shpërndarja e tokës,
- liberalizimi i tregut dhe i çmimeve,
- investimet në rehabilitimin e infrastrukturës, e veçanërisht të asaj ujtitese etj.

Ekonomia bujqësore jo rentabël, e dominuar nga fermat e mëdha shtetërore dhe ndërmarrjet bujqësore, pas vitit 1990 u shndërrua në ekonomi të karakterizuar nga mijëra ferma të vogla me bazë familjare.

Me gjithë ndryshimet e bëra, si rrjedhojë e veprimit të faktorëve të jashtëm (dërgesat e emigrantëve, ndihmat nga vende të zhvilluara, institucione ndërkombëtare, fondacione, organizata joqeveritare etj.), varfëria në zonat rurale është ende e pranishme. Pothuajse një në çdo tre shqiptarë mund të konsiderohet i varfër dhe katër në çdo pesë të varfër jetojnë në zonat rurale<sup>16</sup>.

Bujqësia shqiptare vazhdon të zërë një pozicion të rëndësishëm në zhvillimin kombëtar për sa i përket peshës së saj në Produktit të Përgjithshëm Bruto ( në vitin 2006 bujqësia jepte 20,5% të PPB)<sup>17</sup>, si dhe numrit të popullsisë së lidhur me të, rreth 46,5 %<sup>18</sup>. Kontributi i saj në vite ka ardhur duke u ulur. Në vitin 2010, bujqësia jepte 18% të PPB<sup>19</sup>.

Ne jemi një vend i varfër në tokë bujqësore, e cila zë rreth 24% të totalit të sipërfaqes, nga e cila vetëm 43% shtrihet në zonën fushore. Ky kufizim në sipërfaqen e tokës bujqësore kërkon një menaxhim më racional të saj. Pyjet zënë 37% të sipërfaqes, ndërsa kullotat 15%<sup>20</sup>. Problematika e bujqësisë ndërlikohet akoma më shumë duke pasur parasysh fragmentimin e madh të tokës: sipërfaqja e fermave në Shqipëri është mesatarisht 1,1 ha. Janë këto disa nga arsytet që, krahas prapambetjes së madhe historike, kanë bërë që rreth 50% e të varfërve të jenë fermerë dhe që varfëria rurale të jetë ulur me ritme më të ngadalta se varfëria urbane. Varfëria në zonat rurale të Shqipërisë shprehet qartë në:

- nivelin e ulët apo shumë të ulët të të ardhurave të njerëzve të varfër. Si pasojë e krizës globale dhe situatës së përgjithshme makroekonomike lidhur me normat e ulëta të rritjes që nga viti 2008, varfëria në Shqipëri është rritur. Pjesa e popullsisë, konsumi mujor real për frymë e së cilës është nën 4891 Lekë, u rrit nga 12,4 % në 2008 në 14,3 % në vitin 2012. Popullsia ekstremisht e varfër, e përcaktuar si personat që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore, është rritur nga 1,2 % në vitin

---

<sup>16</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Zhvillimi Rural si një Qasje Ndër-Sektoriale dhe Implikimet për Shqipërinë*, qershor 2010, fq. 16.

<sup>17</sup> SHEME S. & QALLIAJ A., “*Tipologjia industriale dhe transformimet urbano-territoriale gjatë periudhës së tranzicionit*”, Studime Albanologjike, viti 2008, fq 14

<sup>18</sup> INSTAT. *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*.

<sup>19</sup> *Vjetari statistikor 2011*, Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, fq 7

<sup>20</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Zhvillimi Rural si një Qasje Ndër-Sektoriale dhe Implikimet për Shqipërinë*, qershor 2010, fq.4.

2008 në 2,2% në vitin 2012. Po kështu, në vitin 2012, varfëria ekstreme është rritur në zonat urbane me 2,2% dhe zonat rurale me 2,3 %<sup>21</sup>.

- mungesën e shërbimeve shëndetësore dhe rrezikun e lartë nga sëmundjet. Shumica e shërbimeve shëndetësore nuk ofrohen në ambulancat e fshatrave, e sidomos të fshatrave malore, dhe kjo popullsi është e detyruar ti drejtohet qendrave shëndetësore në qytetet përkatëse apo në Tiranë.
- analfabetizmin dhe nivelin e ulët të shkollimit. Megjithë masat e marra si në aspektin legjislativ, por dhe administrativ, vihet re një nivel i ulët i arsimimit të popullsisë në zonat e thella rurale. Kjo i dedikohet infrastrukturës së dobët në këto zona, vështirësive të klimës (gjatë dimrit një pjesë e shkollave mbyllen), mungesës së shkollave në disa fshatra, distancës së largët të shkollave për disa fshatra etj.
- aksesin e kufizuar në institucionet vendim-marrëse qeveritare, shpeshherë dhe mosfunksionimi si duhet i organeve të pushtetit vendor në këto komuna.

Si një nga shkaqet kryesore të varfërisë në zonat rurale mund të konsiderohet sipërfaqja shumë e vogël e tokës së punueshme për frymë (1,2 dy për frymë).

Me gjithë masat e marra si nga pushteti qëndror dhe nga ai vendor, ende mbeten shumë probleme që lidhen me prodhimin bujqësor dhe ekonominë rurale në Shqipëri. Në ekonominë rurale ende ekzistojnë:

- sisteme prodhimi primitive;
- rendimente të ulëta;
- ferma me sipërfaqe shumë të vogël dhe të copëtuar në mesatarisht 4-5 parcela;
- infrastrukturë e prapambetur;
- sektori privat ende nuk e ka mbushur boshllëkun e lënë nga strukturat e vjetra shtetërore të përpunimit dhe tregtimit;
- mosrespektimi i plotë dhe korrekt i ligjeve të aprovuara;
- shfaqja e korrupsionit, i cili minon reformat dhe mungesa e transparencës etj.

Shumë pak përpjekje janë bërë përtej sektorit bujqësor dhe orientimit drejt aktiviteteve me karakter jobujqësor në zonat rurale, e për pasojë një numër i konsiderueshëm njerëzish mbeten pa punë dhe në varfëri ekstreme.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit u shënuan edhe disa ndikime serioze në gjendjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore si:

- shpyllëzimi i pakontrolluar;
- shtimi i numrit të bagëtive dhe, për rrjedhojë, mbikullotja;
- erozioni dhe degradimi i tokës, si rrjedhojë e braktisjes së tokave në shpat, të shpyllëzuara gjatë sistemit të kaluar;
- humbja e sipërfaqeve të tokës pjellore si pasojë e ekspansionit urban;
- ndotja e burimeve ujore dhe e tokave, si dhe përmytjet.

### ***1.2.3 Synimet e Strategjisë së Zhvillimit Rural në Shqipëri***

Pas vitit 1990, zhvillimi i qëndrueshëm rural ka qenë një nga përparësitë e programit të qeverive shqiptare në rrugën e përgatitjes së vendit për integrim në Bashkimin Europian.

---

<sup>21</sup> INSTAT dhe BB, Shqipëria: *Trend i varfërisë 2002-2005-2008-2012*, shtator 2013. fq.2

Në Strategjinë e Zhvillimit Rural të Shqipërisë,(SKZHR 2007-2013),janë parashikuar këto synime kryesore:

- rritja e aftësisë konkurruese të sektorit bujqësor dhe agro-ushqimor;
- mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit, duke menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore në zonat rurale;
- përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe nxitja e aktiviteteve të shumëllojshme ekonomike, nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës;
- zhvillimi i kapaciteteve institucionale për të planifikuar, menaxhuar dhe bashkërenduar në mënyrë efikase aktivitetet në mbështetje të zhvillimit rural<sup>22</sup>.

#### *A. Zhvillimi i agro-industrisë*

Zhvillimi i agro-industrisë përbën një aspekt të rëndësishëm për punësimin e njerëzve në fshat dhe rritjen e të ardhurave të tyre. Rreth 50% i buxhetit total për zhvillimin rural gjatë periudhës 2007-2013 kanë shkuar për sektorin bujqësor, agrobiznesin dhe pyjet<sup>23</sup>.

Rritje është shënuar në teknologjinë e prodhimit dhe në ndërtimin e objekteve agropërpunuese. Një pjesë e madhe e saj është financuar nga rritja e kredive bankare, të cilat sot përbëjnë rreth gjysmën e investimit të përgjithshëm në agro-industri.

Shqipëria ka tradita në prodhimin e produkteve ushqimore të cilat janë të njohura në tregjet evropiane, si vaji i ullirit, kosi, djathi i bardhë, mishi, molusqet etj. Në të ardhmen, sukcesi i zhvillimit të sektorit të përpunimit dhe aftësia për të konkurruar me sektorin dinamik të prodhimit të produkteve ushqimore në Evropë varen nga mundësitë për progres teknologjik, menaxhim, standardizim dhe marketing.

#### *B. Mjedisi rural*

Mjedisi rural është jo vetëm vendi ku kryhet veprimtaria e përditshme bujqësore apo blegtorale, por edhe një potencial i pashfrytëzueshëm, fitimprurës dhe afatgjatë.

Pyjet përbëjnë rreth 37% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit dhe përfaqësojnë një nga burimeve natyrore të rëndësishme<sup>24</sup>.

Pjesa më e madhe e kësaj trashëgimie natyrore të vendit tonë shtrihet në zonat rurale të saj. Prandaj, ruajtja e trashëgimisë natyrore, por dhe të trashëgimisë historike dhe kulturore të zonave rurale është me rëndësi për identitetin e tyre. Përtëritja dhe mbrojtja e trashëgimisë rurale duhet të jenë pjesë e pandarë e politikave dhe strategjive të zhvillimit rural.

Mbrojtja e kësaj trashëgimie do të sjellë përfitime ekonomike nga zhvillimi i turizmit. Mundësia e zbatimit të bujqësisë tradicionale që ruan tiparet e veçanta shqiptare, siç janë zonat me shumëllojshmëri të kulturave bujqësore, kultivimi i llojeve autoktone e produkteve bio, përbën një avantazh të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare.

Gjithashtu, bujqësitë tradicionale luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e shumëllojshmërisë së specieve të kafshëve të egra dhe bimëve, të zonave natyrore me vlerë të

---

<sup>22</sup> *Strategjia Ndër-Sektoriale e Zhvillimit Rural (SKZHR), 2007-2013, fq. 18.*

<sup>23</sup> Po aty, fq. 19.

<sup>24</sup> INSTAT 2010, *Shqipëria në shifra*. fq 48



madhe ekologjike, ruajnë habitatet specifike dhe biodiversitetin ekzistues të mjedisit bujqësor.

### *C. Cilësia e jetesës në zonat rurale*

Bujqësia në zonat rurale vazhdon të luajë rolin kryesor në punësim, biznes rural jobujqësor, të ardhurat, zbutjen e varfërisë dhe reduktimin e migracionit.

Veprimtaritë jobujqësore në zonat rurale janë të pakta dhe kryesisht joformale, prandaj zhvillimi i tyre është një mundësi e pashfrytëzuar dhe një potencial i madh për hapjen e vendeve të reja të punës, shtimin e të ardhurave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në fshat.

Krijimi i vendeve të punës jashtë sektorit bujqësor do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në zonat rurale në të ardhmen. Shumica e tyre mund të krijohen nga biznesi familjar apo bizneset e vogla, në sektorë që plotësojnë atë bujqësor (përpunimi dhe zejtaria lokale, turizmi etj.) dhe që synojnë zhvillimin e ndërmarrjeve, bazuar në avantazhet konkurruese që ka fshati (njohuritë tradicionale, fuqia punëtore, lëndët e para dhe kushtet e punës).

Turizmi bujqësor mund të jetë një burim të ardhurash të rëndësishme për fermat dhe bazë për zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara, si ato malore.

Mundësi e pashfrytëzuar është edhe zhvillimi i turizmit rural, që bazohet në trashëgiminë e pasur rurale, traditat dhe zakonet, folklorin dhe veshjet, tipin e banesës dhe mënyrën e jetesës, festat popullore lokale dhe panairt.

### *D. Zhvillimi i agro-turizmit*

Turizmi rural mund të kombinohet me atë bujqësor, sidomos të bujqësisë organike. Fermat që janë aktive në fushën e turizmit, mund t'i ofrojnë tregut turizmin ekologjik, si një mundësi e re që po bëhet popullore në gjithë Evropën.

Disa ferma, përreth Tiranës dhe qyteteve të tjera të mëdha, mund të jenë të hapura që të vizitohen nga turistët dhe qytetarët, të cilët qëndrojnë një ditë, blejnë prodhime bujqësore, konsumojnë diçka dhe mësojnë mbi jetën në fermë.

Krijimi i fermave të hapura, të cilat ofrojnë shërbime të lidhura me to, duhet të mbështeten fuqimisht nëpërmjet politikave të zhvillimit rural.

### *E. Zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe sociale*

Zhvillimi i qëndrueshëm rural realizohet jo vetëm nga investimet e drejtpërdrejta në fushën e bujqësisë, por edhe nga koordinimi i ndërhyrjeve të realizuara në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, mjedis dhe në fushën e përkrahjes sociale.

Zhvillimi i qëndrueshëm rural përbën strategjinë kryesore të qeverisë shqiptare për përmirësimin e cilësisë së jetës në fshat në mënyrë të tillë që fëmijëve t'u ofrohen mundësi të

barabarta në gjithë vendin<sup>25</sup>. Shpenzimet e sotme dominohen nga investimet në ferma dhe infrastrukturë.

Përveç kësaj, gjatë identifikimit të programeve të mësipërme, strategjia e zhvillimit rural gjithashtu shtrihet në sektorë si arsimit, shëndetësia, zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura, të cilët nuk mbulohen nga investimet lokale.

Këto aktivitete që bëjnë pjesë në zhvillimin rural do të monitorohen nëpërmjet sistemit të raportimit rural, të quajtur “rural proofing”, i njëjtë me atë të zhvilluar në vendet anëtare të BE-së. Secila nga Ministrinë e përfshira si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, duhet të dërgojnë një raport vjetor “rural proofing”, në cilin të paraqiten programet e tyre për zonat rurale, krahasuar me ato për zonat urbane, ku përfshihen edhe të dhënat për shpenzimet për frymë.

#### ***1.2.4 Reformat për nxitjen zhvillimit të qëndrueshëm rural në Shqipëri***

Për zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri me rëndësi është hartimi dhe zbatimi i politikave, si dhe krijimi i kuadrit ligjor që mundëson bujqësinë të operojë në mënyrë efikase dhe të suksesshme, si dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve për fermat e vogla, të sapokrijuara.

*Disa nga reformat e ndërmarra në këtë drejtim janë:*

##### *a. Decentralizimi i ekonomisë bujqësore*

Decentralizimi në zonat rurale ndikon në bujqësi, burimet natyrore, aktivitetet jobujqësore si dhe infrastrukturë. Deri tani, rolet e niveleve të ndryshme qeverisëse nuk kanë qenë të përcaktuara qartë, veçanërisht ato që lidhen me menaxhimin e fondeve dhe përgjegjësitë për shpenzimin e tyre.

Një numër përgjegjësish duhet të mbeten në nivelin qendror, si politikbërja, legjislacioni, marrëveshjet tregtare, akordimet e buxheteve, mbledhja e të dhënave, shërbimet veterinarë etj., por të tjerat si drejta për të vendosur në përputhje me ligjin taksat vendore, si dhe nivelin e tyre, planifikimi urban, mbrojtja e mjedisit, furnizimi me ujë të pijshëm, financimi dhe administrimi i shkollave, qendrave shëndetsore etj., duhet të jenë pjesë e qeverisjes vendore.

Kështu, decentralizimi do të ndikojë në nxitjen e iniciativës dhe çlirimin e energjive krijuese të fermerëve, duke çuar në hapjen e bizneseve të reja, shtimin e vendeve të punës dhe të të ardhurave.

Decentralizimi i një pjese të kompetencave dhe të taksave fiskale bën të mundur që pushteti lokal të ketë më tepër të ardhura dhe të jetë më i motivuar për gjetjen e rrugëve dhe mundësive për zhvillim<sup>26</sup>.

---

<sup>25</sup> *Strategjia Ndër-Sektoriale e Zhvillimit Rural (SKZHR), 2007-2013*, fq. 24.

<sup>26</sup> Laçi S., “*Gjeografia rurale*”, Tekst universitar. Shtëpia botuese “PROGRES”, viti 2005, fq. 43

b. Reforma e tokës

Shqipëria ndoshta ka shkuar më tej se çdo vend tjetër në rajon për të zbatuar një reformë sa më të plotë të tokës, si një parakusht për zhvillimin e tregjeve të tokës. Si rezultat i saj, peizazhi rural është transformuar në mënyre radikale që prej vitit 1990, kur afërsisht 98% e tokës bujqësore (546.000 ha) është shpërndarë për ekonomitë e vogla private. Proçesi i kalimit nga sistemi i pronës shtetërore dhe ekonomia e centralizuar në sistemin e pronësisë private dhe të ekonomisë së tregut të lirë është shoqëruar me shndërrimin e gjithanshëm të strukturave agrare<sup>27</sup>.

Kjo reformë ka transformuar fermën nga një strukturë e kolektivizuar dhe e komanduar, në një njësi plotësisht private, me ekonomi të vogla, të përbërë nga shumë parcela, që prodhojnë për konsum familjar dhe pak për treg.

Zbatimi i Ligjit për tokën ka bërë që bujqësia private në Shqipëri të dominohet nga fermat që veprojnë vetëm në nivel familjar dhe gjysmëfamiljar. Ato përbëjnë rreth 95 % të të gjithë fermave private<sup>28</sup>.

Kullotat dhe pyjet nuk kanë qenë në pjesën më të madhe pjesë e proçesit të privatizimit. Vetëm së fundmi, pronësia shtetërore është transferuar në komunitete dhe persona privatë. Pothuajse 29 ligje dhe rregullore në lidhje me administrimin e pronës së paluajtshme janë aprovuar në Shqipëri.

Legjislacioni në fuqi ofron një kuadër të përshtatshëm ligjor për funksionimin e tregut të tokës. Nuk ekzistojnë barrierat themelore ligjore që të pengojnë transaksionet e tokës si p.sh. blerja, shitja, qiradhënia, dhurimi apo trashëgimia. Sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme operon me 36 zyra në gjithë vendin.

Problematik mbetet ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit. Janë studiuar, vendosur në hartë, titulluar dhe regjistruar rreth 55% ose rreth 1,6 milion copëza të tokës rurale të shpërndarë. Megjithatë ende shfaqen probleme si:

- a. ngecja e proçesit të regjistrimit të pronës (shumica e fermerëve nuk kanë dokument pronësie;
- b. mungesa e një takse mbi pronën rurale, sidomos tokën bujqësore, e cila do të siguronte një burim të ardhurash për të mbështetur sistemin e administrimit dhe menaxhimit të pronës, si dhe do të shërbente si shtysë për të mos e lënë tokën djerr;
- c. ngecja e proçesit të kompensimit të ish-pronarëve. Proçesi i privatizimit të tokës bujqësore i filluar në 1991 nuk lejon kthimin e tokës atyre që e kishin në pronësi përpara shtetëzimit të saj më 1945, por lejon kompensimin e tyre. Qeveria ende nuk ka zbatuar procedurat për kompensimin me para të ish-pronarëve të tokës bujqësore, për rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm kërkesash gjenden të bllokuara në sistemin gjyqësor.

---

<sup>27</sup> Laçi S., *Aspekte të zbatimit të ligjit për tokën dhe të bujqësisë familjare*. Studime Albanologjike I. Viti 1997. fq. 177

<sup>28</sup> Po aty. fq. 180

c. *Infrastruktura rurale*

Infrastruktura përfshin të gjitha gjërat e siguruara nga shteti, të cilat, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, ndikojnë në zhvillimin e aktiviteteve prodhuese.

Kështu, transporti, furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimi shëndetësor, edukimi e shërbimet urbane janë konsideruar elementë të rëndësishëm të infrastrukturës. Në një ekonomi të përzier, me një sektor të rëndësishëm publik, zhvillimi i infrastrukturës duhet të planifikohet me kujdes dhe të sigurohet nga shteti<sup>29</sup>.

Infrastruktura është një nga faktorët më të rëndësishëm dhe për zhvillimin rural. Ajo u shërben qëllimeve të tilla si: përmirësimi i kushteve të jetesës, krijimi i aksesit në treg, përmirësimi i prodhimit bujqësor, tërheqja e investimeve etj.

Prania e rrugëve, ujit, energjisë elektrike dhe, në disa zona, e sistemit të ujitjes do të përbëjë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm rural. Mungesa e infrastrukturës fizike përmendet shpesh nga banorët e zonave të thella si një nga shkaqet kryesore të prapambetjes ekonomike dhe sociale.

Por, ekzistojnë shumë nevoja të tjera që lidhen me infrastrukturën sociale, të tilla si: shërbimi shëndetësor dhe arsimor, të cilët janë të një rëndësie të jashtëzakonshme, si dhe objektet kulturore e sportive, rëndësia e të cilave është e rendit të dytë. Infrastruktura rurale është më e zhvilluar në zonat fushore, më pak e zhvilluar në zonat kodrinore dhe shumë më pak e zhvilluar në zonat malore.

Kushtet e vështira të jetesës dhe shërbimet e kufizuara infrastrukturore u kanë imponuar banorëve të zonave malore lëvizje masive drejt ultësirës bregdetare dhe qendrave të mëdha urbane.

d. *Uji dhe higjiena*

Zonat rurale përballen me probleme serioze të furnizimit me ujë dhe të higjienës. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe të higjienës përbën një nga detyrat kryesore për përmirësimin e kushteve shëndetësore të popullsisë në zonat rurale.

Problemet më kryesore janë:

- degradimi i rrjetit fizik;
- shpërdorimi i ujit të pijshëm, si rezultat i përdorimit për bujqësinë;
- mungesa e kontrollit mbi konsumin faktik, përfshirë çmimin e ulët të ujit dhe nivelin e ulët të faturimit;
- mungesa e një strategjie për të përmirësuar shërbimet lidhur me furnizimin me ujë.

Përmirësimet në zonat rurale lidhen ngushtësisht me procesin e decentralizimit, i cili e kalon përgjegjësinë e furnizimit me ujë te pushteti vendor. Është përgatitur një strategji për furnizimin me ujë dhe higjienën në zonat rurale, e cila synon të ndryshojë mënyrën e sotme të furnizimit me ujë, por kjo duhet të mbështetet me kuadrin e ri institucional dhe të sigurojë mekanizmin rregullator, i cili garanton pjesëmarrjen e organizatave komunitare në menaxhimin dhe vendim-marrjen në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm.

---

<sup>29</sup> Laçi S., "Gjeografia rurale", Tekst universitar. Shtëpia botuese "PROGRES", viti 2005, fq. 55.

*e. Ujitja dhe kullimi*

Proçesi i rehabilitimit të sistemeve të ujitjes dhe kullimit duhet të vazhdojë dhe të shtrihet në të gjitha rajonet bujqësore të vendit. Vëmendja duhet të përqendrohet në ndërtimin dhe vënien në funksionim të kanaleve të mëdha. Përveç kësaj, fermerët duhet të përfitojnë më shumë këshillim në lidhje me përdorimin efikas të ujit për ujitje, përmirësimin e menaxhimit të burimeve, si dhe administrimin e qëndrueshëm të ujërave.

*f. Rrugët rurale*

Rrjeti i rrugëve rurale është i varfër dhe në kushte jo të mira. Disa nga rrugët rurale ekzistuese janë rikonstruktuar, por cilësia e punimeve lë shumë për të dëshiruar. Është neglizhuar mirëmbajtja e tyre dhe sot ato paraqesin vështirësi si në transportin e njerëzve dhe në atë të mallrave.

Një numër i konsiderueshëm rrugësh rurale janë përmirësuar me asistencën e donatorëve gjatë viteve të fundit si Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Banka Botërore etj. Pjesa më e madhe e punës për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve rurale është decentralizuar në nivel komuniteti.

Edhe për rrugët e reja, shumë pak është investuar për mirëmbajtje, si rezultat i mungesës së fondeve, kapaciteteve dhe organizimit. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale është me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik e social të zonave rurale.

Rrjeti i rrugëve u krijon banorëve akses për informacion dhe tregje, si dhe në shërbimin arsimor dhe shëndetësor, por gjithashtu bën të mundur edhe lëvizjen e lirë të njerëzve drejt zonave ku ka më shumë shanse për të siguruar të ardhura për jetesën. Rrugët e kalueshme lehtësojnë kryerjen e shërbimeve sociale dhe janë një parakusht për thithjen e investimeve vendëse dhe të huaja në këto zona.

Për përmirësimin e rrugëve rurale është e domosdoshme të merren këto masa:

- krijimi i një strukture organizative më efektive, e cila të përgjigjet për sistemin e rrugëve;
- sigurimi i financimeve kryesisht për mirëmbajtje;
- rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale.

*g. Furnizimi me energji elektrike*

Aksesi në rrjetin e furnizimit me energji është një faktor tjetër i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm. Problemet që lidhen me furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë vazhdojnë të pengojnë zhvillimin rural, veçanërisht bizneset dhe industrinë rurale.

Rrjeti i furnizimit me energji ka një shtrirje të gjerë, por pjesa më e madhe e zonave rurale marrin energji vetëm për disa orë në ditë, si pasojë e ndërprerjeve të energjisë apo problemeve në furnizim.

Spektori i mirëmbajtjes, shtrirjes dhe përmirësimit të rrjetit energjetik nuk funksionon normalisht. Për rrjedhojë ndërprerjet mbeten ende të shpeshta dhe zonat rurale furnizohen më me pak energji sesa ato urbane. Përmirësimi i furnizimit me energji në zonat rurale është domosdoshmëri.

Mungesa e energjisë përmendet shpesh si një nga faktorët kryesorë që pengon zhvillimin e biznesit. Ajo vështirëson dhe funksionimin dhe zgjerimin e shërbimeve sociale.

Për ta përmirësuar situatën është e nevojshme që të merren këto masa:

- përmirësimi i furnizimit me energji, nëpërmjet investimeve të mëtjshme në centralet e prodhimit të energjisë ose rritjes së sasisë së importit;
- funksionimi më efikas dhe më pak i kushtueshëm i KESH-it;
- nivele më të mira të arkëtimit të faturave të energjisë, inspektim e penalizim në rastet e shfrytëzimit të paligjshëm të energjisë;
- vënia në shfrytëzim e burimeve alternative të energjisë dhe plane të veçanta veprimi për zonat rurale.

### ***1.2.5 Zhvillimi rural përtej sektorit bujqësor***

Sektorët jobujqësor janë pjesë të rëndësishme të ekonomisë rurale. Ndërkohë që në zonat rurale bujqësia vazhdon të luajë rolin kryesor, është e nevojshme të zhvillohen biznese të tjera, veçanërisht për zënie me punë të fuqisë punëtore, uljen e papunësisë, shtimin e burimeve dhe të sasisë së të ardhurave. Gjithashtu, zhvillimi i aktiviteteve me karakter jobujqësor do të ndikojë në kufizimin e eksodit rural, përmirësimin e kushteve të përgjithshme të biznesit në të gjitha fushat, duke i bërë hapësirat rurale më tërheqëse për veprimtaritë ekonomike, shërbimet, popullsinë dhe turistët.

Zhvillimi i sotëm i sektorit jobujqësor është minimal dhe ka natyrë informale. Ai kufizohet në ndërtime të dorës së dytë (të cilësisë së ulët), shërbime të vogla teknike dhe personale. Vetëm rreth 20% e këtyre ndërmarrjeve agro- përpunuese janë të shtrira në zonat rurale. Vetëm një pjesë e vogël e prodhimit vendas përpunohet në Shqipëri nga agro-industria, e cila zë vetëm 8% të GDP dhe punëson 5% të fuqisë punëtore në nivel kombëtar<sup>30</sup>.

Në vitin 2011 ekzistonin rreth 200 agro-ndërmarrje, të cilat operonin me investime relativisht të mëdha në prodhimin e pijeve freskuese, vajit të ullirit, verës dhe përpunimin e qumështit, mishit etj<sup>31</sup>. Zhvillimi i potencialeve agro-përpunuese është me rëndësi të veçantë për nxitjen e zhvillimit dhe vazhdueshmë të sektorit bujqësor, nëpërmjet rritjes së kërkesës për lëndë të parë të zonave rurale, duke mundësuar rritjen e të punësuarve.

Cilësia e lartë e produkteve të përpunuara dhe përmirësimi i marketingut të tyre do të rrisin aftësitë konkurruese të Shqipërisë në tregjet europiane dhe të ndikojnë në gjetjen hapësirave të reja tregtare në botë. Interes të veçantë për tregjet e huaja paraqesin prodhimet organike, promovimi i të cilave do të çojë në zotërimin e segmenteve të rëndësishme në treg. Pjesa më e madhe e fabrikave përpunuese janë të vogla, dhe ndikimi i tyre në marketing, zakonisht paraqitet shumë i lokalizuar. Marketingu kryhet nga disa tregtarë privatë dhe nëpërmjet tregjeve lokale. Fuqia negociuese e fermerëve shqiptarë është e vogël, si pasojë e mungesës së informacionit mbi tregjet, çmimet dhe mundësitë të kufizuara për shitje. Që tregjet të funksionojnë në mënyrë më efektive, me rëndësi të veçantë është përmirësimi i infrastrukturës së tyre dhe i informacionit lidhur me to, në të gjitha nivelet.

---

<sup>30</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Zhvillimi Rural si një Qasje Ndër-Sektoriale dhe Implikimet për Shqipërinë*, qershor 2010, fq. 14

<sup>31</sup> *Vjetari statistikor 2011*, Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, fq. 32

Shqipëria ka mundësi për të eksploruar disa tregje bujqësore lidhur me bimët mjekësore, produktet e ullirit, mjalti dhe produktet e tjera të bletarisë, djathërat, mishi i tymosur etj. Rëndësi ka që këto tregje të arrihen e të zotërohen në mënyrë të qëndrueshme. Veçanërisht për bimët mjekësore, zhvillimi duhet të orientohet drejt kultivimit, më shumë sesa drejt grumbullimit të tyre në gjendje të egër, me qëllim që të shmanget rreziku i zhdukjes së tyre si pasuri natyrore. Përpunimi i tyre në Shqipëri si bimë kurative do ta rriste interesin e popullsisë për to.

### ***1.2.6 Financimi rural***

Mungesa e financimit të vazhdueshëm të investimeve, përbën një pengesë themelore për zhvillimin rural të qëndrueshëm në Shqipëri. Disa nga faktorët frenues për zhvillimin e tregjeve financiare rurale janë:

- kostot e larta të transaksioneve dhe rreziqet e mëdha që mbart financimi rural;
- informacioni jo i plotë mbi klientët potencialë dhe mundësitë për huadhënie në zonat rurale;
- kuadri i varfër ligjor dhe institucional për transaksione të sigurta.

Këto pengesa i kanë mbajtur bankat komerciale të instaluar në qendrat urbane dhe të fokusuar në financimin urban, duke ngadalësuar kështu, zhvillimin e shërbimeve financiare dhe të agjentëve financiarë. Pavarësisht se zhvillimi i shërbimeve financiare në hapësirën rurale ka qenë i ngadalshëm, disa prirje inkurajuese kanë filluar të shfaqen. Disa banka kanë filluar të aplikojnë kredinë e gjelbërt apo agro në ndihmë të fermerëve, por interesat e tyre janë ende të larta.

Shumë iniciativa të financuara nga Banka Botërore, IFAD, IFC dhe organizata joqeveritare kanë hedhur bazat për shtrirjen e një sistemi të qëndrueshëm të financimit rural. Iniciativat e hershme të huadhënies për fermerët dhe sipërmarrës të tjerë ruralë, nëpërmjet fondeve të kredisë së fshatit, po kompletohen tani me përpjekje të përqendruara për të zhvilluar një sistem kombëtar të shoqatave të kursim kredisë, i cili do të mundësojë depozitimin e kursimeve, si dhe shërbimet e huadhënies.

Gjatë tri viteve të ardhshme 2010-2013, fusha e mbulimit të popullsisë rurale me shërbime të tilla do të zgjerohet, por numri i ekonomive bujqësore rurale që do të kenë akses në kredi, ende do të jetë më pak se 10% të totalit<sup>32</sup>. Paralel me zhvillimin e sistemit kombëtar të institucioneve të mikro-kredisë, inkurajuese duken edhe sinjalet që tregojnë se sektori bankar tregtar po fillon të shtrihet përtej bazës së tij të sotme urbane. Kjo shtrirje ka ardhur në përgjigje të zhvillimit të përgjithshëm të tregjeve financiare shqiptare. Degë bankash po shfaqen në zonat rurale Raiffaissen Bank, Banka Kombëtare Tregtare, Credins Bank etj.

Dërgesat e parave nga emigrantët mund të shërbejnë si një mjet tjetër për të investuar në zonat rurale. Ato ndihmojnë për të filluar një biznes, por, paralelisht me këtë, është e nevojshme që bankat apo institucionet e kredisë të ofrojnë burime financiare të mjaftueshme për të filluar biznese me orientim jobujqësor në zonat rurale. Kjo do të nxiste zhvillimin e këtyre zonave.

---

<sup>32</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Zhvillimi Rural si një Qasje Ndër-Sektoriale dhe Implikimet për Shqipërinë*, qershor 2010, fq.16.

Qeveria duhet të marrë parasysh krijimin e lehtësirave, si në aspektin e taksave, ashtu edhe në atë të subvencioneve dhe kredive të buta për bizneset e interesuar për të investuar në zonat rurale.

Pas vitit 1990 ka ndodhur një ulje e vazhdueshme në nivelin e kualifikimit të fuqisë punëtore rurale, si pasojë e fenomenit të plakjes së popullsisë, migrimit, pamjaftueshmërisë së shkollave të arsimit profesional dhe të kushteve për arsimim të vazhdueshëm, trajnim të të rinjve etj. Në këto rrethana, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë formimit profesional, në funksion të përgatitjes së një fuqie punëtore më të kualifikuar në zonat rurale. Kjo do të ndikonte edhe në krijimin e alternativave të reja të punësimit dhe, për rrjedhojë, zvogëlimin e numrit të të papunëve në fshat.

Për të nxitur zhvillimin e bizneseve rurale me karakter jobujqësor, sugjerohet të mbahet parasysh sa vijon:

- ndërtimi i kapaciteteve dhe mbështetja për sipërmarrësit në hapësirat e tyre për prodhim dhe punësim;
- arsimimi dhe trajnimi i fuqisë punëtore në drejtim të aftësive teknike dhe biznesit;
- futja e teknologjive me kosto të ulët, të përshtatshme për të shfrytëzuar oportunitetet e identifikuar;
- mbështetja për zhvillimin e mundësive për biznes dhe instrumenteve të tregut për zonat rurale;
- ndërtimi i kapaciteteve institucionale në fushat e pushtetit vendor, organizatave të shoqërisë civile dhe shërbimeve financiare rurale;
- zgjidhja e çështjeve ligjore lidhur me pronën, disiplinimin mjediseve institucionale dhe komerciale që pengojnë zhvillimin e biznesit.

### ***1.2.7 Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore***

Burimet natyrore në Shqipëri janë të shumta, por ato janë keqpërdorur. Disa nga problemet që shfaqen janë: erozioni i tokës e degradimi i saj, përdorimi i tokës bujqësore për truall ndërtimi, ndotja e burimeve ujore, tokave dhe ajrit, prerja pa kriter e pyjeve, mbikullotja sidomos në zonat kodrinore-malore, rënia e zjarreve në zonat pyjore etj.

Para vitit 1990, ndotja ishte kryesisht industriale dhe bujqësore. Burimi kryesor i ndotjes vinte kryesisht nga përdorimi i teknologjive të vjetra në industri dhe sasia e tepruar e plehrave dhe pesticideve në bujqësi. Burim ndotje ishin ndërmarrjet industriale që përdornin lëndë helmuese, si p.sh. lëndë organike ose inorganike të arsenikut, kromit, mërkurit, si dhe pesticidet dhe stoqet e lëndëve kimike. Gjatë asaj kohe, prej industrisë shkarkoheshin drejtpërdrejt në lumenj rreth  $250 \times 106 \text{ m}^3/\text{vit}$  mbeturina të lëngëta. Meqë rreth 65% e popullsisë jetonte e shpërndarë nëpër fshatra ndotja urbane mund të konsiderohej e pakët, vetëm në zona shumë të kufizuara.

Pas vitit 1990, shumë prej aktiviteteve industriale u mbyllën dhe përdorimi i kimikateve në bujqësi u pakësua dukshëm. Lëvizja masive e popullsisë drejt qendrave të mëdha të Ulëtësirës Perëndimore, si në Tiranë, Durrës etj. bëri që ndotja urbane të rritet shumë. Po kështu, nga kjo lëvizje e lirë, masive dhe kaotike, u prekën dhe tokat bujqësore, në të cilat u ndërtuan shumë shtëpi banimi apo ndërtesa me karakter ekonomik.

Mbi 80% e ujërave të lumenjve në Shqipëri kanë përgjithësisht cilësi të lartë. Sipas Ministrisë së Mjedisit, me përjashtim të Ishmit dhe Semanit, ushqyesit tek të gjithë lumenjtë



e tjerë ishin të ulët. Pas vitit 2000, vihet re rritje e ndotjes së ujrave të lumenjve si nga mbetjet urbane e industriale, por dhe nga shfrytëzimi i shtratit të tyre për nxjerjen e inerteve.

Rrethet me nivele të larta të varfërisë kanë sipërfaqe më të mëdha të shpyllëzuara dhe të prekura nga erozioni. Kjo tregon lidhjen ndërmjet varfërisë dhe degradimit të tokës. Shpyllëzimi ndikon dhe në rezervat ujore malore, duke reduktuar sasinë rrjedhëse të lumenjve dhe dike rritur rrezikun e përmytjeve gjatë periudhave me reshjeve të shumta.

Sipas hartës të intensitetit të erozionit në Shqipëri, territoret jo të degraduara ose pa erozion zënë rreth 48 % të sipërfaqes, ndërsa territoret me vlera të larta të erozionit përfshijnë 14 % të sipërfaqes e me vlera shumë të larta deri në shkretëtirizim zënë 10 % të sipërfaqes së vendit tonë<sup>33</sup>. Pjesa tjetër dallohet për vlera të ulëta ose mesatare të erozionit. Gjithë lumenjtë e vendit tonë mesatarisht çojnë në det mbi 65 milion tonë prurje të ngurta<sup>34</sup>.

Rezervat pyjore, megjithëse të pakësuara e dëmtuara shumë deri më sot, mund të shfrytëzohen për zhvillimin e sektorit të ekonomisë pyjore, që do të kontribuonte në rimëkëmbjen e ekonomisë rurale dhe të asaj kombëtare, do të gjeneronte të ardhura nga shitja e lëndës drusore, do të rriste punësimin rural e përfitime të shumta për mjedisin e peizazhin.

Menaxhimi më i mirë i pyjeve do të mund të arrihet nëpërmjet:

- rehabilitimit të sipërfaqeve pyjore dhe të kullotave të degraduara, në pronësi të shtetit apo komuniteteve vendore;
- sensibilizimi i popullsisë rurale dhe i subjekteve që operojnë në sektorin e pyjeve për shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre;
- nxitja e ruajtjes së ekosistemeve pyjore natyrore.

Ndërmarrja e hapave për të mbrojtur dhe përtërirë rezervat pyjore do të ndikojë shumë pozitivisht për zhvillimin e ardhshëm të sektorit bujqësor dhe të ekonomisë rurale, sidomos në kushtet e Shqipërisë, ku sipërfaqja e tokës së punueshme është e kufizuar.

Disa nga masat që duhen marrë për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe ekonomisë pyjore janë:

- krijimi i mundësive të reja për gjenerim të ardhurash dhe akses në treg për komunitetet e varfra rurale brenda kuadrit të menaxhimit të qëndrueshëm në aspektin ekologjik, ekonomik dhe social të pyjeve dhe kullotave, përfshirë aksesin në teknologjitë e informacionit;
- rehabilitimi i integruar i pyjeve, kullotave dhe tokave në shpat, të erodura dhe degraduara, nëpërmjet menaxhimit në nivel njësisht prodhuese, komunash e deri rajonal;
- stabilizimi i biodiversitetit dhe mbrojtja e mjedisit nëpërmjet konservimit të florës dhe faunë, kryesisht në zonat e mbrojtura, si dhe ndërgjegjësimi popullsisë për mbrojtjen e natyrës së egër;
- fuqizimi i kapaciteteve institucionale të menaxhimit të burimeve natyrore dhe agjencive të mjedisit në nivel qendror, rajonal dhe vendor, si dhe sigurimi i mbështetjes për krijimin e një kuadri koherent ligjor, politik dhe ekonomik për decentralizimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave.

---

<sup>33</sup> Qiriaz P., *Degradimi dhe shkretëtirizimi i peizazheve në vendin tonë si rrezik i vazhdueshëm dhe përherë kërcënues*. Studime Albanologjike IV, viti 2010, fq. 79.

<sup>34</sup> Po aty.

Për zhvillimin e qëndrueshëm rural kërkohet të hartohen *strategji*, në kuadër të cilave të parashikohet zbatimi i masave të tilla si:

- a. mbështetja e mëtejshme e reformave për të krijuar një mjedis politik favorizues për zhvillimin e zonave rurale;
- b. vazhdimi i regjistrimit të tokës dhe zhvillimi i tregjeve të tokës;
- c. rritja e iniciativave komunitare që synojnë përmirësimin e infrastrukturës rurale, përfshirë ujitjen, furnizimin me ujë të pijshëm, menaxhimin e tokës për kullotë dhe rrugët rurale;
- d. fuqizimi i mëtejshëm i shërbimeve mbështetëse rurale me fokus qendror në ato bujqësore dhe sigurinë ushqimore, por pa përjashtuar aktivitetet e orientuara drejt sektorëve jobujqësor.

Për zhvillimin e qëndrueshëm rural, është e rëndësishme të tregohet kujdes i veçantë për përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë, nëpërmjet ngritjes së një infrastrukture fizike (rrugë, ujësjellës, kanalizime, energji elektrike) dhe sociale (qendra shëndetësore, objekte arsimore, kulturore dhe sportive etj.) të krahasueshme me ato të zonave urbane. Këto janë parashikuar në Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm Rural 2007-2013. Dokumenti është përgatitur sipas direktivave të përshkruara në nenin 11 të Rregullores së Këshillit Evropian, për mbështetjen e zhvillimit rural. Plani bazohet në parimet e menaxhimit të burimeve natyrore të përsëritshme dhe i kushtonte vëmendje të veçantë ruajtjes së peizazhit kulturor, mbrojtjes së mjedisit, mirëmbajtjes së vendbanimeve dhe ruajtjes së identitetit rural.

Zhvillimi i qëndrueshëm rural në Shqipëri ka disa avantazhe, që lidhen me: pozicionin e favorshëm gjeografik të saj, nivelin e ulët të pagave, popullsi rurale relativisht të arsimuar, një pjesë e së cilës ka punuar në vende të tjera europiane, aftësia e fermerëve shqiptarë për t'iu përshtatur ndryshimeve, tokë pjellore dhe klimë e favorshme në disa prej rajoneve.

Prandaj, është e rëndësishme jo vetëm hartimi i strategjive, por zbatimi i tyre korrekt për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së Shqipërisë, për një integrim dinjitoz të saj në BE. Projektet dhe programet e zhvillimit rural, si pjesë e rëndësishme e programeve të zhvillimit të vendit, duhen parë me përparësi. Ato do të bëjnë të mundur futjen e aktiviteteve të reja, punësimin e njerëzve, rritjen e prodhimit, furnizimin e tregut të brendshëm me produkte të prodhuara në vend etj<sup>35</sup>.

---

<sup>35</sup> Laçi S., "Gjeografia rurale", Tekst universitar. Shtëpia botuese "PROGRES", viti 2005, fq. 41.

## KAPITULLI II

### POZITA, KUSHTET DHE PASURITË NATYRORE, SI PREMISA PËR ZHVILLIMIN RURAL

#### II.1 Pozita gjeografike, kufijtë, përmasat dhe organizimi administrativ

##### ➤ *Komuna Dajt*

Komuna e Dajtit shtrihet në verilindje të qytetit të Tiranës, në sektorin qëndror të vargmalit perëndimor Krujë-Dajt, ndërmjet luginës së Zezës në veriperëndim dhe asaj të Skoranës në juglindje. Si kufi veriperëndimor i saj shërben gryka e Tujanit, në juglindje gryka e Murdharit, në verilindje shtrihet deri në lugun e Deries e përroit të Tiranës, dhe në jugperëndim kufizohet me pellgun e Tiranës.

Si njësi administrative, komuna bën pjesë në rrethin e Tiranës dhe qarkun me të njëjtin emër. Ajo përbëhet nga 13 fshatra: Linzë, Qafmollë, Shkallë, Murth, Darshe, Selbë, Priskë, Surrel, Lanabregas, Tufinë, Ferraj, Brarë dhe Tujan. Qendra e komunës është në fshatin Linzë, që ndodhet 12 km larg qytetit të Tiranës, 50 km nga aeroporti Nënë Tereza dhe 60 km nga porti i Durrësit.

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës është 11602 ha. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 5166 ha, nga e cila 3440.7 ha janë tokë e papunueshme dhe rreth 1725.3 ha tokë e punueshme<sup>36</sup>. Komuna ka 20139 banorë, të organizuar në 4847 familje<sup>37</sup>.

Popullsia e komunës merret kryesisht me ekonomi bujqësore, ku rëndësi të veçantë ka blegtoria, e cila mbështetet në sipërfaqet e konsiderueshme me pyje dhe kullota. Sektorë me perspektivë për të ardhmen e komunës janë turizmi, artizanati, agroindustria, ndërtimi etj.

##### ➤ *Komuna Bërzhitë*

Pjesa më e madhe e komunës Bërzhitë shtrihet në zonën kodrinore të Krrabës, midis Erzenit të mesëm (kufi verior) dhe Shkumbinit të mesëm (kufi jugor). Kufiri lindor kalon në veriperëndim të fshatit Pëllumbas, duke ndarë komunën me Malësinë e Çermenikës.

Komuna është krijuar si njësi administrative në 1992, nga bashkimi i ish-kooperativave të Bërzhitës, Killojkës dhe Myshqetasë. Deri në vitin 1997, ajo bënte pjesë në komunën Krrabë-Bërzhitë. Pas këtij viti, komuna Bërzhitë do të ishte një njësi më vete. Ajo bën pjesë në rrethin dhe qarkun e Tiranës dhe përbëhet nga 14 fshatra<sup>38</sup>: Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Ibë e Sipërme, Pëllumbas, Mihajas, Cirmë, Kusë, Fravesh, Killojkë, Pashkashesh, Lugë, Shalqizë dhe Rozaverë.

---

<sup>36</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, INSTAT, Tiranë, 2011, fq. 84.

<sup>37</sup> Po aty, fq. 90

<sup>38</sup> Jepen edhe 12 fshatra, për shkak të bashkimit të katër prej tyre në dy: Mihajas + Cirmë dhe Lugë + Shalqizë.

Komuna shtrihet në rreth 5793,9 ha, në të dy anët e rrugës nacionale Tiranë–Elbasan. Qendra e saj ndodhet në fshatin Bërzhitë, 16 km në juglindje të kryeqytetit<sup>39</sup>. Ajo ka 4973 banorë<sup>40</sup>, pjesa më e madhe autoktonë, të organizuar në 1095 familje<sup>41</sup>.

Krahas ekonomisë bujqësore, popullsia e komunës merret me ndërtim, tregti dhe restoranteri-turizëm. Interes për zhvillim në të ardhmen paraqet dhe artizanati dhe agroindustria.

Pozita gjeografike e dy komunave është shumë e favorshme për banim dhe veprimtari ekonomike të shumëllojshme. Ato bëjnë pjesë në Rajonin Perëndimor të Shqipërisë, me kushtet më të favorshme fiziko-gjeografike dhe më i zhvilluari në vend, ndodhen shumë pranë kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës (12km/16km), pranë aeroportit N.Tereza (50km/54km) e pranë portit më të madh të vendit, portit të Durrësit (60km/64km).

Të dyja komunat janë të favorizuara nga afërsia me qytetin e Tiranës, që përbën një treg të madh për produktet bujqësore dhe blegtorale, krijon mundësi të gjera punësimi në sektorët jobujqësor (ndërtim, tregti etj.), ka një kontingjent të madh njerëzish që në fundjavë frekuentojnë restorantet dhe baret e hapësirës periurbane dhe rurale. Ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan do të krijojë mundësi të reja zhvillimi për komunën e Bërzhitës.

Distanca midis vendbanimeve dhe me qendrën e komunës është favorizuese për të dyja njësitë, për bashkëpunimin dhe shfrytëzimin racional të burimeve të brendshme natyrore dhe humane. Kjo pozitë e tyre është shumë e favorshme për zhvillimin e turizmit. Ai shihet si një ndër burimet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik këtyre komunave.


Në strategjitë e tyre të zhvillimit ato parashikojnë krijimin e bazave për një turizëm energjik, të integruar dhe të qëndrueshëm, që do të mbështetet në burimet natyrore, humane dhe infrastrukturën në proces modernizimi etj, i cili do të sigurojë më shumë vende pune dhe të ardhura për banorët e të dy komunave, duke ndikuar në stabilitetin e popullsisë, mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

---


<sup>39</sup> *Plani i Zhvillimit të komunës Bërzhitë*. Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

<sup>40</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, INSTAT, Tiranë, 2011, fq. 84

<sup>41</sup> Po aty, fq. 90.



Harta II.1 Pozita administrative e komunave Dajt dhe Bërzhitë



Harta II.2 Pozita geografike e komunave Dajt dhe Bërzhitë

## **II.2 Karakteristikat e mjedisit natyror dhe roli i tyre në zhvillim**

Trajtimi i mjedisit natyror është me rëndësi të veçantë në kushtet e zhvillimeve demografike, sociale dhe ekonomike të viteve të fundit, kur janë shfaqur probleme të mprehta lidhur me shfrytëzimin e burimeve natyrore. Analiza gjeografike do të ndihmonte në vlerësimin e resurseve, hartimin planeve të përdorimit të tokës, rregullimit të territorit, planifikimit e zhvillimit të integruar dhe të qëndrueshëm të komunave.

Gjithashtu, ajo do të kontribuonte në hartimin e politikave dhe të strategjive të përtëritjes rurale, korrigjimin e gabimeve të bëra lidhur me shfrytëzimin e burimeve gjatë periudhës së zhvillimeve joformale dhe rivendosjen e ekuilibrit ekologjik.

Në këtë kuadër, ruajtja e bashkëveprimit të qëndrueshëm të faktorit human me natyrën, me qëllim mbrojtjen e peizazheve tokësore dhe ujore të periferisë, përbën një hap të rëndësishëm zhvillimi për të ardhmen.

### ***II.2.1 Ndërtimi gjeologjik dhe pasuritë nëntokësore në funksion të zhvillimit të sektorit sekondar***

Të dy komunat e marra në studim, dallohen për një larmishmëri të ndërtimit gjeologjik të tyre. Territori i tyre është ndërtuar kryesisht nga shkëmbinj terrigjenë (flishe) dhe karbonatikë (gëlqerorë dhe gëlqeror-dolomite).

Me këtë përbërje gjeologjike lidhen minerale si boksitet, qymyrguri, rezervat e gurit gëlqeror, inerteve etj, mbi bazën e të cilave është zhvilluar industria e material-ndërtimit, prodhimi i asfaltit, nxjerrjes së qymyrgurit etj, që ka një kontribut modest në ekonominë e komunave.

#### **➤ *Komuna Dajt***

Territori i komunës shtrihet në zonat tektonike të Krujës, Krastë-Cukalit dhe Mirditës (në skajin lindor). Në të mbizotërojnë shkëmbinj të terrigjenë flishorë të kretak-paleogjenit. Molasat e tortonianit shtrihen në jugperëndim të vargut malor Krujë Dajt, gjatë krahut verilindor të sinklinalit të Tiranës, midis grykave të Skoranës dhe të Tujanit<sup>42</sup>.

Pra, litologjia e zonës ku shtrihet komuna Dajt përfaqësohet nga dy komplekse të veçanta:

- shkëmbinj terrigjenë (flishe),
- shkëmbinj karbonatikë (gëlqerorë dhe gëlqeror-dolomitë).

Sipërfaqen më të madhe në të zënë shkëmbinj të terrigjenë si alevrolite, argjilo-ranorë, mergele etj, të cilët formojnë relieve kodrinore-malore dhe janë të ndjeshëm ndaj erozionit, veçanërisht në pjerrësi të mëdha.

Shkëmbinj të karbonatikë ndërtojnë kurrizet malore të vargut Krujë-Dajt. Këta shkëmbinj janë të dukshëm sidomos në pjerrësitë e kreshtave, rrëpirat dhe pjesët shkëmbore të këtyre vargjeve.

---

<sup>42</sup> Gruda Gj., Hoxha A., *Veçoritë morfologjike dhe rreziqet natyrore të PK të Dajtit*. Studime Albanologjike, Tiranë 2009. fq. 350.

Roli kryesor në evolucionin e relievit të kësaj zone u përket ngritjeve tektonike të strukturave të reja, të cilat kanë nxitur karakterin seleksionues të dukurive reliev-formuese të jashtme. Rrjedhojë e këtyre ngritjeve është ulja e vazhdueshme e nivelit bazë të erozionit të lumit Erzen dhe Ishëm, të cilët kanë përparuar me erozion regresiv, duke krijuar vlera të mëdha të dendësisë së copëtimit, kurse thellësia e këtij copëtimi arrin vlera të vogla deri në mesatare. Krejt ndryshe paraqitet relievi i modeluar në strukturat karbonatike, në të cilat ka mbizotëruar erozioni regresiv në thellësi të tyre, duke çuar në formimin e grykave të shumta<sup>43</sup>.

Kalimi tërthor në strukturat gëlqerore, të lumenjve Erzen dhe Ishëm, ka çuar në formimin e gryk-luginave tërthore si ajo e Priskës, Tujanit, Skoranës etj.

Lumenjtë Erzen dhe Tërkuzë e fillojnë rrjedhjen nga Mali me Gropa dhe prekin anën verilindore të malit Dajt. Erozioni i këtyre lumenjve është shumë i shprehur në shkëmbinjtë e butë terrigjenë, ndërsa përparon shumë ngadalë në shkëmbinjtë e fortë karbonatikë. Midis territoreve të degraduara e të paqëndrueshme janë Bastari, Qafmolla, Derja, Shkalla etj.<sup>44</sup>

Faktorët morfostrukturorë kanë luajtur rolin vendimtar në evolucionin e relievit, duke nxitur njëkohësisht veprimtarinë e dukurive morfogjenetike të jashtme.

Kjo paqëndrueshmëri shkaktohet dhe nga karakteristikat klimatike të zonës, si:

- ❖ klima mesdhetare paramalore, me dimër të ftohtë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë;
- ❖ amplituda e theksuar e temperaturave mesatare vjetore (15-22°C) dhe ditore (10-12°C);
- ❖ periudha relativisht e gjatë me ngrica;
- ❖ regjimi mesdhetar dhe karakteri i rrëmbyeshëm i reshjeve.

Karakteristikat e klimës së kësaj zone janë të lidhura me relievin kodrinoro-malor, afërsinë me detin (40 km) dhe drejtimin mbizotërues të erës nga veriperëndimi në juglindje.

Ato kanë kushtëzuar vlera të larta të shkatërrimit fizik e mekanik të shkëmbinjve. Kjo ka çuar në formimin dhe tjetërsimin e kores së tokës, veçanërisht të shkëmbinjtë e depërtueshëm gëlqerorë dhe ata ranorë (flishe).

Gjithashtu, reshjet luajnë rol të rëndësishëm në procesin morfologjik, veçanërisht shpërndarja e çrregullt gjatë vitit, pasi 60–70% e sasisë vjetore të tyre bie gjatë periudhës nëntor-prill, me rastësi të dendur të ditëve me reshjeve të shumta: deri në 237 mm në 24 orë. Reshje të tilla rezultojnë në përmbytje, krijimin e lumenjve me shumë gjarpërime etj, kryesisht mbi shkëmbinjtë terrigjenë të papërshkueshëm.

Mbi lartësinë 1000 m, pjesa më madhe e reshjeve është në formë bore, shkrirja e së cilës gjatë pranverës shkakton rritjen e nivelit të lumenjve dhe përrenjve. Reshjet në sasi të mëdha gjatë pranverës dhe shkrirja e borës shkaktojnë përshpejtim të erozionit, në veçanti në tokat me përbërje argjile, alevrolite dhe mergeli.

Gjithashtu, zona është e njohur për burimet ujore. Shumica e tyre fillojnë në kontaktin e shkëmbinjve gëlqerorë me flisheet, mbi pjesën perëndimore dhe jugperëndimore të Xibrit dhe Malit me Gropa. Pikërisht nga këto burime janë krijuar lumenjtë Ishëm dhe Erzen.

---

<sup>43</sup> Po aty. fq.350.

<sup>44</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të PK të Dajtit*, Tiranë 2004 fq. 43.



Njëkohësisht, dhe bimësia luan një rol të rëndësishëm në morfologjinë e zonës. Ndërhyrjet e vazhdueshme e të pastuduara të njeriut kanë çuar në shpyllëzimin dhe degradimin e territorit, duke sjellë uljen e funksionit mbrojtës të bimësisë. Kjo është më e evidente në fshatrat afër lumenjve dhe mbi tokat bujqësore në shpate të pjerrët. Shumica e sipërfaqeve të degraduara gjenden në fshatrat Mner, Vilëz, Bastar, Selitë, Qafëmollë dhe Derje. Mbulesa bimore është në gjendje të mirë në shpatet veriore dhe veriperëndimore, ndërmjet Domjes dhe Malit Murriz, mbi malin e Dajtit, e ndërmjet Qafë Priskës dhe grykës së Tujanit.

➤ *Komuna Bërzhitë*

Nga pikëpamja strukturore territori i komunës bën pjesë në zonën tektonike të Krujës dhe atë Jonike. Përbëhet kryesisht nga shkëmbinj terrigenë (flishe të paleogjenit dhe molasa të neogjenit) dhe pak gëlqerorë<sup>45</sup>.

Ndërtimi strukturor-litologjik dhe intensiteti i dobët i lëvizjeve neotektonike ngritëse janë faktorët kryesorë të mbizotërimit të relievit kodrinor, me lartësi që ulet nga lindja në drejtim të perëndimit.

Rol të rëndësishëm në formimin e tipareve kryesore të relievit kanë proceset aktuale, sidomos erozioni dhe denudimi.

Veçoritë dalluese të morfometrisë së zonës janë:

- shkalla shumë e lartë e copëtimit horizontal;
- shkalla e vogël deri në mesatare e copëtimit vertikal;
- pjerrësia mesatare e shpateve.

Ndryshimet hipsometrike janë të vogla në brendësi të territorit dhe më të theksuara në kontaktet litologjike midis flishit dhe molasave, ku shpeshherë janë të pranishëm burime me prurje të vogël.

Si rrjedhojë e ndërtimit gjeologjik të larmishëm, në territorin në studim gjenden disa pasuri nëntokësore si boksitë (Tujan, Priskë), qymyrguri (Priskë, Brar, Ferraj), gurë gëlqerorë (Priskë, Linzë, Tujan, Brar), rërë e zhavore në luginat e lumenjve Tërkuzë, Tiranë dhe Erzen etj. Një gurore gjendet në fshatin Pashkashesh të komunës Bërzhitë, ndërsa në fshatin Dobresh zhvillon aktivitetin një subjekt për prodhim inertesh dhe asfalti.

Këto pasuri minerale, miniera e gurore që janë ngritur për shfrytëzimin e tyre, që pas vitit 1950-të, kanë rëndësi, së pari: si potenciale të rëndësishme për zhvillimin e industrisë nxerrëse e përpunuese të tyre, dhe së dyti: për punësimin e banorëve të të dy komunave e rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre.

### ***II.2.2 Relievi si përcaktues i profilit ekonomik të zonës***

Relievi, me formën e tij, ndikon në përqëndrimin ose jo të popullsisë. Në rastin e një reliev të thyer e malor përqëndrimi dhe ngulimi i popullsisë ka pak shanse dhe mundësi që të

---

<sup>45</sup> Grup autorësh, *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Volumi II, QSGJ, ASHSH, Tiranë 1991.fq. 480

rezultojë pozitiv. Një territor i ngritur dhe i thyer krijon kushte më pak të përshtatshme për të bërë të mundur sigurimin e kushteve për jetesë<sup>46</sup>.

#### ➤ *Komuna Dajt*

Duke u bazuar në kushtet dhe faktorët e formimit, në komunën Dajt dallohen këto tipe gjenetike të relievit:

- ❖ strukturor, që zë pjesën më të madhe të territorit;
- ❖ lumor;
- ❖ karstik të zhveshur.

Këto tipa relievi kanë pasur zhvillim morfologjik shumë intensiv.

#### *Relievi strukturor*

Format tipike të relievit strukturor, që krijojnë kontraste morfologjike në këtë zonë, janë rrëpirat litologjike dhe tektonike. Ndërthurjet e afërta të strukturave të shkëmbinjve gëlqerorë me ato të flisheve kanë nxitur erozion të diferencuar, i cili ka avancuar me shpejtësi në largimin e flisheve që ndodhen mbi gëlqerorë. Këto rrëpira janë karakteristike për shpatet veriperëndimore dhe veriore, si dhe për majat e shkëmbinjve gëlqerorë.

Rrëpira më e madhe litologjike është mbi shpatin juglindor të Dajtit, ndërmjet grykës së Cudhinit dhe asaj të Skoranës. Kjo rrëpirë është 35 km e gjatë, 200–700 m e lartë (relative), ndërsa majat më të larta janë në Malin e Brarit (1214 m) dhe atë të Selbës (1353 m). Rrëpira është ndërprerë nga tri gryka të mrekullueshme perpendikulare, me gjatësi prej 2,5 km (Skorana), deri në 4,5 km (Tujani dhe Tërkuza). Këto gryka janë krijuar fillimisht në shkëputjet tektonike perpendikulare, ndërsa më pas janë thelluar nga erozioni lumor.

#### *Relievi fluvial (lumor)*

Sasia e madhe e reshjeve (rreth 1700 mm në vit), e kombinuar me shkëmbinjtë terrigjenë të papërshkueshëm, ka çuar në krijimin e një rrjeti të dendur të honeve, përrrenjve dhe lumenjve. Degëzimet e sipërme të Erzenit dhe Ishmit janë lokalizuar respektivisht në pjesët juglindore dhe veriperëndimore të PK të Dajtit. Në disa vende, si në Bruzë dhe Zall-Bastar, janë krijuar diga natyrore.

Në përgjithësi, lumenjtë kanë shtretër gjarpërues dhe të gjerë. Gjatë vërshimeve të shkaktuara nga reshjet e shumta, lumenjtë transportojnë sasi të mëdha uji dhe materiale aluvionale, të cilat i depozitojnë në lugina, në drejtim të rrjedhjes.

Shumica e fshatrave janë lokalizuar pikërisht mbi ndërthurjen e niveleve strukturore me depozitimet lumore. Këto sipërfaqe janë të pasura me burime ujore dhe toka bujqësore. Prania e gjerë e shkëmbinjve flishorë dhe tokave që i shoqërojnë ato, ka sjellë erozion të shpateve, rrëshqitje dhe deformim të tokave, veçanërisht gjatë rasteve me reshje të shumta. Këto kushte kanë shkaktuar një morfogjenezë shumë aktive, duke krijuar situata të thyera dhe të paqëndrueshme për aktivitetet e përditshme njerëzore, madje të rrezikshme, si në fshatrat Bastar, Bruz, Qafmollë, Derje, Shkallë dhe Selbë. Në shpatet e thyera, të pjerrëta dhe të

---

<sup>46</sup> Axhemi S., *Gjeografia e popullsisë dhe e vendbanimeve*. Tekst universitar. Shtëpia botuese “ALSA”, Tiranë 2007, fq.26.

paqëndrueshme formohen tokat e këqija që janë burime të materialeve të erozionit, të cilat përbëjnë rrezik potencial për punimet hidro-teknike, fshatrat, tokat bujqësore, rrugët, ujëmbajtësit etj.

### *Relievi karstik*

Në përgjithësi, kushtet topografike të zonës karstike janë të papërshtatshme për zhvillimin e dukurive e formave karstike, por ndikimi i tyre minimizohet nga faktorë të tjerë që e favorizojnë atë, si përbërja litologjike, klima etj. Formacionet karstike duken në formën e hinkave dhe dolinave që janë modeluar prej shkrirjes së kimikateve të shkëmbinjve gëlqerorë gjatë shkëputjeve tektonike lokale. Formacione të tilla tektonike janë gjetur kryesisht në Malin e Brarit, malin me Gropa dhe atë të Gamtit.



*Fig. II.1 Pamje nga shkëmbinj terrigjenë në komunën e Dajtit*

### ➤ **Komuna Bërzhitë**

Relievi i komunës pasqyron drejtpërsëdrejti përbërjen litologjike të territorit. Kështu, relievi i formuar në shkëmbinj të flishore e molasikë është shumë i ulët, me forma të buta, shumë i copëtuar, aq sa janë formuar vatra të fuqishme erozive dhe terreni është degraduar në shkallë të lartë. Kjo dukuri është shumë e theksuar në pjesën qendrore të zonës, ku çimentimi i flishit dhe i molasave është bërë me material argjilor<sup>47</sup>.

Elementët kryesorë të relievit të zonës janë kodrat dhe luginat. Kodrat përbëhen nga vargje apo grumbuj të copëtuar nga degët e lumenjve Ezen e Shkumbin. Lartësitë e kodrave luhaten nga 90-100 m në pjesën perëndimore, deri në 932 m në lindje (kulla e Gracenit). Pjesën më të madhe e zënë kodrat me lartësi 200-400 m, me forma të rrumbullakosura të kreshtës dhe shpate asimetrike e tepër të copëtuar.

Luginat e formuara në këtë zonë janë të shumta, pasi dhe rrjeti hidrografik është i zhvilluar, por ato janë pak të përpunuara, për shkak të sasisë e vogël të rrjedhjes dhe dobësisë së forcës transportuese. Tipat e relievit që takohen në këtë zonë janë: erozivo-denudues, që është mbizotërues, strukturoro-eroziv dhe lumor.

---

<sup>47</sup> Grup autorësh, *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Volumi II, QSGJ, ASHSH, Tiranë 1991.fq.480

### *Relievi erozivo-denudues*

Ky tip relievi shtrihet pothuajse në të gjithë zonën dhe përfaqësohet kryesisht nga rrëshqitjet, të cilat ndodhin nga veprimi faktorëve të tillë si:

- a. kushtet klimatike (sasia e madhe e reshjeve);
- b. përbërja gjeologjike (prania e argjilave);
- c. strukturat (rënia monoklinale dhe pjerrësia e shtresave);
- d. prishja e ekuilibrit të shpatit nga rrjeti hidrografik;
- e. varfëria e mbulesës bimore etj.

Ekzistenca e vatrave të shumta erozive, të kushtëzuara nga ndërtimi prej shkëmbinjsh terrigjenë të çimentuar dobët, kushtet klimatike, mungesa e bimësisë, kanë çuar në degradimin e thellë të relievit.

### *Relievi strukturor-eroziv*

Ky tip relievi përfaqësohet nga kuestet, formimi i të cilave lidhet me krahët monoklinale të strukturave gjeologjike të zonës. Ato shtrihen kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore, por dallohen qartë dhe në pjesën lindore, sidomos në sektorin midis fshatrave Bërzhitë dhe Mushqeta.

Në vargjet kodrinore të zonës, krahas kuesteve shfaqen edhe kreshtat monoklinale. Ato ndërtohen kryesisht nga gëlqerorë, kanë kënd të madh rënie dhe ndodhen në lartësitë më të mëdha të vargjeve kodrinore.

Pjesë e relievit strukturor-eroziv janë dhe luginat konsekuente dhe subsekuente. Të parat të zhvilluara në pjesën lindore e perëndimore, të dytat në pjesën qendrore.

Relievi, kryesisht kodrinor-fushor, ka favorizuar popullimin dhe zhvillimin e ekonomisë bujqësore, që është dega kryesore e ekonomisë së komunave Dajt dhe Bërzhitë.

Relievi nuk ka qenë pengesë për ndërtimin e akseve të rëndësishme të transportit rrugor rajonal dhe kombëtar, si dhe në ndërtimin e strukturave të shumëllojshme turistike që nga godinat e thjeshta dhe hotelet e deri tek komplekset turistike.

## ***II.2.3 Klima dhe ndikimi i saj në veprimtaritë jetësore dhe ekonomike***

Klima dhe elementët e saj, luajnë rol të rëndësishëm në popullimin e një hapësire të caktuar. Ato ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë social-ekonomike dhe sigurimin e të mirave materiale të njerëzve që vendosen në të.

Klima e komunave të marra në studim është mesdhetare kodrinore dhe paramalore, me dimër të ftohtë e të lagësht dhe verë të ngrohtë e të thatë.

### *➤ Komuna Dajt*

Pozita gjeografike e komunës Dajt, në pjesën qendrore të Shqipërisë, dhe lartësia relativisht e ulët mbi nivelin e detit, kanë përcaktuar veçoritë kryesore të klimës së saj.

*Temperaturat.* Nga analiza e të dhënave shumëvjeçare, temperatura mesatare vjetore në komunën Dajt është 13 C. Temperatura mesatare shumëvjeçare e verës luhet në 21.6 C,

kurse lagështia mesatare e ajrit është 65-68%<sup>48</sup>. Stina e dimrit paraqitet më e lagësht, por jo shumë e ftohtë. Temperatura mesatare shumëvjeçare e muajit janar është 4.9°C.


Temperatura minimale absolute është -12°C, ndërsa temperatura absolute maksimale është 38°C.

Tabela II.1 Vlerat mesatare mujore të temperaturës së ajrit në komunën Dajt

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	T mes. vj.
T °C	4,9	5,3	7,8	11,1	15,5	18,8	21,6	21,6	18,6	14,5	9,9	6,3	13,0

Burimi: Manuali i temperaturave. Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë.

Grafiku II.1 Ecuria e temperaturave mesatare shumëvjeçare në komunën Dajt



Burimi: Manuali i temperaturave. Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë.

*Rrezatimi diellor.* Të dhënat e Stacionit Meteorologjik në Tiranë tregojnë se gjatë vitit ka mesatarisht 106 ditë të kthjellta (me diell) e 99 ditë me re<sup>49</sup>. Ditët e tjera karakterizohen nga vranësira dhe reshje, kryesisht në formë shiu dhe më rrallë në formë bore. Zgjatja vjetore e diellzimit është 2400-2600 orë, që mundëson kultivimin e një game të gjërë të produkteve bujqësore.

Tabela II.2 Rrezatimi diellor sipas muajve të vitit

Tiranë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Ditë me diell	6,5	5,8	5,2	4,6	5,5	8,1	17,3	17,6	13,5	9,6	6,1	6,1	106
Ditë me re	12,3	12,6	12,2	11,7	7,2	4,3	1,2	1,8	3,6	7,2	11,9	12,7	99

Burimi: Plani i menaxhimit të PK të Dajtit, IDA, Tiranë 2004. Annex2

<sup>48</sup> Atlas Klimatik i RPS të Shqipërisë, Tiranë 1988.

<sup>49</sup> International Development Association (IDA), Plani i menaxhimit të PK të Dajtit, Tiranë 2004. Annex 2 fq.12.

Me rëndësi është numri i orëve me temperaturë  $\geq 10^{\circ}\text{C}$ , si përcaktues për zhvillimin optimal të kulturave bujqësore dhe për zonat fitoklimatike. Ky numër është i konsiderueshëm, 4608 orë në vit.

Tabela II.3 Ecuria e numrit të orëve me temperaturë  $\geq 10^{\circ}\text{C}$


Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Nr.orëve	55	70	192	178	530	624	702	713	602	487	320	135

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë

*Era.* Stacioni më i afërt për regjistrimet e erës është ai i Tiranës. Të dhënat tregojnë që shpejtësia vjetore mesatare e erës është e vogël (2,3 m/s) dhe se mbizotëruese janë erërat e drejtimit veriperëndim dhe juglindje, rreth 15%. Rreth 47% të ditëve janë pa erë të dallueshme.

Gjatë 3% të ditëve të vitit, drejtimi i erës është nga VP i Tiranës në JL të PK të Dajtit. Ka patur raste kur këto erëra janë shoqëruar me shi të rrëmbyeshëm dhe për pasojë kanë dëmtuar të mbjellat. Dhe kur era ka qenë e fuqishme, ka sjellë rrëzim të pjesshëm të bimëve dhe shterpësi të tyre, për shkak të uljes së lagështirës relative të ajrit të shkaktuar prej saj.

Grafiku.II.2 Trëndafili i erës, stacioni Tiranë



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë.

*Reshjet.* Nga të dhënat shumëvjeçare del se sasia vjetore e reshjeve është 1488 mm, por në vite të veçantë mund të jetë dhe më e lartë, sidomos gjatë stinës së dimrit apo pranverës. Kur kjo shoqërohet dhe me shkrirjen e borës, vështirëson situatën në këtë zonë, duke shfaqur probleme të kullimit, erozionit etj.

Reshjet bien në formë shiu, bore dhe breshëri. Rreth 94.7% e reshjeve bien në formë shiu. Reshjet e borës bien thuajse çdo vit, por shtresa e borë nuk qëndron për një kohë të gjatë. Janë mesatarisht 5-15 ditë me borë në vit (në lartësitë mbi 700m: 15-30 ditë). Trashësia mesatare e shtresës së borës është 25 cm, ndërsa maksimalja 50 cm<sup>50</sup>. Breshëri bie zakonisht në dimër e në fund të pranverës, mesatarisht 8-11 ditë në vit, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në kulturat bujqësore. Lagështia relative mesatare e ajrit në muajin janar është 65-75%, ndërsa në muajin korrik 45-50%.

<sup>50</sup> Atlasi Klimatik i RPS të Shqipërisë, Tiranë 1988.

Tabela II.4 Vlerat mesatare mujore të reshjeve në komunën Dajt

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes. vj.
Reshjet (mm)	129	123	110	85	70	42	24	32	68	130	151	162	1488

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë

Grafiku II.3 Ecuria e reshjeve mesatare shumëvjeçare në komunën Dajt



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë.

Të dhënat tregojnë se sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë periudhës tetor-prill, ndërsa periudha tjetër merr sasi të pamjaftueshme. Në këto kushte, ndërtimi i sistemeve ujitëse artificiale është i domosdoshëm për shmangien e pasojave negative të thatësisë dhe zhvillimin e bujqësisë.

#### ➤ Komuna Bërzhitë

Pranë sistemit kodrinor të Krrabës dhe në lartësi jo të mëdha mbi nivelin e detit, territori i komunës Bërzhitë ka klimë mesdhetare fushore-kodrinore. Temperatura mesatare vjetore është 13.9°C, e korrikut 22.9°C, ndërsa e janarit është 5.6°C<sup>51</sup>. Temperatura maksimale e regjistruar është 38°C, ndërsa minimalja absolute është -11°C.


Tabela II.5 Vlerat mesatare mujore të temperaturës së ajrit në komunën Bërzhitë

St. Krrabë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VII I	IX	X	XI	XII	T.mes. vjetore
	5,6	6,4	8,8	12,1	16,3	19,5	22,9	22,5	19,5	15,5	10,3	7	13,9

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë

<sup>51</sup> Atlas Klimatik i RPS të Shqipërisë, Tiranë 1988.

Grafiku II.4 Ecuria e temperaturave mesatare shumëvjeçare në komunën Bërzhitë



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë.

Nga të dhënat shumëvjeçare, del se sasia mesatare vjetore e *reshjeve* është rreth 1500 mm në vit. Sasia më e madhe e tyre është përqendruar në stinën e dimrit.


Në rastet e shirave të rrëmbyeshëm shfaqen probleme të kullimit, rritjes së koeficientit të erozionit, rrëshqitjes së dherave etj, ndërsa gjatë verës bie sasi e vogël reshjesh, duke e bërë të domosdoshëm sistemin e ujitjes.

Tabela II.6 Ecuria e reshjeve mesatare shumëvjeçare në komunën Bërzhitë

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Krrabë	168	151	160	129	108	70	45	70	93	128	193	185	1500
Kllojkë	179	162	161	134	115	88	58	74	90	141	203	197	1602

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë

Grafiku II.5 Ecuria e reshjeve mesatare shumëvjeçare



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë

Në të dy komunat klima është pothuajse e njëjtë: mbizotëron klima mesdhetare kodrinore dhe paramalore, me dimër të ftohtë e të lagësht dhe verë të ngrohtë e të thatë.



Temperaturat mesatare vjetore si dhe sasia mesatare e reshjeve gjatë vitit kanë diferenca të vogla midis komunave dhe ato paraqiten favorizuese për kultivimin e një game të gjërë kulturash bujqësore.

Numri i madh i ditëve me diell si dhe të orëve me temperaturë  $\geq 10^{\circ}\text{C}$ , janë përcaktues në zhvillimit optimal të kulturave bujqësore dhe i zonave fitoklimatike.

Mjegulla është e pranishme vetëm disa ditë në vit dhe nuk sjell vështirësi për transportin. Ajo shfaq ndikim pozitiv për zhvillimin e kulturave bujqësore, sidomos gjatë periudhës së ftohtë, pasi ul rrezatimin efektiv.

Reshjet në formë rrebeshi apo breshëri janë të pakta dhe janë karakteristike për stinën e ftohtë të vitit, por rastisin edhe në stinën e ngrohtë. Shpesh, ato shkaktojnë dëme në kulturat bujqësore.

Thatësira disa ditore, si dhe ulja e nivelit të ujërave nëntokësore gjatë stinës së verës, krijojnë probleme për zhvillimin e kulturave bujqësore, prandaj janë bërë përpjekje për ndërtimin e ujëmbajtësve, kryesisht në komunën e Dajtit, si dhe të sistemeve të ujitjes artificiale.

Pas kësaj analize, mund të dilet në përfundimin se komunat Dajt dhe Bërzhitë kanë klimë të shëndetshme dhe të përshtatshme për veprimtari ekonomike të shumëllojshme, sidomos të bujqësisë dhe të turizmit.

#### ***II.2.4. Pasuri ujore të konsiderueshme***

Pasuritë ujore të komunës Dajt dhe Bërzhitë janë të shumta. Ato lidhen me sasinë e konsiderueshme të reshjeve, kohëzgjatjen e shtresës së borës, ndërtimin e territorit kryesisht nga shkëmbinj gëlqerorë etj.

Lumenjtë kryesorë që përshkojnë territorin e komunës Dajt janë: Erzeni, Tërkuza dhe Tirana. Ata kanë rëndësi të madhe për të ashtuquajturin metropoli Tiranë-Durrës.



*Fig. II.2 Lumi i Tiranës*

Të rëndësishëm janë edhe përrrenjtë si Selita, Shupali, Malisht, Zall Dajti, Zall Bastari, Zall Mareci etj. Në komunën Dajt gjendet ujëmbajtësi i Bovillës, i ndërtuar në vitin 1998, i cili furnizon me ujë të pijshëm qytetin e Tiranës.

Rrjedhjet sipërfaqësore furnizohen me ujë nga reshjet e shiut dhe, në një masë të vogël, nga shkrirja e borës. Analiza e shpërndarjes vjetore të prurjeve të lumenjve tregon se

niveli i më i lartë arrihet në muajt prill dhe maj, kur shkrin bora. Përrjashtim bën përroi i Lanës, sepse në pellgun ujëmbledhës të tij bora nuk është e pranishme.

Reshjet intensive të shiut janë shkaku kryesor për daljen e lumenjve nga shtretërit dhe përmbytjet, të cilat ndodhin zakonisht gjatë periudhës nëntor – janar.

Lumenjtë e Tiranës dhe Tërkuzës janë furnizues kryesor për lumin e Ishmit. Shkarkimet mesatare vjetore të këtyre lumenjve variojnë nga 2,52 m<sup>3</sup>/s deri në 5,18 m<sup>3</sup>/s, ndërkaq që shkarkimet maksimale variojnë prej 412 m<sup>3</sup>/s deri në 720 m<sup>3</sup>/s. Materiali i ngurtë i transportuar prej këtyre lumenjve është në sasi të vogël dhe varion nga 5,92 kg/s në 11,8 kg/s<sup>52</sup>. Kjo është në saj të formacionit gjeologjik dhe prezencës së vegjetacionit në pjesën më të sipërme të këtyre lumenjëve. Uji i lumenjve është i pastër në pjesën e sipërme të rrjedhjes, por ngarkohet me material të ngurtë gjatë rrjedhjes së mesme dhe të poshtme, si rrjedhje e kalimit nëpër shkëmbinj flishorë dhe e veprimtarisë së impianteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror dhe inerteve.

Në territorin e komunës janë ndërtuar disa ujëmbledhës (Skoranë, Shupal, Besh, Linzë), kryesisht për qëllime ujitje, me përjashtim të rezervuarit të Bovillës, i cili është specifikisht për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës.

Tabela II.7 Rezervuarët<sup>53</sup>

Nr	Rezervuarët	Volumi (mijë m <sup>3</sup> )
1	Bovilla	80.000
2	Skoranë	2.000
3	Shupal	420
4	Besh	150
5	Linzë	160

Burimi: Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit, 2004

Cilësitë fizike dhe kimike të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të komunës Dajt janë të mira, pasi ato dalin në formacione gëlqerore dhe rrjedhin në një territor ku i vetmi burim ndotjeje janë impiantet e shfrytëzimit të gurit gëlqeror dhe inerteve. Përdorimi i kimikateve është i kufizuar për të pasur ndonjë ndikim negativ në cilësinë e ujit.

Rrezik potencial për cilësinë e ujit përbën turizmi, veçanërisht nëpërmjet derdhjes së ujërave të zeza dhe shpërndarjen e mbetjeve të ngurta. Sot objektet turistike janë përqendruar në “ballkonin” e Dajtit, por në të ardhmen mund të shtrihen deri në ujëmbajtësin e Bovillës dhe fshatrat përreth. Në këtë rast, kërkohet të sensibilizohen banorëve dhe turistët mbi rëndësinë e mbrojtjes së cilësisë së ujit. Institucionet vendore duhet të lejojnë të zhvillohen vetëm aktivitetet turistike që nuk ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, si lundrimi, peshkimi, shëtitjet etj.

Kohët e fundit, në vitet 2009-2011, ka patur shqetësime lidhur me cilësinë e ujit të Bovillës. Ekspertët besojnë se kjo mund t’i atribuohet dekompozimit të vegjetacionit, i cili nuk është hequr para mbushjes së ujëmbajtësit. Për ruajtjen e cilësisë së ujit të ujëmbajtësit të

<sup>52</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit*, Tiranë 2004. Anex 2. fq.21

<sup>53</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit*, Tiranë 2004. Anex 2. fq.23

Bovillës, burimeve të Selitës dhe Shënmërisë është rekomanduar instalimi i një sistemi monitorimi sipas standardeve ndërkombëtare. Gjithashtu, është rekomanduar të ndërmerret një studim për natyrën dhe origjinën e ndotjes së ujit të Bovillës.

Një problem i vazhdueshëm i ujësjellësit të Tiranës është gjendja jo e mirë e tubacioneve prej çeliku ose hekuri, të instaluar 20 apo 30 vite më parë. Ato janë dëmtuar dhe për rrjedhojë 50-70% e ujit humbet gjatë shpërndarjes.

Një tjetër problem lidhur me ujin e pijshëm është edhe përdorimi i paligjshëm për ujitje dhe veprimtaritë e tjera ekonomike.

Ndërsa, territori i komunës Bërzhitë përshkohet nga lumi Erzen dhe ai i Murdharit, si dhe nga disa përrenj të vegjël e të përkohshëm. Erzeni rrjedh në veri të fshatrave Kllojkë, Fravesh, Pëllumbas, Ibë, Bërzhitë e Dobresh, ndërsa lumi Murdharit në jug të fshatrave Kllojkë, Fravesh, Rozavere, Pëllumbas, Ibë. Pëllgjet ujëmbledhëse të këtyre lumenjve nuk janë të mëdhenj. Në veri të fshatit Pashkashesh ndodhet ujëmbajtësi i Skoranës, që furnizohet me ujin e lumit Erzen dhe ka kryesisht funksion ujitje.

Ushqimi kryesor i rrjetit hidrografik janë reshjet e shiut, me disa ndikime prej shkrirjes së borës. Kjo shprehet në veçoritë e regjimit të rrjedhjes vjetore, që arrin maksimumin në periudhën e reshjeve (nëntor-maj), ndërsa në stinën e verës prurja pakësohet deri në shterim, për disa përrenj. Kjo vjen nga sasia e vogël e reshjeve dhe prurjet e pakta të burimeve, për shkak të përhapjes së gjerë të formacioneve të papërshkueshme, si argjilat.



*Fig. II.3 Lumi i Erzenit*

Krahas lumenjve, në territoret e komunave, rrjedhin dhe një sërë përrenjsh, ujërat e të cilëve përdoren kryesisht për ujitje, me rrjedhje të lirë ose nëpërmjet sistemit të pompimit, të instaluar drejtpërdrejt në lumin Erzen.

Vlerë të veçantë për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës kanë burimet e Selitës dhe Shënmërisë, si dhe ujëmbajtësi i Bovillës. Një pjesë e burimit uhor të Shënmërisë është transferuar në sipërfaqen e pellgut ujëmbledhës të lumit të Tiranës nëpërmjet tubave në mënyrë që të rritet sasia e furnizimit me ujë të pijshëm për Tiranën.

Burimet natyrore të Selitës dhe Shënmërisë, që vijnë nga territori gëlqeror i Mali me Gropa, kanë rëndësi veçanërisht për furnizimin e qytetit të Tiranës me ujë të pijshëm. Prurjet mesatare vjetore të këtyre burimeve janë respektivisht 200-300 l/s dhe 350 l/s. Burimi i Bovillës ka prurje rreth 350 l/s<sup>54</sup>. Gjithashtu, ndërmjet mali të Dajtit dhe atij me Gropa dalin

<sup>54</sup> *Politika e zhvillimit të territorit të Bashkisë Tiranë*. Tiranë 2012, fq.345.

një numër i madh burimesh të vegjël. Ujërat e tyre janë të pijshëm. Shfrytëzimi i këtyre ujërave bëhet nga subjektet private Kristal dhe Selita, të cilat bëjnë trajtimin dhe ambalazhimin.

Një pjesë e rrjetit hidrografik mund të përdoret për zhvillimin e turizmit: shëtitje me varka e kanoe, sporte ujore, peshkim etj. Për këtë qëllim mund të shërbejnë edhe peizazhet e piktoreske të luginave, ujëvarat, ujëmbajtësit etj.

Uji i burimeve të Selitës përdoret për prodhimin e energjisë elektrike, para se të hyjë në rrjetin e ujit të pijshëm të Tiranës. HEC-i ndërtuar në vitin 1951, në rrëzë të malit të Dajtit, punon me ujin që rrjedh në tubacione me rënie të lirë. Fuqia e instaluar e tij prej 5 MW, ndërsa prodhimi vjetor rreth 30 GWH<sup>55</sup>. Studime fizibiliteti janë bërë për HEC-e të tjerë në lumin e Tërkuzës dhe ujëmbajtësin e Skoranës.

Ndërtimi i digave, ujëmbajtësve dhe HEC-ve të tjerë në lumenjtë dhe përrënjtë e PK mund të dëmtojnë biodiversitetin dhe vlerat peizazhore të Parkut, prandaj, projektet për ndërtime të tilla duhet të shqyrtohen me kujdes dhe vendimet të merren pasi të jetë bërë vlerësimi ekonomik dhe ai mjedisor.

Një nga shqetësimet mjedisore në territorin e komunave është shfrytëzimi pa kriter i inerteve, që ka çuar në uljen e tabanit të shtratit të lumit dhe aktivizimin e proceseve erozive dhe denuduese, me pasoja për tokat bujqësore, vendbanimet, infrastrukturën etj.

Gjatë viteve të tranzicionit, si pasojë e gjuetisë së pakontrolluar dhe ndotjes, është dëmtuar fauna ujore dhe shumë specie janë në rrezik zhdukjeje.

### **II.2.5 Tokat dhe përdorimi i tyre**

Cilësia dhe tiparet e tokave ndikojnë drejtpërsëdrejti në aktivitetin human dhe ekonomik të shoqërisë njerëzore. Në varësi të llojit të tokës bëhet e mundur ose jo vendosja e një ndërtimi të caktuar. Nisur nga cilësia e saj, një tokë mund të jetë e përshtatshme ose jo për mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore.

Tokat më të përhapura në të dy komunat janë *tokat* e hirta kafe, të kafenjta dhe të murrme pyjore, por ka edhe sipërfaqe të tokave aluvionale.

- a. *Tokat e hirta kafe* shtrihen në lartësitë 50-600m. Formimi dhe përhapja e tyre lidhet me shtrirjen e gjerë të shkëmbinjve molasikë. Ato nuk janë shumë pjellore, prandaj duhen pasuruar me lëndë organike. Janë toka të thata dhe, për nga përbërja mekanike, të ngjeshura dhe subargjilore mesatare. Me qenë se ndodhen mbi shkëmbinj terrigjenë dhe shpate të pjerrët, ato janë të ekspozuara ndaj gërryerjes e shpëlarjes nga ujërat rrjedhëse.
- b. *Tokat e kafenjta*, që shtrihen në lartësitë 600-1000m, zakonisht formohen mbi shkëmbinj të flishorë, margelorë dhe gëlqerorë, në kuotat më të larta të relievit, ku i nënshtrohen procesit të gërryerjes, sidomos në viset e zhveshura, ku janë krijuar shumë terrene të degraduara e vatra të fuqishme erozive. Ato janë të varfra në lëndë ushqyese, prandaj kanë nevojë për plehërim organik.

---

<sup>55</sup> Po aty. fq.26

- c. Tokat e murrme pyjore, me një shtrirje më të kufizuar në lartësitë 1000-1300m. Kanë përmbajtje të lartë humusi, por për shkak të shtrirjes në lartësi nuk shfrytëzohen për mbjelljen e kulturave bujqësore, por ekziston një bimësi e pasur natyrore, kryesisht drurë ahu.
- d. Tokat aluvionale gjenden në luginat e lumenjve Erzen, Murdhar, si dhe të disa përrenjve. Përbërja e këtyre tokave është përgjithësisht argjilore dhe shtufe. Ato janë tokat më pjellore, që japin redimente të larta në drithëra buke, foragjere e kultura të tjera bujqësore.

Nga të dhënat rreth bonitetit të tokave, rezulton se ato janë të vlerave mesatare në përbërjen e elementeve kimikë të tyre si humusi, azoti, potasi apo fosfori<sup>56</sup>.

Problemi më shqetësues për tokat e kësaj zone është erodimi, që shpesh shoqërohet me shembje të mëdha, duke çuar çdo vit në pakësimin e fondit të tokës bujqësore, prandaj është e domosdoshme të merren masa për sistemimin dhe kullimin e tokave në shpate dhe lugina.

Një rol të rëndësishëm kanë luajtur dhe depozitimet mijëravjeçare të bimësisë së dekompozuar në këtë zonë, të cilat kanë formuar një shtresë torfike.

Horizonti punues në zonat kodrinore përfshin thellësinë 10-40 cm, e cila për shkaqe të ndryshme, kryesisht të lënies djerr, po i nënshtrohet erozionit. Në zonën fushore horizonti punues është më i thellë.

Bimët e arave kryesore që rriten në komunat e marra në studim janë: grurë, misër, foragjere, bimët në kopshtet shtëpiake, vreshta, ullinj, fruta, patate dhe bishtaja.

Sipërfaqet e tokave jobujqësore shtrihen në territoret e kodrave dhe maleve. Në këto territore kultivohen bimë spontane barishtore, bimë pylli dhe bimë mjekësore. Për këtë bimësi nuk ka patur dhe nuk ka ndonjë plan të mirëfilltë shfrytëzimi.

Tabela II.8 Ndarja e tokës(ha) sipas mënyrës së përdorimit në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Komuna	Tokë e punueshme	Tokë e papunueshme	Pyje <sup>57</sup>	Livadhe e kullota	Troje, tokë djerr etj.
Dajt	1725,3	3440,7	1795,7	36,1	137,3
Bërzhitë	1308,49	1059,15	3297,85	44,5	83,91

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Në komunën Dajt, fshatrat Tufinë, Linzë, Lanabregas, Surrel, Priskë, Selbë e Darshen kanë sipërfaqen më të madhe të tokës së punueshme. Kjo kushtëzuar nga shtrirja e tyre na zonat fushore e kodrinore. Ndërsa, fshatrat Shkallë, Qafmollë e Murth, për shkak të shtrirjes së tyre në territore të larta malore dallohen për një sipërfaqe të pakët të tokës së punueshme. Kjo është dhe një nga arsytet që banorët e këtyre fshatarve janë zhvendosur drejt fshatrave të tjerë të komunës, por dhe drejt qytetit të Tiranës. Sipërfaqja e tokës së punueshme për frymë, në komunën Dajt, është pak a shumë sa mesatarja në shkallë vendi (1,2 dy për frymë).

<sup>56</sup> Relacioni i studimit të masterplanit të komunës Dajt. Tiranë 2011. fq. 13

<sup>57</sup> Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në komunën Dajt është 6252,6 ha, nga të cilat vetëm 1795,7ha administrohen nga komuna Dajt, pjesa tjetër prej 4466,9ha administrohen nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

Tabela II.9 Ndarja e tokës(ha) sipas mënyrës së përdorimit në fshatrat e komunës Dajt

Fshatrat	Tokë e punueshme	Pyje	Livadhe, kullota	Të tjera (troje, djerr etj.)
Brarë	137,9	376,1	-	24,1
Ferraj	122,0	-	-	-
Tujan	84,1	88,9	-	69,4
Tufinë	121,0	103,9	-	3,6
Linzë	160,6	59,7	-	-
Lanabregas	94,3	197	-	4,1
Surrel	169,0	90,7	-	21,6
Priskë	346,4	878,5	36,1	20,1
Shkallë	67,8	-	-	-
Qafmollë	51,0	-	-	-
Selbë	150,6	-	-	-
Murth	64,0	-	-	-
Darshen	166,6	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>1725,3</b>	<b>1795,7</b>	<b>36,1</b>	<b>137,3</b>

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt.

Tabela II.10 Ndarja e tokës (ha) sipas mënyrës së përdorimit në fshatrat e komunës Bërzhitë

Fshatrat	Tokë e punueshme	Pyje	Livadhe, kullota	Të tjera (troje,djerr etj.)
Bërzhitë	157,0	140,0	-	21,2
Dobresh	94,0	133,0	-	-
Fravesh	140,0	374,7	-	-
Ibë e Sipërme	100,0	-	-	18,4
Ibë e Poshtme	161,6	212,5	-	13,2
Kllojkë	157,8	512,1	-	23,4
Kus	24,49	263,8	-	-
Lugë-Shalqizë	88,0	305,25	-	6,71
Mihajas-Cirmë	78,9	472,5	44,5	-
Pëllumbas	144,1	370,0	-	-
Pashkashesh	101,0	380,0	-	-
Rozaverë	61,6	194,0	-	-
<b>Totali</b>	<b>1308,49</b>	<b>3297,85</b>	<b>44,5</b>	<b>83,91</b>

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Bërzhitë.

Dallohen për sipërfaqe të madhe të tokës së punueshme fshatrat Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Bërzhitë e Kllojkë, ndërsa fshatrat që dallohen për një sipërfaqe të kufizuar të tokës së punueshme janë fshatrat Rozaverë, Lugë, Shalqizë, Mihajas e Cirmë, dhe kjo është e shpjegueshme pasi këto fshatra shtrihen në territore më të larta, me shpate të pjerrëta, ku pyjet zënë sipërfaqen më të madhe të tyre.

Sipërfaqja e tokës së punueshme për frymë në komunën e Bërzhitës është më e lartë se në komunën Dajt, madje dhe më e lartë se mesatarja në shkallë vendi (2,2 dy/1,2 dy)<sup>58</sup>. Kjo përbën një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunë.


*Tabela II.11 Sipërfaqja e tokës së punueshme (dy) për frymë për komunat Dajt dhe Bërzhitë*

<b>Komunat</b>	<b>Sipërfaqja e tokës së punueshme për frymë</b>
Dajt	1,2
Bërzhitë	2,2

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë


---

<sup>58</sup> Sipërfaqja e tokës së punueshme për frymë në shkallë vendi është 1,2 dy.



Harta II.3 Përdorimi i tokës në komunën Dajt





Harta II.4 Përdorimi i tokës në komunën Bërzhitë

## II.2.6 Veçoritë e florës dhe të faunës

Relievi, klima, ujërat dhe tokat, kanë kushtëzuar florën dhe faunën e komunave. Në komunën Dajt dallohen qartë këto kate bimore:

- *Kati i shkurreve mesdhetare*, që shtrihet në lartësitë 300-600 m, ku janë zhvilluar makiet, xina, mërsina, murrizi, gjjeshtra, sherebela dhe manaferra si bimë karakteristike e zonës;
- *Kati i dushqeve*, që shtrihet nga 500-600 m deri në 1000-1300 m lartësi dhe ku ndërthuren gështenja dhe lloje të tjera drurësh. Pyjet e dushkut përbëhen nga lloje të lisit gjethe gjerë (*Quercus frainetto*, *Quercus cerris*, *Quercus petraea* dhe *Quercus trojane*) ose faza të degraduara të lisit *Carpinus orientalis*, *Carpinus betulus*, *Fraxinus ornus*, *Juniperus oxycedrus*, *Prunus spinosa*, *Pyrus amygdaligormis*, *Paliurus spina-cristi* etj. Ky brez zhvillohet midis atij të shkurreve mesdhetare dhe pyllit të ahut. Lartësia ndryshon nga 500 m deri në 1100 m mbi nivelin e detit. Duke qenë afër vendbanimeve, ky kat bimor është shumë i ekspozuar ndaj shfrytëzimit dhe dëmtimit nga njeriu dhe bagëtitë;
- *Kati i ahut*, që shtrihet në lartësitë 1000-1600 m, përfaqëson një formacion pyjor të rëndësishëm, me drurë ahu 200 vjeçar, me vlerat e monumenteve natyrore të çmuara<sup>59</sup>. Këtu gjenden edhe sipërfaqe të vogla halorësh, si *Pinus nigra*, *Pinus leucodermis*, bredhi i bardhë, arneni i bardhë, rrobulli etj.
- *Kati i kullotave alpine*, që shtrihet në një sipërfaqe të kufizuar mbi 1600m lartësi. Ato shfrytëzohen pa ndonjë plan konkret dhe pa studime për përmirësimin e tyre.

Ndër bimët *endemike* është *Ramonda serbica* e familjes *Gesneriaceae*, që zhvillohet në faqen lindore të malit të Dajtit.

*Fauna* është e larmishme dhe e shprehur mirë, megjithëse e shqetësuar nga veprimtaria e pakontrolluar e njeriut. Në këtë zonë gjejë kushte të përshtatshme gjitarët e mëdhenj si derri i egër, ujku, baldosa, dhelpra etj, ndërsa ariu është vizitor i rrallë. Nga gjitarët e tjerë të lidhur me pyjet fletore janë ketri, kunadhja, macja e egër etj.

Nga shpendët rriten harabelat, gardalinat, trishtilat, qukapikët, grifshat, gushëkuqi, mëllenja etj.

Zona është e pasur me lloje të quajtura “vlera natyrore”, nga të cilët katër janë amfibë, tetë zvarranikë, 11 shpendë dhe nëntë gjitarë.

Fauna e PK të Dajtit është e pasur dhe e shumëllojshme. Inventarizimi i grupeve ka treguar se ka shumë lloje që paraqesin një trashëgimi të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Siç mund të vërehet dhe në tabelën e mëposhtme, në PKD, gjenden një numër i madh i llojeve të ndryshme të faunës që gjenden Shqipëri<sup>60</sup>.

<sup>59</sup> Sulovari H., Gjeta Z., Ibrahimi A., *Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik të komunës Dajt*. fq.108

<sup>60</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit*, Tiranë 2004. Anex 1. fq.14

Tabela II.12 Përbërja e faunës në PK Dajt<sup>61</sup>

Klasa	Numri i llojeve në PK Dajt	Nr. i llojeve në listën kombëtare	%
Gjitarët	44	71	62
Shpendët	143	330	43
Zvarranikët	25	37	67
Amfibët	12	15	80
Insektet*	229	S'ka informacion	

\*Vetëm disa rende të insekteve janë të përfshirë në këtë inventarizim.

Këto lloje dominantë janë një tregues i habitatit të pasur, diversitetit dhe produktivitetit. Kjo shpjegohet me pozitën PK të Dajtit në zonën kalimtare midis Mesdheut dhe zonave fitoklimatike të Evropës Qendrore. Ai ndodhet afër detit dhe në lartësi të konsiderueshme mbi nivelin e detit. Shtrirja e gjerë e habitateve përfshin shkurret mesdhetare (maquis), masivet pyjore të përziera (dushkajat, pyjet e gështenjës), ahishtet, shoqërimet pyjore të ahut me bredh, pyjet e pishës, kullotat, livadhet sub-alpine, rezervuarët, përrenjtë dhe gurrat e ujit, moçalishtet, greminat, shpellat etj. Të gjitha këto habitate sigurojnë ushqim, ujë, strehë, vende riprodhimi dhe pushimi për një numër të madh llojesh, disa prej të cilave janë me interes kombëtar dhe global ruajtje.

*Fauna* është relativisht e pasur, dhe në komunën Bërzhitë, sidomos në zonën me bimësi më të dendur. Ndër kafshët që kanë përhapje më të madhe janë ujku, dhelpra, derri i egër, lepuri dhe kunadhja. Në territorin e komunë rriten edhe shpendë si shkurta, shapka, thëllëza, turtulli etj. Fauna e zonës ka ardhur duke u zvogëluar për shkak të dëmtimit të pyjeve, zgjerimit të vendbanimeve, tharjes së disa burimeve ujore dhe gjuetisë pa kriter.

Si përfundim mund të themi se flora dhe fauna e komunave është e pasur, për meritë të pozicionit gjeografik dhe të shumëllojshmërisë së elementeve të mjedisit gjeografik.

Flora dhe fauna e zonës mbetet shumë e ekspozuar ndaj veprimtarisë së pakontrolluar të njeriut. Dëmet më të mëdha janë shkaktuar nga shpyllëzimi me qëllim hapjen e tokave të reja, prerjet pa kriter, zjarret, zgjerimi i vendbanimeve, ndërtimi i objekteve të shfrytëzimit të inerteve, të shërbimeve dhe i infrastrukturës rrugore, ndotja e ujit dhe tokës etj.

Për rrjedhojë, janë shfaqur probleme të tilla si:

- humbja dhe degradimi i habitateve për shumë lloje bimore dhe shtazore;
- dëmtimi i biodiversitetit dhe zhdukja e specieve të rralla;
- rrëshqitje dhe shembje të provokuar nga shpyllëzimet dhe shfrytëzimi i inerteve në shpate dhe shtretërit e lumenjve;
- dëmtim i vlerave estetike të peizazheve etj.

Masat për përtëritjen, shtimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e florës dhe faunës kanë qenë të pakta dhe jo të vazhdueshme, si për pamjaftueshmëri të fondeve, ashtu edhe për mungesë të kujdesi dhe organizimit të shërbimeve nga ana e ndërmarrjeve pyjore dhe institucioneve përgjegjëse në nivel qendror. Veçanërisht është neglizhuar ripyllëzimi i përvitshëm, mbrojtja nga zjarri, luftimi i dëmtuesve, zbatimi i legjislacionit për shfrytëzimin e pyjeve dhe kullotave, gjuetinë dhe peshkimin, shfrytëzimin e inerteve etj.

<sup>61</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit*, Tiranë 2004 Anex 1. fq.15

## KAPITULLI III

### POPULLSIA, VENDBANIMET DHE ZHVILLIMI SOCIAL

#### III.1 Gjeografia e popullsisë dhe vendbanimeve

##### III.1.1 Historiku i popullimit

###### ➤ Komuna Dajt

Territori i komunës Dajt është populluar herët. Kjo dëshmohet nga një numër i konsiderueshëm objektesh dhe monumentesh kulturore të periudhave të ndryshme të historisë, që nga Paleoliti i Hershëm<sup>62</sup>. Vegla pune të asaj periudhe janë zbuluar në rrëzë të Dajtit. Këto materiale përbëhen kryesisht nga vegla stralli, kryesisht thika, kruese dhe gërryese të tipit aurinjacien<sup>63</sup>, me forma më të larmishme dhe të përparuar me teknikë më të avancuar. Gjithashtu janë gjetur edhe disa vegla prej kocke, të cilat në atë kohë kishin përdorim të gjerë, krahas përsosjes së mëtejshme të punimit të strallit.

Për vazhdimësinë e popullimit të kësaj zone dëshmon edhe Kalaja e Dajtit, që është shpallur monument kulture i kategorisë së parë më 15.01.1963. Me sipërfaqe 1,12 ha, ajo i përket antikitetit të vonë (vitet 600 të erës sonë). Kalaja ndodhet mbi një majë që ngrihet në shpatin perëndimor të malit të Dajtit, në të djathtë të rrugës që të çon te ish-Kampi i Punëtorëve, rreth 25 km larg Tiranës. Me qenë se ndodhet në lartësinë 1200 m, prej saj mund të vrojtohet një horizont shumë i gjerë që përfshin fushën e Tiranës dhe vargjet kodrinore të saj, deri në bregdet.

Në fshatrat e komunës së Dajtit shquhen disa fise të hershme si Lalajt, Shkozajt, Skurajt, nga i cili është marrë dhe emblema e komunës Dajt. Emblema ka ruajtur dhe simbolet mesjetare si shqyti (mburoja), luanesha e ngritur lart, që mban në njëren këputë (këmbë) shenjën e zambakut, që simbolizon lidhjen e fisit të Skurajve me Mbretërinë Franceze të Napolit (1724). Simboli i urës që gjendet në pjesën e poshtme të emblemes, tregon se ky territor ka pasur në vazhdimësinë e shekujve një rëndësi të veçantë komunikimi, si pikë tregtare dhe kulturore ndërkrahinore.



Fig. III.1 Emblema e komunës Dajt<sup>64</sup>

<sup>62</sup> ASHSH, *Instituti i Historisë, Historia e popullit shqiptar*, vëll.I, Toena 2002, fq. 8.

<sup>63</sup> Aurinjacien-kulturë arkeologjike që i përket periudhës së Paleolitit të Hershëm, 45000-35000 vjet më parë, lokalizuar në Europë dhe Azinë JP.

<sup>64</sup> Përgatitur nga piktori Lulëzim Myrtaj.

➤ *Komuna Bërzhitë*

Zbulimet e bëra në Shpellën e Zezë (Pëllumbas) dëshmojnë që kjo zonë ka qenë e populluar që nga paleoliti e deri në mesjetën e hershme<sup>65</sup>.

Streha e shpellës, korridori i gjatë, salla qendrore dhe pjesërisht degëzimet formojnë një sipërfaqe horizontale me depozitime të trasha të veprimtarisë së njeriut të shpellave. Ndër gjetjet e para dhe me vlerë të veçantë janë disa fragmente stralli, që i përkasin paleolitit të vonshëm, disa fragmente të enëve prej balte, nga të cilat më të hershmet i përkasin neolitit, pra 7000 – 3000 vjet p.e.s, gjetje të epokës së bronzit dhe të hekurit, afërsisht 2000-500 vjet p.e.s.

Të gjitha këto gjetje arkeologjike, krejt të reja për epokën që përfaqësojnë, gjenden në një zonë të panjohur më parë. Këtu qëndron edhe vlera e tyre shkencore e shumëfishtë.

Burime të shkruara dëshmojnë që Killojka dhe Përsqopi (mbi fshatin Dobresh) kanë pasur një qytetërim që prej 2000 vjetësh. Emrat Ibë, Bërzhitë, Dobresh flasin për ndikimin e qytetërimit sllav.



Fig. III.2 Emblema e komunës Bërzhitë

### **III.1.2 Ecuria e numrit të popullsisë sipas komunave (1994 – 2011)**

➤ *Komuna Dajt*

Numri i popullsisë dhe i familjeve në komunën Dajt është rritur vazhdimisht, ndërsa vitet e fundit ritmet e rritjes kanë qenë ndër më të lartat, krahasuar me komunat e tjera të rrethit të Tiranës.

Komuna Dajt, sipas të dhënave të Censur-it të popullsisë dhe banesave të vitit 2011, ka 20139 banorë nga 8486 që kishte më 2001, pra rreth 2,4 herë më shumë<sup>66</sup>. Po kështu, numri i familjeve është rritur nga 1795 në 2001 në 4847 familje në 2011.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e popullsisë së komunës Dajt janë:

- ❖ rritja e numrit të lindjeve;
- ❖ ulja e vdekshmërisë;
- ❖ saldoja pozitive e migrimit;

<sup>65</sup> ASHSH, *Instituti i Historisë, Historia e popullit shqiptar*, vëll.I, Toena 2002, fq. 9.

<sup>66</sup> *Censuri i popullsisë dhe i banesave*. INSTAT 2011.

- ❖ zhvillimi ekonomik i komunës, që ka krijuar mundësi punësimi dhe kushte më të mira jetese për banorët vendas dhe të ardhur.

Në fund të vitit 2011 në komunë janë regjistruar 176 të lindur ose 13,9‰ dhe 54 të vdekur ose 4,1 ‰, ndërsa vdekshmëria foshnjore ka qenë 0<sup>67</sup>. Shtimi natyror i popullsisë në vitin 2011 është rritur nga 9,4 ‰ që ishte në vitin 2001 në 9,8 ‰.


Numri i popullsisë në këtë komunë ka ardhur duke u rritur vazhdimisht që nga viti 1994. Në fund të vitit 2011, popullsia banuese e komunës ishte 13.306 banorë<sup>68</sup>.

Tabela III.1 Numri i popullsisë sipas fshatrave në komunën Dajt në vite sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile<sup>69</sup>

Fshatrat/ vitet	1994	2001	2006	2011
Shtish-Tufinë	678	1065	1721	2107
Tujan	370	352	285	319
Brar	505	571	603	615
Ferraj	370	489	499	550
Linxë	920	1579	2880	4777
Priskë e Madhe	1166	1315	1280	1411
Surrel	600	762	796	837
Lana Bregas	537	717	1218	1531
Shkallë	406	336	215	195
Qafmollë	537	219	183	190
Darshen	530	374	276	261
Selbë	665	528	365	360
Murth	231	206	163	153
<b>Gjithsej</b>	<b>7391</b>	<b>8513</b>	<b>10484</b>	<b>13306</b>

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt.

Grafiku III.1 Numri i popullsisë sipas fshatrave në komunën Dajt në vite sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile<sup>70</sup>



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt.

<sup>67</sup> Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt.

<sup>68</sup> Po aty.

<sup>69</sup> Po aty.

<sup>70</sup> Po aty.


Sipas të dhënave të INSTAT, numri i popullsisë në komunën Dajt ka ardhur duke u rritur.

Tabela III.2 Numri i popullsisë në komunën Dajt në vite sipas të dhënave të INSTAT<sup>71</sup>

Vitet	2001	2011
Komuna Dajt	8486	20139

Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011*

Grafiku III.2 Numri i popullsisë së komunës Dajt në vite



Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011*.

Diferenca me të dhënat e Censurit 2011 (20139 banorë) dhe të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile të komunës Dajt (13306 banorë), shpjegohet me faktin se në këto të fundit figuron vetëm popullsia e pranishme.

Të dhënat tregojnë se në zonat pranë Tiranës si Linzë (Qesarakë), Shtish-Tufinë, Lana Bregas Priskë e Madhe etj., ku janë ndërtuar kryesisht pallate (në këtë komunë janë ndërtuar 83 ndërtesa 3-5 kate si dhe 109 ndërtesa mbi 6 kate)<sup>72</sup>, ka shumë të ardhur, rreth 6833 banorë, që jetojnë me qira, por nuk figurojnë në statistikat e komunës. Gjithashtu, në këto zona janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm shtëpish të dyta (295 ndërtesa)<sup>73</sup>, banorët e të cilave nuk janë në regjistrat e komunës.

Pakësim të popullsisë në komunën Dajt kanë shënuar fshatrat Shkallë, Murth, Selbë dhe Darshen. Kjo lidhet kryesisht me kushtet jo të përshtatshme fiziko-gjeografike, terrenin malor dhe të fragmentarizuar, sipërfaqen e kufizuar të tokës bujqësore, mungesën e vendeve të punës, nivelin e ulët të shërbimeve publike etj.

Duke u mbështetur në të dhënat e Censusi-it 2001 e 2011, dendësia e popullsisë në komunën Dajt ka njohur rritje nga 73.15 b/km<sup>2</sup> në 2001 në 173.6 b/km<sup>2</sup> në 2011. Ajo paraqitet dhe më e lartë se dendësia mesatare e Shqipërisë që sipas Censusi-it 2011 ishte 97 b/km<sup>2</sup>.

<sup>71</sup> Proçesi i ndarjes së re administrative të Shqipërisë në 36 rrethe në 1992, nga 26 rrethe që ishin në 1989, nuk mundëson krahasimin e rritjes së popullsisë si një proces në vazhdimësi pasi fshatrat që përhshihen sot në komunën Dajt kanë qënë pjesë e njërive të ndryshme administrative. Për këtë arsye janë paraqitur vetëm të dhënat e regjistrimit të popullsisë të Censusi-it 2001 e 2011.

<sup>72</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, Tiranë 2011, fq 99.

<sup>73</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, Tiranë 2011, fq 104.

➤ *Komuna Bërzhitë*

Më parë Bërzhita bënte pjesë në komunën Krrabë-Bërzhitë. Në vitin 1997 ajo u nda më vete, kështu që edhe të dhënat për popullsinë e zhvillimin ekonomik të saj fillojnë në atë vit.

Në vitin 1997 komuna kishte 6.105 banorë dhe 1.326 familje<sup>74</sup>. Të dhëna të njëjta paraqiten dhe për vitin 2000. Në fund të vitit 2006, popullsia banuese në komunën Bërzhitë ishte 5.556 banorë. Diferenca në numrin e popullsisë lidhet me pakësimin e lindjeve dhe emigrimin e popullsisë si në drejtim të qytetit të Tiranës, ashtu edhe jashtë vendit.

Në fund të vitit 2011, popullsia e komunës ishte 5.923 banorë dhe e organizuar në 1.496 familje<sup>75</sup>.

Ka pasur një rritje të popullsisë pas vitit 2006, që lidhet me ardhjen e banorëve nga komunat fqinje, pasi Bërzhita shihet si më e përshtatshme për banim dhe veprimtari ekonomike bujqësore dhe të shërbimeve, kryesisht të bar-restoranteve, por numri i saj mbetet më i ulët se në vitet 1997-2000<sup>76</sup>.

*Tabela III.3 Numri i popullsisë në komunën e Bërzhitës sipas fshatrave<sup>77</sup>*

<b>Fshatrat / Vitet</b>	<b>1997</b>	<b>2006</b>	<b>2011</b>
1.Bërzhitë	949	966	1067
2.Dobresh	418	539	570
3.Ibë e Poshtme	828	901	1018
4.Ibë e Sipërme	1416	1418	1492
5.Pëllumbas	503	394	441
6.Mihajas	169	167	175
7.Cirmë	88	78	74
8.Kusë	118	84	88
9.Fravesh	305	188	171
10.Killojkë	650	389	401
11.Pashkashesh	272	139	159
12.Lugë	229	156	144
13.Shalqizë	75	79	72
14.Rozaverë	116	58	51
<b>Gjithsej</b>	<b>6105</b>	<b>5556</b>	<b>5923</b>

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë, viti 2012

Në komunën Bërzhitë rritjen më të madhe të popullsisë e kanë patur fshatrat Bërzhitë, Ibë e Sipërme, Ibë e Poshtme dhe Pëllumbas, për shkak të pozitës më të favorshme gjeografike dhe kushteve më të mira të jetesës, si rrjedhojë dhe të nivelit më të lartë të zhvillimit ekonomik se fshatrat përreth.

<sup>74</sup> Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë, viti 2012

<sup>75</sup> Po aty.


<sup>76</sup> Po aty.

<sup>77</sup> Zyra e gjendje civile, komuna Bërzhitë, viti 2012



Ndërsa në fshatrat Pashkashesh, Lugë, Fravesh dhe Rozaverë ka patur ulje të numrit të popullsisë. Kjo lidhet kryesisht me terrenin malor e sipërfaqen e kufizuar të tokës bujqësore që vështirësojnë jetesën në këto zona.

Grafiku III.3 Numri i popullsisë në komunën e Bërzhitës në vite<sup>78</sup>



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë, viti 2012


Të dhënat e Censurit 2001 dhe 2011 tregojnë se popullsia e komunës është zvogëluar nga 5.437 banorë në 2001 në 4973 banorë në 2011. Kjo shpjegohet me migrimin e popullsisë së kësaj zone, e cila nuk ka qenë e pranishme në momentin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. Ulje ka njohur dhe dendësia e popullsisë nga 95.38 b/km<sup>2</sup> në 2001 në 87.24 b/km<sup>2</sup> në 2011.

Tabela III.4 Numri i popullsisë në komunën Bërzhitë në vite sipas të dhënave të INSTAT

Vitet	2001	2011
Komuna Bërzhitë	5437	4973

Burimi: INSTAT, Censuri i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011

Grafiku III.4 Numri i popullsisë në komunën Bërzhitë në vite sipas të dhënave të INSTAT



Burimi: INSTAT, Censuri i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011

<sup>78</sup> Zyra e gjendjes civile, komuna Bërzhitë


Në tabelën e grafikun e mëposhtëm janë paraqitur të dhëna për numrin e popullsisë në vite për të dy komunat, duke bërë më të lehtë krahasimin e tyre sipas INSTAT- për vitet 2001 e 2011.

Tabela III.5 Numri i popullsisë në komunën Dajt e Bërzhitë<sup>79</sup>

Komuna	2001	2011
Dajt	8486	20139
Bërzhitë	5437	4973


Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011*

Grafiku III.5 Numri i popullsisë në komunën Dajt e Bërzhitë në vite



Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011*

<sup>79</sup> INSTAT, *Popullsia e Shqipërisë 2001, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*.



Harta.III.1 Ndryshimet e popullsisë (2001-2011)

Duke analizuar tabelat, grafikët dhe hartën e mësipërme shohim që numri i popullsisë në komunën Dajt është rritur me ritme të larta (në 2011 numri i popullsisë është më shumë se dyfishuar në krahasim me vitin 2001). Në rritjen e shpejtë të popullsisë së kësaj komune ka ndikuar imigrimi i lartë i popullsisë, fillimisht nga zonat VL të vendit, por vitet e fundit vihet re një ardhje dhe nga zonat jugore kryesisht nga Permeti, Skrapari, Pogradeci etj. Urbanizimi i fshatrave që ndodhen pranë Tiranës si Linza, Shti-Tufinë, Lanabregas është një faktor tjetër që ka sjellë rritjen e numrit të popullsisë në këtë komunë. Po kështu, vitet e fundit, ka ndikuar dhe kthimi i një pjese të emigrantëve në vendlindje (kryesisht nga Greqia, për shkak të krizës që përfshiu këtë vend në vitet 2010-2013). Po kështu, ka ndikuar dhe rritja e shtimit natyror të popullsisë si pasojë e rritjes së numrit të lindjeve e uljes së numrit të vdekjeve (nga 9,4 % që ishte në vitin 2001 në 9,8 % në vitin 2011).

Duke u mbështetur në të dhënat e Census-it 2001 e 2011, dendësia e popullsisë në komunën Dajt ka njohur rritje nga 73.15 b/km<sup>2</sup> në 2001 në 173.6 b/km<sup>2</sup> në 2011.

Po sipas të dhënave të Census-it 2011, numri i popullsisë në komunën e Bërzhitës ka ardhur duke u ulur me ritme jo të larta (nga 5437 banorë në 2001 në 4973 banorë në 2011). Ky zvogëlim i numrit të popullsisë së kësaj komune lidhet me uljen e numrit të lindjeve pasi saldo migruese paraqitet pozitive gjatë kësaj periudhe. Ulje ka njohur dhe dendësia e popullsisë nga 95.38 b/km<sup>2</sup> në 2001 në 87.24 b/km<sup>2</sup> në 2011.

Dendësia mesatare e popullsisë në komunën Dajt është dy herë më e lartë se në shkallë vendi, ku ajo ka pësuar ulje nga 107 b/km<sup>2</sup> në vitin 2001 në 97 b/km<sup>2</sup> në vitin 2011, ndërsa në qarkun e Tiranës është i lartë 454 b/km<sup>2</sup><sup>80</sup>. Kjo shpjegohet me numrin e lartë të të ardhurve në këtë komunë pas vitit 1990, por dhe si pasojë e shtimit natyror të lartë të saj. Ndërsa, për komunën Bërzhitë, ky tregues është më i ulët se në shkallë vendi, dhe kjo për shkak të uljes së shtimit natyror të saj, si pasojë e zvogëlimit të numrit të lindjeve.

Të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile në komunën Bërzhitë flasin për një rritje të lehtë të popullsisë gjatë periudhës 2006-2011 (nga 5556 banorë në 2006 në 5923 banorë në 2011). Kjo rritje e numrit të popullsisë lidhet me saldon pozitive të migrimit të popullsisë së kësaj komune. Gjatë kësaj periudhe nga fshatrat e komunës Bërzhitë janë larguar vetëm 15 banorë. Për shkak të kushteve natyrore më të favorshme e impulsit të zhvillimit ekonomik që ka marrë kjo komunë pas vitit 2000, me hapjen e një sërë bar-restoranteve e resorteve turistike, si dhe së fundmi, me ndërtimin e tunelit të Krrabës e autostradën e re Tiranë-Elbasan, në komunën e Bërzhitës kanë ardhur 382 banorë, të ardhur kryesisht nga komunat përreth si Krrabë, Baldushk por dhe nga komuna të rrethit të Elbasanit që e kanë parë atë si një mundësi më të mirë, pranë qytetit të Tiranës.

Duke parë tendencën që ka ecuria e numrit të popullsisë në të dy komunat Dajt e Bërzhitë mendoj se ato kanë kapitalin e mjaftueshëm human që do të ndikojë fuqimisht në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të tyre. Megjithë mangësitë që ka, mund të themi që ky kapital human në vite paraqet një rritje jo vetëm sasiore, por dhe cilësore. Është rritur shkalla e arsimimit e profesionalizmit të saj që do ta pasqyrojmë në vazhdim në paragrafin mbi zhvillimin e arsimit në të dy komunat. Gjithashtu dhe emigrantët e kthyer sjellin eksperiencën të reja, mundësi më të shumta financiare, teknologji të re, që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të të dy komunave.

---

<sup>80</sup> INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*. fq. 11.

### III.1.3 Veçoritë e lëvizjes natyrore

Ndryshimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë është në varësi të drejtpërdrejtë të lëvizjes natyrore dhe hapësinore të saj<sup>81</sup>. Ecuria pozitive e tij është tregues i zhvillimit dhe ndodh kryesisht si rrjedhojë e përmirësimit të cilësisë së jetës, kujdesit shëndetësor, kushteve për arsimim, punësim etj.

Studimi i lëvizjes natyrore dhe hapësinore ndihmon në përlogaritjen e fuqisë riprodhuese të popullsisë, prirjeve për të ardhmen, pakësimin apo shtimin e burimeve humane, hartimin e politikave në lidhje me arsimin, shëndetësinë, punësimin etj.

#### III.1.3.a Lindjet, vdekjet dhe shtimi natyror

Në komunën Dajt numri i lindjeve është rritur nga 148 foshnje në vitin 2006 në 176 lindje në 2011, ose nga 12,8% në 13,2% banorë. Numri i lindjeve në këtë komunë paraqitet më i lartë se në shkallë vendi, që sipas Census-it 2011, ishte 12,048%. Vdekshmëria foshnjore në 2011 ishte 0, ndërsa numri i vdekjeve në vitin 2011 ishte 4,3%. Ky tregues është zvogëluar në krahasim me vitin 2001, kur ishte 5,2%. Dhe ky tregues është më i ulët se në shkallë vendi, ku sipas të dhënave të Census-it 2011, ishte 7,08 %. Kjo lidhet me përmirësimin e kushteve social-ekonomike dhe shëndetësore në komunë. Shtimi natyror i popullsisë është 8,8% banorë. Vlera në rritje të shtimit natyror ka qenë një ndër faktorët kryesorë që ka ndikuar në shtimin e shpejtë të popullsisë së komunës.

Në komunën Bërzhitë vihet re pakësim i numrit të lindjeve nga 11,3% në vitin 2001, në 10 % në vitin 2011 dhe ky tregues është më i ulët se në shkallë vendi (12,048%)<sup>82</sup>. Ulje ka pësuar edhe numri i vdekjeve nga 5,6% më 2001 në 4,5% më 2011. Si pasojë e ndikimit të të dy këtyre treguesve të popullsisë, shtimi natyror i popullsisë në komunën Bërzhitë është ulur, ndonëse me një ritëm jo të lartë, nga 5,7% në vitin 2001 në 5,5% në vitin 2011. Vlerat në ulje të shtimit natyror të popullsisë kanë ndikuar në pakësimin e popullsisë së kësaj komune.

Përmirësimi i infrastrukturës, sidomos përmirësimi i treguesve social-ekonomikë, kthimi i emigrantëve në shtëpi do të mundësojnë shtimin e popullsisë së komunës në të ardhmen. Sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile të komunës, shenjat e kësaj rritje kanë filluar të duken gjatë viteve të fundit, si rrjedhojë dhe e shtimit të numrit të lindjeve të cilat në vitin 2013 ishin 11,2 %.

#### III.1.3.b Martesat, divorcet dhe abortet

Studimi i martesave dhe divorceve ndihmon në parashikimin e ecurisë së numrit dhe karakteristikave strukturore të popullsisë.

Ende sot, kur shoqëria rurale është shumë tradicionale dhe kundërshtuese ndaj bashkëjetesës së çiftëve të pa martuar ligjërisht, lindjeve jashtë martese etj, martesat

---

<sup>81</sup> Dumani B., Stringa A., *Demografia social-ekonomike*. Tekst universitar. Shtëpia botuese Pegi. Tiranë 2009. fq.5

<sup>82</sup> INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*. fq. 7

vazhdojnë të mbeten një tregues i rëndësishëm për parashikimin e lindjeve dhe shtimin natyror të popullsisë.

Numri i të martuarve në komunën Dajt është 10111 banorë, ndërsa i të divorcuarve është 111 banorë<sup>83</sup>. Për komunën Bërzhitë këta tregues janë përkatësisht 2466 banorë të martuar dhe 6 banorë të divorcuar. Ajo që konstatohet këto vitet e fundit është rritja e numrit të divorceve, sidomos në komunën Dajt, (nga 13 divorce në vitin 2006 në 18 divorce në vitin 2012), ndërsa në komunën Bërzhitë ky tregues është më i ulët, (madje në vitet 2010-2012 ka qenë 0). Kjo lidhet me popullsinë më autoktone e me pak të ardhur nga rajone të tjera në komunën e Bërzhitës dhe me një numër të madh të të ardhurve nga krahina të ndryshme të vendit në komunën e Dajtit.

Si faktorë që kanë ndikuar në këtë dukuri mund të përmëndim:

- a. vështirësitë ekonomike. Familjet në fshatrat e thella, por dhe ato me pak ose aspak tokë bujqësore në fshatrat fushore, për shkak të mungesës së vendeve të punës, sipërfaqes së kufizuar të tokës bujqësore, mungesës së infrastrukturës, përballen me vështirësi të shumta të cilat janë shkak kryesor i grindjeve e më pas i ndarjeve të çifteve;
- b. emigracioni. Emigrimi kryesisht i meshkujve në moshë pune, vështirësitë në marrjen e familjes, por shpeshherë dhe për bërjen e dokumentave, kanë çuar në prishjen e një sërë lidhjeve martesore;
- c. problemet e ndryshme sociale. Integrimi i familjeve të ardhura nga rajone të tjera të vendit, me tradita e mentalitete të ndryshme, është i vështirë dhe shpesh shoqërohet me prishjen e martesave të krijuara midis tyre.

Për numrin e aborteve në të dy komunat nuk kishin të dhëna të sakta, pasi ky proces kryhej në spitale shtetërore apo private në Tiranë e shpesh nuk deklarohen pranë qendrave shëndetsore në fshatra.

### *III.1.3.c Ndikimi i lëvizjes natyrore në numrin e popullsisë*

Duke analizuar treguesit e mësipërm të lëvizjes natyrore del se numri i popullsisë në komunën Dajt në vitin 2011 është pothuajse 2,4 herë më e lartë se në vitin 2001, nga 8.486 banorë në 2001 në 20.139 banorë në 2011<sup>84</sup>, ndërsa në komunën e Bërzhitës shihet rënie e numrit të popullsisë nga 5.437 banorë në 2001 në 4.973 në 2011.

Faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e popullsisë në komunën Dajt është shtimi natyror që është rritur nga 7,6‰ në 2001 në 8,8‰ në 2011 si rrjedhojë e rritjes së numrit të lindjeve nga 12,8‰ në 2001 në 13,2‰ në 2011 dhe e zvogëlimit të numrit të vdekjeve nga 5,2‰ në 2001 në 4,3‰ në 2011.

Kjo rritje e numrit të lindjeve lidhet me mentalitetin tradicional të familjes rurale shqiptare për të pasur shumë fëmijë, me përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që kanë çuar edhe në uljen e vdekshmërisë. Popullsia në këtë komunë është mjaft vitale, për rrjedhojë këto ritme në shtimin natyror do të ruhen dhe për të ardhmen e afërt.

Shtimi natyror i popullsisë në komunën Bërzhitë ka shënuar rënie nga 5,7‰ më 2001, në 5,5‰ më 2011. Kjo lidhet me zvogëlimin e numrit të lindjeve nga 11,3‰ më 2001 në

---

<sup>83</sup> INSTAT, *Censuri i popullsisë dhe i banesave 2011*. fq. 86

<sup>84</sup> INSTAT, *Censuri i popullsisë dhe i banesave 2011*.fq.85

11‰ më 2011. Numri i vdekjeve ka pësuar ulje nga 5,6‰ në 2001 në 4,5‰ më 2011, por pa arritur të balancojë pakësimin e lindjeve.

### III.1.4 Struktura moshore dhe gjinore e popullsisë

#### III.1.4.a Struktura moshore


Struktura moshore dhe gjinore janë tregues të rëndësishëm të zhvillimeve demografike. Lëvizjet natyrore dhe hapësinore të popullsisë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në treguesit e grupmoshave. Pushtetet vendore janë të interesuara për ruajtjen e raporteve të drejta midis grupmoshave, veçanërisht për sigurimin e vazhdimësisë së jetës dhe shmangien e plakjes së popullsisë, si dhe për hartimin e politikave të punësimit, arsimimit, strehimit etj.

Tabela III.6 Struktura moshore e popullsisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë 2011<sup>85</sup>

Komuna	Grupmosha					
	0-14 vjeç		15-64 vjeç		Mbi 65 vjeç	
	Nr.tot.	%	Nr.tot.	%	Nr.tot.	%
Dajt	4779	23,73	13917	69,1	1443	7,16
Bërzhitë	1089	21,09	3407	68,5	477	9,59

Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave, 2011*.

Grafiku III.6 Struktura moshore e popullsisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë 2011



Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*

Të dhënat tregojnë se përqindja e grupmoshës 0-14 vjeç është më e lartë në komunën e Dajtit se në atë të Bërzhitës, si rrjedhojë e diferencës në numrin e lindjeve. Pështetja e popullsisë së aftë për punë 15-64 vjeç është pak më e lartë në komunën Dajt, ndërsa pështetja e popullsisë mbi moshën e punës është më e madhe në komunën e Bërzhitës, por ende larg rrezikut të plakjes demografike. Kjo lidhet me uljen e numrit të lindjeve e rritjen e jetëgjatësisë.

<sup>85</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave, INSTAT, Tiranë, 2011.fq.85*

### III.1.4.b Struktura gjinore e popullsisë


Sipas të dhënave të Censurit të 2011, meshkujt përbëjnë 50,8 %, ndërsa femrat 49,2% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së komunës Dajt. Ky mbizotërim i lehtë i femrave ndaj meshkujve ishte karakteristikë dhe për vitin 2001. Kjo shpjegohet me lindjen e më shumë bebeve meshkuj se femra (në vitin 2011 nga 176 lindje 111 prej tyre ishin meshkuj), gjë që pasqyrohet dhe në të dhënat e grupmoshës 0-14 vjeç, ku struktura gjinore karakterizohet nga një mbizotërim i theksuar i meshkujve (4779 meshkuj kundrejt 2297 femra)<sup>86</sup>. Ky raport, jo në këto përmasa, ruhet dhe në grupmoshat e tjera të popullsisë.

Tabela III.7 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Dajt

Bërzhitë/vitet	2001	2011
Nr. popullsisë	8486	20139
Meshkuj	4532	10255
Femra	3954	9884

Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011

Grafiku III.7 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Dajt



Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011

Mbizotërim i lehtë i meshkujve ndaj femrave vihet re dhe në popullsinë e komunës Bërzhitë. Në vitin 2011, meshkujt përbënin 50,6%, ndërsa femrat 49,4% të popullsisë. Arsyeja është e njëjtë, lindja e më shumë bebeve meshkuj se sa femra. Kjo pasqyrohet qartë dhe në raportin meshkuj/femra në grupmoshën 0-14 vjeç (1089/539). Ky mbizotërim i meshkujve vihet re dhe në grupmoshat e tjera të popullsisë së kësaj komune.

Tabela III.8 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Bërzhitë


Bërzhitë/vitet	2001	2011
Nr. popullsisë	6105	4973
Meshkuj	3089	2515
Femra	3016	2458

Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011

<sup>86</sup> Po aty, fq 85.



Grafiku III.8 Struktura gjinore e popullsisë në komunën Bërzhitë



Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011

Raporti midis gjinive është i rëndësishëm. Sa më i ngushtë të jetë ndryshimi midis gjinive aq më të shumta do të jenë mundësitë për çiftëzim, integrim dhe bashkëpunim midis tyre për zhvillimin e zonës. Mbizotërimi i theksuar i njëres gjini shkakton probleme sociale dhe ekonomike për gjininë tjetër, për familjen e komunitetin.

Në të dy komunat ky tregues është i ekuilibruar dhe i tillë pritet të jetë edhe në të ardhmen. Një strukturë e tillë do të favorizojë dhe rritjen e numrit të popullsisë në të ardhmen në të dy komunat.

### III.1.5 Struktura fetare dhe komunitetet kulturore


#### III.1.5.a Struktura fetare

Myslimanët përbëjnë rreth 90% të popullsisë në komunat Dajt dhe Bërzhitë, ndërsa 10% e zënë besimet e tjera fetare si ortodoksë, katolikë etj. Por, si në të gjithë Shqipërinë, përkatësia fetare nuk ka përbërë asnjëherë problem. Në fshatra e komunave ka xhami dhe kisha. Konflikte me bazë fetare pothuajse nuk ndodhin. Njerëzit gëzojnë së bashku në festat fetare dhe shkëmbejnë urime e vizita në vendet e shenjta dhe shtëpitë e njëri-tjetrit.

Në komunën Bërzhitë gjenden dy xhami, në fshatin Ibë e Poshtme dhe një xhami e re, e ndërtuar në fshatin Bërzhitë. Kisha nuk ka. Gjendet vetëm një ambient në fshatin Ibë e Sipërme, ku në ditë të caktuara misionarët e krishterë japin mësim biblike.

Ndërsa në komunën Dajt gjenden shtatë objekte fetare, dy kisha dhe pesë xhami.

Grafiku III.9 Struktura fetare e popullsisë



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt dhe Bërzhitë

### *III.1.5.b Komunitetet kulturore*

Për sa i takon *strukturës etnike* mund të themi se të dy komunat Dajt dhe Bërzhitë kanë popullsi homogjene, por krahas shqiptarëve që përbën shumicën absolute, ka tek-tuk edhe elemente të komuniteteve kulturore rome, arumune etj, por mungojnë të dhënat për numrin e tyre.

Sipas disa burimeve jo zyrtare, në fshatin Shtish-Tufinë të komunës Dajt, jetojnë rreth 180 rom, të grupuar në 37 familje. Pjesa më e madhe e tyre janë sistemuar në banesat sociale të siguruara nga qeveria shqiptare, ndërsa të tjerët janë gjithmonë në lëvizje. Ata kanë qenë pjesë e komunitetit rom që ndodhej në Allias (periferia e Tiranës), ku gjenden 850 familje rome, me rreth 4.250 persona. Rreth 74% të këtij komuniteti e përbëjnë fëmijët dhe të rinjtë<sup>87</sup>.

Familjet rome përballen me vështirësi të shumta sociale dhe ekonomike. Papunësia në radhët e tyre është shumë e madhe. Niveli i ulët arsimor është problemi më serioz që pengon integrimin e këtij komuniteti në shoqëri. Fëmijët romë janë shumica analfabetë, kryesisht për shkak të vështirësive gjuhësore që hasin në klasën e parë, të varfërisë që pllakos familjet e tyre, të largësisë që kanë vendbanimet e tyre nga institucionet shkollore, si dhe, ndonjëherë, nga mentaliteti i gabuar i prindërve.

Nuk ka informacion të saktë për numrin dhe gjendjen social-ekonomike të komunitetit rom në komunën Dajt, për rrjedhojë, pushteti vendor nuk ka marrë ndonjë masë të veçantë për përmirësimin e gjendjes së tij.

### **III.1.6 Lëvizja hapësinore e popullsisë dhe ndikimet në zhvillim**

#### *III.1.6.a Migrimi i brendshëm*

Gjatë periudhës 1945-1990 lëvizja e njerëzve brenda vendit ishte e kufizuar dhe e kontrolluar, ndërsa për jashtë tij ishte e ndaluar me ligj. Liria për të zgjedhur vendbanimin në kërkim të kushteve dhe mundësive më të mira për punësim, arsimim etj, nuk ekzistonte. Çdo lëvizje ishte e kontrolluar dhe e motivuar vetëm nga pushteti qendror. Vendbanimi mund të ndërrohej vetëm në rastet e emërimeve në vende pune në qytete apo fshatra të tjerë, si dhe në rastet e martesave. Për këtë arsye deri në vitet 1990, roli i lëvizjeve hapësinore në ndryshimin e numrit të popullsisë ishte i papërfillshëm.

Ndryshimi i sistemit politik dhe njohja e të drejtës së njerëzve për të zgjedhur lirshëm vendbanimin e tyre, ndikoi në rritjen e menjëhershme të lëvizjes hapësinore të popullsisë brenda dhe jashtë vendit. Qytetet kryesore dhe fshatrat përreth tyre u bënë destinacione të preferuara të popullsisë së larguar nga fshatrat e brendshëm kodrinorë e malorë, por dhe nga qytetet e vogla e më pak të zhvilluara të vendit.

Siç u theksua dhe më lart, numri i popullsisë në komunën e Dajtit ka ardhur duke u rritur jo vetëm si rrjedhojë e shtimit natyror, por edhe e saldosh migruese pozitive. Vlera e saldosh migruese është një ndër treguesit kryesor të zhvillimit të një zone apo të një vendi.

---

<sup>87</sup> *Romani-Baxt*, Revistë informative e përmuajshme, mars 2007, fq. 6.

Popullsia tenton të largohet kur kushtet e jetesës nuk përmirësohen, kur nuk ka akses të mjaftueshëm në shërbime, punësim, arsimim, shëndetësi etj.

Vetëm gjatë vitit 2010 numri i të ardhurve në këtë komunë ishte 507 dhe i të larguarve 95<sup>88</sup>. Fshatrat që kanë regjistruar numrin më të madh të të ardhurve janë Qesarakë, Shtish-Tufinë, Linxë, Priskë e Madhe dhe Lana Bregas. Kjo i dedikohet shtrirjes së tyre pranë Tiranës si dhe faktorëve fiziko-gjeografikë më të favorshëm se fshatrat e tjerë të kësaj komune. Në këto fshatra për shkak të infrastrukturës më të mirë, të mundësive më të shumta për punësim sidomos në sektorin e ndërtimit dhe turizmit, por dhe mundësive për të shitur produktet e tyre bujqësore dhe blegtorale në tregun e Tiranës janë vendosur pjesa më e madhe e të ardhurve.

Në komunën Bërzhitë, gjatë periudhës 1997-2005, numri i popullsisë së larguar ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Numri më i madh i popullsisë së shpërngulur nga kjo komunë është në vitin 2005 me 368 banorë, nga të cilët 286 banorë janë vendosur kryesisht në komunat e tjera më pranë Tiranës (Farkë, Petrelë etj.) dhe në qytetin e Tiranës (82 banorë janë larguar jashtë vendit). Viti 2006 shënon fillimin e rënies së numrit të popullsisë së shpërngulur. Në këtë vit, ky numër puthuajse u përgjysmua në 176 banorë<sup>89</sup>.

Numri i popullsisë së ardhur në komunën Bërzhitë ka patur luhate, duke arritur numrin më të lartë në vitin 2005 me 270 banorë. Kjo përkon dhe me numrin më të lartë të të larguarve nga kjo komunë. Popullsia e saj, duke patur mundësi më të shumta financiare zhvendoset kryesisht drejt qytetit të Tiranës e rrethinat e tij, ndërsa popullsia e fshatrave përreth, me mundësi më të pakta financiare vendoset në këtë komunë duke blerë shpeshherë, shtëpitë e tokat e banorëve të larguar.

Pas vitit 2006 vihet re një stabilizim i lëvizjes së popullsisë. Në vitin 2011 kanë ardhur në komunë 118 persona dhe janë larguar vetëm 19 persona<sup>90</sup>.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i autostradës së re Tiranë-Elbasan, ngritja e një sërë restoranteve e komplekseve turistike, afërsia e kësaj komune me qytetin e Tiranës, ka rritur interesin e banorëve të fshatrave përreth për tu vendosur në këtë komunë. Mendohet se kjo do të jetë dhe tendenca për vitet e ardhshme.

Ardhja e banorëve të rinj, nga fshatrat e komunat e afërta, Krrabë, Killojkë etj., nuk është shoqëruar me probleme në integrimin e tyre me komunitetin vendas apo në shërbimet social-kulturore. Probleme janë shfaqur në lidhje me punësimin e tyre, por dhe kjo jo në përmasa të mëdha, pasi me blerjen e shtëpisë është blerë dhe një sipërfaqe toke (zakonisht 2-4 dynym), që i ka ndihmuar familjet e ardhura për të plotësuar nevojat e tyre, por dhe për të shitur një pjesë të prodhimeve bujqësore.

Kryesisht ata janë vendosur në fshatrat më të populluara të komunës Bërzhitë, në Bërzhitë, Pëllumbas, Ibë e Sipërme, për shkak të mundësive më të shumta që ata kanë si: sipërfaqe të konsiderueshme dhe të favorshme të tokës bujqësore, infrastrukturë më të mirë, mundësi më të shumta për punësim për shkak të ekzistencës së një numri të lartë të bar-restoranteve etj.

*Rritja e numrit të lindjeve, kthimi i një pjese të emigrantëve në shtëpi, ardhja e banorëve të rinj nga komunat përreth, por dhe rritja e numrit të personave që ndërtojnë një shtëpi të dytë në fshatrat e këtyre komunave, do të jenë faktorë pozitivë në rritjen e popullsisë*

<sup>88</sup> INSTAT, *Lëvizjet demografike të popullsisë*, 2010.

<sup>89</sup> *Zyra e Gjendjes Civile*, komuna Bërzhitë, viti 2012

<sup>90</sup> *Zyra e Gjendjes Civile*, komuna Bërzhitë, viti 2012

së tyre, duke siguruar një potencial human më të madh, jo vetëm si numër, por dhe më të mirëarsimuar e më të mirëkualifikuar, që do të përbëjë një faktor të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

### *III.1.6.b Emigracioni*

Ndryshimet politike dhe social-ekonomike, pas vitit 1990, ndikuan në rritjen e menjëhershme të numrit të emigrantëve shqiptarë kryesisht drejt Greqisë dhe Italisë, por dhe në vende të tjera si Gjermania, Franca, Belgjika, e më pas Anglia, SHBA-ja, Kanadaja etj. Fillimisht ka mbizotëruar emigracioni klandestin por gjatë viteve të fundit janë krijuar kushte për emigrim të ligjshëm, nëpërmjet nënshkrimit e kontratave të punës, arsimimit, bashkimit të familjeve, aplikimeve për lotarinë amerikane, kanadeze, australiane etj.

Pamundësia për të siguruar një nivel jetese të kënaqshëm i ka detyruar banorët e komunave Dajt e Bërzhitë, veçanërisht të fshatrave me sipërfaqe të kufizuara të tokës bujqësore, të emigrojnë jashtë vendit. Zakonisht emigrantët i përkasin grupmoshës 20-35 vjeç, që përbën pjesën më të rëndësishme të krahut të punës. Emigracioni nga njëra anë, ka kompromentuar, deri diku, të ardhmen e fermave, ndërsa nga ana tjetër, kapitali financiar i dërguar prej tyre është bërë burim i rëndësishëm investimesh në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së familjeve rurale.

Llogaritet që nga komuna e Dajtit të ketë emigruar përgjithmonë 18,2% e popullsisë (1218 banorë) dhe përkohësisht 27,3% e popullsisë (3610 banorë)<sup>91</sup>.

Numri i emigrantëve nga komuna Bërzhitë është 655, nga të cilët 200 janë të përhershëm, duke përbërë 11,05 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë.

Fillimisht emigrantët meshkuj u punësuan në bujqësi, ndërtim dhe më pak në sektorin e shërbimeve e profesione të tjera, ndërsa femrat si sanitare në familje, hotele, restorante etj.

Emigracioni ka pasur ndikime pozitive për popullsinë dhe zhvillimin social-ekonomik të komunave, sidomos në aspekte të tilla si: uljen e papunësisë, shtimin e investimeve në degët kryesore të ekonomisë, sidomos në bujqësi ku është investuar për ngritjen e serave, të vreshtave, për mekanizimin e bujqësisë, përmirësimin e kushteve të banimit (shumë shtëpi në të dy komunat janë ndërtuar me paratë e sjella nga emigrantët) etj.

Aspektet negative të emigracionit lidhen me karakterin klandestin të tij, që ndikon në kushtet e jetesës dhe të punës të emigrantëve, të cilët: nuk përfitojnë sigurim shëndetësor ose jete për aksidentet në punë, nuk u njihen vitet e punës për përfitimin e pensionit, janë të diskriminuar në paga dhe pozicionet e punës etj. Emigracioni ka ndikuar dhe në uljen e martesave apo prishjen e lidhjeve ose fejesave të mëparshme me vajzat shqiptare.

Në vitet e fundit, të ardhurat e sjella nga emigrantët kanë rënë. Kjo për arsye të krizës që ka përfshirë vendet fqinje, kryesisht Greqinë e Italinë, ku janë vendosur dhe përqindja më e lartë e emigrantëve të të dy komunave.

Një pjesë e tyre janë kthyer përgjithmonë dhe kanë investuar të ardhurat e fituara në emigracion kryesisht në bujqësi dhe në sektorin e shërbimeve ( hotele dhe restorante).

---

<sup>91</sup> Sulovari H., Gjeta Z., Ibraliu A., *Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik*. Komuna Dajt. Rrethi Tiranë. Tiranë 2005, fq. 70.

### III.1.6.c. Ndikimi i lëvizjeve hapësinore në numrin dhe strukturën e popullsisë

Komunat e marra në studim paraqesin karakteristika të ndryshme lidhur me lëvizjen hapësinore të popullsisë së tyre. Kështu, komuna Dajt është karakterizuar nga ritme të larta të popullsisë së vendosur në territorin e saj dhe gjatë gjithë periudhës 1994-2011, është karakterizuar nga një saldo pozitive, duke përbërë një nga faktorët më të rëndësishëm, që ka ndikuar në dyfishimin e popullsisë së saj nga viti 2001 në vitin 2011.

Gjatë kësaj periudhe në këtë komunë janë vendosur 6052 persona dhe janë larguar 1615 persona<sup>92</sup>. Në këtë preferencë të banorëve për të jetuar në këtë komunë kanë ndikuar afërsia e saj me qytetin e Tiranës, që përbën një mundësi të madhe për punësim, zhvillimi i shpejtë që ka marrë sektori terciar e veçanërisht turizmi, por dhe sektori i ndërtimit.

Ndërsa, komuna Bërzhitë deri në vitin 2006 është karakterizuar nga një saldo migruese negative. Popullsia e saj, për shkak të infrastrukturës më të dobët krahasuar me komunën Dajt, të investimeve më të pakta të bëra në këtë komunë si nga pushteti qëndror dhe lokal, por dhe nga ai privat, është zhvendosur kryesisht drejt qytetit të Tiranës. Pas vitit 2006, numri i të ardhurve në këtë komunë është rritur vazhdimisht, ndërsa numri i të larguarve ka ardhur duke u ulur, duke bërë që saldoja migruese gjatë kësaj periudhe të jetë pozitive (janë larguar 194 persona dhe kanë ardhur 499 persona, S=305 persona)<sup>93</sup>. Kjo tendencë mendohet të vazhdojë dhe në vitet e ardhshme, falë investimeve të shumta të bëra në sektorin e shërbimeve, kryesisht private, të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, ndërtimit të autostradës së re Tiranë-Elbasan, të potencialeve të shumta që ofron kjo zonë për zhvillimin e turizmit etj.

### III.1.7 Punësimi dhe papunësia sipas komunave

Komunat e marra në studim ndryshojnë nga njëra-tjetra për nga shkalla e punësimit të popullsisë. Komuna Dajt ka përqindjen më të lartë të të punësuarve dhe kjo është e lidhur me pozitën më të favorshme të saj si dhe me nivelin më të lartë të zhvillimit social-ekonomik.

Tabela III.9 Popullsia banuese sipas statusit aktual në lidhje me punësimin në vitin 2001

Rrethi	Komunat	Statusi lidhur me punësimin						Gjithsej
		Të punësuar		Të papunë		Jo ekon. aktivë		
		Nr.tot.	%	Nr.tot.	%	Nr.tot.	%	
Tiranë	Dajt	3198	55,17	437	7,5	2161	37,28	5796
	Bërzhitë	1315	34,49	676	17,73	1821	47,77	3812

Burimi: INSTAT, *Popullsia e Shqipërisë, 2001*.

Të punësuarit në komunën Dajt përbëjnë 55,17% të popullsisë aktive, kundrejt 34,4% në komunën e Bërzhitës. Komuna Dajt, pas vitit 1995, mori një zhvillim më të madh. Aty u kryen investime më të mëdha, falë pozitës së saj të favorshme, u përmirësua infrastruktura, që mundësoi dhe ngritjen e një sërë bar-restoranteve, ndërtimi i pallateve, në disa fshatra që

<sup>92</sup> Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt. 2012

<sup>93</sup> Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë. 2012

shtrihen pranë qytetit të Tiranës, të cilat krijuan kushte të favorshme për rritjen e numrit të të punësuarve në këtë komunë.

Numri i të papunëve në komunën Bërzhitë është 17,73% të popullsisë aktive, pra më i lartë se në komunën Dajt, ku përbën 7,5% të popullsisë aktive. Ky tregues në shkallë vendi është 13,8%, ndërsa në Qarkun e Tiranës 15,5% të popullsisë së aftë për punë<sup>94</sup>. Siç e shohim, ky tregues është shumë pozitiv për komunën Dajt, ku përqindja e popullsisë së papunë është sa gjysma e përqindjes së popullsisë së papunë në rang qarku dhe vendi. Ndërsa për komunën Bërzhitë ky tregues paraqitet më i lartë se në shkallë vendi e qarku.

Nëse në komunën Dajt vihet re një rritje e tempit të zhvillimit social-ekonomik që pas vitit 1995, në komunën Bërzhitë ky impuls zhvillimi filloi pas vitit 2005. Kjo është e lidhur me pozitën e saj, por dhe me mosshfrytëzimin si duhet të kapaciteteve natyrore dhe humane nga pushteti lokal deri në këtë periudhë.

I lartë paraqitet në komunën Bërzhitë edhe treguesi i popullsisë ekonomike jo aktive: 47,77%, kundrejt 37,28% në komunën Dajt. Për shkak të numrit të lartë të lindjeve, të numrit të lartë të popullsisë së ardhur, dhe kryesisht në moshë të re, popullsia aktive në komunën e Dajtit paraqitet më e lartë se në komunën Bërzhitë.


Megjithatë, për të dy komunat mund të themi, se përqindja e lartë e popullsisë së aftë për punë përbën një potencial të rëndësishëm e të domosdoshëm në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të tyre.

Tabela III.10 Popullsia banuese sipas statusit aktual në lidhje me punësimin vitin 2011

Rrethi	Komunat	Statusi lidhur me punësimin						Gjithsej
		Të punësuar		Të papunë		Jo ekon. aktivë		
		Nr.tot.	%	Nr.tot.	%	Nr.tot.	%	
Tiranë	Dajt	5.653	61,3	682	7,4	2.888	31,31	9.223
	Bërzhitë	1.535	38,7	560	13,5	2.055	49,51	4.150

Burimi: Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Grafiku III.10 Numri i popullsisë banuese e punësuar në komunat Dajt e Bërzhitë 2001, 2011



Burimi: INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2001 dhe Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë.

Duke krahasuar të dhënat e vitit 2011 me ato të vitit 2001, del se numri i të punësuarve në të dy komunat është rritur. Kjo lidhet me investimet private, kryesisht në bar-

<sup>94</sup> INSTAT, Buletini Statistikor. Tremujori i I, viti 2012, fq 10.

restorante, hotele e komplekse turistike, numri i të cilave në të dy komunat është rritur, falë pozitës, ajrit të pastër dhe peizazhit piktoresk që kanë këto dy komuna. Rritja më e madhe është shënuar në komunën Dajt: 6,13% kundrejt 4,21% në komunën Bërzhitë. Ndikim pozitiv në këtë rritje ka patur edhe ndërtimi i teleferikut “Dajti Expres”, infrastruktura më e mirë, shtrirja më afër qytetit të Tiranës etj.


Shkalla e lartë e punësimit në këto komuna, në shumë raste nuk është një e dhënë reale, pasi konsiderohen si të punësuar të gjithë ata që zotërojnë një ngastër toke apo 2 dy tokë. Kjo ndikon në rritjen artificiale të numrit të të punësuarve.

Të punësuarit në sektorin primar (bujqësi, blegtori etj.) përbëjnë rreth 70% të të punësuarve në të dy komunat (përkatësisht 69,5% në komunën Dajt dhe 72,3 % në komunën Bërzhitë).

Në bujqësi, numri i specialistëve në raport me numrin e të punësuarve, është shumë i vogël. Bazuar në të dhëna jo shumë të sakta të shërbimit të statistikave dhe të informacionit të komunës Dajt, numri i specialistëve të bujqësisë me arsim të lartë është 10 persona, nga të cilët katër punojnë aktualisht si specialistë të bujqësisë, tre persona janë të vetëpunësuar, ndërsa tre të tjerë janë të punësuar në punë jobuqësore. Në komunën Bërzhitë, numri i specialistëve të bujqësisë me arsim të lartë është tetë persona.

Kjo vështirëson zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë rurale, përzgjedhjen e duhur të kulturave bujqësore, përdorimin shkencor të kimikateve, mekanikës, prodhimit sipas standarteve të BE-së, marketingun dhe tregtimin e produkteve lokale etj.

Grafiku III.11 Përqindja e popullsisë banuese e papunësuar në 2001 e 2011



Burimi: INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2001 dhe Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Përqindja e popullsisë e papunësuar është më e lartë në komunën Bërzhitë. Por, nëse në komunën Dajt numri i të papunëve është zvogëluar shumë pak, në atë të Bërzhitës zvogëlimi është i konsiderueshëm: nga 17,73% në 2001 në 13,5% në 2011, por duke mbetur pothuajse dy herë më i lartë se në komunën Dajt, ku është ulur nga 7,5% në 7,4%. Kjo lidhet me impulsin e zhvillimit social-ekonomik që ka marra komuna e Bërzhitës pas vitit 2005. Ndërtimi i autostradës së re, Tiranë-Elbasan, do të ndikojë në uljen e mëtejshme të numrit të të papunëve në këtë komunë, pasi tashmë përveç qytetit të Tiranës, do të jetë dhe qyteti i Elbasanit një mundësi më shumë për tu punësuar.

Fshatrat me numrin më të madh të të papunëve janë kryesisht fshatrat e thella, me sipërfaqe të kufizuar të tokës bujqësore, si Qafmollë e Darshen në komunën e Dajtit, si dhe fshatrat Rozaverë e Kusë në komunën Bërzhitë.

Po ti referohemi numrit të të punësuarve sipas sektorëve, vëmë re se sektori privat ka numrin më të madh të të punësuarve (86,3 % në komunën Dajt dhe 89,2% në komunën Bërzhitë). Në sektorin shtetëror banorët e këtyre komunave janë punësuar kryesisht në arsim, shëndetësi si dhe në administratën e komunës, prandaj dhe përqindja që ato zënë është e vogël. Numri më i madh i të punësuarve në të dy komunat është në bujqësi (69,5%/72,3 %) <sup>95</sup>. Përqindja e të punësuarve në këtë sektor paraqitet dhe më e lartë se në nivel qarku (Qarku Tiranë, 56,9 % janë të punësuar në bujqësi) <sup>96</sup>.

Tabela III.11 Numri i të punësuarve në % sipas sektorëve

Komuna	Sektori privat	Sektori shtetëror
Dajt	86,3	13,7
Bërzhitë	89,2	11,8

Burimi: Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Tabela III.12 Numri i të punësuarve (%) sipas sektorëve të ekonomisë

Komuna	Bujqësi	Ind.nxje	Ind. përp	Ndërtim	Tregti artik	Hotel-rest.	Transport telek.	Banka	Arsim	Shënd.
Dajt	69,5	0,5	0,4	5,2	17	6	0,8	0,5	1,2	0,4
Bërzhitë	72,3	0,2	0,2	4,2	18,2	3,6	0,6	0,1	1,4	0,6

Burimi: Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë

### III.1.7.a Punësimi dhe papunësia sipas grupmoshave dhe gjinisë

Punësimi është një nga objektivat kryesore të qeverisjes vendore, në të dy komunat. Suksesi dhe vazhdimësia e qeverisjes varen shpesh nga shtimi i mundësive për punësim të shpejtë. Kualifikimi dhe mosha janë dy kushte të rëndësishme për sigurimin e vendit të punës.

Në analizën e punësimit sipas grupmoshës dhe gjinisë janë shfrytëzuar të dhënat e vitit 2001, pasi deri në nëntor 2013, nuk janë publikuar ato të Censurit të popullsisë dhe banesave të vitit 2011 në nivel komune.

Përqindja më e madhe e të punësuarve në të dy komunat i përket grupmoshës 30-44 vjeç (respektivisht 42,18% dhe 38,63%). Preferenca e punëdhënësve për këtë grupmoshë lidhet me përgatitjen profesionale më të lartë, përgjegjshmërinë më të madhe në punë, stabilitetin në vendin e punës, vitalitetin dhe energjinë.

<sup>95</sup> Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2012

<sup>96</sup> INSTAT, Anketa e forcave të punës, viti 2010, fq. 3



Përqindjen më të ulët në punësim, në të dy komunat, e ka popullsia mbi 55 vjeç (respektivisht 4,12% dhe 2,96%). Kjo grupmoshë është e punësuar në bujqësi e tregti private dhe më pak në sektorin publik.

Bie në sy fakti që përqindja e të punësuarve të grupmoshës 20-29 vjeç në komunën e Dajtit është mbi dy herë më e lartë se në atë të Bërzhitës (respektivisht 30,38% ndaj 14,37%).

Kjo lidhet kryesisht me punësimin në sektorin e shërbimeve (bar-restorante, hoteleri, transport etj.), i cili është më i zhvilluar në komunën Dajt. Gjithashtu, kjo grupmoshë paraqitet dhe më e kualifikuar në komunën e Dajtit se në atë të Bërzhitës.

Tabela III.13 Popullsia banuese e punësuar sipas grupmoshave<sup>97</sup>

Komunat	Grupmoshat (%)						Gjithsej
	15-19	20-29	30-44	45-54	55-64	65+	
Dajt	14,82	30,38	42,18	18,54	3,94	0,18	3,198
Bërzhitë	15,13	14,37	38,63	28,89	2,58	0,38	1,315

Burimi: INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2001

Nga analiza e të dhënave të punësimit sipas gjinisë del se, në të dy komunat, përqindjen më të lartë e përbëjnë meshkujt, që janë të angazhuar kryesisht në ekonominë bujqësore, ndërtimtari etj.

Komuna Dajt ka një përqindje më të lartë të të punësuarve femra se komuna Bërzhitë (përkatesisht 39,05 kundrejt 31,40). Kjo lidhet me mundësitë më të mëdha që kanë femrat për punësim në komunën e Dajtit, kryesisht në bar-restorante e hotele, numri i të cilave është rritur ndjeshëm në këtë komunë dhe kryesisht në fshatrat Linxë, Lanabregas e Shtish-Tufinë. Kjo lidhet dhe me shkallën më të lartë të arsimimit dhe emancipimit të femrës në këtë komunë.

Tabela III.14 Popullsia banuese e punësuar sipas gjinisë<sup>98</sup>

Komunat	Meshkuj		Femra		Gjithsej
	Nr.total	%	Nr.total	%	
Dajt	1949	60,94	1249	39,05	3198
Bërzhitë	902	68,59	413	31,40	1315

Burimi: INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2001

Tabela III.15 Popullsia banuese e papunë sipas grupmoshave

Komunat	Grupmoshat (%)					Gjithsej
	15-19	20-29	30-44	45-54	55-64	
Dajt	14,41	58,12	23,11	3,66	0,68	437
Bërzhitë	11,24	59,31	25,59	2,51	1,33	676

Burimi: INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2001

<sup>97</sup> INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2011, fq.8

<sup>98</sup> INSTAT, Popullsia e Shqipërisë 2001, fq. 16

Tabela III.16 Popullsia banuese e papunë sipas gjinisë

Komunat	Meshkuj		Femra		Gjithsej
	Nr.total	%	Nr.total	%	
Dajt	296	67.73	141	32.26	437
Bërzhitë	486	71.89	190	28.10	676

Burimi: INSTAT, *Popullsia e Shqipërisë 2001*

Me gjithë pakësimin e të papunëve në komunën e Bërzhitës, përqindja e tyre mbetet ende më e lartë së në komunën e Dajtit (respektivisht 13,5% kundrejt 7,4%).

Përqindjen më të lartë të të papunëve në të dy komunat e zë grupmosha 20-29 vjeç. Kjo shpjegohet me faktin se kjo grupmoshë nuk ka kualifikimin dhe përvojën e kërkuar nga punëdhënësi. Gjithashtu, ajo është mosha më e prirur për të emigruar dhe në pritje të një mundësie të tillë, preferon të mos angazhohet në punë.

Numri i vogël i banorëve të papunë, (437/674), lidhet me mosdeklarimin si të papunë në zyrat e punësimit, dhe kjo është më e shprehur sidomos tek femrat. Mosdeklarimi i tyre si të papuna bën që numri i tyre të jetë akoma dhe më i lartë se ç'është në të vërtetë. Kjo është e shpjegueshme dhe nga ekzistenca e një shkalle të lartë të informalitetit të ekonomisë në të dy komunat.

### III.1.7.b Të ardhurat dhe niveli i varfërisë

Si pasojë e krizës globale financiare dhe situatës së përgjithshme makroekonomike lidhur me normat e ulëta të rritjes që nga viti 2008, varfëria në Shqipëri është rritur. Pjesa e popullsisë, konsumi mujor real për frymë i së cilës është nën 4891 lekë, u rrit nga 12.4 % në vitin 2008 në 14.3% në vitin 2012. Popullsia ekstremisht e varfër, e përcaktuar si personat që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore, është rritur nga 1.2% në vitin 2008 në 2.2% në vitin 2012. Varfëria ekstreme, në vitin 2012 është rritur në zonat urbane me 2.2% dhe zonat rurale me 2.3%<sup>99</sup>.

Qarku i Tiranës ka një normë të varfërisë afër mesatares së vendit 14.2% kundrejt 14.3% në shkallë vendi<sup>100</sup>. Dhe hapësira rurale e saj ka një normë të varfërisë afër mesatares në shkallë vendi që është 15.3%. Konsumi real për frymë në vitin 2012, ka rënë nga 9731 lekë në 2008 në 8939 lekë në 2012.<sup>101</sup>

Të ardhurat mesatare mujore për familje në shkallë vendi janë 38,141 LEK, ndërsa për Qarkun e Tiranës ato paraqiten më të larta 56,434 LEK, dhe për zonat rurale të tij 50,226 LEK<sup>102</sup>. Në komunën Dajt e Bërzhitë, të ardhurat mesatare mujore për familje janë më të larta se në shkallë vendi, dhe pak më të larta se zonat rurale të Qarkut Tiranë. Ky tregues për komunën Dajt është 52,600 LEK, ndërsa për komunën Bërzhitë 51,750 LEK<sup>103</sup>.

<sup>99</sup> INSTAT & BB, *Shqipëria: Trendi i varfërisë, 2002-2005-2008-2012*. Shtator 2013. fq. 2

<sup>100</sup> Po aty. fq. 6

<sup>101</sup> Po aty. fq. 3


<sup>102</sup> INSTAT, *Prodhimi i Brendshëm Bruto në RSH sipas nivelit 2 dhe 3. Tiranë 2009*.

<sup>103</sup> *Zyra e Statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2012*

Duke analizuar hartën e treguesit të varfërisë (Head Count), për vitin 2004, vëmë re se të dy komunat Dajt dhe Bërzhitë, ndodhen në të njëjtin nivel, krahas komunave të tjera të zhvilluara të rrethit të Tiranës, si: Paskuqan, Farkë, Kashar e Zallbatar.

Pjesa dërrmuese e familjeve në komunat Dajt dhe Bërzhitë arrijnë të plotësojnë nevojat e tyre jetësore, por disa familje kanë nivel të ulët jetese. Ndër shkaqet e kësaj gjendje janë:

- sipërfaqja e kufizuar e tokës bujqësore, sidomos për fshatrat kodrinoro-malore si fshatrat Murth, Selbë, Qafmollë e Darshen në komunën Dajt dhe Shalqizë, Rozaverë e Klllojkë në komunën Bërzhitë.
- papunësia, sidomos në komunën Bërzhitë ku përqindja e popullsisë aktive e papunë është e lartë.
- niveli i ulët i mekanizimit të bujqësisë;
- mungesa e fondeve dhe investimeve;
- niveli jo i latë i shërbimeve shëndetësore, arsimore e sociale;
- mungesa e aksesit për punësim në aktivitetet jobujqësore, dhe kjo është më e shprehur në komunën Bërzhitë etj.



Harta III.2 Harta e varfërisë

➤ *Komuna Dajt*


Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Dajt është ulur nga 138 më 2006, në 107 në 2011. Kjo ka ardhur si rezultat i përmirësimit të kushteve të jetesës së disa familjeve që trajtoheshin më parë me ndihmë ekonomike, por dhe për shkak të pamundësisë së paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar nga disa familje në kushte të vështira jetese.

*Tabela III.17 Numri i familjeve me ndihmë ekonomike sipas fshatrave në komunën Dajt*

<b>Fshatrat/ vitet</b>	<b>2006</b>	<b>2011</b>
1. Shtish Tufinë	19	14
2. Tujan	6	11
3. Brarë	5	20
4. Ferraj	-	-
5. Linxë	15	14
6. Priskë e Madhe	15	15
7. Surrel	12	7
8. Lana Bregas	6	4
9. Shkallë	2	3
10. Qafmollë	2	1
11. Darshen	6	2
12. Selbë	25	15
13. Murth	2	1
<b>Gjithsej</b>	<b>138</b>	<b>107</b>


Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt

*Grafiku III.12 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Dajt*



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt

Grafiku III.13 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në fshatrat e komunës Dajt



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt

Megjithatë, numri i familjeve në nevojë është më i madh. Shumë familje, rreth 75% e tyre, konsumojnë të gjitha të ardhurat e vitit dhe nuk kanë mundësi të investojnë në ferma në përmirësimin e teknologjisë apo përdorimit të farërave më cilësore, në përmirësimin e sistemit ujitës apo në përdorimin e plehrave kimike<sup>104</sup>.

➤ *Komuna Bërzhitë*


Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në këtë komunë, në vite, ka ardhur duke u rritur, siç pasqyrohet në tabelën e grafikon në vijim.

Tabela III.18 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Bërzhitë

Vitet	2001	2006	2011
<b>Bërzhitë</b>	253	135	203

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë

Grafiku III.14 Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Bërzhitë



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë

Në vitin 2001 përfitonin ndihmë ekonomike 253 familje, nga të cilat 197 përfitonin ndihmë të plotë, kurse 56 ndihmë të pjesshme.

Në vitin 2006 përfitonin ndihmë ekonomike 135 familje, nga të cilat 75 përfitonin ndihmë të plotë dhe 60 ndihmë të pjesshme.

<sup>104</sup> Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Në janar të vitit 2011 përfitojnë ndihmë ekonomike 203 familje, nga të cilat 99 përfitonin ndihmë të plotë dhe 104 ndihmë të pjesshme.

Kjo ndihmë në vitet e mëparshme luhatej nga 6800 deri në 8000 lekë, ndërsa në 2011 nga 2600 deri në 5100 lekë.

Tabela III.19 Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën Dajt e Bërzhitë

Komuna/vitet	2006	2011
Dajt	5,64	3,34
Bërzhitë	9,89	13,56

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën e Dajtit është më i vogël se në atë të Bërzhitës, përkatësisht 3,34% kundrejt 13,56% në komunën e Bërzhitës. Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike në komunën e Dajtit ka ardhur duke u ulur në vite dhe kjo lidhet dhe me përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë komunë si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve në disa sektorë si në sektorin e shërbimeve, në ndërtim, në bujqësi etj. E kundërta ka ndodhur në komunën Bërzhitë, ku përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike ka ardhur duke u rritur. Dhe në këtë komunë numri i bar-restoranteve apo mundësitë për t'u punësuar në sektorin e ndërtimit të rrugëve janë rritur, por papunësia ende është e lartë.

## III.2 Vendbanimet dhe banesat

### III.2.1. Karakteristikat e vendbanimeve

Karakteristikë e vendbanimeve është shtrirja kryesisht pranë rrugëve, në kodrat e ulëta, pranë rrjedhjes së lumenjve etj, por edhe në lartësi më të mëdha si fshati Killojkë në komunën e Bërzhitës apo fshatrat Shkallë, Murth e Darshen në komunën Dajt.

Tabela III.20 Klasifikimi i fshatrave sipas lartësisë

Komuna	F. fushore	F. kodrinore	F. malore
Dajt	Tufinë	Ferraj,Linzë,Surrel Lanabregas,Priskë.	Brari,Tujani, Shkallë, Qafmollë, Selbë, Darshen, Murth.
Bërzhitë	Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme,	Pëllumbas, Ibë e Sipërme,	Killojkë, Fravesh, Kusë, Lugë, Pashkashesh, Rozaverë, Mihajas, Cirmë, Shalqizë

Burimi: Zyra e Menaxhimit të Tokës në komunat Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

Në vendbanime dallohet pjesa e ndërtuar gjatë regjimit komunist dhe ajo me ndërtime të reja. Këto dy pjesë diferencohen nga stili, materialet, numri i kateve të banesave, largësia dhe përhapja gjeografike e ndërtesave.

Vendbanimet rurale, para vitit 1990, kishin organizim hapësinor të rregullt dhe pothuajse të njëjtë. Në qendrën e fshatit ndodhej sheshi, zyrat, shkolla, qendra shëndetësore, shtëpia e kulturës, në ndonjë rast muzeu dhe biblioteka, mjediset sportive dhe 2-3 dyqane.

Shtëpitë shtriheshin përgjatë rrugëve të ngushta të fshatit dhe pas banesave ndodheshin magazinat, stallat, thertoret, SMT-të (Stacionet e Makinave dhe Traktorëve) etj, ndërsa më tej tokat e punueshme, pyjet dhe kullotat.

Ndryshimet në organizimin hapësinor të vendbanimeve pas vitit 1990, shfaqen në:

- përhapjen pa planifikim të ndërtimeve;
- shtimin e ndërtimeve administrative, tregtare e rezidenciale pranë qendrave të vendbanimeve;
- zgjerimin ose ngushtimin e rrugëve kryesore të lagjeve;
- modelimin e banesave brenda dhe jashtë sipas stileve perëndimore;

Shtimi i popullsisë ka rritur intensitetin e përdorimit të tokës për ndërtime rezidenciale dhe për funksione të tjera.



*Fig. III.3 Ndërtesa shumëkatëshe në Qesarakë, në fshatin Linzë, komuna Dajt*

Planet e organizimit hapësinor dhe zhvillimit urban të fshatrave mungojnë në të dy komunat. Mungesa e planeve rregulluese ka ndikuar në pamjen e çrregullt të pothuajse të gjitha fshatrave.

Sipas aktivitetit ekonomik, pothuajse të gjitha këto vendbanime, bëjnë pjesë në fshatra të tipit të përzier. Disa prej tyre si Linza (Qesaraka), Shtishtufina, Lanabregasi në komunën Dajt, mund ti konsiderojmë si vendbanime rurale në urbanizim, madje lagje të tyre janë përfshirë në territorin e Bashkisë së Tiranës, në Projektin për Planin Tematik Urban të Tiranës së Madhe, 2012<sup>105</sup>.

Ky studimim është hartuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës në vitin 2012. Ai mbulon të gjithë zonën e Tiranës Metropolitane (ZTM), ku përfshihen territoret e urbanizuara aktuale e perspektive të Bashkisë Tiranë, dhe shtatë bashkive e komunave kufitare.

Disa fshatra si Rozaverë, Shalqizë, Cirmë, Kusë në komunën Bërzhitë, popullsia e së cilës ka ardhur duke u zvogëluar vazhdimisht, luhetet nga 51-88 banorë në vitin 2011, janë prekur nga fenomeni i braktisjes dhe e ardhmja e tyre është e pasigurtë.

<sup>105</sup> *Projekti për Planin Tematik Urban të Tiranës së Madhe*, hartuar nga JICA, viti 2012, fq.76



Dhe në komunën Dajt ka fshatra, popullsia e të cilave është zvogëluar shumë, në disa raste është përgjysmuar nga viti 1994 në vitin 2011, si fshatrat Selbë, Shkallë, Darshen, Murth, por ato ende nuk kanë hyrë në fazën e braktisjes masive. Kjo lidhet me kushtet jo të favorshme për veprimtarinë jetësore që kanë këto fshatra si pasojë e shtrirjes së tyre në zona të thella malore. Në këto fshatra nuk ka ndërtime të reja, madje nuk po investohet dhe në rikonstruksionin e ndërtesave të vjetra.

### ***III.2.2. Banesa rurale, funksionet dhe evolucioni i saj***

Gjatë regjimit komunist shtëpitë ndërtoheshin kryesisht me tulla dhe mbuloheshin me tjegulla, tualeti ndodhej i veçuar nga banesa dhe mobilimi ishte i thjeshtë. Banesat ishin të gjitha njëkatëshe, të tipit “Elbasani”<sup>106</sup>, shumë pranë njëra tjetrës dhe me oborr të vogël, që mbillej me pemë frutore, hardhi, perime etj.

Oborri i banesës përbënte rrethinën e shtëpisë së një familje dhe përfshinte ndërtimet ndihmëse për ekonominë e familjes si prodhimet bujqësore dhe ato blegtorale. Oborret përgjithësisht rrethoheshin me gardhe dhe në hyrje mbyllej me trinë<sup>107</sup>. Brenda tij gjendeshin kasollja e barit, koshari i misrit, kasollja për bagëtitë, hajat për veglat bujqësore, koteci i pulave dhe streha për qentë.

Banesat e fshatarëve ishin të ulta dhe pa oxhak, me përjashtim të banesave që i përkisnin familjeve të pasura. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë të përhapura dy tipe shtëpish: në tipin e parë bëjnë pjesë shtëpi dy katëshe, ku në katin përdhes vendosej bagëtia dhe në katin e dytë banonte familja dhe ky tip banese i përkiste familjeve më të pasura. Tipi i dytë, që i përkiste familjeve më të varfra, banesa ishte një katëshe dhe një pjesë banohej nga familja, pjesa tjetër e ndarë me gardh përdorej për bagëtinë. Zjarri ndizej në mes të shtëpisë dhe tymi mbulonte gjithë banesën. Tavan nuk kishte dhe mbi trarë varej një zinxhir ku vendosej ibriku për ngrohjen e ujit. Dyshemeja ishte me dhe të ngjeshur dhe mbi të vendosej hasra.

Ndryshimet në tipat e banesave dhe shpërndarjen e tyre filluan të shfaqen pas vitit 1990 dhe vazhdojnë akoma dhe sot. Sot ato shtrihen në të gjitha drejtimet e mundshme, në varësi të dëshirave dhe mundësive financiare të banorëve.

Pas vitit 1990, shtëpitë janë ndërtuar dhe në tokat bujqësore, të përfituara nga zbatimi i ligjit 7501 “Për Tokën” dhe kryesisht të tipit vilë, me jo më pak se dy kate.

Ato dallohen për stilet e veçanta dhe të larmishme, kanë më shumë se një kat, tualet dhe ujë të ngrohtë, pajisje elektro-shtëpiake cilësore, mobilim bashkëkohor etj, ndërsa kafshët sistemohen në ndërtesa të veçanta, larg mjediseve të banimit. Në disa raste shtëpitë e vjetra janë përshtatur për kafshët.

Në Qesarakë dhe Lana-Bregas të komunës Dajt janë ndërtuar edhe pallate shumëkatëshe apo komplekse pallatesh, ndërsa në komunën Bërzhitë vetëm shtëpi private. Në total, në të dy komunat përhapjen më të madhe e kanë banesat individuale.

Të dy komunat janë të varfra në drejtim të planeve e projekteve urbanistike. Fillimisht, është punuar me vijat kufizuese të fshatrave, që janë përcaktuar në vitin 1986, por që në përgjithësi, nuk janë zbatuar. Ekziston një studim urbanistik, i hartuar në vitin 1994,

---

<sup>106</sup> Shtëpi e tipit “Elbasani”, shtëpi njëkatëshe me verandë përpara, karakteristike për Shqipërinë e Mesme.

<sup>107</sup> Trinë- derë e thurur me thupra.

për ndërtimet 1-3 katëshe në zonën kodrinore të Linzës. Ka patur studime të pjesshme dhe për fshatin Tufinë. Në vitin 2006-2007, është miratuar një studim për zonimin funksional të fshatit Qesarakë, dhe mbi bazën e tij janë dhënë dhe sheshe ndërtimi për ndërtesa shumëkatëshe në Qesarakë.

Numri i banesave është më i lartë në komunën Dajt se sa në atë të Bërzhitës, përkatësisht 8401 banesa në komunën Dajt e 1348 banesa në komunën Bërzhitë. Në komunën Dajt numri i banesave është 72,4 banesa për km<sup>2</sup>, ndërsa për komunën Bërzhitë ky tregues është 23,26 banesa për km<sup>2</sup>. Kjo lidhet me pozicionin pranë qytetit të Tiranës dhe relievin më të përshtatshëm, si dhe me kërkesën më të madhe për strehim.

Zona Qesarakë e fshatit Linzë, është zona më e populluar e komunës Dajt, për shkak të pozitës së saj dhe terrenit të përshtatshëm për ndërtim. Kjo zonë gjatë periudhës së tranzicionit pësoi një urbanizim të shpejtë dhe godinat e ndërtuara janë 6-7 kate. Këto godina janë vendosur në bazë të studimeve urbanistike të pjesshme, të veçuara ose të grupuara në formë kompleksesh. Një zonë tjetër, në të cilën ka kërkesa për të ndërtuar, është dhe zona e fshatit Priskë. Këtu janë ndërtuar kryesisht vila individuale.


Nga vërtetimet e bëra në terren del se shtëpitë e ndërtuara në këto zona nuk kanë ndonjë karakteristikë të veçantë. Materiali ndërtimor është si kudo: tulla, gurë dhe, në disa raste, blloqe betoni. Zakonisht janë të mbuluara me tjegulla, soletë e materiale të tjera. Janë të përmasave dhe modeleve të ndryshme, pa një arkitekturë specifike dhe të studiuar. Një shtëpi tipike përbëhet nga 3-4 dhoma, ndërsa mobilimi i brendshëm është në përgjithësi modest.

Vilat e veçuara apo në blloqe, me gjithë se të ndërtuara, në shumicën e rasteve, pa plan urbanistik, janë një element i shtuar në peizazhin rural të zonës.

Në fshatrat e thella numri i ndërtimeve është i kufizuar. Kjo lidhet me mundësitë e pakta ekonomike që kanë banorët dhe me zhvendosjen e popullsisë drejt qytetit apo fshatrave të tjerë.



*Fig. III.5 Ndërtim i ri në komunën Dajt*



Harta III.2 Numri i banesave në vitin 2011

### III.2.3. Traditat ndërtimore dhe ecuria e numrit të ndërtimeve

Në periudhat e hershme dhe para vitit 1990, ndërtimet bëheshin në vende të ngritura, si kodrina, apo zona të pasura me burime ujore.

Pas vitit 1990, mungesa e planeve rregulluese në të dy komunat si dhe lëvizja kaotike e popullsisë ka sjellë zënien e sipërfaqeve të tokës bujqësore me ndërtime të shumta e pa planimetri.

Ecuria e ndërtimeve në të dy komunat ngjason me atë të numrit të popullsisë.

Tabela III.21 Ecuria e numrit të ndërtimeve<sup>108</sup>

Komuna	Vitet e ndërtimit						Gjithsej
	Deri më 1960	1961-1980	1981-1990	1991-2000	2001-2005	2006-2011	
Dajt	125	147	149	843	483	459	3108
Bërzhitë	83	154	142	117	86	80	1203

Burimi: INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*


Në komunën e Dajtit ka 4.768 ndërtime të reja, ndërsa në atë të Bërzhitës 1.070. Nuk ka të dhëna për vitin e ndërtimit të disa shtëpive.

Nga harta III.3 del se gjatë periudhës 1945-1990, ndërtimet kanë qenë më të shumta në komunën e Bërzhitës sesa në komunën Dajt. Kjo shpjegohet me ekzistencën e sipërfaqeve të mëdha të tokës së punueshme e zhvillimin që mori bujqësia gjatë kësaj periudhe në këtë komunë. Ndërsa në komunën Dajt, krahas sipërfaqes së kufizuar të tokës së punueshme, një pjesë e saj ishte zonë ushtarake ose hapësirë rezidenciale për udhëheqësit komunistë të asaj kohe, prandaj dhe ndërtimet ishin shumë të kufizuara.

Për të dy komunat, rritjen më të madhe, numri i ndërtesave, e ka patur gjatë periudhës 1970-1980, por me ritme shumë herë më të larta në komunën Bërzhitë. Numri i ndërtesave mbetet i lartë dhe në dhjetëvjeçarin tjetër 1980-1990. Kjo lidhet me rritjen e numrit të popullsisë gjatë kësaj periudhe në të dy komunat, e kjo falë shtimit natyror të lartë të popullsisë së tyre.

Pas vitit 1990, e sidomos pas vitit 2000, me zhvillimin e shpejtë që mori komuna Dajt, pati një rritje të madhe të numrit të ndërtesave. Kjo, dhe si rrjedhojë e shtimit të popullsisë së ardhur nga zonat e tjera të vendit. Është rritur jo vetëm numri i ndërtesave për banim, por dhe i atyre që përdoren për funksione të ndryshme ekonomike, si ndërmarrje, punishte etj.

<sup>108</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, INSTAT, Tiranë, 2011. fq. 84.



Harta III.3 Ecuria e numrit të ndërtesave në periudha të ndryshme

Në komunën Bërzhitë, gjatë periudhës 1991-2000, numri i ndërtesave ka ardhur duke u ulur, duke njohur ulje të konsiderueshme lidhur dhe me periudhat e para vitit 1990. Kjo lidhet me mundësitë më të pakta që kanë ekzistuar në këtë komunë si në aspektin e infrastrukturës, por dhe në zhvillimin social-ekonomik të saj.

Gjatë kësaj periudhe, shumë nga banorët e saj u larguan jashtë vendit apo u vendosën në Tiranë, dhe njëkohësisht ajo ende nuk ishte një destinacion i përshtatshëm dhe për banorët e zonave përreth. Përmirësimi i infrastrukturës, investimet e bëra në këtë komunë pas vitit 2000, si nga pushteti vendor e ai qëndror, por dhe nga investitorë privatë, kanë bërë që pas këtij viti numri i ndërtesave të ketë njohur rritje. Kjo rritje vazhdon dhe sot. Pas ndërtimit të autostradës Tiranë-Elbasan e zhvillimit social-ekonomik të saj, kjo komunë do të jetë e preferuar dhe për një sërë fshatrash të tjera dhe të rrethit të Elbasanit.

Shumë nga bizneset, kryesisht fashione, ushqimore etj., për shkak të taksave më të ulëta e krahu të lirë të punës, po zhvendosen tashmë në periferi të Tiranës. Komunitat Dajt e Bërzhitë, për shkak të pozitës së tyre, shumë pranë këtij qyteti, por dhe të ekzistencës së një kapitali human të madh e relativisht të kualifikuar, do të jenë të përshtatshme për vendosjen e tyre. Kjo do të sjellë, përveç të tjerave, dhe rritjen e numrit të ndërtesave.

### **III.3 Veçori të zhvillimit social**

#### ***III.3.1 Familja rurale, numri, madhësia dhe evolucioni***

Shtimi i popullsisë në komunat Dajt dhe Bërzhitë është shoqëruar dhe me rritjen e numrit të familjeve. Ky është një tregues i rëndësishëm i përmirësimit të kushteve të jetesës, punësimit dhe strehimit, si dhe i stabilitetit social-ekonomik.

##### **➤ *Komuna Dajt***

Pas vitit 1990, numri i familjeve në komunën Dajt ka ardhur duke u rritur, krahas shtimit të popullsisë në këtë komunë. Gjatë periudhës 2001 - 2011, numri i familjeve është rritur nga 1.795 (v. 2001) në 4.847 (v. 2011)<sup>109</sup>. Rritjen më të madhe e kanë pasur disa fshatrat që shtrihen më afër qytetit të Tiranës, si Linxa, Shtish-Tufina, Lanabregasi, Priska e Madhe etj, që kanë nivel më i lartë të zhvillimit social-ekonomik.

Në fshatrat më larg kryeqytetit, që kanë infrastrukturë të dobët, sipërfaqe të kufizuara të tokës bujqësore etj, numri i familjeve është pakësuar. Popullsia e fshatrave Shkallë, Selbë e Murth është zhvendosur në drejtim të fshatrave më afër Tiranës, me mundësi më të mira jetese.

---


<sup>109</sup> INSTAT, *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, Tiranë 2011, Fq. 90.

Tabela III.22 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Dajt<sup>110</sup>

Fshatrat/ vitet	1994	2006	2011
Shtish-Tufinë	164	374	465
Tujan	89	63	70
Brar	103	117	126
Ferraj	106	97	115
Linxë	234	710	1190
Priskë e Madhe	262	273	296
Surrel	140	171	185
Lana Bregas	148	291	347
Shkallë	118	62	56
Qafmollë	84	53	65
Darshen	155	88	97
Selbë	176	100	93
Murth	67	47	45
<b>Gjithsej</b>	<b>1846</b>	<b>2446</b>	<b>3200</b>


Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt

Grafiku III.15 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Dajt



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt

Grafiku III.16 Numri i familjeve në komunën Dajt



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Dajt

<sup>110</sup> Zyra e gjendjes civile, komuna Dajt

➤ *Komuna Bërzhitë*


Numri i familjeve në komunën Bërzhitë ka rritje të lehtë pas vitit vitit 2006: nga 1.364, në 1.496 (v. 2011). Kjo është rezultat i shpërbërjes së familjeve të mëdha dhe i krijimit të familjeve të reja.

Tabela III.23 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Bërzhitë<sup>111</sup>

Fshatrat / Vitet	1997	2006	2011
1. Bërzhitë	189	232	264
2. Dobresh	95	113	127
3. Ibë e Poshtme	178	198	234
4. Ibë e Sipërme	304	381	404
5. Pëllumbas	102	94	109
6. Mihajas	45	43	45
7. Cirmë	4	19	19
8. Kusë	38	27	24
9. Fravesh	63	45	48
10. Kllojkë	132	104	112
11. Pashkashesh	61	35	43
12. Lugë	54	35	35
13. Shalqidhë	17	19	17
14. Rozaverë	26	19	15
<b>Gjithsej</b>	<b>1326</b>	<b>1364</b>	<b>1496</b>

Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë, viti 2012

Grafiku III.17 Numri i familjeve sipas fshatrave në vite në komunën Bërzhitë




Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë

Rritje të numrit të familjeve kanë pasur fshatrat Ibë e Sipërme, Bërzhitë, Ibë e Poshtme dhe Pëllumbas, që ndodhen më afër kryeqytetit dhe kanë kushte më të favorshme social-ekonomike.

<sup>111</sup> Zyra e gjendjes civile, komuna Bërzhitë, viti 2012



Grafiku III.18 Numri i familjeve në komunën Bërzhitë



Burimi: Zyra e Gjendjes Civile, komuna Bërzhitë, viti 2012

Po t'u referohemi të dhënave të dy regjistrimeve të fundit të popullsisë së Shqipërisë, të viteve 2001 e 2011, të kryera nga INSTAT, vëmë re disa ndryshime.

Së pari, numri i familjeve në komunën Dajt është shumë më i lartë se shifra e marrë pranë Zyrës së Gjendjes Civile në këtë komunë (4847/3200). Kjo lidhet me numrin më të madh të popullsisë së pranishme gjatë regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë 2011.


Së dyti, numri i familjeve në komunën Bërzhitë është më i vogël se numri i familjeve të regjistruara në Zyrën e Gjendjes Civile të komunës Bërzhitë (1095/1496). Kjo shpjegohet me mospraninë e tyre në momentin e regjistrimit.

Tabela III.24 Numri i familjeve në komunën Dajt dhe Bërzhitë<sup>112</sup>

Komuna	2001	2011
Dajt	1795	4847
Bërzhitë	1195	1095

Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011

Grafiku III.19 Numri i familjeve në komunën Dajt dhe Bërzhitë



Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011

<sup>112</sup> INSTAT, Censusi i banesave dhe popullsisë 2001, 2011

Disa nga faktorët që kanë ndikuar në rritjen e numri i familjeve në komunën Dajt janë:

- ❖ ritmet pozitive në ecurinë e numrit të popullsisë;
- ❖ ardhja e familjeve të reja për shkak të shtrirjes së saj pranë qytetit të Tiranës si dhe kushteve të favorshme fiziko-gjeografike që ofron kjo komunë;
- ❖ ulja e numrit të anëtarëve për familje, që lidhet me formimin e një kulture të re në popullsinë rurale për krijimin e familjeve të vogla, kundrejt atyre tradicionale me shumë anëtarë dhe disa brezni;
- ❖ shtimi i mundësive për strehim;
- ❖ emancipimi i popullsisë, sidomos i gruas, që bën që çiftet të vendosin të jetojnë më vete;
- ❖ emigracioni, i cili tërthorazi ka çuar në shpërbërjen e familjes shumëkurorëshe e, për rrjedhojë, në shtimin e numrit të familjeve;
- ❖ migruesit e brendshëm, që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të popullsisë së komunës, zakonisht janë me shumë fëmijë, të cilët janë rritur, martuar dhe kanë dalë familje më vete etj.

Numri i familjeve në komunën Bërzhitë, sipas Census-it 2011, është ulur si rrjedhojë e uljes së numrit të popullsisë. Njëkohësisht popullsia në komunën Bërzhitë paraqitet më autoktone dhe tradicionale dhe kjo ka ndikuar dhe në ekzistencën e një përqindjeje më të lartë të familjeve me më shumë se një kurorë.

#### *Madhësia e familjes*

Struktura dhe funksionet e familjes fshatare, deri në mesin e shekullit të XX, mbetën pothuajse të pandryshuara. Familja ishte e përbërë nga shumë kurorë dhe mjaft e qëndrueshme.

Fëmijët trashëgonin nga prindërit jo vetëm pronën dhe mjeshtërinë, por edhe mënyrën dhe psikologjinë e jetës, mentalitetin e deri në disa tipare të personalitetit<sup>113</sup>.

Në tri dekadat e fundit, profili i familjes shqiptare ka ndryshuar shumë. Numri mesatar i anëtarëve në familje është ulur. Kështu, numri i familjeve të mëdha, me më shumë se një kurorë, gjithnjë e më shumë po zvogëlohet. Në vitin 2001 numri mesatar i anëtarëve për familje ishte 4,2 pjestarë dhe në vitin 2011 ishte 3,9 anëtarë, për zonat rurale ishte 4,2 anëtarë<sup>114</sup>. Në komunën Dajt ky tregues është 4,15 anëtarë për familje kundrejt 4,54 anëtarë për familje në komunën Bërzhitë<sup>115</sup>.

Struktura dhe përbërja e familjes në komunat Dajt dhe Bërzhitë kanë ndryshuar pas vitit 1990, krahas ndryshimeve politike dhe social-ekonomike që përfshinë shoqërinë shqiptare. Një nga këto ndryshime është pakësimi i familjeve me 5-8 anëtarë dhe në shtimi i atyre me 2-4 anëtarë.

Në këtë ecuri kanë ndikuar: rritja e mirëqenies dhe e mundësive për strehim, lëvizja e lirë e njerëzve brenda dhe jashtë vendit.

---

<sup>113</sup> Laçi S., Sheme S., *Gjeografia Humane e Shqipërisë*. Tiranë 2005, fq. 48

<sup>114</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*. INSTAT, viti 2011, fq.11

<sup>115</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*. INSTAT, Tiranë 2011, fq.84

Tabela III.25 Numri mesatar i anëtarëve për familje<sup>116</sup>

Komuna	Nr. popullsisë	Nr. familjeve	Mesatarisht anëtarë/ familje
Dajt	20.139	4.847	4,15
Bërzhitë	4.973	1.095	4,54

Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2001, 2011

- Familja në komunën e Bërzhitës është pak më e madhe se në atë të Dajtit, sepse:*
- ✓ shumica e popullsisë në këtë komunë është autoktone dhe më e lidhur me traditën;
  - ✓ popullsia e komunës Dajt ka nivel zhvillimi social-ekonomik më të lartë;
  - ✓ kushtet dhe mundësitë për strehim janë më të favorshme për banorët e komunës Dajt.

### III.3.1.a Marrëdhëniet brenda familjes, roli i kryefamiljarit dhe i anëtarëve të tjerë

Mënyra dhe organizimi i jetesës kanë ndryshuar si rrjedhojë e të gjitha ndryshimeve në të cilat është përfshirë shoqëria shqiptare. Gjatë regjimit komunist ekzistonte një afri dhe mirëkuptim më i madh midis banorëve të fshatit. Jeta e vështirë i mbante njerëzit më të lidhur me hallet e njeri-tjetrit, si dhe më të gatshëm për të plotësuar kërkesat e gjithsecilit. Ky lloj bashkëpunimi duket sikur është tkurrur në nivel fisi e fqinjësie, pas vendosjes së marrëdhënieve të reja mbi pronën. Pas vitit 1990 është vënë re rritje graduale e individualizimit të veprimtarisë dhe të mënyrës së jetesës së shumicës së shqiptarëve, proces ky që po realizohet nën ndikimin e dy rrethanave kryesore:

- ❖ Shumica e njerëzve po largohen nga njëri-tjetri, po “ngujohen në vetmi nën trysinë e konflikteve për probleme të pronës dhe përgjithësisht të fitimeve të ligjshme e sidomos të paligjshme.
- ❖ Dobësimi i vlerave dhe i normave të kulturës tradicionale shqiptare që u kultivonin shqiptarëve “artin e heshtjes së artë”<sup>117</sup>.

Gjithashtu procesi i urbanizimit, si dhe emigrimi i një pjese të konsiderueshme të të rinjve kanë ndikuar në ftohjen dhe individualizimin e marrëdhënieve midis banorëve.

Lëvizja e lirë e njerëzve, kontakti që ato kanë me kulturat e vendeve apo qyteteve të tjera ndikojnë në shfaqjen e formave të reja në mënyrën e organizimit të jetës, stilit e jetesës, mendësinë e njerëzve, në ndryshimin e vlerësimit të vetes dhe të të tjerëve etj.

Këto faktorë kanë sjellë ndryshime dhe në strukturën apo organizimin e funksionimin e familjes.

Familja është baza e zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Në harkun e zhvillimit historik të shoqërisë, familja, duke qenë qelizë aktive e saj, ka ndryshuar madhësinë, strukturën, funksionet etj. Disa nga faktorët me ndikim në këto ndryshime janë:

- ❖ krijimi dhe përsosja e bazës ekonomike dhe materialo-teknike,
- ❖ ndryshimet politike,
- ❖ rritja e nivelit arsimor e kulturor të popullsisë,
- ❖ përmirësimi i cilësisë së jetës etj.

<sup>116</sup> Censusi i popullsisë dhe i banesave, INSTAT, Tiranë, 2011, fq. 84

<sup>117</sup> Dervishi Z., *Vullnetarizmi ind shumëfunktional i shoqërisë*, Tiranë 2004, fq.16

Si dukuri shoqërore familja dhe lidhjet martesore përfshijnë një seri marrëdhëniesh sociale, të tilla si ato: etiko-morale (dinjiteti, personaliteti, nderi etj.), juridike (të drejtat dhe detyrimet reciproke të pjesëtarëve), shpirtërore (dashuria, simpatia, mirënjohja etj.).

Në të dy komunat, në popullsinë autoktone, ende shfaqen mendime e qëndrime të “vjetëruara” si roli parësor i mashkullit në familje, preferenca për bebet meshkuj, marrja e vendimeve kryesore nga kryefamiljari, marrja pak ose aspak e mendimit të gruas në familje, pjesmarrja e vogël e meshkujve në punët e shtëpisë etj.

Në tërësi mund të themi se marrëdhëniet brenda familjes janë në periudhë kalimtare, nga tradicionale tek modernia. Zhvillimet e viteve të fundit kanë ndikuar disi në ndryshimin e mendësive së familjarëve dhe përfshirjen gjithnjë e më shumë të grave në vendimmarrje, veprimtari ekonomike, shërbime etj. Në rastet kur kryefamiljari ka emigruar, gratë drejtojnë jetën ekonomike dhe sociale të familjes.

Marrëdhëniet midis familjeve të një fisi ose të një lagjeje janë gjithashtu duke kaluar një fazë kalimtare, por mbeten korrekte dhe në frymën e bashkëpunimit reciprok. Ndjenja e të jetuarit në të njëjtin komunitet dhe marrja e vendimeve të përbashkëta është ende e dobët.

### *III.3.1.b Mënyra e jetesës: kalim i ngadalshëm nga tradicionale te modernia*

Shoqëria moderne shqiptare është vendosur përballë ndryshimeve të vazhdueshme në marrëdhëniet e individit me familjen dhe shoqërinë në tërësi. Ky trekëndësh social po bëhet gjithnjë e më shumë i brishtë e i papërcaktuar.

Raportet e individit me familjen dhe shoqërinë kanë ndryshuar shumë, që pas vitit 1990, ku ndryshimet politico-ekonomike u shoqëruan me ndryshime esenciale dhe në strukturën dhe përmbajtjen e familjes shqiptare. Shumë dukuri brenda familjes, në kohën e qytetërimit modern nuk ngjajnë aspak me familjen dhe shoqërinë tradicionale shqiptare.

Vendin e një realiteti të thjeshtë, kryesisht rural, homogjen, të bazuar mbi një marrveshje sociale, e zuri një realitet i ri, më i ndërlikuar, gjithnjë e më shumë urban e heterogjen<sup>118</sup>.

Magjia e dikurshme e familjes tradicionale shqiptare si qelizë e cila determinonte sjelljen, progresin dhe personalitetin e njeriut ka pësuar dhe vazhdon të pësojë ndryshime. Në shoqërinë e së kaluarës emri, fama, atributet, personaliteti politik i familjes kanë qenë shumë determinante për fatin e individit. Ky rol dhe ky mision interferues social i familjes është zbehur tani në kohën moderne.

Mënyra e jetesës në familjet e të dy komunave ka shfaqur ndryshime të vogla, që vihen re kryesisht në familjet e reja, pasi ato ndikohen më pak nga tradita, duke qenë se shumica e tyre jeton në banesa të veçanta. Mënyra tradicionale e organizimit të brendshëm të familjes, vendimmarrjes brenda saj etj., ruhet në të dy njësitë.

---

<sup>118</sup> Sokoli L., *Analiza Sociologjike*. Instituti i Sociologjisë, Tiranë 2006, fq 7.

### III.3.2 Arsimi

#### III.3.2.a Infrastruktura arsimore

➤ *Komuna Dajt*

Shkolla e parë në komunën Dajt është hapur në vitin 1916, në fshatin Priskë e Madhe, në një godinë të vogël afër xhamisë së vjetër. Mësuesi i parë ishte Hamdi Tavani. Në vitin 1956, u ndërtua shkolla 8-vjeçare dhe drejtor i saj i parë ishte Asllan Troci. Ajo kishte fillimisht 17 nxënës.

Pas vitit 1945, një nga objektivat kryesore të regjimit komunist ishte zhdukja e analfabetizmit dhe shkollimi i popullsisë. Si rezultat i masave të zbatuara, analfabetizmi u zhduk dhe arsimi fillimisht 7-vjeçar e më pas 8-vjeçar u bë i detyrueshëm. Gjatë periudhës 1945-1990, në fshatrat e kësaj komune janë ndërtuar 10 shkolla<sup>119</sup>. Vetëm njëra prej tyre ishte shkollë e mesme e bashkuar, në fshatin Surrel (shkollë e cila vazhdon të ekzistojë dhe sot), ndërsa të tjerat ishin kryesisht shkolla fillore dhe 7 e 8 vjeçare.

Ndryshimet politike pas vitit 1990 ndikuan në ecurinë e zhvillimit të arsimit. Përfshirja e një pjese të madhe të popullsisë në eksodin e vitit 1990 dhe largimet klandestine në vitet që pasuan ndikuan në arsim, nga njëra anë në uljen e numrit të nxënësve dhe braktisjen e shkollës dhe, nga ana tjetër, në rritjen e dëshirës për të ndjekur studimet e mesme dhe të larta. Moshë dhe gjinia më e prekur nga braktisja e shkollës ishin meshkujt mbi 14 vjeç. Për të shmangur këtë fenomen nga MASH u morën masa për ndjekjen e arsimit bazë e të mesëm me kohë të pjeshme, në shkollat përkatëse ekzistuese, gjë që ka minimizuar numrin e nxënësve që kanë braktisur shkollën.

Për vitin 2013, në arsimin e detyruar, kishte vetëm një nxënës që kishte braktisur shkollën<sup>120</sup>.

Pas vitit 1990, zhvillimit të arsimit në komunën Dajt i është kushtuar rëndësi. Kjo duket, së pari, me investimet e bëra në infrastrukturën arsimore. Pas vitit 1990 në këtë komunë janë ndërtuar dy shkolla të reja 9-vjeçare dhe tre kopshte, janë rikonstruktuar të gjitha shkollat dhe kopshtet ekzistuese. Janë marrë masa për ngritjen e kabineteve të informatikës, kimisë e fizikës. Në këtë komunë funksionojnë gjashtë kabinate informatike dhe asnjë kabinet fizike apo kimie për të zhvilluar punët laboratorike në këto lënë<sup>121</sup>.

Në shkollat e kësaj komune funksionojnë dhe gjashtë biblioteka. Jo të gjitha shkollat kanë bibliotekë dhe ajo që bie në sy është numri i paktë i titujve të librave dhe sidomos të librave të rinj dhe të huaj. Në këtë komunë funksionon vetëm një palestër, në shkollën e mesme të bashkuar “Ymer Lala” në fshatin Surrel.

Përsa i takon sistemit të ngrohjes dy prej shkollave të kësaj komune ngrohen me dru, pjesa tjetër ngrohen me korent. Nuk ekziston në asnjë nga shkollat e kësaj komune sistem ngrohjeje me kalidajë. Të gjitha shkollat dhe kopshtet kanë ujë të rrjedhshëm, por tualetet dhe higjiena lënë shumë për të dëshiruar.

---

<sup>119</sup> *Spektori TIK*, në DAR Qarku Tiranë, 2014

<sup>120</sup> *Spektori TIK*, në DAR Qarku Tiranë, 2014

<sup>121</sup> *Spektori TIK*, në DAR Qarku Tiranë, 2014

Tabela III.26 Shtrirja e shkollave dhe kopshteve në komunën Dajt sipas fshatrave<sup>122</sup>

Fshati	Shkollë	Numri:				
		nxënës	mësues	kopshte	fëmijë	edukatore
Shtish-Tufinë	CU + 9 vjeçare	172	11	2	70	4
Tujan	CU	9	1	----	---	--
Brarë	CU	24	2	----	---	---
Ferraj	CU + 9 vjeçare	134	12	1	15	1
Linxë	CU	15	1	1	17	1
Priskë	CU + 9 vjeçare	157	11	1	20	1
Surrel	Mesme e bashkuar	191	11	1	20	1
Lana Bregas	CU	44	3	1	20	1
Shkallë	CU + 9 vjeçare	23	4	----	---	---
Qafmollë	-----	-----	----	----	----	----
Darshen	CU+9vjeçare	17	4	----	----	---
Selbë	CU + 9 vjeçare	41	4	----	----	----
Murth	CU	11	1	----	----	----
Qesarakë	CU + 9 vjeçare (dy)	942	39	2	200	5
<b>Gjithsej</b>	<b>14 shkolla</b>	<b>1780</b>	<b>104</b>	<b>9</b>	<b>362</b>	<b>14</b>

Burimi: Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, viti 2013


Në fshatin Surrel funksionon një shkollë e mesme e bashkuar, ku mësojnë 191 nxënës, nga të cilët 24 nxënës në arsimin e mesëm. Në fshatrat Selbë, Priskë dhe Tufinë, ka shkolla 9-vjeçare të arsimit të detyruar, ndërsa në fshatrat më të vegjël si Lanabregas dhe Darshen, ka vetëm shkolla të ciklit të ulët. Një pjesë e nxënësve të kësaj komune, pasi mbarojnë klasën e 9-të, u drejtohen gjimnazeve të Tiranës. Kështu, pothuajse 40% e nxënësve që mbarojnë arsimin 9-vjeçar në Qesarakë (Linxë), vazhdojnë studimet në gjimnazet Abdulla Keta, A.Z.Cajupi, Partizani. Ekzistenca dhe e një linje të rregullt urbani krijon lehtësi për lëvizjen e nxënësve që studiojnë në këto shkolla.

Për të shmangur udhëtimin e përditshëm dhe rreziqet që mund të vijnë prej tij, do të ishte me interes ndërtimi i një shkolle tjetër të mesme në këtë komunë, në fshatin Qesarakë, si dhe i një shkolle profesionale.

Numri i nxënësve dhe i mësuesve në këtë komunë ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, si rrjedhojë e rritjes së numrit të lindjeve dhe e të të ardhurve në moshën e shkollimit.

Në fshatin Linzë është ndërtuar një gjimnaz dhe shkollë profesionale private, por që për momentin nuk funksionon. Marrja e nismave të tilla private do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit në këtë komunë.

<sup>122</sup> Zyra e statistikës, Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, Tiranë 2013



Skicë III.1 Vëndndodhja e shkollave në komunën Dajt

➤ *Komuna Bërzhitë*

Ashtu si në gjithë vendin, dhe në këtë komunë, i është kushtuar një rëndësi e veçantë zhvillimit të arsimit. Shkolla e parë në këtë komunë është hapur në vitin 1920, në fshatin Bërzhitë. Pas disa vitesh ajo do të mbyllet për t'u rihapur përsëri në vitin 1947. Në këtë vit shkolla kishte tri klasa dhe 33 nxënës. Mësuesja e parë në këtë shkollë ishte Afërdita Gjika. Për të plotësuar më mirë nevojat për një arsim më cilësor, në vitin 1974, nga shkollë e ciklit të ulët ajo u bë shkollë 8-vjeçare. Po kështu, në vitin 1977 hapet kopshti i parë në fshatin Bërzhitë.

Në vitin 1936, një shkollë tjetër do të hapte dyert e saj për arsimimin e popullsisë së kësaj zone. Ajo u ndërtua në fshatin Ibë dhe nxënësit vinin nga katër fshatra përreth si Ibë, Pëllumbas, Bërzhitë e Myshqeta. Kishte gjithsej 34 nxënës, prej të cilëve katër ishin vajza. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore, ajo u mbyll për t'u rihapur përsëri në vitin 1945. Mësuesi i parë ishte z.Sami Gonxhi, anëtar i shoqërisë patriotike “ Bashkimi”.

Gjatë periudhës 1945-1990, në fshatrat e kësaj komune janë ndërtuar katër shkolla dhe dy kopshte. Në fshatin Killojkë dhe Ibë e Poshtme funksiononin shkolla të mesme të bashkuara.

Pas viti 1990, në këtë komunë janë ndërtuar dy shkolla dhe dy kopshte të reja si dhe janë rikonstruktuar të gjitha shkollat dhe kopshtet ekzistuese.

Në këtë komunë i është dhënë rëndësi dhe pajisjes së tyre me bazë materiale moderne si: kabineti i gjeografisë në shkollën e mesme Ibë e Poshtme, kabinetet e informatikës (në këtë komunë funksionojnë katër kabinate informatike), pesë biblioteka (me një numër të kufizuar librash), një kabinet fizike, dy kabinate kimie për zhvillimin e punëve laboratorike, si dhe një palestër për zhvillimin e lëndës së edukimit fizik<sup>123</sup>.

*Tabela III.27 Shtrirja e shkollave dhe kopshteve në komunën Bërzhitë sipas fshatrave<sup>124</sup>*

Fshati	Shkollë	Numri:				
		nxënës	mësues	kopshte	fëmijë	edukatore
Ibë e Poshtme	e mesme	254	18	1	23	1
Killojkë	e mesme	218	18	1	15	1
Bërzhitë	9-vjeçare	211	14	1	61	4
Ibë e Sipërme	9-vjeçare	162	12	1	17	1
Mihajas	9-vjeçare	73	6	-		
<b>Gjithsej</b>	<b>5 shkolla</b>	<b>918</b>	<b>68</b>	<b>4</b>	<b>116</b>	<b>7</b>

Burimi: Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, viti 2013

Në komunën Bërzhitë funksionojnë dy shkolla të mesme, tri shkolla 9-vjeçare jo vartëse dhe katër kopshte. Shkolla vartëse të ciklit të ulët gjenden në fshatrat Dobresh, Pashkashesh dhe Pëllumbas, ndërsa në fshatin Fravesh gjendet një shkollë 9-vjeçare vartëse. Numri i nxënësve dhe i mësuesve të këtyre shkollave janë përfshirë në statistikat e shkollave nga të cilat varen. Në këtë komunë nuk ekziston asnjë shkollë profesionale.

<sup>123</sup> *Sektori TIK, në DAR Qarku Tiranë, 2014*

<sup>124</sup> *Zyra e statistikës, Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë, Tiranë 2013.*



Duke krahasuar të dhënat e mësipërme me ato të vitit 2006 dalin këto veçori:

- a. numri i nxënësve dhe i mësuesve është zvogëluar, si rrjedhojë e pakësimit të numrit të popullsisë (nga 1158 nxënës e 95 mësues në vitin 2006 në 918 nxënës e 68 mësues në vitin 2013);
- b. numri i kopshteve dhe edukatoreve është zvogëluar (nga gjashtë kopshte e nëntë edukatore në vitin 2006 në katër kopshte dhe shtatë edukatore në vitin 2013).

Nga anketat e zhvilluara në lidhje me vlerësimin për gjendjen e shkollave kanë dalë këto rezultate:

- ✓ 70% e banorëve shprehen të kënaqur dhe shumë të kënaqur,
- ✓ 23% të pa kënaqur dhe shumë të pakënaqur,
- ✓ 7% nuk kanë ndonjë vlerësim të veçantë.

Pakënaqësitë kanë të bëjnë me mungesën e bazës mësimore në të gjitha shkollat psh jo të gjitha shkollat janë të pajisura me harta gjeografike e historike, në shumë prej tyre ato janë të vjetra, numri i kompjuterave është ende i kufizuar e linja e internetit paraqitet me probleme e kufizime të shumta, mungesa e botimeve të viteve të fundit të autorëve vendas apo të huaj nëpër bibliotekat e ngritura në shkolla, mungesa e këndeve sportive dhe palestrave. E njëjta pakënaqësi është dhe për ambientet shkollore në tërësi. Këto mangësi e ulin shumë cilësinë e shërbimit arsimor.

Në fshatin Mihajas, banorët kërkojnë investimet e duhura për ndërtimin e një shkolle të re me gjithë infrastrukturën e nevojshme. Hapja e një shkolle profesionale në Bërzhitë shihet me shumë interes nga banorët.

Një pikë e fortë e arsimit në këtë komunë është stafi i kualifikuar i mësuesve. Numri i mësuesve në komunë arrin në 68 dhe 98% e tyre janë me arsimimin përkatës.


Gjendja e kopshteve paraqitet më e dobët krahasuar me gjendjen e shkollave. Rreth 44% e popullsisë së komunës shprehet e pakënaqur me këtë shërbim dhe po kaq shprehen të kënaqur<sup>125</sup>. Në komunë nuk ka asnjë çerdhe, ndërsa të gjithë kopshte janë pa drekë. Si shumë i domosdoshëm shihet ndërtimi i një kopshti në Lugë. Këtu kopshti është mbyllur si prej pakësimit të fëmijëve, ashtu edhe sepse godina i është kthyer ish pronarit të saj. Kushtet hidro-sanitare në shkolla lënë shumë për të dëshiruar.

Arsimimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i banorëve të komunave Dajt dhe Bërzhitë duhet të shihet si një nga prioritetet kryesore që do të ndikojë në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, d.m.th, që përmes arsimimit, njerëzit të edukohen që ta shohin dhe ta përdorin natyrën në mënyrë racionale, dhe çdo ndërhyrje në të ta bëjnë të studiuar, me qëllim që të ruhen ekosistemet natyrore. Ndërgjegjësimi dhe rritja e ndjeshmërisë së popullsisë, sidomos e fëmijëve dhe e të rinjve, për vlerat e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike të zonës ka rëndësi për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe veprimtarive të tjera ekonomike.

Zbatimi i sistemit të detyrueshëm 9-vjeçar, rritja e përqindjes së nxënësve që vazhdojnë gjimnazin në shkollat e komunës apo shkollat profesionale në qytetin e Tiranës, rritja e përqindjes së banorëve që përfundojnë arsimin e lartë do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e shkallës së arsimimit të popullsisë në të dy komunat.

---

<sup>125</sup> *Plani i zhvillimit të komunës Bërzhitë*. Fondi Shqipëtar i zhvillimit. Tiranë 2011. fq. 19.



Skicë III.2 Vendndodhja e shkollave në komunën Dajt

### III.3.2.b Niveli i arsimit të popullsisë

Niveli i arsimit të popullsisë është një komponent i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm. Një popullsi e mirëarsimuar dhe e kualifikuar përbën një potencial human të domosdoshëm për ecjen përpara si në aspektin social-kulturor dhe në atë ekonomik.


Tabela III.28 Niveli i arsimit të popullsisë në komunën Dajt e Bërzhitë në vitin 2011<sup>126</sup>

Emërtimi	Komuna Dajt	Komuna Bërzhitë
Analfabetë	1,38	3,49
Dinë shkrim dhe këndim	1,12	1,08
Me arsim fillor	11,7	15,7
Me arsim 9-vjeçar	30,58	33,38
Me arsim të mesëm	27,28	27,32
Me arsim të lartë	11,64	5,28

Burimi: INSTAT, Censuri i popullsisë dhe i banesave 2011

<sup>126</sup> Censuri i popullsisë dhe i banesave, INSTAT, Tiranë, 2011.fq.87.

Grafik III.20 Niveli i arsimit të popullsisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë (2011)



Burimi: INSTAT, Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011

Treguesit e raporteve mësues/nxënës dhe edukatore/fëmijë janë relativisht të mira në të dyja komunat. Në komunën e Dajtit ka një mësues për 17,1 nxënës, ndërsa në komunën Bërzhitë një mësues për 13,5 nxënës.

Ky raport në shkallë vendi është një mësues për 16,5 nxënës, ndërsa për vendet e OECD ky tregues është një mësues për 14,4 nxënës<sup>127</sup>.

*Siç e shohim raportin mësues-nxënës në komunën e Bërzhitës është më i ulët se në shkallë vendi dhe rajoni, dhe kjo mundëson një mësim më cilësor. Për komunën Dajt, ky tregues është më i lartë se në shkallë vendi dhe rajoni, prandaj për këtë komunë është e domosdoshme hapja e shkollave të reja.*

Në komunën e Dajtit ka një kopsht për 40 fëmijë, ndërsa në komunën Bërzhitë një kopsht për 29 fëmijë. Raporti edukatore/ fëmijë në komunën e Dajtit është një me 25,8, ndërsa në atë të Bërzhitës një me 16,57 fëmijë.

Ky raport në shkallë vendi është një edukatore për 18,9 fëmijë, ndërsa për vendet e OECD ky tregues është një edukatore për 12,3 fëmijë<sup>128</sup>.

*Dhe ky tregues paraqitet më pozitiv për komunën Bërzhitë, ku është më i ulët se në shkallë vendi, por më i lartë se rajoni. Kjo shpjegohet me numrin më të madh dhe në rritje të nxënësve e fëmijëve parashkollorë në komunën e Dajtit, si pasojë e numrit të lartë e në rritje të lindjeve, por dhe të fëmijëve të ardhur e vendosur në këtë komunë.*

Është e domosdoshme të punohet më shumë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit. Pajisja më e mirë e shkollave me laboratorë dhe mjete didaktike do të ndihmonte në përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënësve gjatë orës së mësimin. Ndikim pozitiv në këtë drejtim do të kishte edhe kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve.

Problem mbetet mungesa e shkollave 9-vjeçare në fshatrat e largëta si Qafëmolla. Mungesa e çerdheve për fëmijët 1-3vjeç, në të dy komunat, vështirëson angazhimin në punë të prindërve të rinj.

<sup>127</sup> Vjetari Statistikor për arsimin 2011-2012 dhe seri kohore, MASH. fq.62

<sup>128</sup> Po aty.

Me interes për banorët e të dy komunave do të ishte hapja e shkollave të mesme profesionale, ku të rinjtë do të aftësoheshin në profesione më mundësi punësimi në zonë, si në sektorin e bujqësisë, turizmit, hotelerisë dhe shërbimeve të tjera. Për ata që nuk kanë mundësi të ndjekin studime të rregullta, mund të ofroheshin kurse 6-mujore deri në 2-vjeçare, në mjediset brenda territorit të komunave.

Përqindja e popullsisë analfabete në komunën e Bërzhitës është më e lartë se në atë të Dajtit, përkatësisht 3,49% ndaj 1,38%. Niveli i analfabetizmit për popullsinë 10 vjeç e lart, për Shqipërinë është 2,8%<sup>129</sup>. Ky nivel paraqitet më i lartë në komunën Bërzhitë dhe kjo shpjegohet me përqindjen më të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç që në këtë komunë është 9,59%, ndërsa në komunën Dajt, kjo grupmoshë përbën 7,16 % të popullsisë. Gjithashtu, në komunën Dajt popullsia e ardhur është kryesisht në moshë të re dhe e arsimuar, gjë që ka sjellë që ky tregues të jëtë nën mesataren e vendit.

Bie në sy përqindja më e lartë e popullsisë me arsim fillor dhe 8-9 vjeçar në komunën e Bërzhitës se sa në atë të Dajtit. Për këtë ka ndikuar infrastruktura arsimore më e dobët e saj, në krahasim me komunën Dajt, mungesa e shkollave të mesme pranë disa fshatrave malore si Shalqizë, Lugë apo Pashkashesh. Gjithashtu, për shkak të afërsisë me qytetin e Tiranës shumë nxënës nga komuna Dajt, vazhdojnë studimet dhe në gjimnazet e tij. Dhe niveli më i lartë social-ekonomik e kulturor i popullsisë së komunës Dajt ka ndikuar në përqindjes më të ulët të popullsisë me arsim fillor apo 8-9vjeçar.

Personat me arsim të lartë kanë peshë më të lartë në popullsinë e komunës së Dajtit (11,64%) se sa në atë të Bërzhitës (6%). Kjo lidhet jo vetëm me rritjen e numrit të popullsisë vendase që ka mbaruar arsimin e lartë por dhe me përqindjen e lartë të të ardhurve në komunën Dajt me arsim të lartë, që janë vendosur kryesisht në Qesarakë (Linzë), Lanabregas e Shtish-Tufinë.

Me rëndësi është fakti se në të dy komunat shkalla e arsimimit të popullsisë ka ardhur duke u rritur, si rrjedhojë e zhvillimit ekonomik të tyre, vëmendjes më të madhe që po i kushtohet arsimit, traditës arsimdashëse të popullsisë.

### ***III.3.3 Shërbimi shëndetësor***

Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe shërbimit shëndetësor ka qenë një nga synimet e komunave Dajt dhe Bërzhitë. Me masat e marra nga pushteti vendor dhe ai qendror janë arritur rezultate të tilla si: ulja e vdekshmërisë foshnjore, rritja e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijës, kryerja e vizitave mjekësore cilësore etj.

#### ***➤ Komuna Dajt***

Gjatë periudhës së regjimit komunist 1945-1990, u morën një sërë masash për të përmirësuar shërbimin shëndetësor në të gjithë vendin. Kësaj periudhe i përkasin dhe qendrat shëndetësore të ngritura në fshatrat Linzë, Tufinë, Lanabregas e më pas në të gjitha fshatrat e kësaj komune. Gjatë kësaj periudhe, çdo fshat kishte qendrën e saj shëndetësore dhe mjek të përgjithshëm.

---

<sup>129</sup> *Censusi i popullsisë dhe i banesave*, INSTAT, Tiranë, 2011.fq. 8

Sot në komunën Dajt funksionojnë 10 qendra shëndetësore. Fshatrat Qafëmollë, Darshen dhe Selbë nuk kanë qendër shëndetësore, ndërsa fshatrat Shkallë e Murth kanë një të përbashkët. Në to shërbejnë 15 mjekëve dhe 23 infermierë. Mjek dhe infermierë ka në çdo fshat të kësaj komune. Ambulanca ka në çdo fshat, me përjashtim të fshatit Tujan. Konsultoret për nënat dhe fëmijët ka në çdo fshat, me përjashtim të Qafëmollës dhe Selbës.

Tabela III.29 Shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe personelit mjekësor sipas fshatrave<sup>130</sup>

Komuna Dajt	Q.shënd.	Mjekë	Inferm.	Ambula.	Konsult.	Farma.	Klin.dent
Tufinë	1	1	3	1	1	2	2
Tujan	---	1	1	---	1	1	-
Brarë	2	1	1	1	1	-	-
Ferraj	1	1	1	1	1	-	-
Linxë	2	4	8	2	2	4	3
Priskë	1	1	2	1	1	1	1
Surrel	1	1	1	1	1	-	-
Lana Bregas	1	1	1	1	1	2	2
Shkallë & Murth	1	1	1	1	1	-	-
Qafmollë	----	1	1	1	----	-	-
Darshen	---	1	1	1	1	-	-
Selbë	---	1	1	1	----	-	-
Murth	--	1	1	1	1	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>15</b>	<b>23</b>	<b>13</b>	<b>12</b>	<b>10</b>	<b>8</b>

Burimi: Zyra e Statistikës në komunën Dajt

Në këtë komunë funksionon vetëm një autoambulancë. Qendrat shëndësore janë rikonstruktuar të gjitha, por pajisja e tyre me mjetet e duhura lë shumë për të dëshiruar. Ka shumë pak pajisje të reja dhe ofrohen kryesisht shërbime të përgjithshme.

Pavarësisht ekzistencës së infrastrukturës dhe personelit, banorët e komunës në shumicën e rasteve u drejtohen klinikave të kryeqytetit, ku shërbimi mjekësor është më cilësor dhe i specializuar.

Rritja e shpejtë e popullsisë në fshatrat Linxë, Shtish-Tufinë, Lana Bregas, Priskë e Madhe etj, shtron si domosdoshmëri ndërtimin e qendrave të reja shëndetësore, rikonstruksionin dhe zgjerimin e kapaciteteve të atyre ekzistuese, si dhe shtimin e personelit shëndetësor.

Rëndësi duhet t'i kushtohet dhe furnizimit të qendrave shëndetësore me pajisje bashkëkohore si dhe kualifikimit të personelit mjekësor.

<sup>130</sup> Zyra e Statistikës në komunën Dajt, Tiranë 2012.

➤ *Komuna Bërzhitë*

Që në vitet e para, pas çlirimit të vendit, u morën masa në drejtim të kujdesit shëndetësor për banorët e fshatrave të komunës Bërzhitë. Fillimisht u ndërtuan ambulanca në fshatrat kryesore si Bërzhitë, Kllojkë, Ibë e Poshtme. Në vitet e para, një mjek mbulonte disa fshatra, më pas, pas vitit 1970, çdo fshat i kësaj komune kishte një mjek të përgjithshëm. Qendra e parë shëndetësore u ndërtua në fshatin Bërzhitë. Qendër e re shëndetësore është në ndërtuar në vitin 2008, në fshatin Ibë e Sipërme.

Sot komuna Bërzhitë ka dy qendra shëndetësore, tetë ambulanca dhe 13 konsultore, ku shërbejnë pesë mjekë dhe 17 infermierë. Konsultore dhe infermierë për kujdesin ndaj nënës dhe fëmijës ka në çdo fshat. Në Bërzhitë funksionon edhe një farmaci, dy klinika dentare dhe një autoambulancë. Në fshatin Dobresh gjendet dhe një klinikë private “Lili” e pajisur dhe me një laboratot për analiza.

*Tabela III.30 Shpërndarja e qendrave shëndetësore dhe personelit mjekësor sipas fshatrave<sup>131</sup>*

<b>K. Bërzhitë</b>	<b>Q. shënd.</b>	<b>Mjekë</b>	<b>Inferm.</b>	<b>Ambula.</b>	<b>Konsul.</b>	<b>Farmaci</b>	<b>Klin.dent.</b>
Dobresh	-	-	1	1	1	-	-
Mihajas-Kusë	-	-	1	1	1	-	-
Lugë-Shalqizë	-	-	1	1	1	-	-
Bërzhitë	1	1	5	-	2	1	2
Ibë e Poshtme	-	1	1	-	1	-	-
Ibë e Sipërme	1	1	2	1	2	-	-
Pëllumbas	-	1	1	1	1	-	-
Pashkashesh	-	-	1	1	1	-	-
Fravesh-Rozav.	-	-	1	1	1	-	-
Kllojkë	-	1	2	1	2	-	-
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>17</b>	<b>8</b>	<b>13</b>	<b>1</b>	<b>2</b>

Burimi: Zyra e Statistikës në komunën Bërzhitë, viti 2012

Rritja e popullsisë në fshatrat Ibë e Poshtme dhe Pëllumbas, shtrun si domosdoshmëri ngritjen e një qëndre shëndetësore të re, si dhe shtimin e personelit mjekësor.

Për shkak të infrastrukturë së dobët dhe mungesës së mjekëve specialistë, banorët e komunës u drejtohen spitaleve dhe klinikave të Tiranës, ku marrin shërbime të kualifikuara.

Raporti mjek/banorë në komunën e Bërzhitës është 1/994,6 pothuajse sa mesatarja e Shqipërisë, por më e lartë se mesatarja në Europë, ndërsa raporti infermierë/banorë është pak më i mirë: 1/292,5. Në komunën e Dajtit raporti mjek/banorë është 1/1342,6, ndërsa raporti infermierë/banorë është 1/875,6 banorë. Këta tregues janë më të mirë në komunën e Bërzhitës se sa në atë të Dajtit. Në komunën Dajt ka patur shumë të ardhur, dhe nevojat e tyre

<sup>131</sup> Zyra e Statistikës në komunën Bërzhitë, Tiranë 2012.

për shërbime shëndetësore janë mbuluar nga infrastruktura ekzistuese. Dhe për këtë komunë është e domosdoshme ngritja e qendrave të reja shëndetsore si në fshatin Lanabregas dhe Shtish-Tufinë, ku popullsia është rritur shumë vitet e fundit.

Investimet e mëtejshme në këtë sektor janë të rëndësishme së veçantë për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të banorëve, uljen e vdekshmërisë dhe rritjen e jetëgjatësisë.

### ***III.3.4 Objektet dhe veprimtaritë kulturore dhe sportive***

Jeta e vështirë e me problematika të shumta e ka privuar popullsinë rurale nga veprimtaritë e mirëfillta social-kulturore. Shtëpitë e kulturës, grupet artistike, muzetë, bibliotekat, mjediset dhe veprimtaritë sportive u ngritën dhe funksionuan vetëm gjatë regjimit komunist. Kjo do të ishte në shërbim të synimit të sistemit në fuqi për përhapjen e ideologjisë e moralit komunist në të gjithë vendin, si dhe për të mbajtur popullsinë rurale në vendbanimet e tyre. Shpërbërja e sistemit të kooperativave dhe e organizimeve kolektive u shoqëruan me zhdukjen e tyre. Puna dhe shqetësimet e përditshme i kanë bërë fermerët më të veçuar e më indiferentë ndaj njëri-tjetrit dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Forma më e përhapur dhe më e lirë për argëtim në familjet rurale është ndjekja e emisioneve televizive. Gratë kanë një jetë sociale më të mbyllur se burrat, të cilët kalojnë më shumë kohë në bare dhe restorante, duke ndjekur ndeshje futbolli, duke luajtur bilardo etj.

Të rinjtë mundohen të organizojnë ndryshe argëtimin e tyre, por kushtet dhe mundësitë janë shumë të kufizuara. Më të shpeshta janë festat e përbashkëta në raste datëlindjesh, veprimtaritë sportive midis klasave apo shkollave etj.

Një formë argëtimi, e ruajtur me fanatizëm nga popullsia rurale, është organizimi i festimeve për dasmat, që zgjasin pothuajse një javë. Këto festa ndihmojnë në argëtimin dhe kultivimin tek të rinjtë të këngës dhe valles tradicionale popullore, promovimin e vlerave artistike të zonës etj. Veprimtari kulturore janë festat kombëtare, fetare dhe të komunitetit etj.



*Fig.III.6 Ambient sportiv në fshatin Linxë, komuna Dajt*

Komuna Bërzhitë nuk ka asnjë qendër kulturore. Jeta kulturore pothuajse nuk ekziston. Sipas përgjigjeve të pyetsorëve të zhvilluar me banorët e kësaj komune, 87% - 90% e tyre shprehen të pakënaqur për mungesën e veprimtarive kulturore apo sportive, si dhe me shërbimet që ofrohen për të rinjtë dhe të moshuarit<sup>132</sup>.

Kryesisht, ka nisma private për ngritjen e ambienteve sportive, si të një fushe sporti të vogël në fshatin Bërzhitë apo të një amfiteatri në kompleksin Kame, por shumë pak shfrytëzohen nga banorët e zonës për shkak dhe të çmimeve të papërbalueshme për ta.

Deri më sot, komuna nuk ka asnjë plan për krijimin e ambienteve pushuese dhe argëtuese për fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit.

Është e domosdoshme që të merren masa për ngritjen e ambienteve sportive. Fillimisht mund të shfrytëzohen hapësirat sportive në shkolla, ku mund të organizohen dhe kampionate midis shkollave të ndryshme të komunës. Kështu mund të krijohet dhe një ekip që të përfaqësojë komunën në kampionatet që mund të zhvillohen midis komunave të afërta.

Ngritja e një kompleksi sportiv, nga ana e komunës, do të nxiste banorët e kësaj zone, e sidomos të rinjtë, që të merren me aktivitete sportive e të largohen nga kafenetë apo qendrat e internetit, që janë nga të paktat ambiente argëtimi që ekzistojnë në këtë komunë.

Organizimi i festivaleve apo panairove të ndryshme, siç ishte Festivali Ditët e Trashëgimisë Kulturore, që u organizua në fshatin Petrelë në vitin 2008, duhet të nxisë organet drejtuese të komunës që të formojnë një grup kulturor, fillimisht duke aktivizuar e shfrytëzuar talentet që ka në shkolla të ndryshme, e duke e zgjeruar më pas pjesmarrjen në të dhe me moshën tjetra.



*Fig. III.7 Grupi artistik i komunës Dajt*

Ngritja e një qendre kulture do të krijonte infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e saj. Cilësia e jetës është një komponent i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e kapaciteteve humane të zonës, aq të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

<sup>132</sup> *Plani i zhvillimit të komunës Bërzhitë*. Fondi Shqipëtar i zhvillimit. Tiranë 2011. fq. 21.



### III.4 Infrastruktura fizike

Infrastruktura dhe shërbimet që ofrohen nëpërmjet saj janë element i rëndësishëm për zhvillimin e një vendi apo rajoni. Rrjeti rrugor dhe transporti, energjia elektrike, furnizimi me ujë dhe largimi i ujërave të përdorura lehtësojnë ose pengojnë veprimtaritë ekonomike dhe sociale. Kapitalet, krahu i punës, bizneset kanë tendencë të lëvizin drejt vendeve që ofrojnë infrastrukturë lehtësuese dhe institucione që i mbështesin ato në aktivitetin e tyre.

#### III.4.1 Komunikacioni

##### III.4.1.a Rrjeti i rrugëve

Në të dy komunat gjenden të gjitha kategoritë e rrugëve:

- a. Rrugë parësore: si rruga nacionale Tiranë- Dajt apo Tiranë-Elbasan.
- b. Rrugë dytësore: ku bëjnë pjesë rrugët urbane me kapacitet të mesëm, që bëjnë të mundur lidhjen e rrugës nacionale me fshatra të ndryshëm.
- c. Rrugë terciare: ku përfshihen të gjitha rrugët e tjera me kapacitet të ulët të destinuar për funksione dytësore.
- d. Në komunën Dajt funksionon dhe teleferiku “ Dajti Expres”.

##### ➤ Komuna Dajt

Infrastruktura rrugore, në komunën Dajt, pas çlirimit të vendit, si në gjithë Shqipërinë, pësoi ndryshime të mëdha. Deri në këtë periudhë ekzistonin vetëm disa rrugë që lidhnin Tiranën me fshatrat pranë saj, si Linzë e Tujan, por gjendja e tyre linte shumë për të dëshiruar. Në këtë periudhë krahas përmirësimit të rrugëve ekzistuese u ndërtuan shumë rrugë që lidhnin fshatrat midis tyre, por dhe me qytetin e Tiranës.

Sot, infrastruktura rrugore në komunën Dajt është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, si rrjedhojë e investimeve të komunës, sektorit publik (MPPT) dhe FSHZH-së.

Me rëndësi janë ndërhyrjet dhe përmirësimet në rrugën Tiranë-Dajt, që lidh kryeqytetin me zonën turistike të Dajtit, e cila është e asfaltuar.


Gjatësia e rrugës së asfaltuar nga qendra e Tiranës deri në pikën e antenave në Dajt është rreth 21 km, por për shkak të rritjes së fluksit të transportit e lëvizjes së mjeteve kjo rrugë ka nevojë për zgjerim. Gjatësia e rrugëve të brendshme që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin është 80 km, por gjendja e tyre lë mjaft për të dëshiruar.

Gjatë viteve të fundit Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka bërë një investim prej 220.000 lekësh për riparimin e rrugëve të brendshme në një gjatësi prej 4,3 km. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e strukturës dhe gjendjes së rrugëve dhe ka lehtësuar komunikacionin.

Punimet e rrugës së Arbrit po vazhdojnë me intensitet të lartë. Fotot e mëposhtme pasqyrojnë punën që po kryhet në segmentin Tufinë - Shënpal. Traseja e këtij segmenti dhe tuneli i shkurtër që u ndërtua për të ruajtur kanionin e Tujanit kanë përfunduar.

Po punohet në segmentin drejt tunelit të Qafë Murrizit. Gjatësia e rrugës së Arbrit nga Bllata në Tufinë është 67 km. Po përfundojnë së ndërtuari 34 kilometrat e para. Edhe nga Klosi po punohet drejt Qafë Murrizit, e cila do të kalohet me një tunel 2,4 km të gjatë.

Kjo është rruga e dytë e Kombit. Ajo shkurton tri herë distancën e Peshkopisë dhe Dibrës së Madhe me Tiranën, shkurton me katër herë distancën nga Bulqiza dhe Klosi në Tiranë, si dhe shkurton me 103 km distancën Tiranë-Shkup.



*Fig. III.8 Rruga e Arbrit*



*Fig. III.9 Punime në Rrugën e Arbrit*



*Fig. III.10 Punime në Rrugën e Arbrit*

Vazhdimi i punimeve për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, që kalon në fshatrat e kësaj komune, do të bënte të mundur lidhjen e kësaj zone jo vetëm me Tiranën, me qarkun e Dibrës, por dhe me një pjesë të rajoneve të Maqedonisë Perëndimore, të populluar kryesisht nga shqiptarë.

Nevojat për ndërhyrje riparuese dhe përmirësuese janë të mëdha, kryesisht në Darshe (7 km), Priskë (3 km) dhe Shkallë (5 km). Po kështu, dhe rruga kryesore që lidh qytetin e Tiranës me qendrën e komunës, Linzë, si dhe me fshatrat e tjera përreth, është rikonstruktuar

disa herë, por për shkak të cilësisë së dobët si dhe të kalimit të makinave të tonazheve të mëdha, paraqitet e shkatërruar në disa sektorë të saj.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe rritja e nivelit të jetesës ka sjellë dhe rritjen e numrit të mjeteve të transportit në këtë komunë. Funkcionojnë rreth 22 furgonë që lidhin fshatrat e kësaj komune me njëri –tjetrin si dhe me qytetin e Tiranës.

#### *III.4.1.b Teleferiku*

Teleferiku “Dajti Ekspres” është i vetmi në Shqipëri dhe më i madhi në Ballkan. Ai u ndërtua në vitin 2005 nga kompania private “Dajti Ekspres Sh.a.”.

Investimi për ndërtimin dhe shfrytëzimin e teleferikut është 6.5 milionë euro.

Ndërtimi i teleferikut ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve në PK të Dajtit. Ky teleferik bën të mundur lëvizjen e njerëzve nëpërmjet 22 gondolave (kabinë transportuese, me tetë vende secila), nga të cilat mund të shijohen bukuritë e natyrës dhe kryeqyteti.

Udhëtimi zgjat vetëm 12 minuta dhe pamja që ofrohet është shumë piktoreske. Vendet më interesante për t’u vizituar janë Tarraca e Dajtit, kanionet e Shkallës, kanionet e Tujanit, Shpella e Zonjës në Brar etj.



*Fig. III.11 Teleferiku Dajti Ekspres*

#### ➤ *Komuna Bërzhitë*

Për shkak të pozitës së saj gjeografike, që në periudhën e sundimit të Ahmet Zogut, midis dy Luftrave Botërore, u ndërtuan rrugë si rruga nacionale Tiranë-Elbasan, e cila kolonte dhe në territorin e një sërë fshatrave të kësaj komune. Kjo ka ndihmuar banorët e kësaj komune për komunikimin e zhvillimin e tregtisë me qytetet kryesore si Tiranën apo dhe Elbasanin. Ndërsa sistemi i rrugëve midis fshatrave ishte shumë i paktë e komunikimi midis tyre shumë i vështirë, sidomos me fshatra të thella malore si Klllojkë, Pashkashesh e Lugë.

Sot, infrastruktura rrugore në komunën e Bërzhitës paraqitet relativisht e mirë. Shumica e fshatrave lidhen me komunën me rrugë automobilistike gjatë gjithë vitit, por ato janë në gjendje jo të mirë dhe nuk mirëmbahen. Në disa raste mungojnë rrugët dytësore që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin. Kështu, fshatrat Kusë dhe Lugë–Shalqizë nuk lidhen me

rrugë automobilistike, ndërsa fshatrat Lugë–Shalqizë dhe Rozavere nuk kanë rrugë automobilistike që të lidhet me komunën, por vetëm një trase provizore.

Qendra e komunës ndodhet në kilometrin e 16-të të rrugës së vjetër nacionale Tiranë–Elbasan.

Si mjete komunikimi midis fshatrave, si dhe midis tyre e qytetit të Tiranës shërbejnë mikrobusat, numri i të cilëve shkon në 20, si dhe mjete të tjera private.

Rehabilitimi i rrugës së vjetër Dobresh–Bërzhitë do të krijonte një unazë për këto dy fshatra, duke i dhënë mundësinë të gjitha familjeve të kenë rrugë deri në shtëpi, duke shmangur kështu daljen e tyre në rrugën nacionale për të komunikuar mes tyre.

Një projekt tjetër i domosdoshëm do të ishte dhe ndërtimi i rrugës lidhëse Lugë–Shalqizë me Tavaren/Kakunjë, fshat i komunës së Baldushkut. Nëse ndërtohet një rrugë automobilistike ndërmjet këtyre fshatrave, banorët do ta kenë më të lehtë komunikimin me Tiranën.

Ndërtimi i tunelit, i autostradës Tiranë–Elbasan (31,7 km, me një tunel 2,4 km) krijon premisa të shumta për zhvillimin ekonomik të zonës, pasi një pjesë e mirë e saj kalon përmes kësaj komune. Që tani, vërehet një pozicionim i ri i ndërtimeve të shtëpive, restoranteve, komplekseve turistike dhe bizneseve në anët e kësaj autostrate, duke krijuar potenciale më të mëdha për zhvillim.



*Fig. III.12 Autostrada Tiranë-Elbasan*



*Fig. III.13 Tuneli i Elbasanit*

#### *III.4.1.c Telekomunikacioni*

Para vitit 1990, në të dy komunat, telekomunikacioni, paraqitej pak i zhvilluar. Numri i telefonave familjarë, ka qenë shumë i kufizuar. Ky shërbim ofrohej nga Zyrat e Postës Shqiptare, por jo për të gjitha fshatrat.

Komunat Dajt dhe Bërzhitë lidhen me qytetin e Tiranës nëpërmjet linjës telefonike të “Albtelekomit”. Në qendër të secilës komunë ndodhen Zyrat e Postës, që siguron shërbim për banorët. Problem paraqitet lidhja ndërmjet fshatrave, pasi aparatet e vjetra janë shkatërruar.

Telefonia celulare përdoret gjerësisht nga fshatarët e kësaj komune, por ka edhe zona ku sinjali shkon i dobët. Operatorët kryesorë të telefonisë celulare janë VODAFON dhe AMC.

Në komunën Dajt, në malin e Dajtit, janë instaluar dhe antenat e një sërë operatorëve të telefonisë celulare, por dhe të televizioneve të ndryshme.

### III.4.2. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe sistemi i kanalizimeve

Hapësirat e komunave Dajt dhe Bërzhitë, për shkak të kushteve të favorshme natyrore të tyre, janë dalluar për potenciale të mëdha ujore. Megjithatë, dhe në të kaluarën, madje dhe sot, gjejmë fshatra që nuk kanë ujë të pijshëm në të gjitha shtëpitë dhe furnizohen me ujë nga puset që kanë ngritur vetë apo nga çezma të ndërtruara nga komuna.

Me gjithë burimet ujore të bollshme të komunës Dajt, furnizimi me ujë të pijshëm nuk është kudo i njëjtë dhe i mjaftueshëm. Vetëm fshatrat Linzë, Tufinë e Lanabregas sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësve, kurse fshatrat e tjera e sigurojnë atë nga burime lokale. Stacionet e pompimit, depozitat e pajisjet e tjera hidraulike, janë të amortizuara.

Aktualisht, në komunën Dajt ekziston një projekt për rehabilitimin e rrjetit të ujit të pijshëm, por ende nuk ka filluar zbatimi i tij, për shkak se financimi nga buxheti i shtetit ka qenë i pamjaftueshëm për ta ndërtuar këtë rrjet.

Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit nga ana e komunës do të mundësojë furnizimin me ujë të pijshëm të disa fshatrave të tjerë të saj si Priskë, Surrel, Tujan e Tufinë.

Sisteme ujësjellësi në komunën e Bërzhitës kanë gjashtë fshatra: Dobresh, Ibë e Sipërme, Ibë e Poshtme, Kllojkë-Fravesh, Pashkashesh dhe Lugë. Në fshatin Kusë uji nuk shkon në çdo shtëpi, por janë ndërtuar tri çezma publike (një në çdo lagje), që sigurojnë ujë të pijshëm pa ndërprerje. Në fshatin Cirmë është e njëjta situatë, por furnizimi është me orar, për shkak të sasisë së kufizuar të ujit.

Gjatësia e rrjetit të jashtëm 5,5 km, ndërsa ajo e rrjetit të shpërndarjes është 44,2 km. Fshatrat Bërzhitë, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë dhe Ibë e Poshtme nuk shërbehen me ujësjellës, por furnizohen me ujë nga puse private apo burime.

Sipas anketës së kryer, në fshatrat Bërzhitë, Ibë e Poshtme, Ibë e Sipërme e Dobresh, mbi 55% e popullsisë së tyre, është e pakënaqur nga furnizimi me ujë dhe cilësinë e ujit të pijshëm .

Tabela III.31 Furnizimi me ujë të pijshëm në komunën Bërzhitë<sup>133</sup>

Sistemi me ngritje mekanike	Sistemi me rrjedhje të lirë	Numri i sistemeve të ujësjellësve	Numri i sistemeve të pompimit
1	8	6	1

Burimi: FSHZH, Plani i zhvillimit të komunës Bërzhitë, viti 2010

Megjithë masat e marra, pas vitit 1960, në ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, në të dy komunat, nuk u arrit të përfshiheshin të gjitha fshatrat e tyre. Ai u ndërtua në fshatrat Linzë, Tufinë e Lanabregas në komunën Dajt, si dhe në fshatrat Bërzhitë e Ibë e Poshtme në komunën Bërzhitë, por dhe në këto raste nuk përfshiheshin të gjitha lagjet e tyre. Në fshatrat e tjerë kanë funksionuar gropat septike.

<sup>133</sup> FSHZH, Plani i zhvillimit të komunës Bërzhitë, viti 2010, fq. 31

Rrjeti kryesor i kanalizimit të ujërave të zeza kalon në fshatrat Bërzhitë dhe Ibë e Poshtme dhe vetëm në dy lagje, por është shumë i amortizuar. Në fshatin Ibë e Sipërme ai është duke u rindërtuar. Në mungese të kanalizimeve të ujërave të zeza funksionojnë 836 gropat septike. Rrjeti i ujërave të bardha nuk ekziston.

Në planet e afërta të komunave Dajt e Bërzhitë parashikohen përmirësime urgjente të situatës, që do të thotë zëvendësimi i gropave septike me kanalizime, instalimi i teknologjive moderne për përpunimin e ujërave të zeza dhe të bardha.

### ***III.2.2 Furnizimi me energji elektrike***

Elektrifikimi i plotë i vendit dhe i fshatrave të komunës Dajt e Bërzhitë, në fillim të vitit 1970, luajti rol të rëndësishëm në jetën e fshatarëve, duke përmirësuar tërësisht mënyrën e jetesës dhe kushtet higjienike. Banorë të këtyre fshatrave blenë radio e më pas televizorë, që do të ndikonin dhe në rritjen e nivelit kulturor të tyre. Të gjithë fshatrat kishin furnizim të rregullt me energji elektrike.

Sot, në të dy komunat ka probleme lidhur me cilësinë e furnizimit, që shkon nga mesatar në të dobët, sidomos në fshatrat periferike, duke vështirësuar funksionimin e pajisjeve elektro-shtëpiake dhe të bizneseve, një pjesë e të cilëve kanë qenë të detyruar të pajisen me gjeneratorë.

Ndërprerjet dhe avaritë në rrjetin elektrik janë të shpeshta për shkak të amortizimit, lidhjeve të paligjshme, furnizimit të dobët etj. Një situatë e tillë ndikon ndjeshëm në kushtet e jetesës si dhe pengon bizneset, numri i të cilave është në rritje në të dy komunat e marra në studim. Nga luhatjet e vazhdueshme të tensionit ka dëmtime të pajisjeve elektrike. Në këto kushte, është e domosdoshme një ndërhyrje në rikonstruksionin e përgjithshëm të rrjetit, si dhe një sensibilizim i banorëve për të paguar në rregull energjinë e konsumuar.

Për të rritur sasinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike në të dy komunat është e rëndësishme të shfrytëzohen burimet e përtëritshme, sidomos ato ujore, të erës dhe diellore, nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve, stacioneve eolike dhe paneleve diellore.

Këto të fundit edhe sot i kanë instaluar shumë familje dhe biznese, kryesisht komplekseve turistike, hotele dhe bar-restorante.

### ***III.2.3 Grumbullimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve***

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta dhe urbane është shqetësuese në të dy komunat. Në fshatrat e komunave janë shumë të rralla ose mungojnë vendet e grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve. Ato hidhen anës rrugëve ose në vende të pa përcaktuara për këtë qëllim. Djegia e tyre është e zakonshme, duke krijuar probleme për mjedisin e komunave, turizmin dhe shëndetin e popullsisë.

Në komunën Dajt janë ngritur dhe funksionojnë 16 pika grumbullimi të mbetjeve urbane dhe 200 kosha kolektivë. Nuk ekziston asnjë fushë grumbullimi të mbetjeve urbane. Ndërsa në komunën Bërzhitë, ekziston një fushë grumbullimi në fshatin Ibë e Sipërme. Në këtë komunë, çdo fshat ka pikën e tij të grumbullimit dhe funksionojnë 80 kosha kolektivë. Në komunën Dajt numri i makinave të grumbullimit të mbetjeve urbane është tetë, ndërsa për komunën Bërzhitë është dy makina të tilla.

Ngritja e impianteve për grumbullimin e përpunimin e mbetjeve urbane është domosdoshmëri për të dy komunat. Në komunën Dajt, është kërkuar nga Këshilli i Komunës, miratimi i një grope përpunimi në zonën e Qafmollës. Një problem shqetësues për këtë komunë janë dhe mbetjet ndërtimore. Për momentin pjesa e dherave që dalin nga gërmimet e themeleve dhe sistemeve të tjera për godinat shumëkatëshe, është vendosur që ato të depozitohen në ato zona ku ka dëmtime të terrenit nga gërryerjet apo erozioni, ndërsa pjesa tjetër është zgjidhur nga vetë firmat e ndërtimit.

Në komunën Bërzhitë, impianti i përpunimit të mbetjeve urbane, mund të ngrihet në pikën e grumbullimit në Ibë e Sipërme. Drejtuesit e komunës mendojnë se kjo mund të dëmtojë zhvillimin e turizmit në këtë zonë, prandaj preferojnë t'i grumbullojnë e më pas t'i depozitojnë ato në Sharrë.

## KAPITULLI IV

### ZHVILLIMI EKONOMIK I KOMUNËS DAJT DHE BËRZHITË

#### IV.1 Veçoritë e zhvillimit ekonomik sipas komunave

Në strukturën ekonomike të të dy komunave sektori primar është bujqësia, që mbizotëron përsa i përket të ardhurave të siguruara, të numrit të të punësuarve, investimeve etj. Në vend të dytë renditet sektori terciar (kryesisht turizmi) e më pas vjen sektori sekondar, industria.

Kushtet e përshtatshme të relievit, klimës, hidrografisë, tokave etj. kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Zonat kodrinore janë përdorur për kultivimin e drufrutorëve, vreshtave dhe ullinjve.

Pozita gjeografike e përshtatshme, shtrirja e tyre pranë qytetit të Tiranës, ekzistenca e Parkut Kombëtar të Dajtit, i Shpellës së Zesë në Pëllumbas, në Bërzhitë, i kalimit të arterieve kryesore të rrugëve si rruga nacionale Tiranë- Elbasan, ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan (ndërtimi i tunelit), vazhdimi i punimeve në Rrugën e Arbrit, kanë ndikuar në zhvillimin e turizmit në të dy komunat.

Larmishmëria e ndërtimit gjeologjik ka kushtëzuar ekzistencën e disa pasurive minerale si qymyrguri, boksite etj. Industria nxjerrëse e tyre ka një kontribut modest në ekonominë e zonave të marra në studim.

#### IV.2. Ekonomia bujqësore dhe nëndegët e saj

##### IV.2.1 Bujqësia

###### IV.2.1.a Historia e zhvillimit të bujqësisë para dhe pas vitit 1990

Ekonomia bujqësore ka qenë dega kryesore e ekonomisë për fshatrat e përfshira në komunën Dajt e Bërzhitë. Prodhimet bujqësore zinin vendin kryesor në raport me blegtorinë sidomos në fshatrat që shtriheshin në lartësi të ulëta mbi nivelin e detit. Në fshatrat që shtriheshin në lartësi më të mëdha për shkak të kufizimit të tokës bujqësore, të kushteve klimatike, të ekzistencës së sipërfaqeve të pyjeve e kullotave ishte e zhvilluar blegtoria. Qëllimi kryesor i fshatarëve në këtë periudhë ishte që të prodhonin sasinë e mjaftueshme për nevojat familjare. Prodhimet e pakta që mbeteshin shiteshin në tregun e qytetit për të siguruar produkte industriale si sheqer, kafe, veshje etj.

Në vitin 1946, si në gjithë Shqipërinë dhe në këto zona u zbatua Ligji i Reformës Agrare që u shoqërua me konfiskimin e tokës nga shteti e rishpërndarjen e saj fshatarëve pa ose me pak tokë. Shpronësimet e pronave gjatë kësaj periudhe u bënë pa asnjë kompensim të pronarëve ekzistues. Me tokën u konfiskuan nga shteti dhe mjetet e prodhimit.



Nga fshatrat që përfshihen sot në komunën Dajt, gjatë asaj periudhe janë shpërndarë rreth 310 ha tokë bujqësore dhe një numër i konsiderueshëm kafshësh pune<sup>134</sup>. Duhet të theksojmë se niveli i mekanizimit ishte shumë i ulët. Pjesa më e madhe e punëve bëhej me dorë. Përdorimi i pesticideve nuk njihej dhe nuk praktikohesh. Sasia e tokës në përdorim ishte deri në 1 ha për një familje. Pyjet, kullotat ishin pronë e shtetit por që shfrytëzoheshin nga banorët e këtyre zonave.

*Zbatimi i Reformës Agrare synonte:*

- a. çrrënjosjen e feudalizmit
- b. krijimin e kooperativave të vogla fshatare
- c. mekanizimin e bujqësisë etj.

Në fillim të viteve 60-të në këto zona filloi krijimi i kooperativave të para bujqësore në bazë fshati. Në këto kooperativa u bashkuan toka, kafshët e prodhimit (kryesisht bagëtitë e imëta dhe lopët), si dhe kafshët e punës (pendët e qeve dhe kuajt). Më pas këto kooperativa u bashkuan duke formuar bashkime më të mëdha si fermat, SMT etj, që nuk patën ndonjë sukses të dukshëm. Gjatë kësaj faze fshatarët ndihmoheshin nga shteti me farëra, me plehra kimike e mjete mekanike. Kooperativat në këto zona dalloheshin për një potencial të konsiderueshëm prodhues bujqësor dhe blegtoral.

*Kjo prodhimtari favorizohej nga faktorë si:*

- a. toka kryesisht kodrinore me pjellori të mirë, me sistem kullues e ujitës;
- b. ekzistenca e një infrastrukture relativisht të mirë;
- c. mbashtrimi i racave me prodhimtari të lartë etj.

Produktet bujqësore që zinin vend të rëndësishëm ishin gruri, misri, patatet, perimet, foragjeret, vreshtat, ullinjt dhe pak pemë frutore. Ndër aktivitetet kryesore ekonomike në komunat Dajt dhe Bërzhitë, pas vitit 1990, janë bujqësia dhe blegtoria. Ato janë përcaktuese në rritjen e mirëqënies sociale dhe ekonomike të banorëve vendas.

Pas vitit 1992 ndodhën ndryshime të rëndësishme në pronësinë mbi tokën. Filloi procesi i shpërbërjes së sistemeve ekzistuese të kooperativave bujqësore, sipas Ligjit të Tokës Nr.7501. Zbatimi i Ligjit për Tokën u shoqërua me fragmentarizim të madh të saj, të kapitalit, të fuqisë punëtore etj. Krijimi i sitemit të ri të mikro-fermave u përball me vështirësi të mëdha të organizimit të punës dhe prodhimit, sigurimit të farërave, kimikateve, ujit për ujitje, orientimit në treg, mungesës së kreditimit etj.

Krahas tyre kanë ndikuar negativisht dhe paqëndrueshmëria politike, mungesa e rendit dhe e sigurisë, mungesa e politikave dhe strategjive të zhvillimit etj.

*Vitet e fundit vihet re ndarja e mëtejshme e pronës për shkak të:*

- a. krijimit të familjeve të reja nga fëmijët dhe shkëputja nga prindërit, pas martesës;
- b. vdekja e kryefamiljarit e ndarja e pronës në disa trashëgimtarë;
- c. emigrimi i një pjese të popullsisë dhe shitja apo dhënia me qera e tokës etj.

Në këto kushte, bujqit kanë filluar riorganizimin e prodhimit bujqësor e blegtoral, kryesisht në varësi të tregut si psh:

- a. duke ndryshuar strukturën e të mbjellave (janë shtuar sipërfaqet e mbjella me foragjere dhe janë zvogëluar sipërfaqet e mbjella me drithëra);

---

<sup>134</sup> Sulovari H., Gjeta Z., Ibraliu A., *Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik*. Komuna Dajt. Rrethi Tiranë. Tiranë 2005, fq. 17

- b. duke rritur përdorimin e kimikateve shpesh dhe jashtë normave të lejuara për të siguruar prodhimtari më të lartë në njësi kohore më të shkurtër;
- c. duke përzgjedhur farërat, varietetet dhe racat, kryesisht nga importi, por dhe të kryqëzuara me ato vendase, për rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit.

#### IV.2.1.b Struktura e sipërfaqes së mbjellë

Në fillim të viteve 90-të, bujqësia pësoi një ulje të madhe të prodhimit pasi tokat bujqësore mbetën pa punuar. Shkatërrimi i kanaleve e veprave të tjera vaditëse bëri që sipërfaqja e mbjellë të ulet shumë. U pakësua shumë dhe sipërfaqja e mjellë me foragjere, jonxhë etj. Interesimi për kultivimin e bimëve mjeksore ra.

Mungesa e eksperiencës, tendenca për një privatizim të skajshëm, mungesa e kujdesit të duhur për ruajtjen e prodhimeve dhe pasurisë nga vjedhjet, çuan në shkatërrimin e sipërfaqeve dhe blloqeve masive të kulturave me pemë frutore, të stallave dhe komplekseve blegtorale etj. Si rrjedhojë prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e fermerëve me gjithë përpjekjet e bëra ishin të pakta.

Prodhimet bujqësore përdorshin kryesisht për konsum familjar dhe vetëm një pjesë e vogël shitej. Kjo ndikohej dhe nga mungesa e një tregu të garantuar, farërat që përdorshin nuk garantonin cilësinë dhe sasinë e dëshiruar të prodhimit, mungesa e kushteve të përshtatshme për ruajtjen e tyre pas vjeljes, problemet e ambalazhimit dhe të transportit të prodhimeve bujqësore në tregje të ndryshme etj.

Pas vitit 2000 kjo gjendje ndryshoi. U rrit interesi i fermerëve për rritjen e prodhimeve bujqësore. Është rritur sipërfaqja e mbjellë me vreshta e pemë frutorë. Është përmirësuar sistemi i ujitjes (është futur vaditja moderne me pika dhe në formë shiu). Gjatë kësaj kohe janë marrë masa dhe për përmirësimin e cilësisë së farërave duke iu përshtatur më mirë cilësisë së tokës, klimës, por dhe kërkesave të tregut.

Toka bujqësore në komunën e Dajtit zë një sipërfaqe prej 5176 ha, ku pjesën më të madhe e zë toka e papunuar rreth 3440,7 ha, ndërsa toka e punuar zë rreth 1725,3 ha dhe përbën 14,87 % të sipërfaqes së përgjithshme të komunës Dajt, ndërsa në komunën Bërzhitë sipërfaqja e tokës së punueshme është 1308,49 ha dhe përbën 22,58 % të sipërfaqes së përgjithshme të saj<sup>135</sup>. Kjo do të mundësojë që dhe në të ardhmen zhvillimi i bujqësisë të jetë primar për këtë komunë.

Tabela IV.1 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (ha) në komunat Dajt e Bërzhitë

Komuna	Tokë e punueshme				Gjithsej
	Ara	Pemishte	Ullishte	Vreshta	
Dajt	1210,50	147,85	350,20	15,52	1725,30
Bërzhitë	1015,70	137,80	141,29	13,70	1308,49

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës-komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

<sup>135</sup> Sulovari H., Gjeta Z., Ibraliu A., Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik. Komuna Dajt. Rrethi Tiranë. Tiranë 2005, fq. 25

Tabela IV.2 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (%) në komunat Dajt e Bërzhitë

Komuna	Tokë e punueshme			
	Ara	Pemishte	Ullishte	Vreshta
Dajt	70,16	8,57	20,29	0,89
Bërzhitë	77,60	10,50	10,70	1,04

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës-komuna Dajt, viti 2011

Tabela IV.3 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (ha) në komunën Dajt

Fshatrat	Tokë e punueshme				Gjithsej
	Ara	Pemishte	Ullishte	Vreshta	
Brarë	63,50	26,85	51,90	-	137,90
Ferraj	81,00	0,89	11,00	3,86	122,00
Tujan	44,70	2,06	39,40	-	84,10
Tufinë	90,00	0,41	30,00	-	121,00
Linzë	102,00	9,44	58,30	0,36	160,60
Lanabregas	56,00	19,40	34,20	8,30	94,30
Surrel	117,00	8,80	49,70	-	169,00
Priskë	248,23	24,70	49,10	3,00	346,40
Shkallë	55,00	7,40	-	-	67,80
Qafmollë	48,00	0,90	-	-	51,00
Selbë	115,00	19,80	-	-	150,60
Murth	64,00	25,40	-	-	64,00
Darshen	159,00	1,80	-	-	166,60
<b>Totali</b>	<b>1210,50</b>	<b>147,85</b>	<b>350,20</b>	<b>15,52</b>	<b>1725,30</b>

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës-komuna Dajt, viti 2011

Tabela IV.4 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme (ha) në komunën Bërzhitë

Fshatrat	Tokë e punueshme				Gjithsej
	Ara	Pemishte	Ullishte	Vreshta	
Bërzhitë	110,90	13,40	32,70	-	157,00
Dobresh	60,00	8,00	26,00	-	94,00
Fravesh	126,10	13,90	-	-	140,00
Ibë e Poshtme	142,60	52,80	12,20	4,00	211,60
Kllojkë	178,80	26,10	-	2,90	207,80
Kus	23,50	0,50	0,49	-	24,49
Lugë-Shalqizë	67,30	1,50	19,20	-	88,30
Mihajas-Cirmë	46,60	7,40	24,90	-	78,90
Pëllumbas	106,40	5,10	25,80	6,80	144,10
Pashkashesh	93,50	7,50	-	-	101,0
Rozaverë	60,00	1,60	-	-	61,60
<b>Totali</b>	<b>1015,70</b>	<b>137,80</b>	<b>141,29</b>	<b>13,70</b>	<b>1308,49</b>

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës-komuna Bërzhitë, viti 2011

Duke krahasuar strukturën e sipërfaqes së tokës së punueshme në komunat Dajt e Bërzhitë arrijmë në këto konkluzione:

- Sipërfaqja e mbjellë me bimë të arave zë pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës së punueshme (70,16 % në komunën Dajt kundrejt 77,6% në komunën Bërzhitë). Kjo sipërfaqe paraqitet më e lartë në komunën Bërzhitë për shkak të relievit më fushor të saj.
- Sipërfaqja e mbjellë me pemë, kryesisht drufrutorë si mollë, kumbulla, qershi etj. është më e madhe në komunën Bërzhitë. Ajo zë 10,5 % të sipërfaqes së tokës së punueshme, kundrejt 8,569 % në komunën Dajt. Kjo lidhet me kushtet shumë të përshtatshme të kësaj komune për mbjelljen e drufrutorëve, por dhe me shkatërrimin e madh të tyre, prerjen masive, në komunën e Dajtit pas vitit 1990-të.
- Sipërfaqja e mbjellë me ullinj është dyfish më e lartë në komunën Dajt 20,29% kundrejt 10,7 % në komunën Bërzhitë, dhe kjo shpjegohet kryesisht që kjo kulturë nuk u prek nga shkatërrimet e prerjet masive gjatë periudhës së tranzicionit. Dhe për të dy komunat në vitet e fundit është karakteristike rritja e investimeve për mbjelljen e ullirit.
- Sipërfaqja e vreshtave është pak më e lartë në komunën Bërzhitë, ku sipërfaqja e mbjellë me vreshtë zë 1.04 % nga 0,89 % që zë në komunën Dajt. Kjo sipërfaqe në të dy komunat ka ardhur duke u rritur vitet e fundit, kjo dhe për shkak të përpunimit të tij e prodhimit të rakisë dhe verës, jo vetëm për konsum familjar, por dhe tregtimin e tyre, kryesisht në restorantet e shumtë që janë hapur në të dy komunat.

Sipërfaqja e kufizuar e tokës së punueshme për disa fshatra si Shkallë, Qafmollë, Murth, Darshen në komunën Dajt, si dhe Rozaverë, Mihajas, Cirmë, Lugë e Shalqizë të komunës Bërzhitë, ka bërë që popullsia e tyre të largohet nga këto fshatra dhe të vendosen në fshatra të tillë si Linzë e Lanabregas (k. Dajt), apo Bërzhitë e Ibë e Poshtme (k. Bërzhitë). Dhe banorët e mbetur, për shkak të kushteve të vështira të jetesës, mendojnë të largohen.


Po të vëmë re shtrirjen e sipërfaqes së tokës sipas lartësisë shikojmë që në të dy komunat mbizotëron relievi kodrinor që krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin e kulturave bujqësore e sidomos të bimëve të arave e drufrutorëve.

*Tabela IV.5 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme sipas lartësisë në ha dhe % në komunat Dajt dhe Bërzhitë*

Komunat	Sipërfaqja e tokës së punueshme						Gjithsej
	Fushë		Kodër		Mal		
	Ha	%	Ha	%	Ha	%	
Dajt	46,00	2,66	1014,30	58,78	665,00	38,54	<b>1725,30</b>
Bërzhitë	408,60	30,69	736,40	55,98	163,49	12,63	<b>1308,49</b>

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës-komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

Grafiku IV.1 Struktura e sipërfaqes së tokës së punueshme sipas lartësisë (ha) në komunën Dajt dhe Bërzhitë



Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës-komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

Sipërfaqja e tokës së punueshme që shtrihet në fushë zë një përqindje të konsiderueshme në komunën Bërzhitë (30,69% /2,66 %), falë shtrirjes së saj në lartësi më të ulëta se komuna Dajt. Kjo ka mundur mbjelljen e bimëve të arave, pemishteve si dhe vreshtave.

Përqindja e lartë e sipërfaqes së tokës së punueshme që shtrihet në lartësi të mëdha në komunë Dajt (38,54 % kundrejt 12,63% në komunën Bërzhitë), e favorizuar dhe nga klima, por dhe nga tradita e banorëve të saj, ka kushtëzuar një sipërfaqe më të madhe të mbjellë me ullinj (20,29 % kundrejt 10,7% në komunën Bërzhitë).

Sipërfaqja mesatare e tokës për frymë e popullsisë, në komunën Dajt, është 1,27 dynym për frymë (afër mesatares për frymë në shkallë vendi), ndërsa në komunën Bërzhitë është më e lartë 2,2 dy për frymë.

Tabela IV. 6 Ecuria në vite e strukturës së mbjelljeve të tokës së punueshme (në ha)

Kulturat bujqësore	Komuna Dajt			Komuna Bërzhitë <sup>136</sup>	
	1992	2004	2011	2004	2011
Grurë	400	282	263	180	120
Misër	50	30	28	90	100
Foragjerë	500	698	730	550	652
Patate	50	30	43	20	30
Fasule	40	60	68	30	40
Perime	32	56	63	130	138
Hasëlla	340	270	270	60	50
Të tjera	263,3	239,3	260,3	220,4	178,4

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

Sipërfaqja e mbjellë me grurë dhe misër, në të dy komunat, në vite, ka ardhur duke u zvogëluar. Në këtë rënie kanë ndikuar: niveli i ulët i mekanizimit, tarifat e larta të punimeve,

<sup>136</sup> Komuna Bërzhitë, u krijua si njësi administrative më vete në vitin 1997, pasi deri në këtë vit ajo bënte pjesë në komunën Krrabë-Bërzhitë, Prandaj në zyrat e komunës nuk dispononin të dhëna për vitin 1992.

sasia e pakët e plehrave kimike dhe pesticideve, si dhe cilësia jo shumë e mirë e farërave të përdorura për mbjellje. Rendimentet në kulturën e grurit, por dhe të kulturave të tjera bujqësore, janë ulur nga 40-45 kv/ha që merreshin në ekonominë e përqëndruar në 22-28 kv/ha. Rendimentet paraqiten më të larta në komunën e Bërzhitës, falë cilësisë më të mirë të tokës. Sipas specialistit të bujqësisë së kësaj komune ato luhaten nga 35-40 kv/ha.

Ajo që bie në sy, është rritja e sipërfaqes së mbjellë me foragjere për të dy komunat. Kjo është e shpjegueshme me zhvillimin e sektorit të blegtorisë e rritjen e numrit të gjësë së gjallë në të dy komunat, kjo pasi prodhimet blegtorale: janë më të garantuara në treg, u sigurojnë fermerëve të ardhura më të shpejta, si dhe për shkak të pranisë sipërfaqeve të konsiderueshme të kullotave natyrore. Kultura më e rëndësishme foragjere është jonxha, por mbillen dhe misri për kokërr dhe hasëllat e ndryshme, që përdoren për ushqim për blegtorinë.

Sipërfaqja e mbjellë me patate dhe fasule, në të dy komunat ka ardhur duke u rritur, kjo për shkak të përdorimit të tyre për konsum familjar, por dhe mundësive të mira për tu tregtuar në qytetin e Tiranës. Por, konkurenca e prodhimeve të huaja, kryesisht maqedonase, mospasja e një tregu të garantuar, problemet e ambalazhimit dhe të transportit, nuk nxisin fermerët e këtyre komunave për të rritur më shumë sipërfaqen e mbjellë me këto produkte.

Perimet kryesore që mbillen në të dy komunat janë: domatja, speci, kastravec, spinaqi, qepa, preshi, hudhra etj. Sipërfaqja e mbjellë me to, në vite, për të dy komunat, ka ardhur duke u rritur, si për të plotësuar nevojat për konsum familjar, por dhe për shitjen e tyre, pasi janë rritur dhe kërkesat për këto produkte bio, nga bar-restorantet që janë ngritur në territorin e tyre.

#### *IV.2.1.c Rrjeti ujitës dhe kullues*

Bujqësia dhe blegtoria nuk mund të zhvillohen nëse nuk sigurohet furnizimi me ujë në sasinë dhe cilësinë e nevojshme. Mosfunksionimi me kapacitet të plotë i sistemeve ujitëse është një nga problemet kryesore të fermerëve shqiptarë sot.

Komuna e Dajtit dhe e Bërzhitës, para vitit 1990, kanë patur një rrjet kanalesh për ujitjen dhe kullimin mjaft të mirë dhe të mjaftueshëm për të realizuar një ujitje dhe kullim në parametra të pranueshëm për kohën kur funksiononte ekonomia e përqëndruar.

Në komunën Dajt, ky rrjet nuk ka patur gjatësi të konsiderueshme. Gjendeshin vetëm 9 km. Aktualisht këto kanale kanë dalë jashtë funksionit të tyre për shkak të mospërdorimit, mungesës së mirëmbajtjes si dhe për shkak të dëmtimeve të ndryshme.

Dëmtimet e pronës shtetërore gjatë viteve 90-të, përfshinë pjesën më të madhe të këtij sistemi, duke vështirësuar sigurimin e ujit për bujqësinë sidomos gjatë stinës së verës. Sot, sipas specialistëve të bujqësisë në këtë komunë, gjatë sezonit veror funksionon vetëm 17.5 % të gjithë sistemit ujitës<sup>137</sup>.

Kjo është shumë pak për të realizuar një kultivim të suksesshëm të kulturave bujqësore dhe sigurimin e rendimenteve të larta.

Prandaj nevojiten më shumë investime, si nga pushteti vendor dhe ai qëndror për rehabilitimin e sistemit ujitës ekzistues, por dhe ndërtimin e veprave të tjera ujitëse, për të patur një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë në këto zona.

---

<sup>137</sup> Sulovari H., Gjeta Z., Ibraliu A., *Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik*. Komuna Dajt. Rrethi Tiranë. Tiranë 2005, fq. 42

Në zonat e marra në studim vetëm rreth 50% e sipërfaqes së tokës bujqësore ka sistem ujitës funksional. Pjesa tjetër, ku ky sistem nuk ekziston ose është pak i zhvilluar, dallohet për prodhim të pakët dhe jo cilësor.

Rrjeti kullues në të dy komunat, paraqitet në të njëjtën situatë si rrjeti ujitës. Por, për shkak të veçorive të relievit, sasisë së reshjeve e shpërndarjes së tyre etj. sistemi kullues nuk duket në pamje të parë shumë problematik. Mungesa e investimeve në vitet e fundit për mirëmbajtjen apo pastrimin e kanaleve kulluese, ka ndukuar jo vetëm në nivelin e prodhimeve bujqësore, por dhe në pjellorinë e tokës, strukturën mekanike të saj, nivelin e qëndrueshmërisë ndaj erozionit etj.

Gjatë stinës së reshjeve, ka mjaft raste, kur sasia e shiut të rënë krijon probleme të kullimit, pasi kanalet nuk arrijnë të largojnë në kohë ujërat sipërfaqësore. Pothuajse 60% e kanaleve kulluese në të dy komunat janë jashtë funksionimit të tyre.

*Prandaj është e domosdoshme të merren masa të shpejta si:*

- a. rikonstruksioni i digave, si psh ajo e Skoranës, vepër marrëse uji për vaditje;*
- b. ndërtimi i rezervuarëve ujëmbledhës;*
- c. menaxhimi më i mirë i ujit;*
- d. mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit aktual;*
- e. rritja e pagesës për fermerët për ujin e përdorur etj.*

#### *IV.2.1.d Mekanizimi i bujqësisë*

Mekanizimi i bujqësisë është një kusht i rëndësishëm për zhvillimin e saj. Rritja e prodhimit për treg ka nxitur fermerët për shtimin e mekanikës bujqësore, sidomos të traktorëve me goma dhe minitraktorëve. Për këtë kanë ndihmuar ndjeshëm dhe grantet me procedura të lehtësuara, pagesa e të cilave bëhet me këste.

Pamvarësisht përpjekjeve të fermerëve për të rritur nivelin e mekanizimit, treguesit janë larg atyre të bujqësisë në vendet e zhvilluara. Në komunat e marra në studim bie në sy psh mungesa e makinave seleksionuese (për domatet, patatet etj.), të cilat do të lehtësonin kategorizimin e produkteve dhe shitjen e tyre me çmime të diferencuara.

Gjithashtu, në shumicën e rasteve, kashta e grurit vazhdon të mbliidhet me dorë e të sistemohet në mullarë, që nuk janë të mbrojtur mirë nga kushtet atmosferike, ndërkohë që mund të përdoren makineri grumbullimi, ambalazhimin me qese plastike, që mundësojnë ruajtjen për një kohë më të gjatë.

Numri i traktorëve është i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat e fermerëve, kështu që një pjesë e proceseve kryhen me mjete alternative. Pjesa më e madhe e fermerëve ende nuk janë të gatshëm të investojnë në blerjen e mjeteve mekanike të nevojshme.

Pothuajse në të gjitha fshatrat e të dy komunave, niveli i mekanizimit të fermave është relativisht i ulët. Në komunën Dajt mekanika bujqësore përfaqësohet nga 20 traktorë me goma, ndërsa komuna Bërzhitë numëron vetëm 6 të tillë. Dhe numri i minitraktorëve paraqitet i kufizuar, 12 minitraktorë në komunën Dajt dhe vetëm 3 minitraktorë në komunën Bërzhitë.

Tabela IV.7 Mjetet mekanike bujqësore në komunat Dajt dhe Bërzhitë<sup>138</sup>

Mjetet mekanike	Komuna Dajt	Komuna Bërzhitë
Traktor me rrota (goma)	20	6
Minitraktorë	12	3
Makina mbjellëse	4	-
Motokorrëse	3	2
Autokombanja	2	-
Traktorë me zinxhirë	-	-
Freza	16	12

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

Punimi i tokës dhe përgatitja e saj për mbjellje është një proces i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në prodhimin bujqësor. Përdorimi i traktorit për punimin e tokës bëhet vetëm në një pjesë të tokave të fermerëve të komunave Dajt e Bërzhitë, kryesisht në sipërfaqe të rrafshëta dhe relativisht jo të vogla.

Përdorimi i mjeteve mekanike në mënyrë të kufizuar kushtëzohet nga faktorë të tillë si pjerrësia e madhe e territorit, sipërfaqet e vogla të parcelave, çmimet e larta të punimeve me mjete mekanike, numri relativisht i ulët i traktorëve, kostoja e lartë e mbajtjes së mjeteve mekanike etj.

Këta faktorë kanë bërë që një pjesë e madhe e tokave të këtyre zonave të punohen me kafshë pune. Shpeshherë, për shkak të sipërfaqeve të vogla të parcelave si dhe të pamundësisë së përdorimit të mjeteve mekanike apo mjeteve të punimit të tokës të tërhequra nga kafshët, shumë fermerë e punojnë tokën e tyre me krahë.

Traktori përdoret kryesisht në punimet përgatitore për mbjellje, ndërsa mbjellja në shumicën e rasteve bëhet me kafshë ose me krahë. Punime të tjera si prashitja, pastrimi i barërave të këqija, vjelja etj. pothuajse bëhen gjithmonë me krahë. Në përgjithësi, çmimet e punimeve mekanike janë të larta dhe shumë fermerë nuk i kanë mundësitë që t'i blejnë këto shërbime.

Mungesa dhe pamundësia e mjeteve financiare për blerjen e pajisjeve të ndryshme mekanike, si dhe kostot e larta të karburanteve dhe pjesëve të ndërrimit, krijojnë vështirësi në blerjen apo shtimin e këtyre mjeteve në të dy komunat e marra në studim.

Mekanizimi i bujqësisë është më i lartë në zonat fushore se sa në zonat malore.

Një ndihmë për fermerët ishte dhe vendimi i qeverisë për heqjen e tvsh për makineritë bujqësore, si dhe kompensimi i karburantit për mjetet bujqësore. Por, mbetet ende për tu parë skema e kompensimit për ta bërë atë sa më praktike dhe për t'iu ardhur sa më mirë në ndihmë fermerëve.

<sup>138</sup> Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011



IV.2.1.e Prodhimi bujqësor sipas llojeve

➤ **Komuna Dajt**

Numri i fermave bujqësore në këtë komunë është 930 dhe sipërfaqja e tyre nuk i kalon zakonisht 1.3 ha dhe kjo gjë përbën një kufizim për zhvillimin në perspektivë të tyre. Në pjesën më të madhe të tyre fermat kanë një strukturë të mbjelljeve të kulturave bujqësore të ngjashme ku vendin e parë e zënë kulturat foragjere 57 % (jonxha dhe hasëllat), drithërat 36%, patatet, fasule etj. 4.5% dhe perime 2.5%<sup>139</sup>. Pjesa më e madhe e këtyre prodhimeve përdoren për plotësimin e nevojave familjare dhe një pjesë e vogël e tyre është e destinuar për treg.

Në përgjithësi në këto ferma nuk vërehet ndonjë lloj kujdesi për qarkullimin bujqësor të kulturave që do të ndikonte në ruajtjen e cilësisë së tokës e rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore.

Tabela IV.8 Prodhimet kryesore (t) në komunën Dajt

Drithërat			Produktet bujqësore				Të tjera
Grurë	Misër	Thekër	Patate	Fasule	Fruta	Vreshta	
15.2	41.2	-----	96	14.4	30	41.8	353.4

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt, viti 2011

Sasia e këtyre prodhimeve do të ishte më e lartë nëse fermerët do të kishin farëra më cilësore, një treg të garantuar, kushte të përshtatshme për ruajtjen e tyre pas vjeljes apo mundësi më të mira për ambalazhimin e transportimin e tyre për në tregje të ndryshme.

Në vitet e fundit, fermerët e kësaj zonë kanë filluar të ndërtojnë dhe mjedise të mbrojtura si serrat. Prodhimet e hershme apo të vonshme që prodhohen në to shfaqin interes në rritjen e të ardhurave të fermerëve.

Pas shkatërrimit që pësuan blloqet e mbjella me drufutorë dhe vreshta, pas vitit 1990, sipërfaqja e mbjellë me to në vitet e fundit po rritet. Fermerët po mbjellin blloqe të reja, relativisht me sipërfaqe të vogla, 1000-1500 m, me pemë frutore si dardha, mollë, kumbulla, qershi, arra etj.

Mosbërja e shërbimeve në kohën dhe cilësinë e rekomanduar nga specialistët, sipërfaqja e vogël e mbjelljes së drufutorëve të rinj në mini-blloqe etj. bëjnë që fermerët e zonës të mos jenë të kënaqur me rezultatet e deritanishme.

<sup>139</sup> Sulovari H., Gjeta Z., Ibraliu A., *Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik*. Komuna Dajt. Rrethi Tiranë. Tiranë 2005, fq. 67



Fig.IV.1 Bllok i ri drufrutor në komunë Dajt

Përsa i takon vreshtarisë, ekziston një traditë e mirë që krijon mundësi për një rritje të sipërfaqes së mbjellë me hardhi, si dhe të rritjes së prodhimit, duke krijuar premisa për një zhvillim më të madh të këtij sektori në të ardhmen. Vreshtat janë kryesisht në formë pjergullash në kopshtet e fermerëve, por janë rritur dhe sipërfaqet e vreshtave në blloqe më të mëdha në sipërfaqe 1.5-2 dynym.

#### ➤ Komuna Bërzhitë

Në këtë komunë sektori i bujqësisë realizon të ardhurat më të larta të aktiviteteve të fermës bujqësore. Janë rreth 758 ferma bujqësore familjare me një mesatare prej 1 ha tokë bujqësore. Gjenden dhe 20 sera të vogla me sipërfaqe rreth 100 m që shërbejnë kryesisht për plotësimin e nevojave familjare, dhe shumë pak për të tregtuar.

Prodhimi më intensiv në këtë komunë realizohet në zonën fushore përgjatë luginës së lumit të Erzenit, ku më tepër se gjysma e sipërfaqes është tokë pjellore dhe pjesërisht nën ujë.

Prodhimi i perimeve zë një vend të rëndësishëm pasi të ardhurat që krijohen janë më të larta në krahasim me kulturat e tjera bujqësore. Pothuajse 10% e fermave që shtrihen kryesisht në zonat fushore të komunës, shesin produktet e tyre bujqësore, kryesisht perime dhe fruta, në tregje spontane, ndërsa fermat që shtrihen në zonat malore janë të njohura për prodhimet e perimeve të vona e të thata.

Prodhimet kryesore bujqësore që kultivohen në komunën e Bërzhitës jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela IV.9 Prodhimet kryesore (t) në komunën Bërzhitë

Drithërat			Produktet bujqësore			
Grurë	Misër	Thekër	Patate	Fasule	Fruta	Vreshta
77.5	354.3	-----	195.5	24.61	93.94	162.8

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Bërzhitë, viti 2011



Fig. IV.2 Tokë e mbjellë me jonxhë në komunën Bërzhitë

Tabela IV.10 Prodhimet kryesore (t) në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Komuna	Drithërat			Produktet bujqësore				Të tjera
	Grurë	Misër	Thekër	Patate	Fasule	Fruta	Vreshta	
Dajt	15,2	41,2	-----	96	14,4	30	41,8	353,4
Bërzhitë	77,5	354,3	-----	195,5	24,61	93,94	162,8	77,5

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2011

Vitet e fundit, i është kushtuar rëndësi dhe krijimit të serave që përbëjnë një mundësi mjaft të mirë për intensifikimin e prodhimit dhe rritjen e të ardhurave të banorëve.

Potencialet që ofrojnë të dy komunat janë shumë të mëdha, madje për të mundësuar një prodhimtari 2 herë më të lartë, por kjo pengohet nga: gjendja jo e mirë e infrastrukturës rrugore për disa fshatra, mospatja e një tregu të sigurtë për shitjen e produkteve bujqësore, parcelizimi i tokës bujqësore, mekanizimi i ulët i bujqësisë, mungesa e vaditjes etj.

#### IV.2.2 Blegtoria

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të komunave Dajt dhe Bërzhitë ka luajtur dhe luan dhe blegtoria.

Që pas privatizimit të kooperativave bujqësore numri i bagëtive në këto dy komuna është rritur vazhdimisht. Kjo është favorizuar nga prezenca e pyjeve dhe e kullotave të shumta, megjithëse shpesh ato janë keqpërdorur dhe shfrytëzuar pa kriter.

Zhvillimi i blegtorisë në këto komuna është kushtëzuar dhe nga faktorë të tjerë si:

- domosdoshmëria e qumështit dhe produkteve të tjera për konsum familjar;
- kërkesa më e madhe në treg për prodhimet blegtorale;
- duke qenë se produktet blegtorale shiten çdo ditë, fermerët sigurojnë të ardhura (para në dorë) çdo ditë;
- prodhimet foragjere, të domosdoshme për blegtorinë, kërkojnë më pak shpenzime se prodhimet e tjera bujqësore etj.

Në këto komuna, ashtu si në gjithë vendin, nuk ka ferma të mirëfillta blegtorale. Ato janë ferma të përziera bujqësore e blegtorale.

Duke qenë se produktet blegtorale shiten më lehtë sesa prodhimet bujqësore, ky sektor ka tërhequr vëmendjen e fermerëve si dhe të përqendrimit të investimeve në këtë fushë. Për sa i takon racave të bagëtive, fermerët nuk kanë mundur të paguajnë për përmirësimin racor. Për pasojë racat e bagëtive nuk paraqiten të pastra.

Shumica e gjedhëve janë me bazë të racës Jersey dhe pothuajse të gjitha janë të kryqëzuara me raca lokale. Gjenden dhe disa gjedhë të racës Holstein ose kryqëzime të kësaj race. Kjo gjë vlen dhe për bagëtitë e imëta.



Fig. IV.3 Stallë lopësh në komunën Bërzhitë

Tabela IV.11 Struktura e gjësë së gjallë në vite në komunën Dajt dhe Bërzhitë

	Komuna Dajt		Komuna Bërzhitë	
	2004	2011	2004	2011
Gjedhë	3541	3640	911	1223
Të leshta	5400	5800	2462	2821
Të dhirta	3950	4150	2551	2925
Shpendë	16600	20826	15410	17824
Njithundrakë	440	460	311	323
Derra	-	-	-	-
Bletë	325	414	215	525

Burimi: Zyra e Shërbimit Veterinar, komuna Dajt dhe Bërzhitë, 2011

Numri i lopëve dhe viçave në vite ka ardhur duke u rritur për të dy komunat. Po kështu dhe numri i deleve dhe dhive. Siç e shohim dhe nga tabela e mësipërme, numri i gjedhëve është më i lartë në komunën e Dajtit (3640 krerë) se në komunën Bërzhitë (1223). Kjo shpjegohet me mundësitë më të mira financiare që kanë fermerët në komunën e Dajtit për të mbarështuar një numër më të madh krerësh si dhe për t'iu siguruar kushtet e nevojshme.

Po kështu, dhe numri i bagëtisë së imët, është më i lartë në komunën Dajt, mbajtja e kujdesi për to është më i paktë dhe i favorizuar dhe nga mjedisi natyror.

Ndër delet janë më të përhapura racat rudë, shkodrane dhe cigaja. Është e përhapur dhe dhia, sidomos në zonat malore. Megjithatë vihet re një kujdes i pakët përsa i përket strehimit të bagëtive, vaksinimit të tyre etj.

Njëhundralet, kryesisht gomerët dhe kuajt, kanë përhapje të konsiderueshme në këtë zonë pasi ato mbahen me pak mundim dhe investim.

Shpendët janë të përhapur në të gjitha fshatrat e zonës së komunës Dajt dhe Bërzhitë. Numri i tyre ndryshon vazhdimisht në varësi të sezonit, prekshmërisë së sëmundjeve etj.

Megjithëse numri i bagëtive të imëta, gjedhëve e shpendëve është i konsiderueshëm dhe është rritur nga viti në vit, në komunën Dajt dhe Bërzhitë, nuk ekziston asnjë baxho apo fabrikë të përpunimit të produkteve blegtorale (ka ekzistuar një e tillë në komunën Dajt, por dhe ajo është mbyllur në vitin 2012).

Tabela IV.12 Struktura e gjësë së gjallë në komunën Dajt

Fshatrat	Numri i krerëve				Njëhundra.	Bletë
	Gjedhë	Të leshta	Dhirta	Shpendë		
Brarë	315	485	310	1150	58	40
Ferraj	305	490	150	1700	23	30
Tujan	270	470	350	1300	34	20
Tufinë	260	470	300	1600	20	40
Linzë	310	500	260	2500	35	35
Lanabregas	320	490	280	2300	32	30
Surrel	205	370	300	1700	46	40
Priskë	380	540	300	2600	43	40
Shkallë	260	390	515	1350	27	40
Qafmollë	270	350	280	1572	40	20
Selbë	280	450	380	1800	43	30
Murth	185	370	205	850	23	25
Darshen	380	420	320	1500	36	24
<b>Komuna</b>	<b>3640</b>	<b>5800</b>	<b>3950</b>	<b>20826</b>	<b>460</b>	<b>414</b>

Burimi: Zyra e Shërbimit Veterinar, komuna Dajt, 2011

Në fshatrat Priskë, Darshen, Linzë e Selbë, për shkak të shtrirjes së tyre në lartësi të ulëta, më të populluara, numri i gjedhëve paraqitet më i lartë. Kjo lidhet dhe me mundësitë më të shumta që kanë këto komuna, si dhe me mundësitë e tyre për shitjen e produkteve në qytetin e Tiranës, për shkak të afërsisë së tyre me të.

Ndërsa, në fshatrat më të thella, që shtrihen në relieve më të larta, është më i lartë numri i të leshtave dhe të dhirtave.

Po e njëjta situatë paraqitet dhe në fshatrat e komunës Bërzhitë, ku relievi, sipërfaqja e kullotave, kanë kushtëzuar shpërndarjen e gjedhëve dhe të të imtave.

Tabela IV.13 Struktura e gjësë së gjallë në komunën Bërzhitë

Fshatrat	Numri i krerëve				Njëthun.	Bletë
	Gjedhë	Të leshta	Dhirta	Shpend		
Bërzhitë	135	70	82	2050	35	39
Dobresh	81	85	182	2400	31	30
Fravesh	93	462	196	835	32	30
Ibë	76	67	136	1455	35	80
Ibë e Poshtme	185	91	91	2700	30	75
Killojkë	197	607	529	2600	20	30
Kus	50	338	192	632	20	34
Lugë-Shalqizë	55	290	390	730	38	85
Mihajas-Cirmë	58	250	582	1077	21	45
Pëllumbas	156	146	180	2060	15	41
Pashkashesh	96	120	258	920	15	20
Rozaverë	41	295	127	365	21	16
<b>Komuna</b>	<b>1223</b>	<b>2821</b>	<b>2925</b>	<b>17824</b>	<b>323</b>	<b>525</b>

Burimi: Zyra e Shërbimit Veterinar, komuna Bërzhitë, 2011

Tabela IV.14 Prodhimet blegtorale në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Prodhimet	Komuna Dajt		Komuna Bërzhitë	
	2004	2011	2004	2011
Qumësht(kv)	58970	64680	25650	29675
Mish(kv)	4875	5565	2345	2778
Vezë(kokrra)	1850	4150	1756	2075
Mjaltë(kg)	950	1250	850	890

Burimi: Zyra e Shërbimit Veterinar, komuna Dajt dhe Bërzhitë, 2011

Siç e shohim dhe nga tabela e mësipërme, sasia e prodhimeve blegtorale, është rritur në mënyrë të kënaqshme në të dy komunat, falë rritjes së numrit të gjësë së gjallë, pasi rendimentet paraqiten jo shumë të lartë, pranë mesatares në shkallë vendi, 2300-2700 litra qumësht për lopë në vit 80-120 litra për të imtat.

Qumështi i marrë nga lopët përpunohet me metoda dhe mjete primitive, në ambientet e familjes fermere. Prej tij nxirret djathi i bardhë, gjalpi e nënprodukte të tjera. Ato përdoren kryesisht për përdorim familjar dhe vetëm një sasi e vogël e tyre është e destinuar për treg.

*Si përfundim, mund të themi se potencialet bujqësore dhe blegtorale të të dy komunave përbëjnë një mbështetje të rëndësishme për zhvillimin e agroindustrialisë e të sektorit terciar të ekonomisë. Gradualisht, investimet bujqësore kanë rritur prodhimin bujqësor e blegtoral duke plotësuar nevojat familjare, por dhe një pjesë të kërkesave të tregut. Këto produkte janë relativisht të një cilësie të lartë, biologjikisht të pastra e të kërkuara prej turistëve vendas e të huaj që vizitojnë apo frekuentojnë restorantet e shumta të ngritura në territoret e komunës Dajt e Bërzhitë.*

#### IV.2.3 Pyjet dhe menaxhimi i tyre

Pyjet, një ndër pasuritë e madhe të vendit tonë, përbëjnë rreth 36% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit<sup>140</sup>. Potencialet ekzistuese bëjnë të mundur rritjen e kontributit të këtij sektori në rimëkëmbjen ekonomike, duke gjeneruar të ardhura nga shitja e lëndës drusore, duke rritur punësimin rural dhe duke sjellë përfitime për mjedisin.

Pyjet zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në komunën e Dajtit dhe përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të saj. Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në komunën Dajt është 1795,7 ha. 3297,8

Në këtë komunë shtrihet dhe një pjesë e Parkut Kombëtar të Dajtit. Parku Kombëtar i Dajtit për një kohë të gjatë është manaxhuar si një Rezervë Pyjore mbi bazën e principit të manaxhimit të qëndrueshëm, me objektiv më kryesor mbrojtjen sesa menaxhimin. Ai mbulon rreth 3,000 ha.

Tabela IV.15 Sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave (ha) në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Komuna	Pyje <sup>141</sup>	Livadhe e kullota
Dajt	1795,70	36,10
Bërzhitë	3297,85	44,50

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Tabela IV.16 Struktura e sipërfaqes pyjore në % në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Komuna	Shkurre	Dushqe	Ahishte	Kullotat e livadhet	Gjithsej
Dajt	76,66	1,40	21,93	0,30	<b>48,09</b>
Bërzhitë	76,50	18,76	4,73	0,76	<b>56,90</b>

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë

Sipërfaqja që zënë pyjet, në të dy komunat, është e lartë (56,9 % në komunën Bërzhitë, kundrejt 48,09 % në komunën Dajt), dhe kjo përbën një potencial natyror të rëndësishëm për ta. Sipërfaqja pyjore është më e lartë në komunën Bërzhitë, pasi në këtë komunë ka qenë më e vogël ndërhyrja e njeriut, prerjet pa kriter të pyjeve për ngrohje apo veprimtari ndërtuese. Pyjet në komunën Dajt janë përfshirë nga zjarre të shkaktuara nga pakujdesia e njerëzve, por dhe për të krijuar kullota për bagëtinë. Shpesh drurët janë prerë dhe për të krijuar sheshe ndërtimi për banesa apo lokale e hotele që në këtë komunë janë më të shumta.

Në të dy komunat sipërfaqen më të madhe të pyjeve e zënë shkurret mesdhetare dhe kjo është pasojë e pozitës së tyre gjeografike. Këtu mund të përmendim marenë, shumë e përhapur në zonën e komunës Dajt, shkoza, shqopa, dafina etj.

<sup>140</sup> Shqipëria në shifra. INSTAT 2010. fq.48

<sup>141</sup> Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve në komunën Dajt është 6252,6 ha, nga të cilat vetëm 1795,7 ha administrohen nga komuna Dajt, pjesa tjetër prej 4466,9ha administrohen nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

Brezi i dushkut ka një përhapje më të kufizuar, kryesisht pranë qendrave të banuara. Në disa sektorë janë të pranishëm drurë të vjetër gështenje, të cilët po zevendësohen me fidanë të rinj, pasi vlera ekonomike e tyre është e madhe.

Kati i ahut, në komunën Dajt, zë një përqindje më të lartë se në komunën Bërzhitë (21,93% / 4,73 %), dhe kjo pasojë e shtrirjes më në lartësi të kësaj komune. Komuna Bërzhitë dallohet kryesisht për një relief fushor e pjesërisht kodrinor, prandaj në këtë komunë dushqet zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ndërsa ahishtet kanë një shtrirje më të kufizuar.

Problemet me pronësinë e pyjeve janë edhe shkaku kryesor i lënies së tyre në mëshirë të fatit. Komuna Dajt prej vitesh ka kërkuar që pyjet t'i kalojnë në pronësi për të patur një menaxhim më të mirë të tyre dhe për t'i kthyer në shërbim të komunitetit. Përfaqësues të kësaj komune thonë se që nga 2008 shteti u ka kaluar në përdorim 1795,7 ha pyje nga 6252,6 ha që ka gjithsej kjo komunë. Por, as kjo sipërfaqe nuk shfrytëzohet për mungesë fondesh. Aktualisht njihen me ligj tre forma të pronësisë së pyjeve, shtetërore, komunale dhe private.

Proçesi i kalimit të pyjeve dhe kullotave pushtetit vendor, në shumicën e rasteve, ka patur mangësi që kanë frenuar reformën në këtë sektor. Por, ky nuk është problemi i vetëm i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Mungesa e një inventarizimi të saktë të sipërfaqeve pyjore dhe ndarja e kufijve mes komunave janë ankesat kryesorë të kryetarëve të komunave. Kalimi i pyjeve në pronësi të komunave ka bërë të mundur ripërtëritjen e tyre.

Pylli, brenda Parkut Kombëtar të Dajtit, paraqet një shembull konkret të shtrirjes vertikale të zonave fito-klimatike në Shqipëri. Katëzimi i bimësisë paraqitet si më poshtë:

- a. në lartësitë 300-600 m mbi nivelin e detit gjenden shkurret mesdhetare me gjelbërim të përhershëm, të ashtëquajtura makiet;
- b. në lartësitë 500 (600) – 1000 (1300) m mbi nivelin e detit shtrihet zona e dushkut, kryesisht lis dhe dushk (*Carpinus orientalis* dhe *Ostrya carpinifolia*);
- c. në lartësitë 1000- 1600 m mbi nivelin e detit shtrihet zona e ahut, ku ahu është lloji më dominues;
- d. në lartësitë mbi 1600 m mbi nivelin e detit shtrihet zona e kullotave alpine, më pak e përhapur në këtë park.

Privatizimi i tokave bujqësore ka krijuar probleme jo të vogla dhe në sipërfaqet pyjore që shtrihen në komunën Dajt. Parcelizimi në sipërfaqe të vogla i tokës bujqësore dhe prodhimitaria e pakët ka bërë që fshatarët të rrisin numrin e bagëtive, sidomos të deleve dhe të dhive. Gjithashtu kullota shumë të mira janë kthyer në toka bujqësore nëpërmjet privatizimit të paligjshëm. Si pasojë e kësaj, një numër i madh i deleve dhe dhive kullosin në kullotat ekzistuese dhe burimet pyjore pa patur asnjë formë kontrolli. Është vlerësuar se rreth 60.000 kafshë kullosin brenda territorit të Parkut Kombëtar të Dajtit. Ky është një numër shumë i madh dhe duhet të përgjysmohet. Prandaj është shumë e rëndësishme që të rehabilitohen kullotat e degraduara.

*Për një menaxhim më të mirë të pyjeve duhet të merren këto masa:*

- ❖ *përmirësimi i sipërfaqeve të degraduara pyjore dhe i kullotave në pronësi të shtetit;*
- ❖ *sensibilizimi për një shfrytëzim sa më të qëndrueshëm të tyre;*
- ❖ *nxitja e ruajtjes së ekosistemeve pyjore natyrore etj.*





Fig. IV.4 Pamje nga pyjet në Parkun Kombëtar të Dajtit



Fig. IV.5 Dëmtimi i pyjeve në Parkun Kombëtar të Dajtit

Në komunën Bërzhitë pyjet zënë një sipërfaqe prej 3297,85 ha, ndërsa kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe prej 44,5 ha.

Siç e shohim, sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave, në komunën Bërzhitë, është e madhe. Ajo zë 59,6 % të sipërfaqes së përgjithshme të saj. Kjo lidhet kryesisht me ndikimin më të pakët të popullsisë së kësaj komune në prerjen e drurëve, si dhe të ndërtimeve më të pakta që vihen re në këtë komunë. Kjo, dhe për shkak të popullsisë më të vogël në numër se sa në komunën Dajt.

Megjithatë, dhe në këtë komunë ndihet veprimtaria e njeriut. Në disa zona vihet re një prerje masive e pyjeve dhe kjo kryesisht për nevojat për ngrohje nga banorët vendas.

Nga bimët mjekësore që rriten në mënyrë spontane apo kultivohen, për të dy komunat, mund të përmendim sherebelën (*Salvia officinalis*), dëllinjën e kuqe (*Juniperus communis*) dhe të zezë (*Juniperus oxycedrus*), trëndafilin e egër (*Roza canina*), salep (*Orchis morio*), bar blete (*Melissa officinalis*), lule murrizi (*Crataegus monogyna*) etj.

Sasia e bimëve mjekësore që grumbullohet në komunën Bërzhitë është 122 kv, ndërsa rezervat e mundshme janë më të mëdha, 270 kv, ndërsa në komunën Dajt sasia e bimëve mjekësore që grumbullohet arrin afërsisht 220 kv, ndërsa për rezervat e mundshme nuk kishte ndonjë shifër të saktë<sup>142</sup>.

<sup>142</sup> Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë, viti 2012

#### IV.2.4 Bletaria dhe peshkimi

Bletaria është një aktivitet jo shumë i përhapur në komunat Dajt dhe Bërzhitë. Koshere bletësh gjenden vetëm në disa ferma të veçanta dhe kjo është e lidhur kryesisht me pasionin individual të disa fermerëve sesa e parë si veprimtari ekonomike fitimprurëse.

Megjithatë, numri i fermerëve që mbarështrajnë bletë ka ardhur duke u rritur. Në komunën e Bërzhitës ai paraqitet më i madh. Numri i koshereve në këtë komunë është rreth 525 koshere të cilat prodhojnë rreth 1250 kg mjaltë. Ndërsa në komunën e Dajtit gjenden 325 koshere që japin një prodhim rreth 414 kg mjaltë. Kryesisht prodhimi përdoret për nevojat familjare dhe shumë pak ose aspak prej këtij prodhimi shitet.

Megjithë kushtet shumë të favorshme për mbarështrimin e bletarisë në të dy komunat, përsëri ajo nuk është shumë e zhvilluar. Kjo lidhet me mungesën e eksperiencës së fermerëve të këtyre zonave dhe mungesës së një tregu të garantuar për shitje.

Tabela IV.17 Shpërndarja e koshereve të bletëve sipas fshatrave në komunat Dajt e Bërzhitë

Fshatrat	Nr.kosh. të bletëve	Fshatrat	Nr.kosh. të bletëve
Darshen	40	Bërzhitë	39
Brarë	30	Dobresh	30
Ferraj	20	Fravesh	30
Tujan	40	Ibë	80
Tufinë	35	Ibë e Poshtme	75
Linzë	30	Kllojkë	30
Lanabregas	40	Kus	34
Surrel	40	Lugë-Shalqizë	85
Priskë	40	Mihajas-Cirmë	45
Shkallë	20	Pëllumbas	41
Qafmollë	30	Pashkashesh	20
Selbë	25	Rozaverë	16
Murth	24	<b>K. Bërzhitë</b>	<b>525</b>
<b>K. Dajt</b>	<b>414</b>		

Burimi: Zyra e Menaxhimit dhe Mbrotjtjes së Tokës, komuna Dajt dhe Bërzhitë, 2011

Megjithatë duhet të theksojmë se ky produkt ambalazhohet lehtë, mund të transportohet lehtë, një produkt rezistent, prandaj sugjerojmë që në të dy komunat mund të zhvillohet lehtësisht pa kërkuar investime të mëdha. Rritja e çmimit të mjaltit dhe e kërkesave për këtë produkt përbën një siguri për të zhvilluar këtë sektor.

Kemi theksuar se komunat Dajt dhe Bërzhitë kanë pasuri të shumta ujore si lumenj, liqene apo rezervuare. Kushtet klimatike dhe faktorë të tjerë lejojnë rritjen e disa llojeve të peshqve si trofta, levreku etj. Aktualisht ekziston vetëm një rezervuar peshku në komunën e Dajtit, por dhe ai është i përmasave të vogla.

Pra, në të dy komunat, mund të rriten mjaft mirë lloje të ndryshëm peshqish, që jo vetëm mund të përdoren për nevoja familjare, por mund të tregtohen dhe në tregjet e afërt, ku

dhe kërkesat janë të larta. Për këtë qëllim mjaftojnë investime modeste, të cilat konsistojnë në ngritjen e rezervuarëve të përshtatshëm sipas një skeme të thjeshtë.

Për këtë qëllim, është e nevojshme një trajnim afatshkurtër për banorët që shfaqin interes rreth mënyrës së rritjes së peshkut në kushtet e rezervuarit.

Tregu i Tiranës, që nuk ndodhet larg nga të dy komunat, ka kërkesa për peshk të tillë si trofta apo lloje të tjera. Rritja e numrit të restoranteve e resorteve në të dy komunat e bën tregun e shitjes së peshkut pothuajse të sigurtë.

*Prandaj sugjerojmë rritjen e prodhimit e peshkut për të dy komunat si një mundësi e mirë e tyre për të rritur të ardhurat si dhe numrin e të punësuarve.*

### **IV.3. Shfrytëzimi i pasurive nëntokësore**

Si rrjedhojë e ndërtimit gjeologjik të larmishëm, në territorin në studim gjenden disa pasuri nëntokësore si boksitë (Tujan, Priskë), qymyrguri (Priskë, Brar, Ferraj), gurë gëlqerorë (Priskë, Linzë, Tujan, Brar), rërë e zhavore në luginat e lumenjve Tërkuzë, Tiranë dhe Erzen etj. Shfrytëzimi i këtyre pasurive ka filluar kryesisht pas vitit 1950. Më të përmendurat kanë qenë miniera e qymyrgurit në Priskë si dhe nxjerrja e boksitëve në fshatin Tujan. Numri i guroreve, sidomos në Linzë, pranë Parkut Kombëtar të Dajtit, ka qenë i kufizuar (në vitin 1985 ekzistonin vetëm 3 kantierë).

Në vitin 2004, brenda kufijve të PK të Dajtit, ushtronin veprimtarinë e tyre rreth 25 miniera dhe gurore, 12 nga të cilat janë të lokalizuara në hyrje të tij, duke cënuar mjedisin dhe peizazhin e tij<sup>143</sup>.

Në vitin 2013, vazhdojnë veprimtarinë e tyre vetëm gjysma, pasi pjesa tjetër u mbyllën me urdhër të Ministrisë së Mjedisit.



*Fig. IV.6 Gurore në malin e Dajtit*

Me gjithë urdhrin e firmosur nga kryeministri i vendit në vitin 2006, dhe deklaratat e Ministrisë së Mjedisit në vitin 2010, që kërkojnë heqjen e Erzenit nga lista e lumenjve të shfrytëzueshëm, firmat e ndërtimit jo vetëm që nuk janë ndaluar, por kanë rritur ritmin e

<sup>143</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të PK të Dajtit, Tiranë 2004*, fq. 38. Anex 2.

punimeve, duke vënë në rrezik shpeshherë dhe jetën e banorëve, si në rastin e lagjes Tagan të fshatit Petrelë.

Gërmimi pa kriter i tabanit të shtratit ka nxitur rrëshqitjet, sidomos gjatë sezonit të reshjeve, kur dhe niveli i lumit rritet ndjeshëm.



*Fig. IV.7 Shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumit të Erzenit*

Një gurore gjendet në fshatin Pashkashesh të komunës Bërzhitë, ndërsa në fshatin Dobresh zhvillon aktivitetin një subjekt për prodhim inertesh dhe asfalti. Në këtë sektor të ekonomisë janë punësuar rreth 30 persona nga komuna Bërzhitë, ndërsa në komunën Dajt 56 punëtorë.

Punësimi i banorëve të komunave në këtë sektor të ekonomisë është me interes për ekonominë familjare dhe të komunave, por është e nevojshme që të ekuilibrohet ky aspekt me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, pasi punimet minerare kanë dëmtuar biodiversitetin, cilësinë e ujit dhe të ajrit, infrastrukturën, objektet natyrore dhe kulturore që paraqesin interes të veçantë për zhvillimin e turizmit, kanë shkaktuar ndotje akustike etj. Gjithashtu, ato rrezikojnë të shkaktojnë edhe dëme të tërthorta, si emetimet toksike në atmosferë, ujë, tokë.

Sot është domosdoshmëri gjetja e burimeve të tjera për lëndët e para (zhavorre, rërë) që i nevojiten Tiranës për ndërtimet urbane dhe zgjerimin e infrastrukturës për një periudhë afatgjatë 15-20 vjeçare. Bëhet fjalë për burime alternative e sidomos për shfrytëzimin e agregateve shkëmbore, me synim të mbrojtjes së shtretërve të lumenjve të cilët janë dëmtuar tej mase.

### **IV.3 Artizanati dhe agroindustria sipas komunave**

Prodhimet artizanale të llojeve dhe materialeve të ndryshme janë shumë të kërkuara në vendet turistike dhe mund të jenë një burim shumë i mirë të ardhurash për banorët e këtyre zonave. Oferta natyrore e pasur me lëndë të parë si dru, lesh, gurë dekorativë etj. si dhe tradita në këtë sektor, janë premisa të rëndësishme për zhvillimin e artizanatit në komunat Dajt dhe Bërzhitë.

### IV.3.1 Artizanati

Ekziston një traditë e mirë në punimet e artizanatit kryesisht të punimit të drurit, qilimave etj. Është e rëndësishme të nxiten artizanët të rikthehen tek tradita, të rinovojnë veglat e tyre të punës, të shikojnë mundësinë e organizimit në shoqata apo bashkësi për ta patur me të lehtë daljen në treg me prodhime tipike të zonës, për të gjetur partnerë tregtarë e për të lidhur kontrata etj. Organizimi i panairove të prodhimeve artizanale nga krahina do të promovonte prodhimin artizanal vendas dhe do ti ndihmonte banorët për shitjen e këtyre produkteve.

Artizanati mund të stimulohet me anë të ngritjes së punishteve të vogla të qëndrueshme, punimeve të drurit, të kashës etj. Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk kërkon investime fillestare të mëdha, ndërkohë që përfitimet financiare janë përgjithësisht të larta. Gjithashtu do të rritej dhe punësimi i grave.



Fig. IV.8 Punime artizanale në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Ekziston një traditë shumë e mirë dhe lëndë e parë për zhvillimin e artizanatit në të dy komunat, por që duhet mbështetur me investime e gjetje të tregjeve për shitjen e këtyre produkteve nga pushteti vendor.

### IV.3.2 Agroindustria



Fig. IV.9 Agropërpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale

Agroindustria është industria që merret me ruajtjen, përgatitjen e përpunimin masiv të produkteve bujqësore.

Sektori i agroindustrialisë në Shqipëri ka potenciale të mëdha zhvillimi. Vetëm në vitin 2009, qeveria vendosi subvencionimin e prodhimit në shkallë të gjerë të qumështit, si dhe

prodhimin e vajit të ullirit ekstra të virgjër. Në vitin 2010, qeveria vendosi subvencionimin e fermerëve të cilët mbjellin ullinj, agrume, drufrutore dhe vreshta. Kjo masë është e domosdoshme, pasi në këtë mënyrë agroindustria shqiptare mund të arrijë të konkurrojë në treg dhe madje të eksportojë produktet e veta. Investimet e bëra nga qeveria zënë 24%, ndërsa investimet individuale dhe të huaja përbëjnë 76% të investimeve të kryera në sektorin e agroindustrisë<sup>144</sup>.

*Një nga synimet kryesore të strategjisë së zhvillimit të bujqësisë në Shqipëri është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit<sup>145</sup>.*

- Rritja e prodhimit bujqësor dhe agro-industrial do të ndikojë në:
  - zhvillimin ekonomik të vendit;
  - uljen e papunësisë;
  - uljen e çmimeve të produkteve kryesore jetike që konsumohen nga popullsia;
  - ul varësinë e vendit nga importet.

#### IV.3.1.a Zhvillimi i agroindustrisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë

Pozita e favorshme gjeografike, kushtet klimatike, shumëllojshmëria e prodhimeve bujqësore e blegtorale, pasuritë e shumta ujore etj. përbëjnë bazën për ngritjen e disa ndërmarrjeve të agroindustrisë. Teknologjia e përdorur është përgjithësisht e vjetër, për rrjedhojë pjesa më e madhe e prodhimeve përpunohet në mënyrë artizanale (prodhimi i bulmetrave, përpunimi i ullirit, prodhimi i pijeve alkolike etj.)

Industria ushqimore ka kushte të mira për zhvillim, sidomos duke investuar në përpunimin dhe konservimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Në komunën e Dajtit ushtrojnë veprimtarinë e tyre 318 subjekte të biznesit të vogël dhe 55 subjekte të biznesit të madh, pra gjithsej 373 biznese. Nga këto vetëm 23 biznese i përkasin sektorit të agroindustrisë<sup>146</sup>.

Tabela IV.18 Ndërmarrjet agropërpunuese në komunën e Dajtit

Nr.	Emërtimi	Nr. i ndër.	Fshatrat ku gjenden
1	Fabrika të prodhimit të vajit të ullirit	2	Tufinë, Lanabregas
2	Fab. të prodh. të lëngjeve dhe pijeve alk.	2	Lanabregas
3	Prodhime brumi (furra buke, pastiç.)	8	Qesarakë (6), Tufinë (1), Lanabregas(1)
4	Prodhim vere	1	Qesarakë
5	Prodhim e ambalazhim uji	7	Lanabregas(5), Linzë(1), Qafmollë(1)
6	Prodhim e tregtim akulli	2	Lanabregas
7	Përpunim i kafesë	1	Tufinë
<b>Totali</b>		<b>23</b>	

Burimi: *Spektori i Tatim-Taksave-komuna Dajt*

<sup>144</sup> Vjetari statistikor 2011, Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

<sup>145</sup> Strategjia Ndër-Sektoriale e Zhvillimit Rural, (SKZHR), 2007-2013, fq.18.

<sup>146</sup> Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Dajt.

Në komunën e Bërzhitës përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale në përgjithësi bëhet në kushte apo ambiente familjare dhe nuk ekziston asnjë baxho për përpunimin e produkteve blegtorale apo fabrikë e përpunimit të produkteve bujqësore.

Gjenden vetëm disa furra buke dhe ato në fshatrat kryesore si Bërzhitë, Pëllumbas, Ibë e Sipërme. Fshatrat e tjerë furnizohen me bukë nga furrat më të afërta.

*Për zhvillimin e mëtejshëm të agro-industrisë në këto komuna është e rëndësishme që të merren disa masa si:*

- *të rritet kreditimi i bizneseve agro-industriale nga shteti e donatorë të huaj;*
- *të përkrahen me investime e asistencë teknike feramat bujqësore dhe blegtorale;*
- *ti kushtohet më shumë rëndësi kualifikimit të fuqisë punëtore;*
- *të përmirësohet infrastruktura e tregjeve dhe të garantohet mirëmbajtja e tyre;*
- *të përmirësohet higjiena duke ulur rrezikun e sëmundjeve të mbartura nga kafshët;*
- *të përmirësohet menaxhimi, ujitja dhe kullimi i tokës bujqësore;*
- *të përmirësohet marketingu i produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara;*
- *të rritet niveli dhe cilësia e teknologjisë, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe agropërpunuesve;*
- *të rritet cilësia dhe siguria ushqimore e produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara.*

Pozita e favorshme gjeografike, kushtet klimatike, shumëllojshmëria e prodhimeve bujqësore e blegtorale, pasuritë e shumta ujore etj. përbëjnë bazën për ngritjen e disa ndërmarrjeve të agroindustrisë në këto komuna.

Prodhimi i vajit të ullirit, për konsum vetjak, por dhe për treg, mund të zgjerohet dhe në disa fshatra si Linzë apo Priskë (në komunën Dajt), si dhe në fshatrat Bërzhitë, Pëllumbas apo Ibë e Sipërme (në komunën Bërzhitë), ku numri i ullinjve është relativisht i lartë.

Ngritja e baxhove për përpunimin e produkteve blegtorale është e mundur dhe do të sillte të ardhura të konsiderueshme për banorët e fshatrave Linzë, Shtishtufinë, Priskë, Lanabregas e Tujan të komunës Dajt, dhe kjo është e mundur dhe për fshatrat Bërzhitë, Ibë e Sipërme, Ibë e Poshtme, Kllojkë të komunës Bërzhitë.

Industria ushqimore ka kushte të mira për zhvillim, sidomos duke investuar në përpunimin dhe konservimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që janë të konsiderueshme në të dy komunat.

#### **IV.4 Aktivitete të tjera të sektorit sekondar**

Duhet të theksojmë se ekonomia shqiptare, e për rrjedhojë dhe e komunave të marra në studim, paraqet një shkallë të lartë informaliteti. Kjo është majft e dukshme sidomos në fushën e bar-restoranteve, ku numri i tyre është në rritje, por dhe në degë të tjera që i përkasin sektorit sekondar të ekonomisë.

Aktivitete të tjera të sektorit sekondar, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën Dajt, janë rreth 12 ndërmarrje të shpërndara sipas strukturës së mëposhtme<sup>147</sup>:

---

<sup>147</sup> *Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Dajt.*

Tabela IV.19 Shpërndarja e ndërmarrjeve të sektorit sekondar

Komuna Dajt	Nr.ndërmarrjeve	Fshatrat ku gjenden
Punime mermeri	3	Shtish-Tufinë
Punime guri	2	Qesarakë, Lanabregas
Punime druri	7	4 Tufinë, 2 Qesarakë, 1 Linxë
<b>Totali</b>	<b>12</b>	

Burimi: Sektori i Tatim-Taksave-komuna Dajt



Fig. IV.10 Punime mermeri në një punishte në Tufinë, komuna Dajt

Në komunën Bërzhitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre 4 punishte të vogla, 2 për punime druri, 1 punime hekuri (kangjella, dyer etj.), dhe një jorganpunues. Kryesisht janë biznese familjare dhe nuk i kalojnë 3-4 persona të punësuar.

Tabela IV.20 Shpërndarja e ndërmarrjeve të sektorit sekondar

Komuna Bërzhitë	Nr.ndërmarr.	Fshatrat ku gjenden
Punime druri	2	Bërzhitë, Dobresh
Punime hekuri	1	Bërzhitë
Jorganpunues	1	Ibë e Sipërme
<b>Totali</b>	<b>4</b>	

Burimi: Sektori i Tatim-Taksave-komuna Bërzhitë

Si përfundim mund të themi se pesha që zë sektori sekondar në komunën Dajt është më e lartë se në komunën Bërzhitë. Kjo i dedikohet kryesisht nivelit më të lartë të zhvillimit social-ekonomik të saj, por dhe afërsisë me qytetin e Tiranës.

Për shkak të mundësive të mëdha që paraqesin të dy komunat, në të ardhmen, mund të rritet numri i ndërmarrjeve që i përkasin sektorit sekondar. Kthimi i emigrantëve dhe investimi në këtë sektor do të ishte njëra rrugë e rritjes së numrit të ndërmarrjeve të sektorit sekondar dhe rruga tjetër do të jetë ajo e zhvendosje së bizneseve të tilla në këto komuna, të afërta me tregun kryesor, Tiranën, për shkak të lehtësirave që kanë në fushën e tatim-taksave, të pagave më të ulëta të të punësuarve etj.



#### **IV.6. Turizmi, degë e rëndësishme e me perspektivë për të ardhmen e të dy komunave**

Turizmi është një nga sektorët e ekonomisë që po zhvillohet me ritme të shpejta në Shqipëri dhe një nga prioritetet e qeverisë në rrugën e zhvillimit ekonomik të vendit. Më 14 maj të vitit 2007, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë, miratoi ligjin nr.9734 “Mbi Turizmin”, ku pasqyroheshin principet kryesore të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm.

Rritja e interesit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ekoturizmin dëshmon për një nivel më të lartë të ndërgjegjësimit të shoqërisë ndaj cilësisë së mjedisit natyror dhe ndikimit të turizmit në të. Turizmi mund të rrisë punësimin dhe të ardhurat e një lokaliteti ose rajoni.

Komuna e Dajtit dhe e Bërzhitës ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit. Sfidat për menaxhuesit dhe planifikuesit e turizmit në këto komuna lidhen me krijimin e kushteve për rritje të përfitimeve ekonomike, mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, përmirësim të cilësisë së jetës dhe njëkohësisht zvogëlim të kostove mjedisore.

##### ***V.6.1 Potencialet turistike të komunës Dajt***

Gjatë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri, vetizolimi i shtetit komunist, ndalimi i lëvizjes së lirë të njerëzve brenda dhe jashtë vendit, si dhe politikat e gabuara ekonomike që u ndoqën gjatë asaj periudhe, duke i dhënë rëndësi zhvillimit të industrisë e kryesisht industrisë së rëndë, bëri që sektori terciar i ekonomisë, e veçanërisht turizmi, të mos kishte peshë të rëndësishme në ekonominë e vendit.

Pesha e sektorit terciar në ekonominë e Shqipërisë, pas vitit 1990, ka ardhur duke u rritur. Kalimi nga një ekonomi e centralizuar, me prioritet zhvillimin e industrisë së rëndë, në ekonominë e tregut, solli prishjen e raporteve tradicionale të sektorëve kryesorë të ekonomisë. Kontributi i këtyre sektorëve në prodhimin e përgjithshëm kombëtar të vendit, evidenton rritjen më të madhe dhe më të shpejtë, të sektorit terciar të ekonomisë.

<sup>148</sup>Dominimi i sektorit terciar, sjell një menaxhim më racional e më të plotë të burimeve humane e fizike të hapësirave gjeografike në përgjithësi e atyre rurale e periurbane në veçanti.

Dhe në komunat e marra në studim ky sektor ka rritur peshën dhe rolin e tij në ekonominë e tyre. Në të dy komunat, në vite, ka ardhur duke u rritur numri i bar-restoranteve, komplekseve e hoteleve. Është rritur dhe numri i të punësuarve. Fillimisht, të punësuarit në këtë sektor vinin nga Tirana, ndërsa në vitet e fundit është rritur numri i të punësuarve nga fshatrat e të dy komunave. Kjo lidhet dhe me ndryshimet që kanë ndodhur në këto komuna, ku një pjesë kanë emigruar jashtë vendit dhe kanë fituar eksperiencën e duhur, por dhe janë arsimuar në shkollën profesionale të hoteleri-turizmit, në Tiranë, pasi nuk ekziston asnjë shkollë e tillë profesionale në asnjërën prej komunave të marra në studim.

Një nga mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të komunës Dajt e Bërzhitë është zhvillimi i turizmit, pasi në territoret e tyre gjenden shumë monumente natyrore e historike që përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit.

---

<sup>148</sup> Belba A., *Gjeografia e sektorit terciar në rajonin e Korçës*, Disertacion doktrate, fq.5

#### V.6.1.a. Monumenetet natyrore në komunën Dajt

Në komunën Dajt një nga zonat më turistike dhe më të frekuentura është Parku Kombëtar i Dajtit. Ky park ndodhet afërsisht 25 km në verilindje të kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës, dhe 50 km nga aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza”. Konsiderohet si “Ballkoni natyror i Tiranës” pasi është një zonë shumë e frekuentuar nga pushuesit ditor. Është shpallur Zonë e Mbrojtur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 402, në datën 21.06.2006, me një sipërfaqe 29384.2 ha dhe administrohet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Tiranë.

Në lartësinë 1000 m, në shpatin perëndimor të malit të Dajtit, ndodhen fragmente të terracës detare, të formuar nga valët e detit helvecian, me një gjatësi 2 km dhe gjerësi 600-800 m. Kjo terracë është e rrethuar nga livadhe e pyje ahu.

Në malin e Dajtit kemi edhe praninë e disa bimëve si: *Lolio - cynosuretum*, *Salvia officinalis* - *Satureja Montana*, *Arbutus unedo* - *Erica arborera*, *Moltkietum petraea* etj. Ndër bimët e rralla endemike përmendim praninë e *Ramona Serbicës*. Mjaft e pasur dhe interesante është edhe bota shtazore e parkut e cila përbëhet nga lloje të ndryshëm gjitarësh, shpendësh, shqiponjash dhe zvarranikësh. Tek gjitarët përmendim: derri i egër (*Sus scrofa*), ujku (*Canis lupus*), baldosa (*Meles meles*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), ariu etj. Gjitarë të tjerë janë: ketri, gjeri (*Glis glis*), kunadhja dhe macja e egër. Shpendët janë kryesisht të tipit harabelorë si: trishtili, qukapikët, grifsha dhe mëllenja<sup>149</sup>.

Prania e monumenteve të natyrës dhe të kulturës, zhvillimi i ekskursioneve nga pushuesit ditorë, bërja e skive, alpinizmit si dhe sporteve ujore e bëjnë këtë park shumë të çmuar dhe me shumë vlerë për turistët. Në bazë të vendimit të KM, nr 402, dt 21.06.2006, në këtë park janë shpallur monumente të natyrës: - Terraca e vjetër detare në malin e Dajtit, - Shkalla e Tujanit në luginën e lumit të Tiranës, - Shpella e Zezë (Shpella e Pëllumbasit) në grykën e Skoranës, Rrapi i Priskës.

Ekzistojnë tre përfitime të veçanta me vlera të rëndësishme që PKD mund t’u ofrojë vizitorëve dhe banorëve vendas në mënyrë të barabartë për shkak të vlerave të tij të veçanta dhe lehtësisë së ardhjes nga metropoli i Tiranës, të cilat janë:

- *Përfitimi ekonomik* – identiteti i fortë i zonës, gama e burimeve të mundshme argëtuese të përshtatshme për zhvillim, që ju siguron si vizitorëve vendas dhe atyre të huaj një largim nga zonat urbane, siguron mundësi të reja për zhvillimin e bizneseve duke i ofruar vizitorëve shërbime ose prodhime.
- *Përfitimi edukues* – diversiteti ekologjik i habitateve dhe specieve brenda territorit të Parkut, sëbashku me interesin e tij kulturor siguron një pasuri të mundësive për studim dhe kërkim. Këto mund të serviren për të siguruar një eksperiencë të pasur mësimi nëpërmjet mënyrave interpretuese për turistët, studentët dhe banorët vendas. Kjo arrihet nëpërmjet edukimit dhe vlerës së shtuar që mbrojtja e mjedisit do të sjellë.
- *Përfitimi social dhe shpirtëror* – zonat e hapura dhe vendet e qeta të PK do të bëjnë të mundur që shumë njerëz të gjejnë kënaqësinë, shplohjen dhe qetësinë<sup>150</sup>.

<sup>149</sup>Mecaj N. “Veçoritë e relievit dhe harta gjeomorfologjie e vargut malor Krujë- Dajt”. Studime Gjeografike Nr. 13. Tiranë, 2000.

<sup>150</sup> IDA, *Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit*, Aneks 3. Tiranë 2004. fq.4

Ndërtimi i teleferikut “ Dajti Expres”, ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve në Parkun Kombëtar të Dajtit.



Fig.IV.11 Teleferiku Dajti Expres

Zonat më të rëndësishme për tu vizituar janë Tarraca e Dajtit, kanionet e Shkallës, kanionet e Tujanit, Shpella e Zonjës në Brar etj.




Fig. IV.12 Imazhi Satelitor dhe kufijtë e PKD<sup>151</sup>

<sup>151</sup> Plani i menaxhimit i Parkut Kombëtar të Dajtit, Raporti Përfundimtar, IDA, 2004. fq 2

Tabela IV.21 Masat që duhen marrë për mbrojtjen e Parkut Kombëtar të Dajtit<sup>152</sup>

<p><b>1. Përmirësimi i ruajtjes së biodiversitetit, duke e vënë theksin te llojet e kërcënuara</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Habitata dhe biotope të veçanta për gjitarë të përfshihen në statusin e mbrojtjes ligjore.</li> <li>- Përmirësimi i mbarështimit të habitatit për llojet e rralla dhe të kërcënuara, veçanërisht për mishngrënësit e përhapur, ruajtja e sëcilëve kërkon mbarështimin e territoreve të gjera jashtë zonave të mbrojtura .</li> <li>- Themelimi i një skeme kompensimi për dëmet në ekonomitë e fermerëve brenda hapësirës së parkut, që shkaktohen nga mishngrënësit e përhapur.</li> </ul>
<p><b>2. Mirëmbajtja dhe rivlerësimi i habitatit dhe diversitetit të landshaftit</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ruajtja dhe rehabilitimi i pyjeve fletorë të përzier, veçanërisht dushkajat dhe pyjet e gështenjës.</li> <li>- Ruajtja dhe rehabilitimi i ahishteve përgjatë kufirit lindor të parkut nga Fekeni deri në Qafë Shtamë.</li> <li>- Mirëmbajtja e strukturës dhe kultivimit të tokës të landshaftit rural agrar në brendësi të territorit të parkut.</li> <li>- Rehabilitimi i landshaftit përreth gurores (Qafë Priska).</li> </ul>
<p><b>3. Themelimi i një sistemi kërkimi dhe monitorim mbi faunën dhe mbarështimin</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryerja e kërkimeve të mëtejshme mbi grupet e njohura shumë pak dhe ekologjinë e llojeve dominantë.</li> <li>- Inventarizimi i mishngrënësve të përhapur, lakuriqët e natës e folezimin dhe shpendët ujorë, si dhe insektet ujore.</li> <li>- Ndërtimi i hartave të habitatit dhe monitorimi.</li> <li>- Fillimi i kooperimit midis administratës së parkut dhe institutive të specializuara kombëtare të kërkimit të lidhura me kërkimet mbi biodiversitetin dhe monitorimin e tij.</li> </ul>
<p><b>4. Rritje e profesionalizmit të personelit mbi mbarështimin e faunës së egër</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shtimi i personelit të kualifikuar që merret me ruajtjen e faunës së egër dhe administrimin e parkut.</li> <li>- Trainimi i personelit vendas (personeli i parkut) mbi mbarështimin dhe ruajtjen e faunës së egër.</li> </ul>
<p><b>5. Shfrytëzim i qëndrueshëm i resurseve natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndalim i prerjes së drurëve brenda hapësirës së parkut, veçanërisht në zonat e ruajtura</li> <li>- Kontroll dhe disiplinim i kullotjes në brendësi të hapësirës së parkut.</li> <li>- Kontroll i gjuetisë brenda hapësirës së parkut.</li> <li>- Kontroll aktivitetit minerar brenda zonës së parkut (Guroret).</li> <li>- Kontroll i ndotjes urbane (mbetjet e ngurta dhe të lëngshme) brenda hapësirës së parkut.</li> <li>- Kontroll dhe disiplinim i aktiviteteve çlodhëse dhe turistike brenda zonave që janë caktuar për një qëllim të tillë.</li> <li>- Kontroll i punimeve për kultivimin e tokës me qëllim që të jenë në përputhje me objektivat e mbarështimit të Parkut.</li> <li>- Formulimi i një programi për kontrollin dhe parandalimin e zjarreve</li> </ul>

<sup>152</sup> International Development Association (IDA), *Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Dajtit*, Tiranë 2004 fq.34

<b>6. Marrja përsipër i edukimit mjedisor dhe turistik, në ruajtjen e faunës së egër</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Nxitja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të publikut mbi vlerat e natyrës dhe biodiversitetit në hapësirën e Parkut Kombëtar të Dajtit.</li><li>- Nxitja e mbarështimit të faunës së egër duke involvuar komunitetet dhe përdoruesit lokal.</li><li>- Nxitja e ekoturizmit dhe bird-watching si alternativa kundër përndjekjes dhe vrasjes së kafshëve.</li></ul>
--	---

Brenda PKD, *Rezervuari i Bovillës* dhe një zonë rrethuese përreth saj, është zonuar si një Rekreacionit Natyror (RZ 2). Rezervuari i Bovillës cilësohet mjaft i ndjeshëm dhe i ekspozuar nga veprimtaria e shoqërisë njerëzore prandaj janë shpallur rregulla strikte dhe vendime rreth përdorimit të tij.

Zhvillimi i ndjeshëm i rezervuarëve të ujit të pijshëm për aktivitete turistike ndërmerret nga mijra organizma të tilla të ujit në të gjithë Europën dhe në Botë, pa krijuar ndonjë problem në cilësinë e ujit të pijshëm. Në të vërtetë, shumë nga rezervuarët e rinj projektohen me qëllim të dyfishtë të rekreacionit dhe furnizimit të ujit të pijshëm.

Ekzistojnë apo jo vendime, është mjaft e besueshme që ky rezervuar do të fillojë të tërheqë një numër në rritje të vizitorëve që kërkojnë zona të reja të argëtimit dhe të eksperiencave në natyrë. Kohët e fundit është ndërmarrë ndërtimi i disa pjesëve të rrugës për tek rezervuari duke inkurajuar dhe mundësitë për shfrytëzimin e tij për rekreacion. Prandaj, parashikohet që në të ardhmen, autoritetet ose do të duhet të shpenzojnë më shumë kohë dhe perpjekje për të ndaluar njerëzit për në zonën e rezervuarit, ose të njohin që disa aktivitete janë të pranueshme duke siguruar që ato të menaxhohen dhe kontrollohen mirë.

Baret dhe restorantet e poseduara nga vendasit dhe ofrimi i akomodimit të thjeshtë të ofruar nga familjet duhet të mbeshtetet në fshatrat përreth dhe larg buzës së ujit.

Është e nevojshme që aktivitetet brenda zonës së rezervuarit të kufizohen në krijimin e shtigjeve për ecje në natyrë, ngarje biçikletash dhe vëzhgim natyre, kanoe të tipit kanadez dhe varka të vogla me vela në rezervuar do të ishin të pranueshme me stausin e ujit, ndërsa çdo aktivitet notimi do të ndalohej menjëherë. Vizitorët në zonë mund të arrijnë komunitetet e ndryshme dhe objektet natyrore përreth rezervuarit me varka si taksi uji me energji diellore.

Rezervuari i Bovillës ofron mundësi të mira për të zhvilluar aktivitete të ekoturizmit.



Fig. IV.13 Rezervuari i Bovillës<sup>153</sup>

<sup>153</sup> Marrë nga interneti

Vizitat në malin e Dajtit po vijnë vazhdimisht duke u shtuar. Është vlerësuar që aktualisht rreth 150.000 persona në vit kryejnë një vizitë në malin e Dajtit. Parashikimet tregojnë që ky numër do të rritet deri në gjysëm milioni në vitin 2015<sup>154</sup>.

### **Shkalla e Tujanit**

Gjendet në luginën e lumit të Tiranës. Përfaqëson një kanion rreth 1.2 km të gjatë, 20-50 m të gjerë dhe 200-300 m të thellë, me guva e shpella karstike të paeksploruara. Përgjatë saj kalonte rruga antike Tiranë-Dibër e Madhe dhe më tej. Ka vlera gjeomorfologjike, didaktike, kulturore e artistike.



*Fig. IV.14. Pamje nga Shkalla e Tujanit*

#### *V.6.1.b Monumentet kulturore*

Në territorin e komunës gjenden shtatë monumente kulture, të cilat mbrohen nga shteti. Ato janë:

- ❖ Kalaja e Dajtit rrëzë malit të Dajtit
- ❖ Kalaja e Tujanit në fshatin Priskë - Shtish – Tufin
- ❖ Ura e Brarit, fshati Brar
- ❖ Rrënojat e Kishës Sh. Mëri, fshati Linxë - Surrel
- ❖ Banesa e Sulejman Metës, (Bajram Ukës) (sot pronë shtetërore), fshati Brar
- ❖ Banesa e Sinan Bonacës, fshati Priskë e Madhe
- ❖ Banesa e Qamil Çullhaj, fshati Surrel Priskë

---

<sup>154</sup> *Plani i menaxhimit i Parkut Kombëtar të Dajtit, Raporti Përfundimtar, IDA, 2004. fq 28*

### ***Kalaja e Dajtit***

Kalaja e Dajtit është shpallur monument kulture i kategorisë së parë më datë 15.01.1963, me nr.vendimi 6 nga Rektorati i Universitetit Shtetëror. E ndodhur në komunën Dajt me një sipërfaqe prej 1.12 ha, ajo bën pjesë në fushën e arkeologjisë dhe qytetare ilire të periudhës së antikitetit të vonë, në vitet 600 e.s. Me një distancë nga Tirana prej 25 km, Kalaja e Dajtit ndodhet në shpatin perëndimor të malit të Dajtit, mbi një majë në të djathtë të rrugës që të çon nga King Parku ose Ish-Kampi i Punëtorëve. Duke qenë në një lartësi rreth 1200 metra mbi nivelin e detit, prej saj mund të vrojtohet një horizont shumë i gjerë që përfshin fushën e Tiranës, vargjet kodrinore të saj deri në bregdet.

Kalaja e Dajtit, duke qenë e vendosur brenda Parkut Kombëtar të Dajtit, përbën një ndër elementët kryesorë të tij, i cili ka si domosdoshmëri të bëhet i vizitueshëm për turistët.



*Fig. IV.15* Fragmente të murit të Kalasë së Dajtit

### ***Kështjella ose kalaja e Tujanit***

Kjo kështjellë ndodhet në afërsi të fshatit Tujan. Nga kjo pikë shihet mjaft mirë “ Shkalla e Tujanit”, që ndan malin e Brarit nga ai i Tujanit, në të cilën kalonte dhe rruga e vjetër e Arbrit. Kodra ka formë konike dhe shpate mjaft të pjerrta. Vetëm në veri ajo lidhet me kodrën fqinje me një qafë të ulët. Ana lindore që është më e larta përbëhet nga një brez shkëmbor, duke krijuar një mbrojtje natyrore, që ulet gradualisht drejt perëndimit.

Ndërtuesit e kalasë kanë shfrytëzuar veçoritë mbrojtëse të terrenit duke lënë anën lindore të pa rrethuar, ndërsa në veri dhe në jug muret janë ndërtuar mbi brezin shkëmbor. Fortifikimi ka planimetri drejtkëndore me përmasa 160 x 190 m, i cili ndahet në tre pjesë prej muresh gjatësorë që kanë drejtim veri-jug.

Në brendësi të mureve rrethuese të fortifikimit janë vërejtur gjurmë banesash me mure 0.8 m të gjera si dhe një sterë uji me diameter 3 m. Teknika e ndërtimit të mureve dhe qeramika e ndërtimit e datojnë fortifikimin në shek. IV-VI.

### **Ura e Brarit**

Është një ndër urat e periudhës osmane pak kilometra larg Tiranës. Ndodhet nën rrugën automobilistike që lidh Tiranën me Zall-Bastarin. Dikur kjo luginë lidhte Tiranën me Dibërën e Madhe. Ky monument përbën përbën gjithashtu një destinacion potencial turistik falë arkitekturës dhe pozicionimit të saj



*Fig. IV.16 Ura e Brarit*

Me ajrin e pastër, bimësinë e pasur, liqenet e vegjël malorë, lokalet me pamje piktoreske, pyjet, kalatë e lashta, ndërtimet tradicionale etj., komuna Dajt po tërheq gjithnjë e më shumë të apasionuarit pas turizmit malor, sidomos turistë të huaj. Gjate verës Dajti vizitohet nga rreth 600 pushues në ditë, nga të cilët 70% e tyre janë turistë të huaj. Parku Kombëtar i Dajtit frekuentohet nga vizitorë ditorë, ndërsa ofron mundësi akomodimi edhe për turistët e huaj. Llojet e aktiviteteve që praktikohen tani në verë këtu janë eskursionet, sportet e ajrit dhe alpinizmi, ndërsa në stinën e dimrit turistët vijnë edhe për ski.

### **V.2 Potencialet turistike të komunës Bërzhitë**

Pesha e sektorit terciar në ekonominë e Shqipërisë, pas vitit 1990, ka ardhur duke u rritur. Kalimi nga një ekonomi e centralizuar, me prioritet zhvillimin e industrisë së rëndë, në ekonominë e tregut, solli prishjen e raporteve tradicionale të sektorëve kryesorë të ekonomisë. Kontributi i këtyre sektorëve në prodhimin e përgjithshëm kombëtar të vendit, evidenton rritjen më të madhe dhe më të shpejtë, të sektorit terciar të ekonomisë.

Dominimi i sektorit terciar, sjell një menaxhim më racional e më të plotë të burimeve humane e fizike të hapësirave gjeografike në përgjithësi e atyre rurale e periurbane në veçanti.

Dhe në komunat e marra në studim ky sektor ka rritur peshën dhe rolin e tij në ekonominë e tyre. Në të dy komunat, në vite, ka ardhur duke u rritur numri i bar-restoranteve, komplekseve e hoteleve. Është rritur dhe numri i të punësuarve. Fillimisht, të punësuarit në këtë sektor vinin nga Tirana, ndërsa në vitet e fundit është rritur numri i të punësuarve nga fshatrat e të dy komunave. Kjo lidhet dhe me ndryshimet që kanë ndodhur në këto komuna, ku një pjesë kanë emigruar jashtë vendit dhe kanë fituar eksperiencën e duhur, por dhe janë



arsimuar në shkollën profesionale të hoteleri-turizmit, në Tiranë, pasi nuk ekziston asnjë shkollë e tillë profesionale në asnjërën prej komunave të marra në studim.

Një nga mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të komunës Dajt e Bërzhitë është zhvillimi i turizmit, pasi në territoret e tyre gjenden shumë monumente natyrore e historike që përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit.

### ***V.2.1 Monumentet natyrore në komunën Bërzhitë***

Një nga potencialet natyrore më të mëdha e të rëndësishme, por jo vetëm për komunën Bërzhitë por dhe për Shqipërinë është Shpella e Zezë, e njohur dhe si shpella e Pëllumbasit.

Shpella e Zezë ndodhet 25 km në juglindje të Tiranës, në krahun e majtë të grykës së Skoranës, në kuotën 600 m mbi nivelin e detit ose rreth 300 m mbi shtratin e lumit Erzen<sup>155</sup>.

Hyrja e shpellës është mjaft e madhe, rreth 6-7 m e gjerë dhe po kaq e lartë. Galeria kryesore e saj është 360 m e gjatë, por ajo ka edhe degëzime të tjera anësore, ende të paeksploruara plotësisht, që tregojnë se shpella duhet të jetë më e madhe, ndoshta me disa kate (shih pamjet në plan dhe prerjet vertikale). Në shpellë nuk mungojnë sallat e mëdha mbi 30 – 40 m të gjëra e të gjata dhe mbi 20 - 30 m të larta. Ambjentet e saj janë të mbushura me konkrecione kalciti me bukuri mahnitëse, stalaktite dhe stalagmite, kollona me diametër mbi 2 m, vello dhe ujëvara të ngurta, perla të shpellave etj. Procesi i formimit të konkrecioneve vazhdon edhe aktualisht: prejëtavanit pikon vazhdimisht ujë, që në dysheme ka formuar liqene të vogla, që ia shtojnë bukurinë.

Të dhënat tregojnë se shpella është mjaft e vjetër. Ajo përfaqëson zgavrën e burimit të dikurshëm të Pëllumbasit, që dilte në buzë të shtratit të Erzenit, i cili ishte shumë më lart se pozicioni aktual i tij. Aktualisht ky burim del shumë më poshtë ( rreth 300 m) në buzë të shtratit të sotmë të Erzenit.

Shpella e Zezë është formuar nga procesi i karstit, pra si rrjedhim i tretjes së ngadalshme gjatë miliona vjetëve në ujë e shkëmbinjëve gëlqerorë. Kjo ka bërë që në të të ruhen gjurmë të evenimenteve kryesore të evolucionit të kores tokësore, të botës së gjallë dhe të jetës humane. Ajo formon një ekosistem shumë interesant nëntokësor karstik me botë shumë të pasur të gjallë.

Eksplorimet e kryera në vitin 1995, së bashku me Grupin Speleologjik të Francës (Itali) treguan se shpella përbën një sensasion të madh shkencor për paleontologjinë dhe prehistorinë e vendit tonë<sup>156</sup>.

Ndryshe nga simotrat evropiane, Shpella e Zezë ka edhe mbetje të kulturës humane, të cilat, sipas konfirmimit të Insitutit të Arkeologjise te Akademise tone te Shkencave, u përkasin periudhës nga Paleoliti në Mesjetën e Hershme. Streha e shpellës, korridori i gjatë, salla qendrore dhe pjesërisht degëzimet formojnë një sipërfaqe horizontale me depozitime të trasha të veprimtarisë së njeriut të shpellave, që flasin në mënyrë të mjaftueshme për këtë fazë njohjeje. Ndër gjetjet e para dhe me vlerë të veçantë janë: disa fragmente stralli, që i përkasin paleolitit të vonshëm; disa fragmente të enëve prej balte, nga të cilat më të hershmet i

---

<sup>155</sup> Qiriaz P., Sala S., Cara G., *Monumentet e natyrës të qarkut të Tiranës*, Tiranë 2004 fq. 26-27

<sup>156</sup> Qiriaz P., Sala S., *Monumentet e natyrës të Shqipërisë*, Tiranë 2006, fq.123.


përkasin neolitit, pra 7000 – 3000 vjet para erës sonë; gjetje të epokës së bronzit dhe të hekurit, me moshë afërsisht 2000-500 vjet p.e. sonë.

Të gjitha këto gjetje arkeologjike, krejt të reja për epokën që përfaqësojnë, gjenden në një zonë krejtësisht të re dhe të panjohur deri tani. Këtu qëndron edhe vlera e tyre shkencore e shumëfishtë. Me zbulimin e vendbanimit shpellor të Shpellës së Zezë, jo vetëm bëhet i njohur zhvillimi i kulturave prehistorike në zonën qendrore të vendit, por krijohet mundësia për të studjuar edhe lidhjet e raportet midis kulturave prehistorike të Korçës (Shqipëria Juglindore) me kulturat e zonave veriore e verilindore të vendit tonë.

Shpella është laborator i vërtetë natyror, ku janë zhvilluar e zhvillohen procese të shumta gjeografike, gjeologjike, kimike, fizike dhe biologjike:

Me përmasat e saj (360 m e gjatë, me koridore dhe sallat e shumta deri në 10 - 15 m të gjera dhe 15 - 45 m të larta), që nuk janë përfundimtare, dhe me mjediset e mbushura me mikroforma të shumta të relievit nëntokësor me stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë dhe vlera të veçanta turistike<sup>157</sup>. Edhe me përmasat e njohura deri tani dhe bukuritë e saj natyrore i plotëson të gjitha kushtet për një shpellë turistike:

- Shpella është e mbushur me konkrecione të shumta kalciti me bukuri mahnitëse;
- Gjetjet humane dhe paleontologjike e shumëfishojnë interesin turistik;
- Gjendet në *grykën e Skoranës*, që për nga bukuritë e peisazhit dhe të formës në trajtën e një kanioni dhe të mënyrës së formimit të saj, përbën një objekt tjetër me rëndësi të madhe turistike;



<sup>157</sup> Qiriazhi P., Sala S., Cara G., *Monumentet e natyrës të qarkut të Tiranës*, Tiranë 2004 fq. 26-27

Fig. IV.17 Pamje nga Shpella e Zezë (Pëllumbasit)<sup>158</sup>

Në këtë zonë ka dhe park gjuetie për zhvillimin e sportit të gjuetisë, që ka tërhequr gjuetarë nga vende të ndryshme.

Pikë tjetër atraktive për turistët mund të jetë dhe burimi i Skoranës si edhe lumi Erzen. Në komunën Bërzhitë janë ndërtuar shumë restorante me gatimet e zonës si edhe qendra argëtimi për stinën e verës, ndërtime këto që thithin shumë vizitorë.

Zhvillimi i mëtejshëm i formave të ndryshme të turizmit shihet si një prespektivë dhe si një prioritet për zhvillimin ekonomik të zonës. Janë duke u ndërtuar fshatra turistike të parametrave bashkëkohore dhe të cilësisë së lartë.



Fig. IV.18 Pamje nga lumi i Erzenit<sup>159</sup>

Në qoftë se rrugët do të përmirësohen, këto gryka ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit. Një kujdes i veçantë nevojitet të tregohet për grykën e Skoranës (me jugorja), ku ekzistojnë shumë shpella, njëra nga të cilat është “Shpella e Zezë”.

Ujëmbajtësi ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit të peizazhit, çlodhjes dhe qetësisë, sporte ujore (not, shëtitje me varkë, peshkim).

Në këtë grykë ka edhe shumë objekte të tjera natyrore që mundësojnë aplikimin e aktiviteteve të tjera turistike si eskursione turistike, alpinizëm në thepisjet e shumta të shpateve, fluturimet ajore nga lartësitë e sheshta të kreshtës së malit të Pashkasheshit, që ngrihet mbi këtë grykë, vozitje me barka të vogla gome në ujërat e Ezenit etj.

Të gjitha këto mundësojnë kthimin e gjithë zonës së komunës së Bërzhitës në një qendër turistike, ku mund të investohet për ndërtimin e hoteleve, bareve, restoranteve dhe objekte të tjera të biznesit turistik.

Shpella ndodhet pranë qendrave të mëdha të banuara: Tirana, Durrësi, Elbasani etj, që njëkohësisht janë edhe qendrat më të mëdha ekonomike, tregëtare, kulturore, shkencore etj. Ajo ndodhet afër akseve kryesore të transportit automobilistik: Koridori Tetë dhe hekurudhore; portit të Durrësit dhe aeroportoit të Rinasit. Të gjitha këto do t'i sigurojnë shpellës një klientelë turistike të vazhdueshme vendase dhe të huaj. Me të ardhurat e siguruar prej saj do të nxjerë shumë shpejt shpenzimet e investimit fillestar.

Është propozuar projekti që synon kthimin e Shpellës së Zezë në një muze të madh gjeologjiko-gjeografik, paleontologjik dhe arkeologjik.

<sup>158</sup> Marrë nga interneti

<sup>159</sup> Marrë nga interneti.

Njihet përvoja botërore për studimin, kthimin në muze dhe trajtimin turistik të shpellave karstike. Në botën e zhvilluar shpellat karstike mbrohen me ligj dhe përbëjnë objektet natyrore më të vizitueshme nga turistët. Jo shumë larg nga ne, në krahinën e Pulias (Itali) ndodhet shpella e Kastelanës, të cilën e vizitojnë mbi 500000 turistë në vit. Shpellat sigurojnë të ardhura të mëdha me investime të vogla fillestare. Shfrytëzimi turistik e ruan shpellën nga ndotja dhe shkatërrimi.

Rajoni ku ndodhet shpella: Tirana, Durrësi, Elbasani etj. kanë mundësi të mëdha për investime dhe menaxhime turistike.

Komuniteti vendor i zonës ku ndodhet shpella është shumë i interesuar për një shfrytëzim turistik të Shpellës së Zezë, nga i cili ajo do të ketë direkt fitime jo të vogla. Kështu që projekti do të ketë mbështetjen e komunitetit vendas.

*Projekti në aspektin e tij ekonomik do të ndihmojë në:*

- zhvillimin e turizmit në rajonin e Tiranës;
- do t'i japë shtytje ekonomisë së rajonit;
- do të stimulojë investimet në infrastrukturën e rajonit;
- do të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës së Bërzhitës, ku ndodhet shpella, duke ndihmuar në ngritjen e mirëqënies së popullsisë së kësaj komune;

Me vlerat e shumta, shpella ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të tokës dhe të prehistorisë, rezultatet e kërkimeve të të cilëve u bënë objekt diskutimi në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Speleologjisë, të mbajtur me sukses në Tiranë në Maj të vitit 1998. Të gjithë pjesëmarrsit, vendas dhe të huaj, evidentuan vlerat e veçanta të Shpellës së Zezë.

### V.3. Infrastruktura turistike

Infrastruktura turistike përfshin shërbimet bazë dhe lehtësirat e nevojshme dhe të mundshme për turistët gjatë udhëtimeve të tyre, siç janë rrugët, vendet e parkimeve, sinjalistika, uji i pijshëm, elektriciteti, mundësitë për akomodimin e tyre si dhe për organizimin e festave dhe aktiviteteve të ndryshme<sup>160</sup>.

*Tabela IV.22 Hotelet dhe resortet*

<b>Komunat</b>	<b>Hotele e resortet</b>	<b>Fshati ku gjenden</b>
Dajt	6	Linzë
Bërzhitë	3	Bërzhitë, Pëllumbas, Dobresh

Burimi: Zyra e statistikave, komuna Dajt dhe Bërzhitë

1. Belvedere Hotel, ndërtuar në vitin 2009, në sipërfaqen e Parkut Kombëtar. Në këtë hotel gjenden 24 dhoma, prej të cilave gjashtë dhoma çifte standart, 16 dhoma dyshe e dy dhoma luksi (speciale me hidromasazh). Gjenden dhe tri salla konferencash, një amfiteatër me 40-50 vende.
2. Kompleksi Chateau Linza, me katër yje. Ka 21 dhoma, 45 apartamente të pajisura me 2 dhoma fjetje, 2 banjo, sallë ndenjeje, kuzhinë dhe 2 ballkone, me 2 ballkone me pamje nga qyteti i Tiranës e mali i Dajtit. Gjenden 3 salla mbledhjeje.

<sup>160</sup> Plani i Zhvillimit të turizmit për komunat Petrelë, Bërzhitë e Baldushk, mbështetur nga ALCDF. fq.8.



Fig. IV.19 Hotel Belvedere<sup>161</sup>



Fig. IV.20 Kompleksi Chateau Linza

3. Hotel Panorama- një tjetër kompleks turistik, i ndërtuar në vitin 1995 e rikonstruktuar në vitin 2002. Ka 10 dhoma, dy restorante, një sallë konferencash e një sallë VIP.
4. Hotel Gold & Gold, në Qesarakë me tre yje e kapacitet akomodues 22 persona.
5. Kompleksi King Park i ndërtuar në vitin 2005, me tre yje.
6. Restorant Gurra e Perrisë. Në këtë komunë gjenden dhe një sërë bar-restorante si 2 Luanët, bar-restorant- piceri Fresku etj.



Fig. IV.21 Kompleksi King Park




Fig. IV.22 Restorant Gurra e Perrisë

Në komunën e Bërzhitës gjenden:

1. Palma Nova Resort- vetëm 14 km nga qyteti i Tiranës. Ka 8 apartamente familjare dhe 2 vila suitë luksoze(1+1+tualet+ballkon).
2. Resort Teatër Kame. Ka 8 shtëpi apartamente, 1 fushë golfi e pishinë.



Fig. IV.23 Palma Nova Resort



Fig. IV.24 Resort Teatër Kame

<sup>161</sup> Marrë nga interneti

### ***Kuzhina dhe akomodimi***

Komunat Dajt dhe Bërzhitë ofrojnë një strukturë të mirëfilltë turistike, si për turizmin ditor ashtu edhe për llojet e tjera të tij. Përgjatë rrugës janë ndërtuar një sërë hotelesh e restorantesh, që mirëpresin pushuesit dhe vizitorët. Kushtet e hoteleve dhe komplekseve turistike janë moderne dhe shumë të rehatshme, të pajisura me shërbime të shumta.

Kuzhina që ofrojnë këto restorante është tradicionale shqiptare, me produktet e mishit të gatuar në shumë mënyra dhe perime të freskëta të stinës, verëra shqiptare dhe franceze si dhe peshk të freskët nga basenet e kompleksit. Edhe qengji i pjekur në hell ju serviret në këto zona. Këtë do t'ju tregojë shumë mirë çdo restorant, i cili në një kënd të ambientit të tij të jashtëm, ka vendosur furrën për të pjekur në hell qengjin. Por, restorantet ju ofrojnë gjithashtu edhe kuzhinë ndërkombëtare apo piceri.

### ***Aktivitetet kryesore turistike***

*Shëtitjet*- janë aktivitete që mund të kryhen gjatë gjithë vitit në territorin e të dy komunave, ku mund të marrin pjesë si vizitorë vendas edhe të huaj. Është e nevojshme që të ndërmerret përcaktimi i një sistemi “shtigjesh” për të përcaktuar itineraret e marshimeve. Këto mund të jenë me gjatësi të ndryshme në formën e një “rrjeti”. Itineraret duhet të jenë të shënuara mirë edhe në tokë dhe të ofrohen harta apo udhëheqës nga zona.

*Çiklizmi malor* – ky është një aktivitet gjithnjë në rritje dhe tërheqës edhe për vizitorët e huaj. Por, është e rëndësishme përcaktimi i një rrjeti itinerari për biçikletat, për të shmangur dhe erozionin në disa shpate të pjerrëta kodrinore.

*Hipizmi* – zona ofron mundësi të shumta për zhvillimin e hipizmit dhe për kalërim, dhe mund të jetë shumë tërheqëse si për vizitorët vendas edhe për ata të huaj. Në komunën Dajt, brenda hapësirave të PKD, ekzistojnë disa inisiativa private për zhvillimin e këtij aktiviteti, por ai duhet të jetë i organizuar dhe kontrolluar për të ofruar një shërbim cilësor. Dhe në afërsi të komunës Bërzhitë ekziston një fushë hipizmi.

*Kanotazhi apo përdorimi i varkave* – ekzistojnë mundësitë për të ofruar këto aktivitete për tregun e brendshëm si fillim përdorimi prurjet e lumenjve janë sezonale, duke kushtëzuar aktivitetet e kanotazhit dhe transportit në sezonin e dimrit dhe të verës. Mund të sigurohen mundësi të tjera duke zhvilluar turet e stilit “kanadez” të kanotazhit në liqenin e Bovillës dhe në liqenet dhe rezervuaret e tjera. Këto lloj aktivitetesh kanë më pak ndikime në mjedis.

*Ski* – ky sport mund të zhvillohet shumë mirë në malin e Dajtit, ku ekzistenca e teleferikut e favorizon atë. Por, nevojiten investime për hapjen e pistave apo sigurimin e pajisjeve. Kryesisht është një nismë individuale.

*Marshimet në borë* – mundësitë për këto aktivitete sigurohen përgjatë gjithë zonës së PKD. Është një sport gjithnjë e më shumë i pëlqyeshëm dhe frekuentohet nga të gjitha grupmoshat,

*Alpinizmi* – ky sport mund të zhvillohet në të dy komunat si psh në ngjitjen e malit të Dajtit, apo grykës së Skoranës etj.

*Eksplorimi i shpellave* – gjeologjia e zonës garanton një potencial për aktivitetet e eksplorimit të shpellave dhe të gropave natyrore. Ky aktivitet nuk është shumë i zhvilluar.

*Hedhjet me parashutë* – ky është një sport që po zhvillohet në afërsi të Dajtit. Vizitorët shpesh duan më shumë ta shohin këtë lloj sporti sesa të marrin pjesë në të. Ndërkohë, që për momentin aktiviteti josh më shumë vizitorët vendas sesa të huajt.

*Kampingu* – mund të zhvillohet në të dy komunat. E përshtatshme është zona e “Ballkonit” të Dajtit, ku sidomos gjatë verës ngrihen kapmingje të tilla një apo disa ditore, por dhe në komunën Bërzhitë mund të përcaktohen hapësira të tilla si në Bërzhitë apo Pëllumbas.

Mund të zhvillohet dhe kampingu me kasolle. Ndërtimi i sistemit të kasolleve për këtë lloj kampingu përgjatë itinerareve të këmbësorëve dhe biçikletave mund të joshë si vizitorët vendas ashtu edhe ata të huaj që përdorin këto itinerare.

*Kultura dhe Trashëgimia* – në të dy komunat, ka një pasuri kulturore dhe trashëgimore që mund të zhvillohet, duke patur interes tërheqjen e turistëve. Kjo përfshin organizimin e festivaleve lokale të përsëritshme, ekspozita të këngës dhe kërcimit vendas etj. Do të jetë një mjet i veçantë për të joshur vizitorët. Është e rëndësishme ngritja e një qendre informacioni që të mund t’i udhëzojë vizitorët për sa i përket monumenteve, zonat dhe fshatrat që paraqesin interes. Në këtë rast është shumë e rëndësishme shitja e sendeve artizanale.

### ***Problemet që hasen në zhvillimin e turizmit***

Pamvarësisht që të dy komunat e marra në studim ofrojnë potenciale të konsiderueshme natyrore e historike për zhvillimin e turizmit, ai përballlet me një sërë problemesh si psh:

- ❖ Infrastruktura e dobët, mungesa e rrugëve drejt atraksioneve, e sidomos në brendësi të territorit, si psh rruga nacionale për në Parkun Kombëtar të Dajtit, apo dhe rruga jo shumë e mirë për në shpellën e Pëllumbasit e mungesa e ndriçimit në të;
- ❖ Shërbimi i transportit publik është jo cilësor;
- ❖ Mungesa e sinjalistikës informative dhe turistike;
- ❖ Prerja ilegale e pyjeve e mungesa e një mirëmenaxhimi të tyre;
- ❖ Gjuetia pa kriter;
- ❖ Mungesa e planeve urbanistike në të dy komunat;
- ❖ Mungesa e investimeve dhe mosmirëmbajtja e monumenteve natyrore dhe kulturore si psh. mungesa e tyre në kalanë e Dajtit, Urën e Brarit apo shpellën e Pëllumbasit;
- ❖ Shfrytëzimi pa kriter i inerteve, si psh në lumin Erzen;
- ❖ Keqmenaxhimi i mbetjeve urbane. Mungesa e impianteve të përpunimit të mbetjeve urbane, por dhe mungesa e kulturës së banorëve vendas për të mbajtur mjedisin pastër, ka bërë që ky mjedis të paraqitet i ndotur, sidomos përgjatë rrjedhjes së lumenjve Erzen apo Tirana, ku banorët përreth hedhin mbeturina të shumta.

Banorët e të dy komunave dallohen për mikpritjen e tyre dhe kjo krijon një atmosferë pozitive për turistët. Por në të dy komunat nuk ekzistojnë shtëpi pritëse, gjë që do të ndihmonte në zhvillimin e turizmit familjar dhe do të kishte përfitimet e saj ekonomike. Mikpritja shprehet dhe në personelin e restoranteve e hoteleve. Megjithatë, hasen disa probleme si: shumica e personelit, (kamarierë, guzhinierë etj.) nuk flasin gjuhë të huaj dhe shpesh ata janë ta pakualifikuar.

Në komunën e Dajtit, në fshatrat Linxë, Shtishtufinë, Lanabregas, gjenden dyqane të souvenireve, ndërsa në fshatra të tjera souveniret shiten në dyqane të artikujeve të ndryshëm. Në komunën Bërzhitë mungojnë dyqane të tilla.

## **V.6. Promovimi i vlerave turistike të komunës Dajt e Bërzhitë, si dhe të zonës përreth**

Promovimi i vlerave turistike përfshin mjetet dhe metodat e përdorura për të tërhequr turistët. Këtu përfshihen reklamat, ekspozitat, artikuj e revista, broshura, harta, video, qendra informacioni për turistët etj.

Në drejtim të promovimit të vlerave turistike të komunave të marra në studim, janë organizuar panairë, broshura informuese, (për komunën e Dajtit këto janë më të shumta, sidomos pas ndërtimit të Teleferikut “Dajti Express), artikuj e revista, ku pasqyrohen vlerat vlerat e shumta turistike që ofrojnë ato.

Megjithatë, mund të themi që nuk është bërë aq sa duhet në këtë drejtim, sidomos në komunën Bërzhitë. Të dyja këto komuna kanë faqe interneti, por promovimi i resurseve natyrore e kulturore në to zë një hapësirë të vogël. Interneti, në ditët e sotme është një mjet mjaft i fuqishëm promovimi, pasi çdo turist i huaj apo shqiptar, përdor internetin për të gjetur vende pushimi, për turizëm apo punë. Në të dy komunat gjenden një numër i konsiderueshëm restorantësh e resorte, por promovimi i tyre në internet duhet të jetë më i larmishëm.

Gjithashtu, për komunën Bërzhitë, mungon një promovim i organizuar në formën e reklamave, materiale të publikuara si broshura, fletpalosje etj. Në përgjithësi, reklamimi bëhet përmes klientëve të cilët ia referojnë njëri-tjetrit restorantet ose hotelet që kanë frekuentuar.

*Cfarë duhet bërë për të patur një promovim të suksesshëm të vlerave natyrore e historike të komunave Dajt e Bërzhitë?*

1. Hartimi i listës së monumenteve dhe evidentimi i gjendjes dhe i statusit të tyre.
2. Dixhitalizimi dhe evidentimi i pikave turistike;
3. Përgatitja e emisioneve televizive, nëpërmjet të cilave njerëzit të njihen nga afër me mrekullitë e natyrës së këtyre dy komunave si dhe të vlerave historike të tyre.
4. Hartimi e shpërndarja e guida ditore e disa ditore, si pranë agjensive turistike, por të ketë njoftime për to dhe në media. Psh. Në ditë festash, “Dajti Exspres” bën njoftime të herpashershme, për udhëtimin me teleferik por dhe përfshirjen e një dreke në Ballkonin e Dajtit. Organizime të tilla mund të realizohen dhe në shpellën e Pëllumbasit, në Bërzhitë dhe ngrënia e një dreke në kompleksin Kame, që është gjatë rrugës. Vetë menaxherët e këtyre resorteve apo restoranteve duhet të bëjnë oferta të tilla, ku të alternojnë vizitat në muze, kala me organizime sportive apo kulturore, për të tërhequr sa më shumë turistë.
5. Hartimi i broshurave informuese të shoqëruara me pamje nga natyra e vendet historike që gjenden në të dy komunat.
6. Ngritja e zyrave të informacionit turistik në të dy komunat e përcaktimi i personave përgjegjës për turizmin dhe kulturën;

Një promovim i suksesshëm i vlerave turistike për komunat Dajt dhe Bërzhitë do të sjellë rritjen e numrit të turistëve vendas e të huaj e njëkohësisht do të gjenerojë vende pune dhe rritje të ardhurash për banorët vendas.

Zhvillimi i turizmit është një ndër burimet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të të dy komunave. Në vizionin e tyre ato synojnë krijimin e bazave për një turizëm energjik dhe të integruar me mirëpordorimin e burimeve dhe pasurive natyrore të tyre, për të siguruar më shumë të ardhura , vende pune, tërheqjen e njerëzve për të mos u



larguar nga venbanimet e tyre, rritjen e ndërgjegjesimit për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe historike.

Shfrytëzimi i potencialeve turistike është më i lartë në komunën e Dajit se sa në atë të Bërzhitës, gjë që ka sjellë të ardhura më të mëdha dhe një numër më të madh të punësuarish në këtë sektor për këtë komunë. Ndërtimi i teleferikut “Dajti Ekspres”, ka shumfishuar numrin e turistëve që vizitojnë Parkun Kombëtar të Dajtit duke rritur më shumë mundësitë për zhvillimin e turizmit në këtë komunë.

Përmirësimi i infrastrukturës në komunat Dajt dhe Bërzhitë si ndërtimi i rrugës së Arbrit, ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan, (tuneli i Elbasanit), do të mundësojnë zhvillimin më të madh të turizmit në këto zona.

#### IV.5 Aktivitete të tjera sektorit terciar

Në të dy komunat ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe një sërë ndërmarrjesh shërbimesh si karburante, firma ndërtimi, shoqëri sigurimi etj. Siç e shohim dhe nga tabelat e mëposhtme komuna Dajt dallohet jo vetëm për numrin e tyre më të lartë se komuna Bërzhitë (300/70), por njëkohësisht dhe për një gamë më të gjerë të shërbimeve që ofrohen. Kjo është e shpjegueshme me ritmet e larta të popullimit, ndërtimeve e zhvillimit që ka marrë marrë kjo komunë sedomos pas vitit 2000.

Tabela IV.23 Biznese të sektorit terciar në komunën Dajt

Nr.	Emërtimi	Nr. i ndër.	Fshatrat ku gjenden
3	Karburante	2	Qesarakë, Lanabregas
4	Firma ndërtimi	13	Qesarakë (12), Lanabregas (1)
5	Shoqëri sigurimi	5	Lanabregas
6	Shoqëri mirëmbajtje ashensorësh	2	Lanabregas
19	Shoqëri shpërndarje ushqimi	2	Linzë, Tufinë
10	Bar-kafe (restorante)	76	
11	Shitje me pakicë B.V	79	
12	Shitje me pakicë B.M	23	
13	Pika shërbimesh të ndryshme	101	
	<b>Gjithsej</b>	<b>303</b>	

Burimi: Sektori i Tatim-Taksave-komuna Dajt, viti 2011

Tabela IV.24 Biznese të sektorit terciar në komunën Bërzhitë

Nr.	Emërtimi	Nr. i ndër.	Fshatrat ku gjenden
1	Karburante	4	Dobresh (2), Bërzhitë (1), Ibë e Poshtme (1)
2	Bar-kafe (restorante)	12	
3	Pika shërbimesh të ndryshme (artikuj të ndryshëm).....	54	
	<b>Gjithsej</b>	<b>70</b>	

Burimi: Sektori i Tatim-Taksave-komuna Dajt, viti 2011

Nga analiza e tabelave të mësipërme, ku janë paraqitur ndërmarrjet që i përkasin sektorit terciar në të dy komunat, vëmë re që në komunën e Dajtit, është krijuar veprimtarinë e tyre 13 firma ndërtimi, ndërsa në komunën Bërzhitë nuk ka asnjë. Kjo lidhet me ndërtimet e shumta që janë bërë në këtë komunë të ndërtesave shumëkatëshe si në Linzë, Lanabregas etj.

Po kështu, në komunën Dajt ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe dy shoqëri mirëmbajtjesh ashensorësh si dhe pesë shoqëri sigurimesh. Numri i bar-restoranteve, i ndërmarrjeve të shitjeve me pakicë e shumicë, është më i lartë në komunën Dajt dhe kjo flet qartë për një shkallë më të lartë të zhvillimit të këtij sektori në këtë komunë.



*Fig. IV.25 Pallate shumëkatëshe në fshatin Linzë, komuna Dajt*

Në komunën Bërzhitë, përhapjen më të madhe e kanë, pikat e shijes së artikujve të ndryshëm dhe kjo është e lidhur me mundësitë më të pakta që kanë banorët e kësaj komune.

Në këtë komunë ka një aktivitet të larmishëm sidomos në fushën e bar-restoranteve. Të tilla janë ngritur shumë sidomos gjatë rrugës nacionale Tiranë-Elbasan. Një pjesë e tyre janë ngritur nga banorët vendas, por dhe nga investues të tjerë privatë. Me ndërtimin e autostradës së re Tiranë-Elbasan pritet që numri i këtyre bizneseve të rritet dhe të ketë një orientim të ri hapësinor të tyre.

Numri i ndërmarrjeve që i përkasin këtij sektori, në të dy komunat është më i lartë sesa nga të dhënat e paraqitura nga Zyra e Tatim-Taksës së të dy komunave, dhe kjo lidhet me shkallën e lartë të informalitetit të këtij sektori.

#### **IV.6 Burimet financiare sipas komunave dhe investimet**

Komunat Dajt dhe Bërzhitë, megjithëse kanë një pozicion mjaft të favorshëm, potenciale të shumta humane e mjedisore, nuk kanë arritur të përfitojnë investimet e nevojshme, aq të domosdoshme në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm të tyre.

Në përgjithësi, vërehen disa investime të realizuara nga buxheti i shtetit dhe shumë pak ndërhyrje nga donacione të ndryshme.


Në tabelat e grafikët e mëposhtëm janë dhënë burimet financiare të komunës Dajt dhe Bërzhitë në vite.

Tabela IV.25 Burimet financiare të komunës Dajt në vitet 2008-2011 ( në lekë)

Vitet	Transferta (grant) nga buxheti i shtetit	Fonde të kushtëzuara nga qeveria (ministritë)	Të adhurat e vetë komunës (taksa,tatime,tarifa)	Donat. Spons.
2008	38.980.000	74.986.000	110.041.000	
2009	36.833.000	72.479.000	200.591.000	
2010	32.704.000	107.874.000	205.922.000	
2011	31.672.000	103.190.000	179.579.000	

Burimi: Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Dajt

Grafiku IV.3 Burimet financiare të komunës Dajt në vitet 2008-2011 (në lekë)




Burimi: Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Dajt

Tabela IV.26 Burimet financiare të komunës Bërzhitë në vitet 2008-2011 ( në lekë)

Vitet	Transferta (grant) nga buxheti i shtetit	Fonde të kushtëzuara nga qeveria (ministritë)	Të adhurat e vetë komunës (taksa,tatime,tarifa)	Donat. Spons.
2008	25.930.000	52.474.717	14.433.461	
2009	26.252.000	49.206.188	10.684.978	
2010	21.151.000	79.878.000	17.803.282	
2011	17.886.427	43.049.791	11.801.066	

Burimi: Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Bërzhitë

Grafiku IV.4 Burimet financiare të komunës Bërzhitë në vitet 2008-2011 (në lekë)



Burimi: Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Bërzhitë, viti 2012

Nga analiza e grafikëve të mësipërm arrijmë në këto konkluzione:

- komuna Dajt, duke qenë një komunë me sipërfaqe më të madhe dhe më e populluar, është karakterizuar nga fonde më të mëdha si nga buxheti i shtetit, po ashtu dhe nga qeveria (ministritë), si fonde të kushtëzuara, se sa komuna Bërzhitë. Kjo i ka dhënë ekonomisë së saj një impuls zhvillimi më të lartë. Po kështu dhe të ardhurat e siguruara nga vetë komuna janë shumë më të larta se në komunën Bërzhitë.
- të ardhurat e siguruara nga stransfertat apo grantet e qeverisë, në të dy komunat, kanë ardhur duke u zvogëluar dhe kjo lidhet më shumë me paaftësinë e përthithjes së këtyre granteve nga komuna sesa nga mosdhënia e tyre.
- po kështu, kanë ardhur duke u zvogëluar dhe fondet e kushtëzuara nga qeveria, nga ministritë përkatëse dhe kjo ka ndikuar në investimet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Këto fonde janë pëdorur kryesisht për ndërtimin e ujësjellsave, rrugë, kanalizime e ndërtesa.
- pas një rritjeje të konsiderueshme në vitin 2010, të ardhurat e vetë komunës nga taksat, tatimet e tarifat e ndryshme, janë zvogëluar. Kjo është e pashpjegueshme duke patur parasysh që numri i bizneseve ka ardhur në rritje. Kjo flet qartë për një informalitet të ekonomisë në këto komuna.
- njëkohësisht është për të ardhur keq që në këto komuna donacionet dhe sponsorizimet janë të pakta. Kryesisht ato janë investuar në ndërtimin e rrugëve të reja si dhe në rikonstruksionin e rrugëve të vjetra. Është detyrë e pushtetit vendor që duke përcaktuar qartë prioritetet në zhvillimin e komunave Bërzhitë dhe Dajt të mundësojë gjetjen e donatorëve, madje dhe në sektorë të rëndësishëm ekonomikë si bujqësi, blegtori apo turizëm.

### ***Investimet e kryera në komunën Dajt dhe Bërzhitë***

Investimet publike të kryera në komunën Dajt dhe Bërzhitë janë përqëndruar kryesisht në rikonstruksionin e shkollave, e shumë pak në ndërtimin e shkollave të reja, si psh shkolla e re 9-vjeçare në Qesarakë, fshati Linxë, në komunën Dajt në vitin 2013, në rikonstruksionin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit dhe të ndërtimit të rrjetit të ri të ujësjellësit si psh ujësjellësi i fshatit Ibë e Sipërme, komuna Bërzhitë në vitin 2009, si dhe të rikonstruksionit të ndërtimit të kanalizimeve të ujërave të zeza etj.

Siç e shohim dhe nga tabelat e mëposhtme, në asnjërën prej komunave të marra në studim, nuk është investuar për ngritjen e tregjeve, që do të ishte një investim i rëndësishëm për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale të tyre.

*Tabela IV.27 Investimet publike të kryera në komunën Dajt në vitet 2008-2011*

<b>Objekti</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>Totali</b>
Për shkolla	50828000	-	9115000	57911000	<b>117854000</b>
Për rrugë	48023000	110073000	140269000	73227000	<b>371592000</b>
Për ujësjellësa	15441000	8339000	24376000	6317000	<b>54473000</b>
Për kanalizime	22600000	5300000	6908000	5282000	<b>40090000</b>
Për tregje	-	-	-	-	-

Burimi: *Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Dajt*

Tabela IV.28 Investimet publike të kryera në komunën Bërzhitë në vitet 2008-2011

Objekti	2008	2009	2010	2011	Totali
Për shkolla	-	-	-	-	-
Për rrugë	42650704	797277	-	71914993	<b>115362974</b>
Për ujësjellësa	60962000	60386109	30188316		<b>151536425</b>
Për kanalizime	20311000	395219	-		<b>20706219</b>
Për tregje	-	-	-	-	-
Për ndërtesa	2700000	12000000	-	-	<b>14700000</b>

Burimi: Statistika 2011, Zyra e Tatim-Taksave në komunën Bërzhitë

Siç e shohim dhe nga tabelat, investimet më të shumta, në komunën Dajt, janë përqëndruar në ndërtimin e rikonstruksionin e rrugëve, ndërsa në komunën Bërzhitë, investimet më të mëdha janë përqëndruar në ndërtimin e ujësjellësave e kanalizimeve, më pas në ndërtimin e rikonstruksionin e rrugëve.

Po kështu, investimet në rikonstruksionin dhe ndërtimin e shkollave në komunën Dajt, zënë një vend të rëndësishëm dhe kjo lidhet me numrin gjithnjë e në rritje të popullsisë së saj për shkak të numrit të lartë të popullsisë së ardhur, kryesisht nga zona veriore e Shqipërisë.

Në komunën Bërzhitë bie në sy mungesa e investimeve për shkollat gjatë periudhës 2008-2011. Kjo pasi rikonstruksioni i shkollave është kryer në vitet e mëparshme si në 2005 është kryer rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Fravesh, 2006 i shkollës së mesme Ibë etj.

Në këtë komunë, në vitet e fundit nuk është ndërtuar ndonjë shkollë e re dhe kjo për shkak të rënies së numrit të nxënësve. Kjo rënie lidhet me uljen e numrit të lindjeve si dhe të arsimimit të një pjese të nxënësve në shkollat e mesme të qytetit të Tiranës.

## KAPITULLI V

### PEIZAZHI, MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

#### V.1 Peizazhi rural

Termi "peizazh", është një fjalë e përgjithshme dhe përshtetëse, pa një përcaktim të qartë, dhe kuptimi i saj mbetet i dyshimtë, si në përdorimin e përgjithshëm, ashtu edhe ndërmjet fushave akademike dhe brenda disiplinave individuale<sup>162</sup>.

*Peizazhi, sipas Konventës Europiane të Peizazhit, është përcaktuar si pjesë e hapësirës, e perceptuar nga banorët ose vizitorët, vetitë vizuale dhe karakteri i së cilës janë rezultat i veprimit të faktorëve natyrorë dhe kulturorë (njerëzor).*

Ky përkufizim pasqyron idenë që peizazhet evoluojnë në kohë, si rezultat i veprimit të forcave natyrore dhe shoqërisë njerëzore.

Gjithashtu, kjo nënvizon që një peizazh formon një të tërë, ku komponentët natyrorë dhe kulturorë të merren së bashku dhe jo të ndarë. Ky koncept nënkupton integrimin e cilësive ekonomike, mjedisore dhe social-kulturore në një pjesë të hapësirë gjeografike.

Ndryshimi i peizazhit është një proces normal, pasi ai është një pasqyrim fizik i ndryshimeve në përdorimin e tokës. Kur ato ndodhin me shpejtësi, mund të ndikojnë në mënyrë dramatike në cilësitë dhe koherencën e brendshme të "peizazhit".

Siç e dimë, nga prishja legale e sistemit kolektiv të fermave, peizazhi bujqësor ndryshoi: parcelat e mëdha, të rregullta e të mbjella me të njëjtën kulturë u zëvendësuan nga ngastra e vogla e të mbjella me kultura të ndryshme, sipas interesit të fermerëve individualë, ndërsa prodhimi bujqësor filloi të ulet. Sot, pas mbi njëzet vitesh, peizazhi bujqësor është bërë edhe më i larmishëm, prodhimi në fermat private është rritur disi, por fermat kanë mbetur të vogla dhe prodhojnë kryesisht për konsum familjar.

Në zonat e metropoleve, qytetet dhe fshatrat shkrihen midis tyre duke krijuar një peizazh të ndërmjetëm, që njihet me emrin "fshat i urbanizuar". Ky tip peizazhi u bashkangjitet dy kategorive të tjera të peizazheve rurale: atij të bujqësisë moderne dhe të fshatrave tradicionale, që dallohen midis tyre jo vetëm nga peizazhi, por edhe nga niveli i zhvillimit ekonomik<sup>163</sup>.

Menaxhimi i integruar i peizazhit rural është sot një detyrë urgjente. Ai duhet të synojë parandalimin e degradimit të pyjeve dhe kullotave, rritjen e pjellorisë dhe mbrojtjen e tokave të punueshme, promovimin e prodhimit artizanal, ruajtjen e traditave në bletari dhe shtimin e numrit të koshereve, shtimin e mikro-ndërmarrjeve përpunuese, rritjen e qëndrueshme të prodhimit, rritjen dhe diversifikimin e të ardhurave, përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në zonat rurale.

Planifikimi i së ardhmes do të kërkojë të identifikohen zonat më të rëndësishme ekonomike dhe biologjike, si dhe të gjenden mënyrat për konservimin e tyre për "komunitetin".

---

<sup>162</sup> Meinig, D.W. (ed) (1979) *The Interpretation of Ordinary Landscapes*. New York. Oxford University Press. fq. 3

<sup>163</sup> Laçi S., në bashkëpunim me Kola E., Xhafa S., Laçi E., *Gjeografia rurale*. Tekst universitar. Shtëpia botuese "Lilo", viti 2014, fq. 207.

## V.2 Tipare kryesore të peizazhit të komunave

Studiues të ndryshëm, duke u mbështetur në karakteristika të dallueshme pamore kanë evidentuar disa hapësira me peizazh natyror të veçantë, që gjenden në territorin e komunave të marra në studim, që janë<sup>164</sup>:

- ❖ mali i Dajtit;
- ❖ grykat dhe luginat e lumenjve;
- ❖ ujëmbajtësi i Bovillës dhe pellgu ujëmbledhës i tij;
- ❖ zona e Qafë Mollës;
- ❖ shpatet e pjerrëta të Malit me Gropa.

*Mali i Dajtit* është një element i dukshëm i peizazhit, ku pjerrësitë rriten duke filluar nga rreth 200 m, deri në rreth 1500 m lartësi mbi nivelin e detit. Ai është pjesë e vargmalit Krujë-Dajt, shtrihet në drejtimin VP-JL dhe përbëhet prej tri njësisish: mali i Brarit (1214 m), mali i Dajtit (1613m) dhe mali i Priskës (1365m)<sup>165</sup>.

Ai ofron shembullin më të mirë në Shqipëri të katëzimit vertikal të vegjetacionit, me brezin e ulët të makies, brezin e mesëm të pyjeve të dushkut dhe brezin e lartë të pyjeve të ahut.

Një pjesë e madhe e vegjetacionit është e degraduar, si rrjedhojë ndërhyrjeve të njeriut për grumbullimin e gjetit dhe prerja e drurëve, si dhe nga kullotja e bagëtisë brenda kufijve të PKD nga banorët e fshatrave. Por, kohët e fundit, ka shenja të përtëritjes graduale, sidomos në hapësirën që i përket Park Kombëtar.

Malet ofrojnë një pamje të mrekullueshme mbi qytetin e Tiranës dhe mbi detin Adriatik, dhe, në kombinim me ajrin e freskët e të pastër, ato sigurojnë një destinacion të shkëlqyer për qytetarët e Tiranës.



Fig. V.1 Pamje piktoreske të malit të Dajtit<sup>166</sup>

*Grykat dhe luginat e lumenjve.* Mali i Dajtit është ndërprerë në tre vende nga lumenjtë, të cilët kanë çarë përmes grykave të ngushta, duke krijuar luginat me shpate të

<sup>164</sup> PK Dajt, Annex 2, *Peizazhi kulturor dhe trashëgimia*, fq. 19

<sup>165</sup> PK Dajt, Annex 2, *Peizazhi kulturor dhe trashëgimia*, fq.19

<sup>166</sup> Marrë nga interneti

pjerrëta e shtretër të thellë. Këto janë Erzeni, lumi i Tiranës dhe ai i Tërkuzes. Ata janë lumenj tipik malor, me ujë të pastër, që rrjedhin rrëmbyeshëm përmes grykave të thella<sup>167</sup>.

Përveç pamjeve spektakolare, këto gryka ofrojnë vegetacion tipik, që zhvillohet në kushtet e mikroklimës së veçantë lokale. Në disa vende mund të vërehet inversionsi i vegetacionit vertikal tipik, ku pyjet e dushkut gjenden më në lartësi sesa pyjet e ahut.

Në vitet e fundit, shtretërit e këtyre lumenj janë përdorur intensivisht për nxjerrjen e inerteve, siç dëshmohet nga prania e një duzine guroresh dhe impiantesh të prodhimit të inerteve, që përveç shkatërrimit të shtretërve të lumenjve ndotin dhe ajrin përreth.



*Fig.V.2 Gryka e Skoranes dhe peizazhi përreth saj<sup>168</sup>*

*Ujëmbajtësi i Bovillës dhe pellgu ujëmbledhës.* Ujëmbajtësi i Bovillës, i ndërtuar në vitin 1998, në pjesën veriore të parkut Kombëtar të Dajtit, ka krijuar një peizazh ujqor mahnitës. Ai e merr ujin prej përrenjve të ndryshëm gjarpërues, që e kanë origjinën në malet përreth.

Përreth ujëmbajtësit, në një distancë të vogël prej tij, ndodhen disa fshatra piktoreske, që krijojnë një peizazh kodrinor të fermave, kullotave dhe pyjeve. Nga ana tjetër, sipërfaqe të mëdha janë degraduar, duke ekspozuar shkëmbinjtë rrënjësor dhe honet e thella. Disa prej këtyre sipërfaqeve kanë mbetur të zhveshura, ndërsa të tjerat janë ripyllëzuar me pisha.



*Fig. V.3 Rezervuari i Bovillës<sup>169</sup>*

---

<sup>167</sup> Po aty.fq 20

<sup>168</sup> Marrë nga interneti

<sup>169</sup> Marrë nga interneti



Zona e *Qafë Mollës* ndodhet në pjesën jug-lindore të Parkut Kombëtar të Dajtit dhe ka Selitën si qendër kryesore. Ajo dallohet nga prezenca e pyjeve të drejtë dhe të dendur, të ruajtura në kushte të mira, të cilat krijojnë peizazhe pyjore shumë të këndshme. Si rrjedhojë e pranisë së pyjeve, në këtë zonë gjejmë kushte të mira zhvillimi specie të ndryshme gjahu, madje edhe ariu dhe ujku janë herë pas here të pranishëm. Pikërisht për faunën e pasur kjo zonë është përcaktuar si një Rezervat Gjuetie.

Për shfrytëzimin e burimeve të Selitës, është ndërtuar një impiant për trajtimin dhe ambalazhimin e ujit “Selita”, duke i shtuar edhe një element antropogjen e modern peizazhit të zonës.

*Shpatet e pjerrëta të Malit me Gropa.* Ky mal është referuar shpesh si “kështjella e ujit” të Shqipërisë, pasi tre prej shtatë lumenjve kryesorë të vendit burojnë prej tij: Mati, Ishmi dhe Erzeni<sup>170</sup>. Kjo zonë karstike ka qenë përcaktuar si Kategoria V e zonave të mbrojtura (Peizazh Natyror i Mbrojtur) dhe kufizon PK të Dajtit nga lindja. Shpatet perëndimore të pjerrëta të Malit me Gropa janë pjesë e parkut, ndërkohë që pjesa e sipërme, pothuajse e rrafshët, me lartësi 1800m, i përket zonës me statusin Peizazh Natyror i Mbrojtur. Gjatë pjesës më të madhe të periudhës së dimrit, këto shpate të pjerrët janë të mbuluara me borë, duke krijuar një peizazh dimëror piktoresk. Shpatet janë shumë të pjerrëta dhe të jo shumë të përshtatshme për zhvillimin e pyjeve. Ato shfrytëzohen kryesisht për kullotjen e bagëtive dhe të bletëve, pasi në pjesën më të madhe janë të mbuluara me livadhe të pasura me lloje të shumta bimësh barishtore dhe lulësh. Mundësia e ripyllëzimit natyror të tyre me dushk dhe ah nuk përjashtohet, por kjo kërkon rritje të kujdesit për drurët dhe pakësimin e përdorimit për kullotë. Sigurisht që pyjet do të ishin një vlerë e shtuar e peizazhit të kësaj zone, gjithsesi shumë interesant.



*Fig. V.4 Pamje nga Mali me Gropa<sup>171</sup>*

Ky peizazh i mrekullueshëm natyror pasurohet më tej me fshatrat tipike të zonës, që përbëhet nga shtëpitë dhe ndërtesa të tjera me karakteristika arkitekturore interesante, fermat, mozaikun e ngastrave shumëformëshe, të ndara nga mure guri, gardhe apo bimësi natyrore si

<sup>170</sup> PK Dajt, Annex 2, *Peizazhi kulturor dhe trashëgimia*, fq. 20

<sup>171</sup> Marrë nga interneti

dhe kostumet popullore, gatimet tradicionale etj, të cilat plotësojnë ofertën turistike të kësaj zone thellësisht rurale.



*Fig. V.5 Foto satelitore e luginës së lumit Erzen*

*Nga lartësitë e shpatit ku ndodhet shpella e Zezë ose Pëllumbasit, në komunën Bërzhitë, mund të soditësh një peisazh të bukur që shtrihet deri në Adriatik në perëndim dhe Malin me Gropa në lindje, që nga ana e tij përbën një objekt tjetër me vlera turistike për zonën e marrë në studim.*

Duhet theksuar se peizazhi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në interesin e përgjithshëm, në rrafshin kulturor, ekologjik, mjedisor e shoqëror, dhe se është burim për veprimtarinë ekonomike, e cila, duke u mbrojtur, menaxhuar dhe planifikuar më së miri mund të favorizojë krijimin e vendeve të punës. Peizazhi ndihmon në ruajtjen e kulturave lokale, karakteristike për zonat rurale, dhe përbën një komponent të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore të vendit. Ai përbën një element dallues dhe për cilësinë e jetës së popullsisë që banon në këto zona rurale.

Zhvillimi i teknikave të prodhimit bujqësor, pyjor, industrial e mineral, si dhe zbatimi i tyre në fushën e planifikimit të territorit, urbanizmit, transportit, rrjeteve të komunikimit, turizmit e organizimit të kohës së lirë, sjellin transformimin e peizazhit. Prandaj është e domosdoshme që të informohen të gjithë që peizazhi përbën një element thelbësor për mirëqenien individuale e sociale, dhe se mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i tij nënkuptojnë të drejta e përgjegjësi për secilin.

Të interesuar që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm në zonat e marra në studim, duhet të mbështetemi mbi një ekuilibër të harmonishëm midis nevojave sociale, ekonomisë dhe mjedisit.

### V.3 Mjedisi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i tij

*“Mjedisi është burimi i gjithçkaje për të cilën njerëzit kanë nevojë për të jetuar dhe për t’u zhvilluar”<sup>172</sup>.*

Pasuria e një kombi përbëhet nga tre elementë: njerëzit, burimet ekonomike dhe mjedisi ku ata ndërveprojnë. Të tre këta elemente janë pashmangshmërisht të lidhur dhe nuk mund të shqyrtohen të ndarë nga njëri-tjetri.

Degradimi i mjedisit ndikon negativisht në shëndetin e popullsisë dhe zvogëlon mundësitë e zhvillimit ekonomik. Parandalimi i ndotjes dhe administrimi racional i burimeve natyrore kanë rëndësi të madhe për uljen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Komponentët kryesorë të mjedisit që preken nga veprimtaria jetësore dhe ekonomike e shoqërisë janë: ajri e cilësia e tij, uji, toka e aftësia prodhuese e tyre, biodiversiteti, peizazhi e trashëgimia natyrore, historike dhe kulturore.

#### V.3.1 Ndotja e ajrit

Cilësia e ajrit, në të dy komunat e marra në studim, për shkak dhe të pozitës gjeografike të tyre e të faktorëve natyrorë të favorshëm, paraqitet në përgjithësi e mirë. Vetëm në disa hapësira, si në hyrje të PKD, ku ndodhen disa gurore, apo pranë disa fshatrave të komunës Dajt që shtrihen pranë qytetit të Tiranës, si në Linzë, Tufinë, Lanabregas, për shkak të ndërtimeve të shumta të pallateve, cilësia e ajrit paraqitet jo shumë e mirë.

*Restaurimi dhe rifutja në shfrytëzim i kantierëve të nxjerrjes së gurit, çakëllit dhe prodhimit të inerteve, me qëllim shmangien e ndotjes së ajrit duhet të jetë një kërkesë themelore para dhënies ose përtëritjes së lejes mjedisore në të dy komunat.*

Detyrimet lidhur me peizazhin duhet të përfshijnë masat përmirësuese dhe ato parandaluese nga dëmtimi që mund të shkaktojë funksionimi i kantierit. Kjo duhet të përfshijë ndërtimin dhe projektimin e skarpateve të dukshme për të ulur zhurmën, pluhurin dhe ndotjen pamore, si dhe restaurimin pas përfundimit të aktivitetit, në rastin e guroreve, sidomos në komunën Dajt, ku ky fenomen është më i pranishëm. Kjo duhet të përfshijë dhe rimbjellen e drurëve në tarraca përgjatë faqes së gurores.

Restaurimi i kantierëve duhet të synojë rikrijimin e mundësive për zhvillimin e botës së egër, si dhe shndërrimin e sipërfaqeve të shfrytëzuara rreth tyre në vende turistike për pushim, shëtitje, alpinizëm etj.

#### V.3.2 Ndotja e ujit

Uji luan një rol të rëndësishëm në ekosistemin natyror dhe në shoqërinë njerëzore, si dhe për zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Të tre lumenjtë e rëndësishëm për komunat e marra në studim, e kanë origjinën e tyre në pjesën lindore të Parkut Kombëtar të Dajtit, lumenjtë Erzeni, Tirana dhe Tërkuza, dhe janë të një rëndësie shumë të madhe për qendrën e rritur urbane të Shqipërisë, të

---

<sup>172</sup> SKZHSE, *Raporti i ecurisë për implementimin 2002, Objektivat dhe vizioni afatgjatë i SKZHSE-së, Plani i veprimtimit prioritar 2003*, Tiranë 8 Maj, 2003, fq. 6.

ashtuquajturin “Metropoli Tiranë-Durrës”, ku banon pothuajse gjysma e popullsisë së Shqipërisë. Kushtet e favorshme klimatike të zonës së Dajtit (më tepër se 1700 mm reshje në vit, mbulesa e borës, etj.) dhe prania e zonës karstike masive, përbëjnë bazën e kësaj pasurie.

Transporti i materialeve të ngurta të këtyre lumenjve është i lartë, që rezulton prej karakteristikave morfometrike të pellgut ujëmbledhës dhe formave të reshjeve. Megjithatë, është e qartë, që lumenjtë janë shumë të ndotur me grimca të ngurta, nga operacionet e guroreve në shtretërit e lumenjve. Uji i të tre lumenjëve është i pastër kur futet në grykat e maleve, por largohet prej tyre i ngarkuar me sedimente, në saj të prezencës së guroreve. Materialet e ngurta të mbajtura pezull dhe të transportuara variojnë nga 4 deri 12 kg/sec<sup>173</sup>. Lumenjtë mbajnë një ngarkesë të lartë shtrati gjatë përmbytjeve, megjithatë nuk ekzistojnë të dhëna për ta matur këtë ngarkesë.

Cilësia e burimeve ujore (sipërfaqësore ose nëntokësore) në zonën e Parkut Kombëtar të Dajtit është e mirë, si në termat e parametrave fizik ashtu edhe ato kimik. Kjo është në saj të faktit që origjina e këtyre ujërave është prej një zone malore karstike. Për më tepër, nuk ekzistojnë burime ndotëse brenda parkut, me përjashtim të guroreve. Përdorimi i agrokimikateve brenda parkut besohet të jetë shumë i kufizuar dhe jo për të patur ndonjë ndikim negativ mbi cilësinë e ujit.

*Guroret dhe minierat, brenda Parkut Kombëtar të Dajtit, kanë një impakt serioz jo pozitiv, në cilësinë e ujit. Për këtë arsye, është rekomanduar të pezullohen aktivitetet e minierave dhe guroreve të lokalizuara brenda tij.*

Gjithashtu turizmi përbën një rrezik potencial në cilësinë e ujit, veçanërisht në lidhje me ujrat e zeza dhe shpërndarjen e mbetjeve të ngurta. Aktualisht, turizmi është përqendruar mbi “ballkonin” e Dajtit. Sidoqoftë, në të ardhmen, është parashikuar që turizmi do të ngjitet deri në Rezervuarin e Bovillës dhe fshatrat rreth e rrotull. Është e rëndësishme të rritet sensibilizimi dhe edukimi i banorëve lokal si dhe i turistëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së cilësisë së ujit. Duhet të zhvillohen vetëm ato aktivitete turizmi, të cilat nuk kanë impakte negative mbi cilësinë e ujit, të tillë si lundrimi, vozitja, etj.

Në lidhje me cilësinë e ujit është rekomanduar që të instalohet një sistem monitorimi i cilësisë së ujit në përputhje me standartet kombëtare, të rezervuarit të Bovillës dhe burimeve ujore të Selitës dhe Shënmërisë. Uji i marrë prej burimeve ujore të Selitës dhe Shënmërisë ka një cilësi të mirë natyrore dhe nuk kërkon ndonjë trajtim të thellë: klorifikimi është i mjaftueshëm.

Ndërkaq uji prej rezervuarit të Bovillës është trajtuar, por jo prej gjithë elementëve ndotës. Kohët e fundit, ka patur ankesa rreth cilësisë së ujit të Rezervuarit të Bovillës. Studiuesit, besojnë se kjo mund ti atribuohet dekompozimit të vegjetacionit, i cili nuk është hequr përpara se Rezervuari të mbushej. Është rekomanduar të ndërmerret një studim i veçantë për natyrën e ndotjes, shkaqet e mundëshme dhe masat që duhet të merren.

Këto burime të furnizimit me ujë nuk monitorojnë cilësinë e ujit në këtë moment. Përsa i përket rezervuarit të Bovillës, është rekomanduar të ndërmerret një studim i veçantë për të shqyrtuar natyrën dhe origjinën e ndotjes së ujit.

---

<sup>173</sup> PK Dajt, Annex 2, *Peizazhi kulturor dhe trashëgimia*, fq. 22

Në përgjithësi, përdorimi i ujit të Parkut Kombëtar të Dajtit mund e përmbledhet si më poshtë: ujë i pijshëm për konsum njerëzor, ujëra si inpute për proceset industriale (pastrim, freskim, etj.), ujë ujitje për bujqësi.

Një problem bazë i rrjetit të ujit të pijshëm të Tiranës, i zakonshëm pothuajse në të gjithë rrjetet e furnizimit me ujë të qyteteve në Shqipëri, është gjendja jo e mirë e tubacioneve. Ato janë bërë prej çeliku ose hekur i derdhur dhe kanë qenë instaluar përgjithësisht 20 apo 30 vite më parë; ato janë gërryer ashpërsisht për arsye të moshës së vjetër, mungesës së mbrojtjes parandaluese dhe mungesës së mirëmbajtjes së mëtejshme. Kjo shkakton humbje të mëdha në sistemet e shpërndarjes prej rreth 50 –70 %.

Një tjetër problem i rrjetit të ujit të pijshëm është që furnizimi me ujë nuk është vetëm për përdorim njerëzor (shtëpiak dhe bashkiak), por pothuajse për të gjithë aktivitetet industriale. Në këtë mënyrë industria përfiton prej cilësisë së mirë të ujit me kosto të ulët, madje nëse uji është me një cilësi më të ulët do të ishte i pranueshëm për përdorim industrial.

Ujitja është një tjetër përdorim i rëndësishëm i ujit. Duke qenë një zonë kodrinoromalore, sistemi i vaditjes është bazuar kryesisht mbi ndërtimin e rezervuareve të vegjël dhe në disa raste mbi rrjedhjen prej lumit ose pompave të vaditjes. Rezervuari artificial më i madh për vaditje në këtë zonë është rezervuari i Skoranës (digë e vogël mbi lumin Erzen) me një volum prej 2106 m<sup>3</sup>.

Sipas Strategjisë kombëtare për Ujërat, përgatitur në vitin 1997 dhe miratuar në Këshillin Kombëtar të Ujërave në Prill 2004, territori i Shqipërisë është ndarë në 6 njësi basenesh ujore. Një prej këtyre është bazeni Ishëm-Erzen, i cili është konsideruar si një rast urgjent për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Ujit në saj të disa problemeve lidhur me mungesën e përgjithëshme të burimeve ujore, konfliktet e mundëshme ndërmjet përdorimeve të ujërave tokësore, ndotjeve të mëdha në zonën e Tiranës, etj. Kështu që, përgatitja e Planit të Menaxhimit të Ujërave të Parkut Kombëtar të Dajtit nuk mund të bëhet më para se të finalizohet dhe miratohet Plani i Integruar i Menaxhimit të Ujërave të bazenit Ishëm-Ezen.

Duke ndjekur ndërtimin e suksesshëm të digës së rezervuarit të Bovillës në lumin Tërkuza, shumë plane kanë qenë zhvilluar për ndërtimin e digave të tjera në të dy lumenjtë, duke krijuar rezervuare me disa funksione si për ujë të pishëm, ujitje e energji hidrike. Një studim është përgatitur tashmë për rezervuarin e Skoranës nga inxhinierët shqiptarë, që ka një volum të mundshëm depozitimi rreth 180 milion m<sup>3</sup>. E njëjta ide është ndërmarrë gjithashtu për lumin e Tiranës tek gryka e quajtur “Shkalla e Tujanit”<sup>174</sup>, që do të furnizojë me ujë të pijshëm dhe për ujitje banorët e zonës përreth.

Menaxhimi i burimeve ujore kërkon aplikimin e metodave integruese, që marrin parasysh jo vetëm nevojat dhe kërkesat e përdoruesve të ujërave të sipërfaqësore, por dhe kërkesat e ekosistemeve për ujë. Gjithashtu, krahas sasisë, menaxhimi duhet të përfshijë edhe cilësinë e ujërave. Kjo e fundit rrezikon të dëmtohet gjatë periudhës së reshjeve intensive, kur erozioni sipërfaqësor është i fuqishëm dhe sasia e ujërave të depozituar në ujëmbajtës është e madhe.

Shembulli i qartë është ai i rezervuarit të Bovillës, i cili mbushet një herë në vit dhe siguron ujë të pijshëm për qytetin e Tiranës.

---

<sup>174</sup> PK Dajt, Annex 2, *Peizazhi kulturor dhe trashëgimia*. fq. 24.

*Lidhur me menaxhimin e ujit, sugjerohet:*

- a. instalimi i një sistemi monitorimi të thjeshtë dhe të besueshëm, të bazuar në rrjetin e stacioneve automatike meteorologjike dhe hidrologjike;
- b. studimi i natyrën dhe shkaqeve të problemeve të cilësisë së ujit të Bovillës, bazuar në analiza laboratorike;
- c. marrja e masave të rrepta për të mbajtur larg bagëtinë nga ujëmbledhësi dhe rrjedhjeve ujore kryesore që shkarkohen në të;
- d. identifikimi i mundësisë së ndërtimit të ujëmbajtësve të tjerë për ujitje etj.

### **V.3.3 Ndotja e tokës**

Ndotja e tokës shkaktohet kryesisht nga mbishfrytëzimi, bujqësia intensive, përdorimi i tepruar i pesticideve, veçanërisht në afërsi të tokave të shfrytëzueshme dhe të fshatrave.

Nga njëra anë, sistemi tradicional i bujqësisë formon një pjesë të peizazhit kulturor, dhe duhet mbrojtur, por nga ana tjetër, shkakton erozion dhe degradim, duke shkaktuar paqëndrueshmëri në përdorimin e tokës, prandaj është e domosdoshme të merren masa të menjëhershme për parandalimin e degradimit të mëtejshëm dhe krijimin e kushteve për rikrijimin e tokave, të tilla si:

- a. ruajtja dhe mbështetja e praktikave dhe zonave ekzistuese të kultivimit, që janë produktive dhe të qëndrueshme. Për këtë duhet bërë një punë më e mirë nga specialistët e bujqësisë në të dy komunat.
- b. heqja nga përdorimi bujqësor i tokave bujqësore të degraduara dhe të pa stabilizuara, sidomos në shpate të pjerrëta. Të tilla hasim në fshatrat Priskë e Darshen në komunën Dajt, apo Klllojkë e Shalqizë në komunën Bërzhitë.
- c. aplikimi i kulturave rikrijuese të tokave dhe krijimi i kushteve për ripyllëzimin natyror të këtyre zonave. Këto masa janë marrë kryesisht në komunën Dajt, por në komunën Bërzhitë janë të pakta. Në këtë, gjatë viteve 2008-2012, nuk ka asnjë parcelë të mbjellë me drurë të rinj.
- d. në rastet e ripyllëzimeve, është e këshillueshme që të mos përdoren fidanë pishash, por lloje indigjene drurësh , që janë me përfitim për njerëzit dhe për botën e egër;
- e. intensifikimi i prodhimit në zonat potenciale, kryesisht nëpërmjet tarracimit, masave përmirësuese të tokës dhe të sistemeve të ujitjes.

E lidhur drejtpërdrejt me mbrojtjen e tokës është edhe ruajtja e rezervave të ujit që depozitohet në shtresat e sipërme të saj pas reshjeve. Kur shtresa e tokës zhduket ose ngjishet (nga mekanika bujqësore dhe kafshët), uji nuk depozitohet, por rrjedh në sipërfaqe, duke mos ndikuar sa dhe si duhet në zhvillimin bimësisë dhe të gjithë ekosistemit. Nisur nga sasia e konsiderueshme e reshjet që bien në këto zona, duket si më mundshme që uji për ujitje të depozitohet në ujëmbajtës të vegjël, duke ndikuar edhe në uljen e forcës shkatërruese të reshjeve dhe erozionit.

### ***V.3.4 Mirëmenaxhimi i florës dhe faunës së pyjeve***

Si rrjedhojë e shfrytëzimit të vazhdueshëm dhe pa kriter, shpyllëzimeve për hapjen e tokave të punueshme, mbikullotjes etj, pyjet janë pakësuar. Pas vitit 1990, presioni human mbi pyjet e mbetura është rritur, si nëpërmjet shfrytëzimit për dru zjarri dhe nxjerrjes së lëndës drusore, ashtu edhe për hapjen e kullotave dhe të trojeve për ndërtim, infrastrukturës rrugore etj. Gjithashtu, në pakësimin e pyjeve kanë ndikuar zjarret e herë pas hershme, shpesh dhe të qëllishme nga banorët vendas, për t'i kthyer ato në kullota. I tillë ishte rasti i zjarrit në një zonë me kullota, pranë fshatit Priskë e Madhe, më 13 korrik 2012. Sipas specialistëve të komunës nga flakët u dogjën rreth 5 ha me shkurre.

Sot është shumë e vështirë që të gjenden pyje të vjetër, përveç dy sipërfaqeve në PK të Dajtit: në Qaf Mollë dhe Bulçesh. Sipërfaqet e tjera pyjore janë të degraduara.

Pavarësisht rëndësisë që kanë pyjet për mbrojtjen e tokës dhe ujit, klimë dhe ajrin, si dhe për zhvillimin e botës së egër etj, banorët e zonës i kanë prerë drurët dhe shkurret për të zgjeruar sipërfaqet me kullota, sepse kanë pasur interes më të madh për mbarështimin e bagëtive.

Procesi i rimbjelljes ka ecur ngadalë ose ka ngecur, për shkak të mungesës së kujdesit, fondeve dhe konkurrencës në përdorimin e tokës.

*Në këto rrethana, është e rëndësishme të merren masat të tilla si:*

- a. nxitja e sistemeve silvo-pastorale në tokat e komunave në zonën veriore të PK të Dajtit;
- b. mbjellja e llojeve drusore shumëpërdorimshme, si ato frutore, leguminoze, arrat, gështenjat, qershitë etj;
- c. kontrolli dhe menaxhimi i zjarreve, sidomos gjatë periudhës së nxehtë të vitit, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit të banorëve, riorganizimin dhe pajisjes me mjetet e nevojshme të ekipeve të Mbrojtjes kundër Zjarrit (MKZ-ve), krijimin e mozaikut të peizazhit, që parandalon përhapjen e zjarreve etj;
- d. pyllëzimi i tokave të degraduara me lloje drurësh shumëpërdorimësh, më mirë se sa me pisha;
- e. mbrojtja e pyjeve ekzistuese, në mënyrë që të mbrohen ato pak drurë të vjetër, që kanë mbetur si dëshmitarë në PK e Dajtit;
- f. rishikimi dhe rregullimi i planeve të menaxhimit të pyjeve komunale dhe atyre publike në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- g. kontrolli i gjuetisë së paligjshme dhe jashtë sezonit të përcaktuar.

Sot gjuetia tradicionale lejohet jashtë sezonit të shumimit, për një numër të caktuar kafshësh dhe shpendësh dhe kur subjekti zotëron autorizimin përkatës. Sidoqoftë, kontrolli për këtë aktivitet është i vështirë, prandaj gjuetia e paligjshme mbetet problem shumë serioz, me ndikim shumë negativ në faunën e zonës, e cila është pakësuar ndjeshëm.

## ***Përfundime dhe sugjerime***

### ***Përfundime***

Komunat Dajt dhe Bërzhitë kanë pozitë gjeografike të favorshme që mundëson zhvillimin e një ekonomie shumëdegëshe dhe një lidhje të shpejtë me rajonet e qendrat urbane më të rëndësishme të vendit. Ato bëjnë pjesë në Rajonin Perëndimor të Shqipërisë që është dhe rajoni më i zhvilluar dhe me kushtet më të favorshme fiziko-gjeografike.

Gjithashtu, të dy komunat janë të favorizuara nga afërsia e tyre me qytetin e Tiranës, duke e parë këtë si një treg mjaft të mirë për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale por dhe si një mundësi të mirë për punësim. Me ndërtimin e tunelit të Elbasanit e autostradës së re, Tiranë-Elbasan, për komunën e Bërzhitës krijohet dhe një tjetër mundësi zhvillimi.

Pasuritë klimatike, relievi kryesisht kodrinor, hidrografia e pasur, tokat përgjithësisht pjellore, shumëllojshmëria e florës dhe e faunës, përbëjnë faktorët kryesorë natyrorë që favorizojnë zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së këtyre dy komunave.

Relievi kryesisht kodrinor, favorizon zhvillimin e veprimtarive kryesore humane dhe ekonomik. Ai mundëson zhvillimin e bujqësisë e blegtorisë si dhe të degëve të tjera të ekonomisë që janë të zhvilluara në të dy komunat. Ai lehtëson zgjerimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore, përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive të përparuara në bujqësi, blegtori, agroindustri etj.

Në të dy këto komunat mbizotëron një klimë mesdhetare kodrinore dhe paramalore me dimër të ftohtë e të lagësht dhe verë të nxehtë e të thatë. Ato kanë një klimë të shëndetshme e të përshtatshme për veprimtari turistike të shumëllojshme, por temperaturat e larta në verë e përqëndrimi i reshjeve gjatë dimrit krijojnë probleme për bujqësinë.

Ato kanë pasuri të shumta ujore si lumenj, liqene burime të ujërave minerale të përshtatshme për t'u menaxhuar dhe përdorur në interes të veprimtarive jetësore dhe ekonomike të popullsisë së tyre.

Tokat janë relativisht të pasura (të hirta në kafe, të kafenjta dhe aluvionale) dhe favorizojnë mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore. Problemi më shqetësues për tokat e këtyre zonave është erodimi i tyre i fuqishëm, që shpesh shoqërohet me shembje të mëdha gjë që çon çdo vit në pakësimin e konsiderueshëm të fondit të tokës bujqësore.

Shkalla e lartë e biodiversitetit në të dy komunat, sidomos në komunën e Dajtit ku shtrihet dhe Parku Kombëtar i Dajtit, paraqet interes shkencor në rritje dhe përbën bazën për zhvillimin e turizmit shkencor.

*Rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të komunave Dajt dhe Bërzhitë kanë dhe trashëgimia e pasur historike dhe faktorët humanë.*

Të dy komunat dallohen për një popullim të hershëm të tyre. Në komunën e Dajtit gjenden zbulime arkeologjike që i përkasin paleolitit të lartë. Veglat e punës të kësaj periudhe përbëhen kryesisht nga vegla stralli të tipit aurinjacien, të një përvoje më të përparuar teknike dhe me forma më të larmishme, kryesisht thika, kruese dhe geryese. Së bashku me veglat prej stralli, në depozitën rrëzë Dajtit, janë gjetur edhe disa vegla prej



koçke, të cilat në këtë kohë marrin një përdorim të gjërë krahas përsosjes së mëtejshme të punimit të strallit.

Një dëshmi tjetër e rëndësishme arkeologjike që dëshmon për vazhdimësinë e popullimit të kësaj zone është dhe Kalaja e Dajtit që është shpallur monument kulture i kategorisë së parë.

Zbulimet e bëra në Shpellën e Zezë (Pëllumbasit), në komunën e Bërzhitës, dëshmojnë që kjo zonë ka qenë e populluar që nga paleoliti e në mesjetën e hershme (sipas konfirmimit të Institutit të Arkeologjisë të Akademisë tonë të Shkencave). Ndër gjetjet e para dhe me vlerë të veçantë janë disa fragmente stralli, që i përkasin paleolitit të vonshëm, disa fragmente të enëve prej balte, nga të cilat më të hershmet i përkasin neolitit, pra 7000 – 3000 vjet para erës sonë, gjetje të epokës së bronzit dhe të hekurit, me moshë afërsisht 2000-500 vjet p.e. sonë.

Gjithashtu burime të shkruara dëshmojnë që Kllojka dhe Përsqopi (mbi fshatin Dobresh) kanë patur një qytetërim që prej 2000 vjetësh. Emrat Ibë, Bërzhitë, Dobresh flasin për një ndikim të qytetërimit sllav. Po kështu dhe ullinjët e kultivuar prej shekujsh që gjenden në këtë zonë vërtetojnë që kjo zonë ka qenë e populluar prej kohësh.

Duke iu referuar të dhënave të Census-it 2011, numri i popullsisë në komunën Dajt është shumë më i lartë se në komunën e Bërzhitës (20139 banorë/ 4973 banorë). Rritja e popullsisë në komunën e Dajtit ka qenë e lartë. Në vitin 2011 numri i popullsisë është dyfishuar në krahasim me vitin 2001. Në rritjen e shpejtë të popullsisë së kësaj komune kanë ndikuar këto faktorë:

- ❖ saldo migruese positive gjatë kësaj periudhe;
- ❖ rritja e numrit të lindjeve;
- ❖ ulja e numrit të vdekjeve;
- ❖ kthimin e një pjese të emigrantëve në vendlindje.

Ndërsa në komunën e Bërzhitës numri i popullsisë ka ardhur duke u ulur me ritme jo të larta. Ky zvogëlim i numrit të popullsisë së kësaj komune ka lidhet me:

- ❖ uljen e numrit të lindjeve pasi saldo migruese paraqitet pozitive gjatë kësaj periudhe.

Rritjen më të madhe të popullsisë në komunën e Dajtit e kanë patur fshatrat Qesarakë, Linxë. Shtish-Tufinë, Lanabregas e Priskë e Madhe, ndërsa në komunën Bërzhitë rritjen më të madhe të popullsisë e kanë patur fshatrat Bërzhitë, Ibë e Sipërme, Ibë e Poshtme dhe Pëllumbas. Kjo rritje e popullsisë lidhet me pozitën e tyre më të favorshme gjeografike dhe me kushtet më të mira të jetesës si pasojë e një niveli më të zhvilluar ekonomik se fshatrat përreth.

Fshatrat që kanë patur zvogëlim të numrit të popullsisë në komunën e Dajtit janë Shkallë, Murth, Selbë e Darshen, ndërsa në komunën e Bërzhitës fshatrat Pashkashesh, Lugë, Fravesh dhe Rozaverë. Kjo lidhet kryesisht me kushtet jo të përshtatshme fiziko-gjeografike, sipërfaqen e kufizuar të tokës bujqësore e nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të këtyre fshatrave.

Në komunën Dajt shtimi natyror i popullsisë është rritur në krahasim me vitin 2001, nga 7,6% në 8,8%, dhe kjo si pasojë e rritjes së numrit të lindjeve, që në 2011 ishin 13,1%. Numri i lindjeve në këtë komunë paraqitet më i lartë se në shkallë vendi, që sipas Census-it 2011, ishte 12,048%. Po kështu ka ndikuar dhe ulja së numrit të vdekjeve në 4,3%. ( më e ulët se në shkallë vendi, që sipas Census-it 2011 ishte 7,08 %.

Duke u mbështetur në të dhënat e Census-it 2001 e 2011, dendësia e popullsisë në komunën Dajt ka njohur rritje nga 73.15 b/km<sup>2</sup> në 2001 në 173.6 b/km<sup>2</sup> në 2011, ndërsa në komunën Bërzhitë vihet re ulje e saj nga 95.38 b/km<sup>2</sup> në 2001 në 87.24 b/km<sup>2</sup> në 2011.

Në komunën Bërzhitë shtimi natyror i popullsisë në vitin 2011 ka pësuar një ulje të lehtë në krahasim me vitin 2001, nga 5,7‰ në 5,5‰, dhe kjo, kryesisht si rezultat i uljes së numrit të lindjeve, nga 11,3‰ në vitin 2001 në 10‰ në vitin 2011, pasi numri i vdekjeve është ulur nga 5,6‰ në vitin 2001 në 4,5‰ në vitin 2011. Këta tregues paraqiten më të ulët se në shkallë vendi.

Numri i familjeve në komunën e Dajtit ka ardhur duke u rritur. Disa nga faktorët që kanë ndikuar në këtë rritje janë:

- ❖ ritmet pozitive në ecurinë e numrit të popullsisë;
- ❖ ardhja e familjeve të reja në këto komuna për shkak të shtrirjes së tyre pranë qytetit të Tiranës si dhe kushteve të favorshme fiziko-gjeografike që ofroj kjo komunë;
- ❖ ulja e numrit të anëtarëve për familje dhe kjo lidhet me formimin e një kulture të re që po zhvillohet në fshatrat tona, drejt krijimit të familjeve të vogla kundrejt familjeve tradicionale me shumë anëtarë dhe disa brezini;
- ❖ shtimi i mundësive për strehim etj.

Ndërsa në komunën Bërzhitë, numri i familjeve ka ardhur duke u ulur dhe kjo lidhet me zvogëlimin e numrit të popullsisë për shkak të uljes së numrit të lindjeve.

Madhësia e familjes në komunën e Bërzhitës paraqitet pak më e lartë se në komunën e Dajtit (4,54 anëtarë/ 4,15 anëtarë) dhe kjo shpjegohet më faktit e të qënurit një popullsi më autoktone dhe më e lidhur me traditën. Po kështu kanë ndikuar dhe kushtet më pak të favorshme për strehim e mundësitë më të pakta ekonomike që kanë banorët e kësaj komune.

Në komunën e Dajtit kemi një përqindje më të lartë të grupmoshës 0-14 vjeç se në komunën e Bërzhitës (23,73 % / 21,09%), dhe kjo lidhet me numrin më të lartë të lindjeve në këtë komunë. Po kështu, kemi një përqindje më të lartë në komunën e Dajtit dhe të grupmoshës së aftë për punë 15-64 vjeç, që tregon për një potencial më të madh të kësaj komune. Për grupmoshën mbi 65 vjeç komuna e Dajtit ka përqindjen më të ulët (7,16 % / 9,59%), gjë që flet për mundësi më të pakta të saj për plakjen e popullsisë.

Raporti midis gjinive është i rëndësishëm. Sa më i ngushtë të jetë ndryshimi midis gjinive aq më të shumta do të jenë mundësitë për çiftëzim, integrim dhe bashkëpunim midis tyre për zhvillimin e zonës. Mbizotërimi i theksuar i njërit gjini shkakton probleme sociale dhe ekonomike për gjininë tjetër, për familjen e komunitetin.

Në të dy komunat ky tregues është pozitiv dhe ky fenomen dhe raportet e pranueshme pritet të vazhdojnë dhe në të ardhmen. Meshkujt përbëjnë 50,8 % të popullsisë në komunën Dajt dhe 50,6 % në komunën Bërzhitë.

Treguesit e punësimit janë më të lartë në komunën e Dajtit se sa në atë të Bërzhitës. Në të dy komunat rreth 70 % e të punësuarve i përkasin sektorit primar, bujqësisë, dhe pjesa tjetër ndahet midis sektorit terciar dhe ndërtimtarisë.

Në pikpamje etnike, popullsia e të dy komunave është homogjene. Duke iu referuar besimit fetar mbizotëron popullsia myslimane në të dy komunat.

Vendbanimet në të dyja njësitë janë ngritur e zhvilluar në pozicione gjeografike të favorshme. Ato janë ndërtuar pranë rrugëve, në kodrat e ulëta e gjatë luginave lumore. Vihen re ndryshime midis vendbanimeve të ndërtuara gjatë regjimit komunist dhe atyre të ndërtuara

pas viteve 1990 për nga stili, numri i kateve, materiale, materialet që janë përdorur në ndërtime, largësia e ndërtesave, mobilimi etj.

Karakteristika të organizimit hapësinor të vendbanimeve pas vitit 1990 janë:

- ❖ përhapja pa planifikim i ndërtimeve;
- ❖ shtimi i ndërtimeve administrative, tregtare e rezidenciale;
- ❖ ngushtimi i rrugëve të lagjeve dhe atyre kryesore;
- ❖ organizimi i brendshëm dhe i jashtëm i banesave sipas modeleve perëndimore etj.

Ecuria e numrit të ndërtimeve është në varësi të numrit të popullsisë. Në komunën e Dajtit, për shkak të dyfishimit të popullsisë në periudhën 2001-20011, por dhe cilësisë së mjedisit, numri i ndërtimeve ka një rritje të shpejtë. Kështu, gjatë periudhës 1981-1990 në komunën e Dajtit janë bërë 149 ndërtime, ndërsa pas viteve 1990, përkatësisht në vitet 1991-2000, janë bërë 843 ndërtime, kurse gjatë viteve 2001-2011, 942 ndërtime. Kjo lidhet jo vetëm me shtimin e popullsisë së vet komunës, por dhe me numrin e madh të të ardhurve në këtë zonë.

Ndryshe paraqitet situata në komunën e Bërzhitës ku numri i ndërtimeve ka ardhur duke u ulur pas viteve 1990. Kështu, gjatë periudhë 1981-1990, numri i ndërtimeve ishte 142, ndërsa në periudhën 1991-2000 u bënë 86 ndërtime dhe kjo për shkak të largimit të popullsisë. Në periudhën 2001-2011 vihet re një rritje e ngadalte e numrit të ndërtimeve, 166 ndërtime dhe kjo lidhet më shumë jo me rritjen e popullsisë, sesa me ndarjen e familjeve dhe investimet e emigrantëve.

Furnizimi me energji elektrike, ujë, sistemi i kanalizimeve dhe grumbullimi i mbetjeve urbane, në të dy komunat sigurohet nga shteti. Cilësia e këtyre shërbimeve shfaq probleme dhe në disa raste ngadalëson ose pengon zhvillimin e disa veprimtarive jetësore dhe ekonomike.

*Zhvillimi i qëndrueshëm i komunëve Dajt dhe Bërzhitë ndikohet në një masë jo të vogël nga infrastruktura arsimore, shëndetsore etj.*

Në komunat e marra në studim raportet shkollë/nxënës e mësues/nxënës janë relativisht të mirë. Ato janë më të lartë në komunën e Dajtit, për shkak dhe të numrit më të madh të nxënësve.

Në komunën e Dajtit ekziston mesatarisht një shkollë për 127 nxënës, ndërsa në komunën Bërzhitë kemi një shkollë për 183 nxënës.

Raporti nxënës/mësues në komunën e Dajtit është një mësues për 17.1 nxënës, ndërsa në komunën e Bërzhitës ky tregues është një mësues për 13.5 nxënës, ndërsa në shkallë vendi është 1/16,5 dhe për vendet e OECD një mësues për 14,4 nxënës.

Raporti kopësht/fëmijë në komunën e Dajtit është një kopësht për 40 fëmijë. ndërsa për komunën e Bërzhitës është një kopësht për 29 fëmijë.

Raporti edukatore/ fëmijë në komunën e Dajtit është një me 25.8 fëmijë dhe në komunën e Bërzhitës është një me 16.57 fëmijë, ndërsa në shkallë vendi është 1/18,9 dhe në vendet e OECD një edukatore për 12,3 fëmijë.

Këta tregues janë pozitivë për të dy komunat prandaj duhet të bëhet një punë më e madhe në arsimimin e nxënësve.

Mungesa e çerdheve për fëmijët 1-3 vjeç në të dy komunat vështirëson angazhimin në punë të prindërve të rinj.

Niveli i arsimimit të popullsisë është relativisht i kënaqshëm në të dy komunat. Këto tregues paraqiten më mirë në komunën e Dajtit. Kështu, përqindja e popullsisë analfabete në komunën e Bërzhitës është më e lartë se në komunën e Dajtit, përkatësisht 3.49% me 1.38% që është në komunën e Dajtit. Përqindja e popullsisë analfabete në Shqipëri, sipas të dhënave të CENSUS-it 2011, është 2,8 %.

Ndërsa, ajo që bie në sy, është përqindja më e lartë e popullsisë me arsim fillor, 8-9 vjeçar e të mesëm më të lartë në komunën e Bërzhitës se sa në komunën e Dajtit.

Dhe treguesi më i rëndësishëm që flet qartë për shkallën më të lartë të arsimimit të popullsisë në komunën e Dajtit, është përqindja e lartë e popullsisë më arsim të lartë 11.64% kundrejt 6 % të popullsisë në komunën e Bërzhitës.

Ajo çka është e rëndësishme të theksojmë për të dy komunat është se shkalla e arsimimit të popullsisë ka ardhur duke u rritur e kjo lidhet me zhvillimin ekonomik në rritje të tyre, me rëndësinë më të madhe që po i kushtohet arsimit, por kjo lidhet dhe me traditën e mirë që ka populli shqiptar si një popull arsimdashës.

*Shërbimi shëndetsor* në hapësirat rurale është një faktor që ndikon në vendimin e shumë banorëve për të qëndruar ose jo në vendbanimin e tyre.

Raporti mjek/banorë në komunën e Bërzhitës është 1/ 994.6 pak a shumë sa mesatarja e Shqipërisë por më e lartë se mesatarja në Europë, ndërsa raporti infermiere/banorë është pak më i mirë 1 infermiere për 292.5 banorë.

Në komunën e Dajtit raporti mjek/banorë është 1 mjek/ 1342.6 banorë dhe raporti infermiere banorë është 1 infermiere/ 875.6 banorë.

Këta tregues paraqiten më favorizues në komunën e Bërzhitës se sa në komunën e Dajtit.

Investimet e mëtejshme në këtë sektor janë të rëndësishme së veçantë për ruajtjen e shëndetit të banorëve, përmirësimin e strukturës së popullsisë etj.

Në të dy komunat janë të pakta ose mungojnë strukturat dhe objektet kryesore kulturore dhe sportive. Nuk ka kinema, muze, qendër kulture, terrenet sportive janë të pakta dhe me kushte të papërshtatshme për zhvillimin e veprimtarive sportive.

Mënyra e jetesës në familjet e të dy komunave ka shfaqur ndryshime të vogla, që vihen re kryesisht në familjet e reja, pasi ato ndikohen më pak nga tradita, duke qenë se shumica e tyre jeton në banesa të veçanta. Mënyra tradicionale e organizimit të brendshëm të familjes, vendimarrjes brenda saj etj, ruhet në të dy njësitë.

*Në strukturën ekonomike të komunës Dajt dhe Bërzhitë mbizotëron sektori primar(bujqësia, blegtoria etj.) si për të ardhurat që siguron, ashtu dhe për numrin e të punësuarve, investimet etj. Në vend të dytë renditet sektori terciar (kryesisht turizmi), ndërsa në të treti ai sekondar.*

Zhvillimi i bujqësisë në komunën Dajt dhe Bërzhitë, ashtu si në gjithë vendin tonë, ka kaluar në disa stade gjatë të cilave kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme që kanë ndikuar në organizimin e saj, nivelin e mekanizimit, si dhe në specializimin e prodhimit. Prodhimet bujqësore, kryesisht drithërat (gruri, misri, thekra etj.) dhe perimet, zinin vendin kryesor në raport me blegtorinë sidomos në fshatrat që shtriheshin në lartësi të ulëta mbi nivelin e detit.

Në fshatrat që shtriheshin në lartësi më të mëdha për shkak të kufizimit të tokës bujqësore, të kushteve klimatike, të ekzistencës së sipërfaqeve të pyjeve e kullotave ishte e

zhvilluar blegtoria. Qëllimi kryesor i fshatarëve në këtë periudhe ishte që të prodhonin sasinë e mjaftueshme për nevojat familjare.

Në vitin 1946, si në gjithë Shqipërinë dhe në këto zona u zbatua Ligji i Reformës Agrare që u shoqërua me konfiskimin e tokës nga shteti e rishpërndarjen e saj fshatarëve pa ose me pak tokë. Shpronësimet e pronave gjatë kësaj periudhe u bënë pa asnjë kompensim të pronarëve ekzistues. Me tokën u konfiskuan nga shteti dhe mjetet e prodhimit. Njëkohësisht niveli i mekanizimit ishte shumë i ulët. Pjesa më e madhe e punëve bëhej me dorë. Përdorimi i pesticideve ishte i ulët. Pyjet, kullotat ishin pronë e shtetit por që shfrytëzoheshin nga banorët e këtyre zonave.

Shpërbërja e kooperativave bujqësore pas përmbyesjes së regjimit komunist dhe zbatimi i Ligjit për Tokën, nr. 7501, sollën rikthimin e pronës private, copëtimin e madhe të tokës bujqësore, ndryshimin e sistemit të kulturave etj.

Sot, bujqësia është e organizuar dhe funksionon sipas parimeve të ekonomisë së tregut, djë që ka sjellë ndryshime në përdorimin e tokës bujqësore.

Sipërfaqja e mbjellë me kultura bujqësorë në komunën Dajt është 1725,3 ha dhe në komunën Bërzhitë është 1308,9 ha, pra 416,4 ha më shumë në komunën Dajt dhe kjo lidhet me mundësitë më të mira që ekzistojnë në këtë komunë e sipërfaqen e saj më të madhe se komuna Bërzhitë.

Pyjet në komunën Dajt zënë një sipërfaqe prej 6252,6 ha, por vetëm 1795,7 ha administrohen nga komuna Dajt, ndërsa kullotat dhe livadhet 36.1 ha. Në komunën Bërzhitë pyjet zënë një sipërfaqe prej 3297,85 ha, ndërsa kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe prej 44,5 ha.

Siç e shohim, sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave është më e madhe në komunën e Bërzhitës dhe kjo lidhet me:

- me popullimin më të paktë të komunës Bërzhitë;
- me ndërtime më të pakta që janë bërë në komunën Bërzhitë;
- në komunën Dajt numri i popullsisë është dyfishuar këto 20 vitet e fundit dhe është rritur sipërfaqja e zënë më ndërtime, kryesisht pallate si në fshatin Qesarakë, por dhe të vilave private si në fshatin Linxë, Shtish-Tufinë, Prezë etj.
- jo e gjithë sipërfaqja e Parkut Kombëtar të Dajtit përfshihet në komunën Dajt.

Duke krahasuar strukturën e prodhimeve kryesore që mbillen në këto komuna arrijmë në këto përfundime:

- Sipërfaqja e mbjellë me bimë të arave zë pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës së punueshme (70,16 % në komunën Dajt kundrejt 77,6% në komunën Bërzhitë). Kjo sipërfaqe paraqitet më e lartë në komunën Bërzhitë për shkak të relievit më fushor të saj. Sipërfaqja e mbjellë me grurë dhe misër, është pak a shumë e njëjtë në të dy komunat dhe në vite ka ardhur duke u zvogëluar. Është rritur sipërfaqja e mbjellë me foragjere të njoma, si dhe sipërfaqja e mbjellë me perime, fasule e patate.
- Sipërfaqja e mbjellë me pemë, kryesisht drufrutorë si mollë, kumbulla, qershii etj. është më e madhe në komunën Bërzhitë. Ajo zë 10,5 % të sipërfaqes së tokës së punueshme, kundrejt 8,569 % në komunën Dajt. Kjo lidhet me kushtet shumë të përshtatshme të kësaj komune për mbjelljen e drufrutorëve, por dhe me shkatërrimin e madh të tyre, prerjen masive, në komunën e Dajtit pas vitit 1990-të.
- Sipërfaqja e mbjellë me ullinj është dyfish më e lartë në komunën Dajt 20,29 % kundrejt 10,7 % në komunën Bërzhitë, dhe kjo shpjegohet kryesisht që kjo kulturë

nuk u prek nga shkatërrimet e prerjet masive gjatë periudhës së tranzicionit. Dhe për të dy komunat në vitet e fundit është karakteristike rritja e investimeve për mbjelljen e ullirit.

- Sipërfaqja e vreshtave është pak më e lartë në komunën Bërzhitë, ku sipërfaqja e mbjellë me vreshtë zë 1.04 % nga 0,89 % që zë në komunën Dajt. Kjo sipërfaqe në të dy komunat ka ardhur duke u rritur vitet e fundit, kjo dhe për shkak të përpunimit të tij e prodhimit të rakisë dhe verës, jo vetëm për prodhim familjar por dhe tregtimin e tyre kryesisht në restorantet e shumtë që janë hapur në të dy komunat.

Komunat Dajt dhe Bërzhitë dallohen edhe për prodhimet cilësore blegtorale, që plotësojnë nevojat e banorëve, të tregjeve të afërta (Tiranës), si dhe të sektorit të turizmit.

Përsa i takon numrit të gjedhëve ai paraqitet më i lartë në komunën e Dajtit se sa në atë të Bërzhitës ( 1382 / 911) dhe kjo lidhet me kushtet më të përshtatshme që ka kjo komunë.

Numri i bagëtisë së imët (deleve dhe dhive), paraqitet më i lartë në komunën Bërzhitë se sa në atë të Dajtit ( 5013 / 4220) dhe jo i detikohet përparësisë që i kanë dhënë banorët e kësaj zone mbarështimit të tyre duke iu përshtatur kushteve të relievit.

Numri i shpendëve paraqitet më i lartë në komunën e Dajtit dhe kjo lidhet me numrin më të madh të popullsisë në këtë komunë.

Përsa i takon prodhimit të mjaltit në të dy komunat ekzistojnë koshere bletësh, por mund të themi që ky sektor nuk luanndonjë rol të rëndësishëm në ekonominë e të dy komunave.

Bujqësia dhe blegtoria nuk mund të zhvillohen nëse nuk sigurohet furnizimi me ujë në sasinë dhe cilësinë e nevojshme. Në zonat e marra në studim vetëm rreth 50% e sipërfaqes së tokës bujqësore ka sistem ujëtës funksional. Pjesa tjetër, ku ky sistem nuk ekziston ose është pak i zhvilluar, dallohet për prodhim të pakët dhe jo cilësor.

Agroindustria dhe artizanati shihen si degë me perspektivë në të dy komunat pasi kushtet natyrore mundësojnë zhvillimin e tyre. Në komunën e Dajtit ushtrojnë veprimtarinë e tyre 373 biznese, nga të cilat 23 prej tyre i përkasin sektorit të agroindustrisë, ndërsa në komunën e Bërzhitës 70 biznese. Kjo kushtëzohet nga disa faktorë si:

- Popullimi më i madh i komunës Dajt
- Kushteve e mundësive më të shumta që ka kjo komunë etj.

Në komunën e Bërzhitës agroindustria nuk është e zhvilluar. Përpunimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet në kushtë të shtëpisë dhe në pjesën më të madhe për plotësimin e nevojave familjare. Të pakta janë familjet që tregtojnë këto produkte në tregje apo lokalet pranë tyre.

Ekziston një traditë shumë e mirë dhe lëndë e parë për zhvillimin e artizanatit në të dy komunat, por që duhet mbështetur me investime e gjetje të tregjeve për shitjen e këtyre produkteve nga pushteti vendor.

Zhvillimi i turizmit është një ndër burimet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të të dy komunave. Në vizionin e tyre ato synojnë krijimin e bazave për një turizëm energjik dhe të integruar me mirëpordorimin e burimeve dhe pasurive natyrore të tyre, për të siguruar më shumë të ardhura, vende pune, tërheqjen e njerëzve për të mos u larguar nga venbanimet e tyre, rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe historike.

Shfrytëzimi i potencialeve turistike është më i lartë në komunën e Dajtit se sa në atë të Bërzhitës, gjë që ka sjellë të ardhura më të mëdha dhe një numër më të madh të punësuarish

në këtë sektor për këtë komunë. Ndërtimi i teleferikut “Dajti Ekspres”, ka shumfishuar numrin e turistëve që vizitojnë Parkun Kombëtar të Dajtit, duke rritur më shumë mundësitë për zhvillimin e turizmit në këtë komunë.

Përmirësimi i infrastrukturës në komunat Dajt dhe Bërzhitë si ndërtimi i rrugës së Arbrit, ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan,(tuneli i Elbasanit), do të mundësojnë zhvillimin më të madh të turizmit në këto zona.

*Infrastruktura rrugore* është element i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të të dy komunave. Vitet e fundit është rritur vëmendja dhe investimet e pushtetit qendror dhe atij vendor në drejtim të përmirësimit të rrugëve që të çojnë në destinacionet turistike. Përfundimi i autostradës Tiranë-Elbasan, vazhdimi i punimeve për rrugën e Arbrit, do të kenë impaktet e tyre pozitive në zhvillimin ekonomik të të dy komunave.

Telekomunikacioni dhe teknologjia informuese janë përmirësuar ndjeshëm nga përhapja e telefonisë fikse e celulare si dhe përdorimi i internetit.

\* \* \*

***Duke iu referuar hipotezës së këtij studimi dhe mbështetur në analizat e hollësish të treguesve dhe komponentëve të karakterit natyror, demografik, social, ekonomik dhe mjedisor, në një këndvështrim krahasues, del se të dyja komunat kanë hedhur hapat e para në rrugën e zhvillimit social-ekonomik e mjedisor të qëndrueshëm. Komuna Dajt dallohet për ritme e qëndrueshmëri më të lartë se ajo Bërzhitë, por ky zhvillim është i brishtë, ashtu si në gjithë Shqipërinë.***

## **Sugjerime**

Komunat Dajt dhe Bërzhitë me potenciale të mëdha natyrore, historike dhe kulturore, do të rrisin përfitimet social-ekonomike dhe mjedisore vetëm nëse do të hartojnë dhe zbatojnë strategji të detajuara e të bazuara në kushtet reale të ekosistemit.

Sigurimi i vazhdimësisë dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike të të dy komunave duhet të përqëndrohet në katër drejtime të rëndësishme:

- në vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore;
- në përmirësimin dhe ruajtjen e treguesve demo-social në parametra që mbështesin zhvillimin;
- në orientimin e ekonomisë drejt sektorëve që sigurojnë njëkohësisht përfitime financiare dhe natyrore;
- në ruajtjen e menaxhimin e mjedisit;

Për arritjen e këtyre objektivave, popullsisë vendase, qeverisjes lokale e qëndrore u sugjerohet që:

### **A. Për vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore:**

- ❖ Shfrytëzimi më me efikasitet i pozitës së favorshme gjeografike, shtrirjes së tyre në rajonin më të zhvilluar, në Rajonin Perëndimor, dhe shumë pranë kryeqytetit të vendit, Tiranës, për të shfrytëzuar tregjet e afërta për shitjen e produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe të produkteve të përfutuara nga përpunimi i tyre;
- ❖ Të nxiten aktivitetet e të mbillen ato produkte bujqësore që favorizohen nga kushtet klimatike dhe të merren masa për mënjanimin e efekteve negative të saj si përqëndrimin të reshjeve në stinën e dimrit, ngricat ;
- ❖ Rritja e investimeve në sistemin e kanaleve ujitëse, stacioneve të pompimit, kanaleve kulluese;
- ❖ Të merren masa për ruajtjen e tokës nga erozioni nëpërmjet mbjelljes së pemëve etj., pasi të dy komunat dallohen për vlera të larta erodimi të përcaktuara nga ndërtimi gjeologjik, relievi, kushtet klimatike etj. Vëmendja e pushtetit lokal duhet të drejtohet dhe në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së tokës nëpërmjet përdorimit me kriter të pesticideve, qarkullimit të kulturave bujqësore;
- ❖ Të sigurohet ruajtja dhe shtimi i biodiversitetit duke zbatuar me korrektësi legjisllacionin në fuqi;
- ❖ Të shfrytëzohen me racionalitet dhe të ruhen me fanatizëm pasyritë natyrore dhe kulturore që gjenden në të dy komunat;

### **B. Për ruajtjen dhe përmirësimin e treguesve demo-social që ndikojnë drejpërsëdrejti në zhvillimin e qëndrueshëm në të dy komunat:**



- ❖ Të ruhen qendrat historike dhe arkeologjike e të shfrytëzohen ato për të nxitur turizmin historik dhe kulturor si psh kalaja e Dajtit, Ura e Brarit, Shpella e Zezë etj.
- ❖ Ruajtja e ritmeve pozitive të shtimit të popullsisë nëpërmjet përmirësimit të kushteve të jetesës, sigurimit të mundësive më të mëdha për arsimim e shërbime shëndetsore etj.
- ❖ Shtimi natyror dhe saldoja migruese janë tregues të rëndësishëm që duhet të mbahen në vlera positive. E para siguron vazhdimësinë dhe eviton procesin e plakjes së popullsisë, e dyta për ruajtjen e raporteve midis grupmoshave etj.
- ❖ Përmirësimi i vlerave të koeficientit të lindjeve, e kjo sidomos në komunën e Bërzhitës, nëpërmjet nxitjes së çifteve të reja për të patur më shumë fëmijë, uljes së vdekshmërisë foshnjore, përmirësimit të kujdesit ndaj nënës e fëmijës etj.
- ❖ Vlera e saldos migruese është e rëndësishme të mbahet pozitive (vihet re një përmirësim pozitiv në komunën e Bërzhitës vitet e fundit, për komunën Dajt kjo nuk përbën problem) nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së jetës, investimeve në sektorët e ekonomisë etj.
- ❖ Për të ruajtur ose arritur vlera pozitive të saldos migruese, nevojiten projekte zhvilluese për të rinjtë për punësim, strehim, arsimim, argëtim etj., për të mos lejuar largimin e tyre nga zonat ku banojnë aktualisht.
- ❖ Tendenca e uljes së përqindjes që zë grupmosha 0-14 vjeç, që shfaqet në strukturën moshore të popullsisë në komunën e Bërzhitës, duhet të rritë interesin dhe marrjen e masave nga ana e pushtetit vendor për rritjen e numrit të lindjeve.
- ❖ Hartimi dhe zbatimi i politikave për uljen e numrit të papunësisë janë domosdoshmëri për të dy komunat, pamvarësisht shkallës së lartë të informalitetit të ekonomisë që pengon hartimin e zbatimin me sukses të tyre.
- ❖ Hartimi i planeve rregulluese të territorit për të dy komunat është shumë i rëndësishëm, sidomos në komunën e Dajtit, për t'i dhënë fund ndërtimeve pa leje dhe në vende të papërshtatshme (në tokat bujqësore, apo vende të destinuara për turizëm etj.).
- ❖ E rëndësishme është që të ruhen dhe të kultivohen më tej raportet e mira që ekzistojnë midis banorëve që kanë besime fetare të ndryshme. Kjo ndikon pozitivisht në rritjen e bashkëpunimit midis banorëve e rritjen e mundësive për organizimin e tyre në shoqata për zhvillim etj.
- ❖ Për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe kushteve për zhvillimin e turizmit është i nevojshëm përmirësimi i vazhdueshëm i furnizimit me energji elektrike e ujë të pijshëm, i cili duhet të jetë i vazhdueshëm dhe cilësor.
- ❖ Duhet të ndërhyhet në rregullimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha e ta zeza, duke mënjanuar gropat septike.
- ❖ Vendgrumbullimet e mbeturinave duhet të përhapen në të gjitha vendbanimet për të shtuar pastërtinë e tyre.
- ❖ Zhvillimi i qëndrueshëm i komunave Dajt dhe Bërzhitë duhet të mbështetet dhe nga një infrastrukturë e re arsimore e shëndetësore. Ndërtimi i shkollave fillore në çdo fshat do të evitonte braktisjen e shkollës. Është e

domosdoshme hapja e shkollave të tjera të mesme e sidomos e shkollave profesionale ( që mungojnë në të dy komunat).

- ❖ Për përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës dhe shërbimit shëndetësor nëpërmjet rritjes së numrit të qendrave shëndetësore, i mjekëve dhe infermierëve, shërbimet e specializuara, farmacitë etj.
- ❖ Për të rritur cilësinë e jetës në këto komuna është e rëndësishme të ndërtohen qendra të argëtimit të të rinjve dhe fëmijëve, kinema, organizimi i festivaleve apo panairove etj.

### **C. Për orientimin e ekonomisë drejt sektorëve që sigurojnë njëkohësisht përfitime financiare dhe natyrore duhet që:**

- ❖ Të hartohen e zbatohen plane konkrete për menaxhimin e të ardhurave që synojnë rritjen e kapaciteteve menaxhuese të burimeve financiare, njerëzore e natyrore.
- ❖ Të rriten investimet për zhvillimin e turizmit si drejtimi kryesor por dhe për degët e tjera të ekonomisë si bujqësia, blegtoria, agroindustria, artizanati etj.
- ❖ Të përmirësohet infrastruktura bujqësore për praktikimin në masë të metodave të qëndrueshme të përdorimit të burimeve të tokës e ujit si: qarkullimi ose alternimi i kulturave bujqësore, agropylltaria, plehërimi jeshil, kontrolli biologjik, ruajtja e cilësisë së tokës dhe ujit etj.
- ❖ Të mundësohet krijimi i kooperativave të vogla, shoqatave të bujqve e blegtorëve për të minimizuar efektet negative të fragmentarizimit të tokës pas zbatimit të Ligjit të Tokës nr. 7501. Krijimi i fermave të qëndrueshme dhe të suksesshme do të kishte efekte pozitive dhe në shfrytëzimin racional të mjedisit.
- ❖ Të merren masa për rehabilitimin e veprave të kullim-ujitjes nëpërmjet ringritjes së sistemit të pritave malore, për kufizimin e gërryerjeve e shkarjeve të dheut, për pyllëzimet e mirëmbajtjen e gjelbërimit ekzistues etj.
- ❖ Të investohet në përmirësimin e mekanikës bujqësore me mjete më të fuqishme e më të specializuara, për informimin mbi arritjet teknologjike më të reja, sigurimin e pasuruesve kimikë etj.
- ❖ Ti kushtohet më shumë vëmendje zhvillimit të agroindustrialisë nëpërmjet ngritjes së pikave të grumbullimit e përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale, rritjes së numrit të specialistëve të bujqësisë, përmirësimit të teknologjisë bujqësore, rritjes së investimeve dhe e mbështetjes nga qeveria nëpërmjet granteve të zhvillimit bujqësor e blegtoral në të dy këto komuna pasi potencialet e tyre janë të shumta.
- ❖ Të mundësohet zhvillimi i mëtejshëm i turizmit sipas parimeve të qëndrueshmërisë përsa i përket aspekteve mjedisore, ekonomike dhe social-kulturore dhe arritjes së një ekuilibri të përshtatshëm dhe afatgjatë midis tyre.  
Kjo mund të arrihet:
  - ❑ duke përdorur me racionalitet burimet natyrore;
  - ❑ duke mbështetur dhe ruajtur biodiversitetin;

- ❑ duke respektuar origjinalitetin social-kulturor të komuniteteve vendase;
- ❑ duke siguruar veprimtari ekonomike të suksesshme për periudha afatgjata;
- ❑ duke mundësuar përfitime social-ekonomike për të gjithë banorët nëpërmjet punësimit të përhershëm etj.
- ❖ Të nxiten e të praktikohen llojet e turizmit që janë më pak të dëmshëm për mjedisin.
- ❖ Të merren masa për përmirësimin e transportit dhe të orientohen këto masa jo vetëm nga përfitimi ekonomik që ai siguron, por dhe ndaj pakësimit të ndotjes që ai shkakton në zonat turistike më shumë të vizitueshme.
- ❖ Në mbështetje të turizmit është e rëndësishme të përmirësohen dhe të shtohen mënyrat e telekomunikacionit dhe teknologjisë informuese, nëpërmjet shtrirjes së telefonisë fikse dhe të lëvizshme, internetit etj. në të gjitha vendbanimet e komunave Dajt dhe Bërzhitë.
- ❖ Ti kushtohet më shumë vëmendje infrastrukturës tregtare e shërbimeve sidomos në fshatrat e afërt me zonat turistike të cilët duhet të kenë kushte optimale higjeno-sanitare, shërbim të kulturuar dhe të shpejtë, shumëllojshmëri produktesh dhe shërbimesh etj.
- ❖ Të nxitet më tej zhvillimi i artizanatit, pasi në këto dy komuna ekziston një traditë mjaft e mirë në punimet e artizanatit nëpërmjet:
  - ❑ nxitjes së artizanëve për tu kthyer tek tradita;
  - ❑ rinovimit të veglave të tyre të punës;
  - ❑ organizimit të tyre në shoqata apo bashkësi;
  - ❑ gjetjes së partnerëve tregtare dhe lidhja e kontratave etj.

**D. Për ruajtjen e mjedisit nëpërmjet praktikave bashkëkohore të menazhimit kërkohet që:**

- ❖ Të përcaktohet qartë roli i faktorëve natyror dhe human në transformimin aktual të peizazhit dhe të merren masat e duhura për mënjanimin e faktorëve që kanë ndikuar negativisht në të;
- ❖ Të përlllogariten dëmet e shkaktuara nga veprimtaria e njeriut si prerja e pyjeve, dëmtimet në Parkun Kombëtar të Dajtit, ndërtimet pa leje, shfrytëzimi pa kriter i inerteve dhe guroreve etj.;
- ❖ Të hartohen projekte e strategji të zhvillimit dhe të mbrojtjes së mjedisit. Për këtë kërkohet forcimi i legjislacionit për shfrytëzimin e shtratit të lumenjve, por dhe zbatimi me korrektësi i tij për rastet kur ekziston;
- ❖ Problemet e mjedisit është mirë të trajtohen në nivel rajonal, duke qenë se shtrihen përtej kufijve administrative të komunave në studim. Bashkëpunimi rajonal do të ndihmonte në këmbimin e ideve dhe përvojave më të mira;

## BIBLIOGRAFIA

1. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti Hidrometeorologjik. *Atlas Klimatik I RPS të Shqipërisë*.
2. Axhemi S., *Gjeografia e popullsisë dhe e vendbanimeve*. ALSA. Tiranë 2007.
3. Axhemi S., *Gjeografia sociale*. ALSA. Tiranë 2008.
4. Anamali S., *Arkeologjia dhe bujqësia*. Tiranë 1980.
5. Agolli Sh., *Bujqësia shqiptare në vite*, Tiranë 2000.
6. Bogucian H., Brandani A., Canali M., Giorgi S., Hetoja A., *Agricultural and environmental issues for sustainable development in Albania*. European Communities, 1999.
7. Börjesson K., *Sustainable Tourism - Nature for all*, Uetlands and valuable landscapes for rural development.
8. Cabini Y., Qendra për nxitjen e zhvillimit njerëzor, *Raporti i zhvillimit njerëzor, Shqipëria 2002*, Tiranë 2002.
9. Civici A., “*Rritje ekonomike apo zhvillim i qëndrueshëm?*”. Revista Monitor 14.06.2009
10. Draçi B., Qiriazzi P., Doka Dh. Koka M. “ *Gjeografia e problemeve globale*”. IDEART 2011.
11. Dumani B., *Profil demografik dhe problematika e ndërvarësive ndërmjet popullsisë dhe zhvillimit*. Ekonomia dhe tranzicioni( revistë ekonomike tremujore), Tiranë prill 1995.
12. Faja E., Sukaj J., *Urbanistika dhe ndërtimet në fshat*, Tiranë 1990.
13. GIGO, *Urgent Rehabilitation of schools of Albania*, July 1998.
14. Gjoka F., *Bujqësia e qëndrueshme dhe problem i saj në Shqipëri*. Tiranë 1998
15. Gjoka F., Cara K., *Tokat e Shqipërisë*, Tiranë 2003.
16. Gjoka F., Nasto Th., Koçi M., *Bujqësia e qëndrueshme ...në praktikë*. Tiranë 2006
17. Gorica K., *Marketingu i tregut turistik shqiptar, domosdoshmëri ekonomike*. Studim monografik, Tiranë 2003.
18. Gruda Gj., *Gjeomorfologjia*, SHBLU, Tiranë 2003.
19. Gruda Xh., Hoxha A., Veçotitë morfologjike dhe rreziqet natyrore të Parkut Kombëtar të Dajtit. Studime Albanologjike, Tiranë 2009.
20. INSTAT, *Disa tregues social sipas qarqeve*, Tiranë 1998
21. INSTAT, *Identifikimi i zonave më të prekura nga emigracioni dhe migracioni i kthimit në Shqipëri: Profili i migrantëve të kthyer*, Tiranë 2008.
22. INSTAT, *Niveli i jetesës dhe pabarazia në Shqipëri*, Tiranë 2004.
23. INSTAT, *Njerëzit dhe puna në Shqipëri*, Tiranë 2004.
24. INSTAT, *Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave 2001*.
25. INSTAT, *Shqipëria në Shifra*, Tiranë 2000.
26. INSTAT, *Shqipëria, tendencat e varfërisë dhe pabarazia 2002-2003*, Tiranë 2006.
27. INSTAT, *Shqipëria: Trendi i varfërisë 2002-2005-2008*, Tiranë 2009.
28. INSTAT, *Tregu i punës*, Tiranë 2003.
29. INSTAT, *Vjetari i Treguesve Socialë*, Tiranë 1999.

30. INSTAT. *Censusi i popullsisë dhe i banesave* 2011.
31. Instituti Hidrometeorologjik, *Buletini i reshjeve*, Tiranë 1989.
32. Instituti Hidrometeorologjik, *Buletini i temperaturës së ajrit*, Tiranë 1989.
33. Instituti Hidrometeorologjik, *Diellizimi në Shqipëri*, Tiranë 1985.
34. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. *Zhvillimi Rural si një Qasje Ndër-Sektoriale dhe Implikimet për Shqipërinë*, qershor 2010
35. International Development Association (IDA). *Plani i Menaxhimit i Parkut Kombëtar të Dajtit*, Maj 2004
36. Kosovrasti A., *Roli i turizmit në zhvillimin e komunës Dajt*. Studime Albanologjike IV. Tiranë 2011.
37. Laçi S., *Gjeografia rurale*, PROGRES, Tiranë 2005
38. Laçi S., Xhafa S., *Klasifikimi dhe drejtimet e zhvillimit të hapësirave rurale në Shqipëri*. Kërkime gjeografike, Prishtinë 2008.
39. Mazari N., ALCDF., *Koncepti i zhvillimit rajonal për qarkun e Tiranës. Orientimet strategjike për zhvillimin rajonal 2012-2017*. Tiranë 2012.
40. Mazniku L., *Sociologji Rurale*, Tiranë 2004
41. Meçaj N., *Gjeografi e aplikuar*. TOENA. Tiranë 2004.
42. METE, *Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2007-2013*, Tiranë 2007.
43. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. *Strategjia e bujqësisë dhe ushqimit në kuadrin e strategjisë kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe social*. Tiranë 2003.
44. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. *Strategjia Sektoriale e bujqësisë dhe ushqimit 2007-2013. Draft përfundimtar*. Tiranë 2007.
45. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. *Plani Kombëtar i Mjedisit 2001*. Tiranë 2001.
46. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave. *Strategjia ndërsektoriale e mjedisit. (Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim)*. Tiranë 2007.
47. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe telekomunikacionit, *Mbi dokumentin e Politikave të Planifikimit Hapësinor në Shqipëri*, Tiranë 2008.
48. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, *Strategjia e zhvillimit të transporteve dhe telekomunikacionit*, Tiranë 2001.
49. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, *Almanak i bashkive dhe komunave të Shqipërisë*, Tiranë 2001.
50. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, *Albania dhe last secret*, Tiranë 2004.
51. Müller R., “Ndryshimi i konceptit të zhvillimit”. Draçi B., Qiriazi P., Doka Dh. Koka M. “Gjeografia e problemeve globale”. IDEART 2011
52. *Plani i zhvillimit të komunës Bërzhitë*. Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
53. *Plani i zhvillimit të turizmit për komunat Petrelë, Bërzhitë, Baldushk*. Fondacioni ALCDF.
54. Pollo S., *Kultura popullore si shprehje e veçorive etnike dhe e formimit të kombësisë shqiptare*. Konferenca Kombëtare e studimeve etnografike. Qershor 1976.
55. Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor. *Shqipëria dhe objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit*. Tiranë 2002.

56. Qendra Rajonale e Mjedisit-REC. *Direktiva europiane për vlerësimin mjedisor-kuadri ligjor europian*. Tiranë 2007.
57. Qendra Rajonale e Mjedisit-REC. *Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm. Dokumente ndërkombëtare*. Tiranë 2007
58. Qendra Rajonale e Mjedisit-REC. *Situata aktuale e emigracionit shqiptar*. Tiranë 2005.
59. Qendra Shqiptare për Migracionin. *Situata aktuale e emigracionit shqiptar*, Tiranë 2005.
60. Qiriazi P., Sala S., Cara G., *Monumentet e natyrës të qarkut të Tiranës*, Tiranë 2004.
61. Qiriazi P., Sala S., *Monumentet e natyrës të Shqipërisë*. Tiranë 2006.
62. Qiriazi P., *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Tiranë 2001
63. *Raport mbi procesin e privatizimit në Shqipëri 1991-1997*, Tiranë 1998.
64. *Raporti i zhvillimit njerëzor, sfidat e qeverisjes vendore dhe zhvillimit rajonal*, Tiranë 2002.
65. Riza E., *Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri*, Tiranë 1997.
66. Riza E., *Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri*, Tiranë 1997.
67. Sachs W., *Pas nesh e ardhmja. Konflikti global mbi drejtësinë dhe ekologjinë*. Frankfurt/Main 2002
68. *Statistika 2011*, Zyra e tatim-taksave në komunën Bërzhitë.
69. *Statistika 2011*, Zyra e tatim-taksave në komunën Dajt.
70. *Strategjia e zhvillimit rural për Shqipërinë*, Tiranë 2002.
71. *Strategjia kombëtare e zhvillimit ekonomik dhe social*, Tiranë 2004.
72. *Strategjia kombëtare e zhvillimit ekonomiko-social, 2004-2007*, Tiranë 2004.
73. *Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani kombëtar i veprimit për migracionin*, Tiranë 2005
74. *Strategjia Ndër-Sektoriale e Zhvillimit Rural, (SKZHR), 2007-2013*.
75. *Strategjia për rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisëm*, Tiranë 2001.
76. *Strategjia për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave në Shqipëri*. Tiranë 2000.
77. Sulovari H., Gjeta Z., Ibrahimi A., *Identifikimi i burimeve njerëzore, material dhe aktiviteti ekonomik*. Komuna Dajt. Rrethi Tiranë. Tiranë 2005.
78. Shundi A., *Bujqësia dhe veprimi agronomik në trojet shqiptare*. Tiranë 2001
79. Telo I., Daci L., *Lidhja midis shtimit të popullsisë dhe zhvillimit ekonomik, Konferenca Kombëtare mbi zhvillimin dhe popullsinë*, Tiranë 1995.
80. UNDP, *Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Shqipëri*, 1998.
81. UNDP, *Vlerësimi mjedisor në Shqipëri pas konfliktit*, Tiranë 2000.
82. Vejsiu Y., *Vështrim mbi harmonizimin e potencialeve njerëzore me zhvillimet ekonomike. Studimet e popullsisë*, Buletin 1, Tiranë 1994.
83. World Bank, *Poverty in Albania, a qualitative assessment*, Tiranë 2002.
84. World Bank, *Albania Decentralisation in Transition*, Volume II Summary Report and Matrix of Issues and Options, 2004.
85. World Bank, *Albania growing out of poverty*, Tiranë 1997.
86. World Bank, *Albania poverty assessment*, Tiranë 2003.
87. World Bank, *Rural Development Strategy*, 2002.
88. Xhindi N., *Drejt zhvillimit të qëndrueshëm Rio+20*. Gazeta Panorama, 20 qershor 2012.

## Shkurtesë

Që nga përdorimi për herë të parë në raportin e Brundtland-it, në vitin 1987, termi zhvillim i qëndrueshëm, është bërë kryefjala e dinamikave dhe strategjive të zhvillimit në mbarë botën. Orientimi drejt këtij modeli zhvillimi përbën një sfidë për politikëbërësit në nivel vendor e qendror në Shqipëri, si dhe për studiuesit e fushave të ndryshme.

Studimi krahasues i komunave Dajt dhe Bërzhitë përbën një përpjekje për të evidentuar tërësinë e faktorëve që kanë ndikuar në drejtimet, ritmet dhe prirjet e zhvillimit demografik, social dhe ekonomik të qëndrueshëm të tyre. Shtrirja në një hapësirë me kushte natyrore të përshtatshme dhe pranë kryeqyteti të vendit, që ka nivelin më të lartë të zhvillimit social-ekonomik, ka ndikuar që dy komunat të jenë shumë të preferuara për banim dhe veprimtari ekonomike të shumëllojshme.

Ato dallohen për pasuri natyrore si: rezerva të qymyrgurit, boksive, inerteve; reliev që favorizon zhvillimin e blegtorisë, bujqësisë, pylltarisë, turizmit; klimë të shëndetshme, që favorizon zhvillimin e florës dhe zhvillimin e ullirit, vreshtave dhe frutikuturës; pasuri ujore të konsiderueshme dhe cilësore; toka relativisht pjellore, florë dhe faunë të larmishme.

Potenciali humane të komunat janë të konsiderueshme, në strukturim e evolucion të vazhdueshëm, duke premtuar të jenë faktorë nxitës për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Peizazhet piktoreske, ajri i pastër dhe qetësia, sitet e shumta natyrore dhe kulturore, që shtrihen në territoret e komunave, i bëjnë ato atraktive për turistët vendas dhe të huaj. Turizmi do të jetë promotori i zhvillimit ekonomik e social të këtyre komunave në të ardhmen. Ndërtimi i autostradës Tiranë-Elbasan, si dhe përfundimi i Rrugës së Arbërit, do të krijojnë mundësi të reja komunikimi dhe zhvillimi të gjithanshëm.

Analizat e treguesve ekonomikë, socialë e mjedisorë zbulojnë se komunat kanë hyrë në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm, por ajo e Dajtit paraqitet më solide dhe më e sigurt.

**Fjalët kyçe:** *zhvillim i qëndrueshëm, pozitë gjeografike, zhvillim demografik, ekonomi e qëndrueshme, peizazh, mjedis.*

## Abstract

Since it was used for the first time in the Brundtland report in 1987, the term sustainable development has become the subject of the development dynamics and strategies all over the world. The orientation toward this developmental model represents a challenge for the Albania's policy-makers, in local and central level, and for the researchers of several domains.

The comparative study of Dajt and Bërzhitë municipality represents an effort to identify the impact factors, the directions, the rhythms and the trends of their sustainable demographic, social and economic development. Thanks to the location in an area of favorable natural conditions and close to the capital, characterized by the highest level of social-economic development, these two communes are preferable for living and exerting multiple economic activities.

They are distinguished for their natural resources such as: reserves of coal, bauxites, inert materials; a relief favoring the development of farming, agriculture, forestry, tourism; a healthy climate favoring the natural vegetation as well as oleiculture, viticulture and arboriculture; considerable and qualitative water reserves; relatively fertile soil; rich flora and fauna.

The human potentials are considerable, in continuous structuring and evolution, promising to be a stimulating factor to their sustainable development. The picturesque landscapes, the fresh air and quietness and the natural and cultural sites situated in the municipalities' territory makes them particularly attractive to domestic and foreign tourists. The tourism will be the promoter of municipalities' socio-economic development. The construction of Tiranë-Elbasan highroad and the achievement of Arbëri Road will boost the chances for communication and overall development.

The analysis of economic, social and environmental indicators reveals that the municipalities have entered the path of sustainable development, but the one of Dajti results more solid and certain.

**Key words:** *sustainable development, geographical position, demographic development, sustainable economy, landscape, environment.*

